



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 8 QERSHOR 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 05.06.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores)*
2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores)*
3. Interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi, kërkuar nga një grup deputetësh *(neni 80 i Kushtetutës, neni 97, pika 1 e Rregullores së Kuvendit)*
4. Raporti i veprimtarisë vjetore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022. *(neni 7, pika 2 e ligjit nr. 53/14, datë 22.05.2014, "Për sigurimin e depozitave", i*

*ndryshuar; neni 103 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë dhe vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr.134/2018 "Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik", shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)*

Paraqitja e raportit nga titullari i institucionit, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë).*

5. Raport i veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2022 *(neni 31 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga Komisioneri, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën

Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

6. Raporti i veprimtarisë vjetore të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri gjatë vitit 2022 *(neni 11, pika 1/g e ligjit nr. 10 242, datë 25.02.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)*.

Paraqitja e raportit nga drejtori ekzekutiv, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

7. Raporti i veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2022 *(neni 26 i ligjit nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)*.

Paraqitja e raportit nga Komisioneri, jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

Koha e votimit të projektrezolutës

8. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat" *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, dhe neneve 55, 82 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

9. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 "Për Policinë e Burgjeve" *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

10. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

11. Projektvendimi "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Kuvendit nr.

43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës” (në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 2 e ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar””, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës)

12. Për një ndryshim në vendimin nr. 67/2021 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit” (në mbështetje të neneve 78, pika 1 të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1 e Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

13. Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar” (në mbështetje të neneve 78, pika 1 e Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1 e Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

14. Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar” (në mbështetje të nenit 78, pika 1 e Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1 e Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

15. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit, çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës, nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)

#### **Lindita Nikolla – Mirëdita!**

Hapim seancën plenare.

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të ditur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Fillojmë më çështjet, sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 5 qershor të vitit 2023. Procesverbalin e keni marrë në rrugë elektronike. A ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se në Kuvend janë depozituar dy akte nga Këshilli i Ministrave dhe 4 projektligje të depozituara nga deputetët. Titujt e çështjeve të depozituara i gjeni në sistemin në sallë, ndërsa materialet i gjeni në sistemin “e-Parlament” dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila miratoi në mirëkuptim kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 9 – 30 qershor 2023.

Ju njoftoj se një grup deputetësh, në bazë të nenit 103, pika 8, të Rregullores, kanë paraqitur kërkesën për diskutime për pikat 4, 5, 6 dhe 7 të rendit të ditës të seancës së sotme, konkretisht, të raportimeve të institucioneve të pavarura.

Konferenca e Kryetarëve, në zbatim të nenit 103, pika 8, të Rregullores, vendosi që koha e debatit për raportet do të jetë 1 orë e 30 minuta për çdo raport. Në bazë të nenit 48, pika 3, koha prej 90 minutash do të ndahet në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve parlamentare dhe deputetëve jashtë grupeve parlamentare. Në këtë mënyrë, Grupi Parlamentar i PS-së do të ketë 45 minuta kohë, Grupi Parlamentar i PD-së 20 minuta, Grupi Parlamentar Aleanca për Ndryshim 5 minuta, Grupi Parlamentar Demokraci dhe Integrim 5 minuta, Partia e Lirisë 5 minuta, Partia Socialdemokrate 5 minuta dhe deputetët jashtë grupeve parlamentare 10 minuta në total.

Nga Grupi Parlamentar i PD-së janë depozituar propozime për anëtarë në komisionet e përhershme parlamentare.

Viojmë me interpelancën urgjente me ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi, e kërkuar nga një grup deputetësh. Interpelanca kërkohet duke u bazuar në nenin 80 të Kushtetutës dhe në nenin 97 të Rregullores së Kuvendit dhe ka për objekt çështjen si vijon: dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me vendimin për mbylljen e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe bashkë me të, edhe të instituteve pjesë përbërëse të saj.

Fillojmë duke respektuar minutazhin e përcaktuar në nenin 96 të Rregullores. Interpelancën do ta prezantojë zonja Ina Zhupa.

Keni të drejtë ta parashtroni interpelancën deri në 7 minuta kohë.

Fjala për ju, zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Kur e kam kërkuar interpelancën, mendoja se ende do të ishte një projekt-VKM për mbylljen e Akademisë së Studimeve Albanologjike, por faktikisht sot kemi një VKM të miratuar me shumë shpejtësi, edhe në mungesë të Kryeministrit, vetëm se nuk priste mbyllja e albanologjisë.

*(Zonja Ina Zhupa tregon disa foto.)*

Në këto foto keni ministren e Arsimit, zonjën Evis Kushi, në takim me senatin e Akademisë së Studimeve Albanologjike. Mund t'i gjeni në Facebook-un e saj lavdërimet më të mëdha për Akademinë e Studimeve Albanologjike, mund të gjeni vlerësimet për punën dhe statusin e veçantë që duhej të kishte Akademia e Studimeve Albanologjike dhe vijueshmërinë që duhej të kishte, po sipas ministres Kushi.

Në këtë foto keni ish-ministrin e fundit të diktaturës, në vitin 1987 (viti im i lindjes), zotin Skënder Gjinushi, i cili në vitin 1990 priste studentët. Ndryshe nga ministrja Kushi, e cila e lavdëronte Akademinë e Studimeve Albanologjike, Gjinushi nuk e fshehu kurrë se donte ta mbyllte atë dhe ta kthente në një aneks dhe në vasal të Akademisë së Shkencave.

Në vitin 2021, 2 vjet më parë, Gjinushi do të shprehte atë që, në fakt, do të ndodhte.

*(Zonja Ina Zhupa tregon një video, në të cilën flet zoti Skënder Gjinushi: "...do ti, s' do ti; kjo nuk ka të bëjë me dëshirat personale, ky është debat konceptual dhe nuk e merr vendimin senati. Ata kanë ikur nga Akademia e Shkencave me vendim qeverie dhe do të vijnë tek Akademia me vendim qeverie".)*

Pra, na thotë që reformat në këtë vend i bën Skënder Gjinushi. Me sa duket, tani, vite më pas, paskemi përsëri ministër Arsimit Skënder Gjinushin, se del fjala e tij dhe jo jua. Ai thotë: "Ashtu siç ikën me VKM, ashtu do të vijnë me VKM". Dhe çfarë bëtë ju? Bëtë një VKM për t'i plotësuar dëshirat politike Skënder Gjinushit; bëtë një VKM, duke shkelur ligjin, për ta shkrirë dhe për ta mbyllur Akademinë e Studimeve Albanologjike, si dhe për ta kthyer atë në vasal të Akademisë së Shkencave.

Është njësoj sikur Akademia e Sigurisë të çohet një ditë dhe të thotë: "Unë dua të shkrihet Akademia e Arteve, se kam një projekt për jetë kulturore në burgje dhe të bëhet drejtori brenda Akademisë së Sigurisë dhe Ministria e Arsimit, meqë ka projektin për jetë artistike në burgje, ta bëjë këtë shkrirje".

Ky ishte justifikimi që kishte Skënder Gjinushi, i cili, meqë kishte projektet e fjalorit, të enciklopedisë e historisë dhe i duheshin vasalët për të punuar në këto projekte, duhej shkrirë Akademia e Studimeve Albanologjike. Justifikimi tjetër ishte që "aty lindën dhe nga aty mund të kthehen". E para, nuk është e vërtetë, se albanologjia ka lindur shumë më herët se Akademia e Shkencave, e cila është ngritur në vitin 1972 nga një vendim i ish-Komitetit Qendror. Albanologjia ekzistonte më herët, por, edhe nëse do të ishte e vërtetë, ju e dini shumë mirë që "lindja" dhe "vdekja" nuk janë procese të njëjta dhe nuk kërkojnë të njëjtin angazhim. Për metaforë: ne lindim nga barku i një nëne, por, pasi fitojmë autonominë dhe lirinë, nuk mund të kthehemi përsëri në barkun e nënës. Kaq e thjeshtë është! Krijimi i një institucioni, nuk është njësoj si mbyllja apo shkatërrimi i tij me një VKM, e cila nis duke cituar ligjin për Akademinë

e Shkencave, ligj për të cilin ju nuk keni kompetencë dhe nuk është në varësi legjislative të ligjeve që ju keni si referencë, ndërkohë që Akademia e Studimeve Albanologjike është e njohur nga ministria juaj që në vitin 2018, me urdhrin nr. 296 të datës 29.05.2018, të lëshuar nga ministrja asokohe, zonja Lindita Nikolla, ku njihet statuti i Akademisë së Studimeve Albanologjike. Pse e them këtë? Sepse në po të njëjtën shkresë nga ministria, në atë kohë ka qenë Erzen Tola drejtor Juridik, të cilin sot e keni sekretar të Përgjithshëm, datë 07.10.2022, kur ishit ju, drejtuar sekretarit tuaj të Përgjithshëm Alqi Kushi, thuhet: “Statusi i Akademisë së Studimeve Albanologjike është sipas statutit të vet, që është një institucion publik i arsimit të lartë dhe shkencës, i cili merret me punë kërkimore e shkencore, me formimin e thelluar akademik universitar dhe përfshin në sistemin e vet institute shkencore, grupe kërkimore, me qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor”. Kjo ishte Akademia e Studimeve Albanologjike, e thelluar për historinë, për gjuhësinë, për letërsinë dhe për antropologjinë e shtetit shqiptar! Dhe ju bëni një VKM, ku e prishni totalisht Akademinë e Studimeve Albanologjike, por, mbi të gjitha, shkëlmi Kushtetutën, shkëlmi ligjet, shkëlmi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sepse ju shkëlmi autonominë dhe lirinë akademike. Ju shkrini një institucion që i raporton Kuvendit, një institucion që buxhetin ia miraton Kuvendi, një institucion që rektorin e ka të dekretuar nga Presidenti, një institucion që është pjesë e Konferencës së Rektorëve dhe e fusni brenda Akademisë së Shkencave, duke i shkëlur autonominë dhe lirinë akademike, të mbrojtura nga Kushtetuta. 15 vjet në atë Akademi ka ndryshuar gjenerata e studiuesve, kanë ndryshuar stema, metodologjia, tezat, projektet që ata janë duke punuar sot. Si e zgjidhni ju? Duke i bërë vasalë të Skënder Gjinushit?

Kjo ishte për pjesën e parë.

Meqë koha mbaroi, nuk dua t’ju marr nga koha juaj, ndaj pres argumentet tuaja që t’ju kundërpërgjigjem.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Ministre Kushi, keni të drejtën e fjalës deri në 20 minuta që të jepni argumentet tuaja.

**Evis Kushi** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja Zhupa,

Dhe ju, kolegë, që keni bërë kërkesën për interpelancë,

Në fakt, interpelanca daton një ditë para mbledhjes së Këshillit të Ministrave, kur ne miratuam VKM-në, dhe unë pas mbledhjes kam bërë një dalje publike, ku i kam prezantuar në mënyrë të hollësishme të gjitha argumentet përse është marrë ky vendim. Megjithatë, le ta shfrytëzojmë edhe sot këtë interpelancë dhe, nëse do të ketë ende ndonjë paqartësi, si në opinionin publik, ashtu dhe te studiuesit, tek albanologët, patjetër që do të jem e gatshme t’ju sqaroj të gjitha.

Dua ta nis me një thirrje për ju, të nderuar kolegë, veçanërisht, për ju, zonja Zhupa, që shpeshherë jeni drejtuar me fyerje për Akademinë e Shkencave, madje në datën 5 qershor ju kam ndjekur personalisht në medie, ku keni thënë: “Akademia e Shkenca është akademia e ish-politikanëve të dalë në pension, të mbledhur nën tutelën e Skënder Gjinushit”. Nuk e di nëse i qëndroni akoma kësaj, por, nëse i qëndroni kjo është një fyerje për Ismail Kadarenë, për Luan Omarin, për Bardhyl Golemin, për Besim Elezin, për Muzafer Korkutin, për Ethem Likajn, për Emin Rizajn, për Apollon Baçen, për Fatos Kongolin, për Arben Merkoçin, për Xhevahir Spahiun, për Rexhep Mejdanim, për Pëllumb Xhufin e për plot të tjerë. Madje kemi edhe anëtarë të jashtëm nderi, si: Ermonela Jaho, Eno Koço, Fjoralba Cakoni, Bardhyl Demiraj e plot të tjerë, të cilëve u kërkoj ndjesë që nuk po ua përmend emrin! Këta qenkan mbledhur nën tutelën e Skënder Gjinushit, sipas jush?! Këta akademikë të nderuar i bëjnë nder jo vetëm Akademisë së Shkencave, por të gjithë Shqipërisë. Si mundet të fyhet një institucion i tërë nga urrejtja personale, nga inati që keni me një individ, profesor Skënder Gjinushin, i cili

është zgjedhur me votat e këtyre akademikëve që përmenda?! Asambleja voton kryetarin e Akademisë së Shkencave, madje edhe pretendimin tuaj se nuk e ka dekretuar Presidenti, ligji e ka sqaruar më së miri: nëse nuk e dekreton Presidenti, i kthehet përsëri Asamblesë, dhe Asambleja merr vendimin, njësoj si ligjet në parlament. Pra, kryetari i Akademisë së Shkencave është plotësisht legjitim në detyrën e tij.

Akademia e Shkencave është institucioni që na bën krenarë. Deklarata juaj, të cilën e pohoni nga vendi se i qëndroni, se ish-politikanë të dalë në pension qenkan mbledhur nën tutelën e Skënder Gjinushit, është një fyerje e rëndë dhe unë nuk do ta pranoja asnjëherë!

Le t'u rikthehem argumenteve.

E deklarova që ditën kur morëm këtë vendim se nuk bëhet fjalë as për zhdukje e as për shkrirje, siç thoni ju. Ju thoni se po zhduken 100 studiues, por se ku po zhduken studiuesit nuk e di! Vendimi parashikon bashkim, parashikon riorganizim të Akademisë së Studimeve Albanologjike, për të cilën unë jam konsistente dhe kam vlerësimet maksimale edhe për studiuesit që janë pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike, shumica e të cilëve janë anëtarë të Akademisë së Shkencave.

Ju lutem, se këtë e kam për të gjithë ata që nuk e dinë, nga 55 anëtarë të Akademisë së Shkencave gati gjysma e tyre janë punonjës aktualë, disa edhe joaktualë, të Akademisë së Studimeve Albanologjike. Pra, nuk shkon ai paralelizmi kur thua: "...sikur ta marrim Akademinë e Arteve dhe ta çojmë te policia". Po flasim për të njëjtën gjë.

Dua ta nis që nga lindja e Akademisë së Studimeve Albanologjike. Institutet kanë qenë gjithmonë pjesë e Akademisë së Shkencave deri në vitin 2007. Në vitin 2007 u mor një vendim, që institutet të shkëputeshin dhe të krijohet Akademia (fillimisht ishte Qendra, pastaj u bë Akademia), por në mënyrë të vazhdueshme i është kërkuar Akademisë së Studimeve Albanologjike që të riorganizohet në përputhje me ligjin.

Tani ju dëgjoj teksa thoni "me një të rënë të lapsit e mbyllni". Po si "me një të rënë të lapsit"? Ja ku i kam shkresat! Ju i merrni fotografitë, por merrini edhe shkresat dhe do të vini re që me shkresën zyrtare të datës 22.06.2021 i jam drejtuar personalisht Akademisë së Studimeve Albanologjike që të riorganizohet në përputhje me ligjin. Por asnjëherë, si me shkresa zyrtare, ashtu dhe me takime (ato që ju i prezantoni me anë të fotove), ata nuk kanë pranuar të riorganizohen sipas ligjit.

Ne jemi institucion që bëjmë ligje dhe nuk shkon të justifikojmë shkeljen e ligjit.

Sot Akademia e Studimeve Albanologjike është institucion i arsimit të lartë dhe në ligj është e shprehur në mënyrë eksplicite që një akademi duhet të ketë një fakultet, por nuk e ka, nuk ka mësimdhënie, nuk është akredituar dhe nuk ka studentë. Këto janë bazat e një institucioni të arsimit të lartë. Si mund të ketë një institucion të arsimit të lartë ku prej 8 vjetësh nuk është regjistruar asnjë student?! Keni një dokument që të ma faktoni që nuk është e vërtetë? Dua të më thuash se përse i kundërshton të gjitha deklaratat e mia!

Prej 8 vjetësh nuk ka asnjë student. Në ligj përsëri thuhet qartë që, nëse për dy vjet nuk ka një student të regjistruar, institucioni duhet të mbyllet, dhe është vetë institucioni ai që aplikon për mbylljen e programit të studimit. Nuk e kanë bërë. Kanë doktorantë prej vitesh, që nuk po i çojnë dot drejt kurorëzimit me sukses. Ju kam dëgjuar të thoni: "Po kështu është doktoratura; zgjat shumë", ndërkohë që ligji e ka të qartë kohën se sa duhet të zgjasë doktoratura. Kanë 12 vjet me doktoraturën. Ne nuk po i hedhim në rrugë, por po garantojmë transferimin e tyre në institucione të tjera të arsimit të lartë, në universitete që kanë programe të ngjashme. E kemi garantuar ne dhe e kemi të shkruar në VKM. VKM-ja i parashikon të gjitha, edhe studiuesit, edhe institutet, edhe pasuritë, edhe asetet; gjithçka transferohet, asgjë nuk shkrihet, asgjë nuk hidhet në erë. Ju po bëni sikur ne po i zhdukim! Si po i zhdukim ne?! E thoni shpesh që po zhduken 100 studiues,

përkundrazi, këta 100 studiues do të ngrihen në një nivel të ri, se ky është qëllimi i VKM-së, pra të riorganizohet, të vijë në përputhje me ligjin, sepse është totalisht në shkelje të ligjit dhe, përveç kësaj, ta ngremë në një nivel të ri. Akademia e Shkencave është institucioni majë i shkencës në vend, përfshirë dhe albanologjinë, dhe është nder për ne që t'i kemi të gjithë studiuesit, të gjithë akademikët bashkë për të vijuar me projektet e mëdha.

Ju e dini shumë mirë që Akademia e Shkencave ka projektin e madh të albanologjisë, “Enciklopedia shqiptare”, në bashkëpunim me Kosovën; është projekti më i madh ndonjëherë i albanologjisë, që drejtohet nga dy akademitë e shkencave, nga academia shqiptare dhe academia e Kosovës. Pra, të gjitha argumentet që thoni, nuk qëndrojnë. Çfarë interesi kemi ne të zhdukim albanologjinë?! “Vendim antishqiptar!” Të gjitha deklaratat tuaja janë vetëm deklaratat publike, por asnjëra nuk bazohet në një shkresë, në një dokument zyrtar apo në një argument ligjor.

Ne jemi institucione që bëjmë ligjet këtu, dhe ne duhet të jemi të parët... Si e interpretoni ju që ata nuk kanë një akademi? Merrni ligjin! Në ligj thuhet “një akademi”, por nuk e kanë; thuhet “studentët”, por nuk i kanë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, prit, se të kam dëgjuar të thuash që ata kanë kërkuar të hapin programe, por i ka penguar ministria. Kush e hap programin? E hap njësia bazë, duhet ta hapë departamenti, duhet ta hapë fakulteti, por ata nuk kanë. Si do ta hapin? Në cilin ligj thuhet që e hap një institut?

Pra, kanë refuzuar të përshtaten me ligjin dhe pse u kemi dhënë shumë kohë, i kemi pritur dhe në janar të këtij viti, se Ministria e Arsimit e ka detyrim ligjor të bëjë kontrollin e ligjshmërisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Gjatë kontrollit që u bë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, u konstatuan të gjitha këto që thashë, por dhe shumë të tjera, pra që nga mënyra se si është struktura, ka shkelje ligjore, por edhe se si funksionon.

E kam përmendur dhe mund t’juja përsëris edhe një herë, edhe nga ana funksionale që nuk kanë as audit, as regjistra, as dokumentacion, madje as se si e kanë punësuar personelin administrativ. Pra, raporti që ka bërë grupi i punës është i plotë dhe i ka të renditura një më një të gjitha shkeljet që janë bërë në këtë institucion.

Për shkak të paligjshmërisë, për shkak të këtyre shkeljeve dhe për ta ngritur albanologjinë në nivelin që duam të gjithë, u mor vendimi i Këshillit të Ministrave për ta bashkuar Akademinë e Studimeve Albanologjike me Akademinë e Shkencave.

Ju thoni: “I keni bërë nder Gjinushit”, dhe e thoni vazhdimisht, a thua se Gjinushi do ta marrë akademinë dhe do ta çojë në shtëpi! Profesor Gjinushi është i zgjedhur, e kanë zgjedhur pikërisht këta të Akademisë së Studimeve Albanologjike, këta bashkëpunojnë dhe janë pjesë e projekteve. “Është shkelur ligji”, thoni ju, por se cili ligj e se cili nen, nuk e thoni asnjëherë; “është shkelur liria akademike”, thoni gjithashtu, ose “liria dhe autonomia”, por liria akademike është kur je legjitim, jo kur nuk je legjitim, pra të bësh ti ç’ të duash e të thuash: “Unë kam liri akademike, mos hajde ti!”, “Unë kam autonomi, mos hajde!”. Autonomi do të thotë të respektosh ligjet një më një. Pra, nuk jemi në kushtet kur një institucion e merr vetë vendimin në senatin akademik për të bërë ndryshime në statut, por jemi në kushtet kur janë në paligjshmëri. Pjesa më e madhe e punonjësve të Akademisë së Studimeve Albanologjike janë dakord me vendimin, sepse aktualisht janë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

I kam edhe deklaratat.

Senati ka 10 veta, por në Akademi punojnë shumë njerëz dhe pjesa më e madhe janë pro këtij vendimi, sepse janë bashkëpunëtorë të Akademisë së Shkencave në projekte shumë të rëndësishme, si projekti i enciklopedisë apo i fjalorit të gjuhës shqipe.

Tani ju më akuzoni përse jam takuar dhe nxirrni një foto ku kam takuar senatin, a thua se është shkelje ligji dhe është një takim i

paligjshëm! Nga njëra anë, thoshit: “I keni bërë të pakonsultuara, nuk takoheni”, nga ana tjetër, thoni: “Ja ku i keni takuar”. Unë kam vlerësimin maksimal për ata studiues, e kam thënë edhe ditën kur u mor vendimi dhe bëra deklaratën publike, ata janë studiues të nderuar, por institucionalisht kanë dështuar ta kthejnë institucionin në rrugën ligjore. Ai institucion, ashtu siç është i organizuar dhe siç ata kanë refuzuar të ndryshojnë, pra duan të qëndrojnë ashtu, nuk është i mbështetur në asnjë ligj, nuk ka hapësirë ligjore dhe, kur ne u bëjmë kërkesë që të vijnë dhe të bëjmë ndryshime në përputhje me ligjin, ata thonë: “Jo, siç keni bërë ligj për Akademinë e Shkencave, bëni dhe një ligj për Akademinë e Studimeve Albanologjike!”. Nuk bëhet ligji sipas institucioneve, por institucionet bëhen sipas ligjit.

Unë mund të rendis edhe shumë argumente të tjera, por e rëndësishme është që atë që thashë që në fillim ta kemi kryefjalë, të tregojmë respekt për akademikët e nderuar dhe për institucionet. Vendimi nuk është bërë asnjëherë me një të rënë të lapsit, por është konsultuar, madje ka kohë që punohet për të, sepse edhe grupi i kontrollit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka punuar me muaj të tërë në Akademinë e Studimeve Albanologjike për të dalë në gjetje dhe konkluzione, të cilat, gjithashtu, janë paraqitur, janë marrë edhe observacionet dhe, në fund fare, është marrë vendimi final.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Zonja Zhupa, keni të drejtën e fjalës deri në 15 minuta.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, Kryetare!

Zonja Ministre, ndodhi ashtu siç e prisja: ishin të njëjtat argumente, përgjigjet e të cilave do t’i merrni tani, sipas ligjit. Nuk doja t’jua thosha paraprakisht, sepse doja të shikoja nëse do të vazhdonit të thoshit të pavërteta edhe nga salla e parlamentit, apo do të ndryshonit.

Zonja Ministre, ju pyetët se ku e ka të shkruar ligji për arsimin e lartë që mund të ekzistojë pa fakultete. Po ju sqaroj: neni 22 i ligjit për arsimin e lartë i kategorizon në të njëjtën vijë njësia bazë

si fakultetet, si institutet dhe kolegjet, pra u vë një *slash*, për të thënë ose këtë, ose këtë, ose atë; janë të baraslarguara, ndërsa njësitë bazë janë departamentet, organizimin e të cilave e ka ASA-ja. ASA-ja sot është e ndërtuar në departamente. Ja ku është ligji “Për arsimin e lartë”, seksioni II, neni 22, ku njësitë kryesore janë fakultetet/institutet/kolegjet, kurse njësia bazë janë departamentet dhe qendrat kërkimore.

Po ashtu, zonja Ministre, që ta kuptoni edhe ligjin për arsimin e lartë, në nenin 23 të tij, ku flitet për fakultetin, në kuptimin e dhënë, nuk kërkohet që kjo njësi të ketë domosdoshmëri programe në të tria ciklet e studimit, por jepet vetëm si mundësi. Në nenin 23, thuhet: “Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme...”, pra nuk thuhet “në të tria ciklet”, por në cikle të ndryshme. ASA-ja ofron programe në dy cikle të ndryshme, në atë master dhe bachelor, siç e ka edhe statuti, që tashmë ju ia keni miratuar me urdhr ministri dhe e keni bërë ligjor. Nëse ju mendonit që statuti i ASA-së ishte në kundërshtim me ligjin, atëherë nuk duhet t’i kishit miratuar, nuk duhet të kishit lëshuar dy shkresa nga ministria juaj në periudha të ndryshme, që e njihnit brenda ligjit. Nëse keni gabuar ju, çfarë faji ka ASA-ja?! Mbylluni ju si Ministri e Arsimit, meqë keni gabuar, dhe për të forcuar punën e Ministrisë së Arsimit ta kthejmë në një drejtori brenda Kryeministrisë, duke e forcuar punën me të njëjtën paradigme që keni ju, që forcuakemi ASA-n duke e kthyer në një institut afatgjatë brenda Akademisë së Shkencave. Ja, pra, si e thotë ligji dhe siç nuk e citoni ju, ndërkohë që ASA-ja është një IAL e kategorisë “akademi”, por që në nenin 3 të statutit që keni njohur ju, është e specializuar për kërkim të thelluar shkencor; atë që po bën më së miri dhe atë për të cilën ju nuk e monitoruat.

Pra, çuat një ekip, të cilit ia kishit thënë paraprakisht që duhet të mbyllet dhe për t’i thënë: pse nuk ke studentë? Por, në fakt, lind pyetja: ore, ASA-ja vërtet nuk ka dashur të hapë cikël të parë studimesh dhe keni të drejtë ju? Le të shikojmë faktet. Ndryshe nga ç’thoni ju, faktet janë që



ASA-ja jo një herë, por disa herë, dhe jo vetëm, por edhe me partnerë të tjerë, që ju të mos kishit mundësi ta kundërshtonit, ju ka kërkuar të hapë cikël bachelor.

Më 26 nëntor të vitit 2022 ju ka sjellë katër programe, edhe masteri: antropologji, gjuhësi, muzeografi dhe historinë e feve. Ju ka sjellë një program bachelor në Universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastër dhe ju i keni thënë, pra argumenti pse nuk duhet ta hapte (ja, ku është shkresa) ishte: “Sepse nuk evidentohet treg, nuk ka punë, mungon një studim tregu”.

Pra, ne presim që albanologjinë ta studiojmë ose ta mbajmë vetëm në qoftë se ka treg. Për shkencën që neve na studion origjinën, historinë, antropologjinë, gjuhësinë, ne shikojmë ka treg apo nuk ka treg, ka biznese që merren me këtë apo jo? Sigurisht, nuk ka biznes që merret me historinë. Por të gjitha këto refuzime, që unë i kam këtu me data (11.4.2022, 12.4.2023 e të tjera), që nuk kalon, nuk kalon, ishin pjesë e planit tuaj për ta mbyllur, për t’i bërë qokën Skënder Gjinushit!

Është kaq e thjeshtë. Ju i çoni një ekip vlerësimi me një metodologji vlerësimi që përdoret për IAL-të, që kanë fakultete dhe kanë studentë, dhe u thoni: ju nuk plotësoni këto kriterë... Më fal, por është një IAL e një forme tjetër; e keni pranuar vetë dhe nuk e keni pyetur fare për kërkimin shkencor, për atë që ju thoni se është gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjë ASA-ja. Dhe, në fakt, është gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjë ASA-ja.

Asnjë pyetje, asnjë vlerësim për kërkimin shkencor, ndërkohë që vetë Akademia ka 30% formim dhe 70% kërkim shkencor që, në mungesë të studentëve, ata e kanë kthyer 100% në kërkim shkencor, derisa ju t’u jepnit leje që të hapnin programin bachelor. Kaq e thjeshtë. Varej përsëri nga ju, ndërkohë që ju i keni bërë një mungesë vlerësimi të punës së atyre. Ata nuk kanë vlerësim sot për punën e tyre të shkëlqyer si “profesor”, “profesor/doktor”, “profesor i asociuar” dhe “doktor”.

Ju thoni se nuk ka akreditim.

Ju, zonjë, me këtë VKM keni bërë edhe një dëm tjetër, keni ndërprerë një proces. Ata janë sot në proces akreditimi. Në qoftë se ju e ndërprisni procesin, normalisht që nuk ka akreditim. Është njësoj sikur unë të hyj për të mbrojtur diplomën, të ikin pedagogët dhe më thonë: jo, ti nuk ke diplomë, nuk punësohesh dot; të njëjtët pedagogë! Më fal, por, kur ti del dhe ndërpret procesin, sot që ne flasim ata ishin në mes të një procesi akreditimi, që e ndërpretë ju me një urdhr arbitrar! “I di unë emrat e atyre që janë kundër”. Më fal, me letra anonime do të flisni këtu? Keni një deklaratë publike të secilit departament, të secilit institut, mbledhje të përbashkëta. Kanë dalë shemat e tyre, të zgjedhur me votë sipas ligjit dhe sipas këtij ligji të arsimit të lartë, që thonë se janë kundër. Kemi vendim të senatit akademik në mënyrë unanime që thotë se janë kundër. Thojini emrat e atyre që ju paskan thënë juve fshehtëazi se janë pro! Çfarë metode është kjo?

Për sa i përket Akademisë së Shkencave, unë nuk dua të harxhoj fjalë.

Me një studim, me një investigim që e ka bërë BIRN-i, po, Skënder Gjinushi sot, dhe ju i ndaluar, thatë “vetëm ata akademikë të ndaluar”, e ka kthyer në një çerdhe të qokave të ish-politikanëve. Numëroji sa ish-politikanë, deputetë të PS-së, ke aty, madje mund të bëni edhe asamblenë socialiste menjëherë, meqë e keni afër edhe sallën e Akademisë së Shkencave! Ky është realiteti dhe nuk janë të gjithë pro.

Është akademik i nderuar edhe Artan Fuga, por nuk e përmende, i cili nuk është pro. Sigurisht që nuk është pro, sepse ka një pikëpamje metodologjike perëndimore, ndaj nuk mund të jetë pro modelit sovjetik që thoni ju. Nuk ka sesi.

As ju nuk duhej të ishit pro, sepse jeni shkolluar në Angli dhe duhej të kishit një model perëndimor në mendje, jo të linit të udhëhiqeshit nga Skënder Gjinushi.

Por le të vazhdojmë me kundërgargumentet.

Thoni se keni bërë një vlerësim të ligjshmërisë nga ministria juaj, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe relacioni sugjeron mbylljen, ndërkohë që të gjitha shkeljet që ju nxirrni aty,

janë të gjitha mosveprime të qëllimshme tuajat si ministre, me qëllim mbylljen e ASA-s, ndërkohë që do t'ju them një rast.

Ju, besoj e dini më mirë se unë, keni gjetur me shkelje të jashtëzakonshme universitetin "Pavarësia" në Vlorë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Prit, një sekondë, ta mbaroj!

Para se të arrinit te mbyllja e tij, keni dhënë pezullim dyvjeçar, apo jo? Ndërsa ASA-n nga sot-nesër e mbyllni dhe nuk bëni as takim, as ngrini grup ndërinstitucional, as pezullim për t'i dhënë kohë. Asgjë. Ju e mbyllni dhe e çoni atje ku ka kërkuar Skënder Gjinushi. Jua mora këtë rast që nuk ka lidhje fare me rëndësinë që ka ASA-ja dhe me punën që bën ASA-ja, por jua mora për të kuptuar se si funksiononi ju, se çfarë standardesh keni ju dhe se si e zbatoni ju ligjin, si Ministri e Arsimit dhe si grup pune.

Ndërkohë, thatë: "Jo, nuk shkrihen ata profesorë, nuk ngelen pa punë!"

Zonja Ministre, a e dini ju se ligji i Akademisë së Shkencave njeh vetëm institute afatshkurtra dhe afatgjata? A e dini ju se "afatgjata" nuk do të thotë të përhershme? "Afatgjatë", në kuptimin e ligjit të Akademisë së Shkencave, është deri në 2 vjet, por nuk do të thotë të përhershëm, se edhe ne afatgjatë jemi në këtë botë, por nuk jemi të përhershëm. Edhe ti afatgjatë mund ta bësh edhe 10 vjet, por nuk është e përhershme, ndërkohë që institutet atje ku janë dhe siç janë, janë institute të përhershme që kanë punë, kanë projekte. Kanë projekte sot. Kanë 45 marrëveshje sot. Do t'jua dorëzoj unë t'i shikoni. Kanë projekte me universitete. Kanë projekte me qendra kërkimore. Çfarë ndodh? Ju hiqni subjektin juridik, ju shkatërroni 45 projekte, 45 marrëveshje. Ato nuk mund t'i bëjnë me Akademinë e Shkencave, sepse nuk ka këto kompetenca! Nuk pyesni, sepse keni urdhrin politik, pastaj thoni pse themi "urdhër politik"? Po se kështu është, pra, se është i pabazuar në pjesën juridike.

Departamenti është njësi kryesore, edhe në ASA departamenti është njësi kryesore dhe ka autonomi, zgjidhet me votim, që nuk është i tillë

në Akademinë e Shkencave, sepse nuk ekziston në Akademinë e Shkencave një nukël që quhet departament, pra e shkrini.

Tani ma shpjegoni mua, shpjegojuani edhe shqiptarëve që, kur Akademia e Shkencave ka këto pozicione: "akademik", "akademik i asociuar" dhe "akademik emeritus", si do t'i integroni këta që kanë tituj të tjerë: "doktor", "profesor i asociuar" dhe "profesor/doktor"? Si? Do t'i bëni vasalë të këtyre dhe do të thoni që po i ruajmë? Si, me çfarë ligji? As e keni menduar fare, fare, fare, thjesht keni bërë qokën!

Si mund të bashkohen uji dhe vaji? Nuk bashkohen.

Ju i keni marrë dhe i keni çuar atje që, ejani, bëni punën që u duhet këtyre, se kanë marrë projektet që nuk duhej t'i merrnin, se shkon projekti tek institucioni dhe jo institucioni te projekti. Shumë e thjeshtë; gjëja më e thjeshtë. Pra, ju nuk keni sot një metodë rekrutimi, ju nuk keni sot një metodë avancimi në karrierë të këtyre profesorëve, që e zëmë se do t'i çojmë tek Akademia e Shkencave. Si do ta vazhdojnë karrierën e tyre në Akademinë e Shkencave? Aty nuk ka një sistem avancimi në karrierë të përshtatshëm për ta, se aty janë akademikë. Nuk e parashikon ligji. Çfarë bëhet, apo i lëmë ata? Nuk ka gjë. Aq sa bënë deri tani, mjafton. Mjafton të jetë mirë Skënder Gjinushi.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Pra, ju keni kthyer një republikë VKM-sh, një diktaturë VKM-je, në të cilën, sigurisht, shkëlqi autonominë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Vendimi nr. 9, se ju do të na detyroni që të bëhemi ekspertë të shkëlqyer të së drejtës kushtetuese. Pas Elvës, që na çoi në Gjykatë Kushtetuese, mund të jeni ju e dyta. Vendimi nr. 9, datë 19.03.2008, i Gjykatës Kushtetuese thotë: "Qëllimi i autonomisë është ruajtja e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studiuesve dhe profesorëve nga influenca politike, nisur nga ideja se shkenca dhe mësimdhënia mund të ekzistojnë dhe të sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura.

Parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë me parimin e lirisë akademike, e lirisë së mendimit, e lirisë së shprehjes, e lirisë së kërkimeve shkencore dhe mësimdhënies. Pse jua citova? Sepse ju u thoni: “Shkoni dhe punoni tek ato projektet që ka Akademia e Shkencave”.

E para, ata janë duke bërë disa projekte vetë, por nuk mund të lënë projektet që kanë vetë dhe të shkojnë të merren me projektet e Akademisë së Shkencave, se nuk është kjo liria akademike.

E dyta, e zëmë se kanë dëshirë dhe qejf të punojnë edhe në ato projekte apo disa kanë edhe marrëveshje, ndërkohë që ju e dini shumë mirë se metodologjinë e ka shpallur Akademia e Shkencave, pra këta nuk kanë zë në metodologji. Po nuk ke zë në metodologji, nuk ke zë në kërkim. Është shumë e thjeshtë. Ndërkohë, prioritetet se cilat do të jenë kërkimore, i ka shpallur Akademia e Shkencave, që sigurisht nuk përputhen me prioritetet e këtyre studiuesve shumë më të rinj në moshë dhe me një karrierë për të avancuar.

*(Bie gongu.)*

Shikoj që koha kaloi, por ka aq shumë shkelje e aq shumë të pavërteta, sa që unë nuk ia dal dot.

Ndërsa për u përket doktoraturave, po, janë 26 doktoratura që vazhdojnë dhe që të kesh një kërkim të mirë, cilësor në fakt, do të duhet që të matesh nga puna që bën. Do t’ju jap shembull të një doktorature të jashtëzakonshme që është për Shqipërinë: “Mbijetesa, Shqipëria në postkomunizëm”, Klarisa Deval”, dhe i ka zgjatur 11 vjet. E ka nisur në vitin 1992, ka botuar edhe një libër, që jua sugjeroj ta lexoni dhe nuk tha njeri që është një doktoraturë e pavlefshme, por është një nga librat më të mirë për Shqipërinë dhe një nga studimet më të mira për Shqipërinë.

I ka zgjatur 11 vjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E ka nisur në vitin 1992, siç e thotë ajo vetë, ndërkohë që ju duhet të kuptoni se cilësia e kërkimit në këto fusha, të cilat lidhen me historinë dhe me antropologjinë, ishte e vështirë dhe ka më shumë rëndësi që të jemi të vërtetë dhe të prodhojmë një material që u shërben brezave të ardhshëm, siç janë vetë këto shkenca, që u

shërbejnë brezave të ardhshëm, sesa një gjë brenda afateve, sesa një gjë të mbyllur. Pastaj, nëse ju doni ta keni si kriter mbylljen, sepse nuk kanë afat doktoraturat, sot mund të mbyllim Universitetin e Tiranës ne, sepse ka shumë doktoratura që janë jashtë afatit, si dhe çdo universitet tjetër; po përmend të Tiranës, që është edhe më afër dhe më i rëndësishmi.

Ndaj, zonja Ministre, të gjitha këto që thatë, unë jua rrëzoj me argumente dhe janë thjesht vjega për një projekt të pafshehur të Skënder Gjinishit, që e quan “reformë”.

Në qoftë se doni të bëni reformë, jua sugjeroj unë. Ta bëjmë të gjithë bashkë dhe të kemi mundësi që këtë IAL, siç është ASA-ja, ta inkorporojmë, në qoftë se për një moment po marr që ekzistojnë këto shkelje, t’i japim mundësinë që për 6 muaj të inkorporohet dhe të gjejë një marrëveshje me një IAL tjetër, siç është Universiteti i Tiranës, sepse IAL-të mund të bashkohen dhe të shkrihen vetëm me IAL...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, përfundoni, sepse e keni kaluar kohën!

**Ina Zhupa** – Po, ndjesë për kohën!

...dhe jo me Akademinë e Shkencave, që nuk i lidh asgjë, përveç interesit të Skënder Gjinishit.

Ka shumë shkelje. Është një çështje jopolitike, zonja Ministre, është çështje kombëtare!

*(Deputeti Braçe flet nga vendi pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – Zonja Kushi, keni në dispozicion 3 minuta dhe më pas zonja Zhupa, 3 minuta.

**Evis Kushi** – Të thuash që Akademinë e Studimeve Albanologjike nuk e lidh asgjë me Akademinë e Shkencave, unë nuk e di, është, si të thuash, që vajza nuk ka lidhje me nënën. Ja, kështu i bie, sepse fakti...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk ka lidhje? Dakord. Sepse nuk mundet që ne për inat të Gjinishit, hajde ta bashkojmë me Universitetin e Tiranës. Ne nuk mund të bëjmë eksperimente, ndërkohë që historia, misioni që kanë përputhet shumë më mirë me Akademinë e Shkencave sesa me çdo lloj IAL-je.

Megjithatë, le të nisim një nga një me argumentet. Ju thatë se ligji nuk e detyron të ketë tri cikle studimi. Nuk kërkuam ne tri cikle, ne dhamë të paktën një, ndërkohë që ata nuk kanë asnjë. Jemi dakord që nuk kanë asnjë cikël?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk kanë asnjë...

Jo, janë të mbyllura. Ina, m'u përgjigj me këtë pyetje. Ligji thotë: "Nëse për 2 vjet nuk ka asnjë të regjistruar, programi mbyllet". Kanë 8 vjet pa asnjë të regjistruar. Tani, më thoni, a është e ligjshme, apo jo? Pra, këtë përgjigje më jep.

E dyta, ju thoni: "U hap..."

Jo, jo, ju thoni: "E keni miratuar si institucion".

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem!

Pra, thoni që e keni hapur ju. Tani, vërtet është hapur, por është hapur para ligjit të ri të vitit 2015. Kur u miratua ligji i ri, iu kërkuua të gjitha institucioneve të arsimit të lartë të riorganizoheshin në përputhje me ligjin. Ky është ndryshimi. Pra, ligji i vitit 2015 u ka dhënë detyrimin të gjitha institucioneve të riorganizohen dhe Akademia e Studimeve Albanologjike është e vetmja që nuk u riorganizua asnjëherë. Kishte 7 vjet kohë për t'u akredituar, ndërkohë që ju thoni se ia ndërprenë ne akreditimin. Kur u akredituan të gjitha IAL-të publike, që para shumë vjetësh, pse ata nuk u akredituan asnjëherë?

7 vjet pa proces akreditimi. Edhe nëse kanë shkuar tani, është e sigurt që nuk akreditohen, sepse nuk kanë asnjë kriter. Duhet të plotësojnë kriteret, prandaj nuk e bëjnë procesin, sepse e dinë shumë mirë që nuk i plotësojnë kriteret dhe natyrisht nuk mund të akreditohen.

Lidhur me argumentin tjetër: "Cilët janë dakord?", pyesni ju, i kam këtu me emra, sepse natyrisht qëndrimet e tyre janë publike në rrjetet sociale.

Po filloj me: Ethem Likaj, Besnik Baraj, Shabani, Sulçebe, Adem Bunguri...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, pra, po, të gjithë i kemi. Kam marrë të gjithë ata që kanë bërë deklaratat, do t'jua lë, i kam publike, të shkruara; dokument.

*(Bie gongu.)*

Ndërsa, meqë ke merakun e qëndrimeve të anëtarëve, të punonjësve të ASA-s, unë po e filloj që me rektorin aktual, Luan Përzhita, profesor i nderuar, për të cilin kam shumë respekt, është anëtar pranë Komisionit të Përhershëm të Arkeologjisë në Akademinë e Shkencave dhe autor i kontraktuar i grupit të studiuesve që po shkruajnë historinë e shqiptarëve. Rektori aktual ka një kontratë me profesor Gjinushin...

*(Drejtimitin e seancës e merr Zëvendëskryetarja e Kuvendit, zonja Ermonela Felaj.)*

**Ermonela Felaj** – Përfundoni, ju lutem, se ka mbaruar koha në dispozicion!

Zonja Ministre, konkludoni, ju lutem!

**Evis Kushi** – Ju e refuzoni profesor Gjinushin, kurse rektori bashkëpunon me profesor Gjinushin, kanë një kontratë së bashku. Shumë mirë, prandaj edhe unë jam optimiste që bashkimi i këtyre dy institucioneve do të jetë i suksesshëm, sepse ata tashmë kanë edhe kontratë institucionale.

Akademia e Shkencave dhe Akademia e Studimeve Albanologjike kanë një kontratë bashkëpunimi dhe, po ashtu, të gjithë anëtarët, punonjësit kanë kontrata, sepse janë angazhuar...

*(Bie gongu.)*

...te profesor Gjinushi me kontratë: njëri për enciklopedinë, tjetri për fjalorin, tjetri për një projekt tjetër. Kjo do të thotë që jo thjesht i bashkon i njëjti mision, siç është albanologjia, por unë jam optimiste, sepse deri tani e kanë pasur shumë të frytshëm bashkëpunimin.

Tjetër argument. Ju thoni: "model sovjetik".

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre! Përfundoi koha e diskutimit.

**Evis Kushi** – Në qoftë se Vjenën e quani model sovjetik, ejani shkojmë bashkë në...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zonja Ministre, se më duhet t'i jap kohë edhe zonjës Zhupa.

*(Ministrja Kushi e vazhdon fjalën e saj pa mikrofon, pasi i mbaroi koha në dispozicion.)*

Jeni pa mikrofon. Ju lutem!

Fjalën e ka zonja Zhupa, 3 minuta kohë për t'u shprehur, dhe mbyllet kjo pikë e rendit të ditës me fjalën e zonjës Zhupa.

**Ina Zhupa** – Për të përfituar nga 3-minutëshi i fundit, zonja Kushi, prapë vazhdoni të thoni se nuk ka studentë. Unë pranoj propozimin e zotit Braçe: regjistrohemi unë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

A ka mundësi, zonjë?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Nuk e keni hapur ju, jo se nuk ka studentë! Nuk e keni hapur ju dhe s'kishte se si të kishte studentë!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Kur ju refuzoni t'i hapni master në drejtime të shkëlqyera, vetëm sepse thoni që nuk ka treg ("nuk ka treg" është i vetmi refuzim, i kam shkresat aty dhe jua tregova), atëherë nuk ka se si të ketë studentë. Pra, të gjitha shkeljet që ju thoni se janë të ASA-s, janë tuajat, janë nga mosveprimet tuaja. Janë të bëra qëllimisht për të arritur në ditën e sotme. Sigurisht, unë zgjidhjen jua ofrova: ejani të integrohemi në një institucion të arsimit të lartë, që është i njëjtë, që i prek i njëjti ligj, sepse ti nuk mund të reformosh një institucion me ligjin e një institucioni tjetër!

Nuk bëhet, nuk e lejon ligji. Është kaq e thjeshtë. Nuk e reformon dot një IAL me ligjin e Akademisë së Shkencave. Është normale që nuk ka asnjë përputhje.

A kanë marrëveshje bashkëpunimi? Po, kanë. Fakti se kanë marrëveshje bashkëpunimi, tregon se është e panevojshme shkrirja dhe bashkimi, se ato punë që kanë për t'i dhënë atje dhe kontribut ku kanë rënë dakord, e japin edhe sot. Pse do të bëhet bashkimi? Të tjerat nuk kanë fare as fushë interesi, as dëshirë, nuk janë as pjesë e punëve të tyre të përditshme. Atëherë, përsëri bashkimi është i pavlefshëm.

Thoni se është me ligjin e vjetër. Nuk është me ligjin e vjetër. Në vitin 2018 ka qenë ministre Lindita Nikolla.

*(Ministrja Evis Kushi ndërhyr pa mikrofon.)*

Lindita Nikolla iku.

Lindita Nikolla i njej kështu siç janë. Lindita Nikolla, ministre...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Nuk u ka kërkuar asgjë. Ja, ku është shkresa dhe sekretari juaj i Përgjithshëm e ka konfirmuar këtë shkresë. Në qoftë se gaboni, shkëlmi ligjin, është faji juaj, jo i atyre.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

E fundit, zonja Ministre, sepse unë nuk dua të më ndërpritet fjala nga efekti i kohës, ja ku është edhe shkresa e kohës suaj. Zonja Ministre, e gjitha kjo është një fiktivitet i madh. Ju doni që të kapeni pas një fijeje bari. Është jashtëzakonisht e dhimbshme që albanologjia sot të trajtohet në një interpelancë mes një deputeteje të opozitës dhe ministres, kur ne të dyja bashkë duhet të ishim në një vijë mendimi për ta fuqizuar këtë shkencë, për të mos kërkuar vjega që, a ka studim tregu apo nuk ka studim tregu në albanologji, në histori apo në gjuhësinë shqipe, por për të gjetur sa më shumë fonde. Por ju nuk e patët kurajën të na thoni se me çfarë guximi ju sot prishni 45 marrëveshje, 45 projekte që janë në vazhdimësi, 45 institucione?

*(Bie gongu.)*

Ju lexuat vetëm katër persona, që nuk e di si i keni marrë dhe në qoftë se janë të vërteta, ndërkohë ju keni publikë 100 studiues, të cilët kanë firmosur me emër dhe mbiemër nga e gjithë bota për të kërkuar të mos mbyllet. Keni publik senatin akademik, keni publik çdo vendim të instituteve! Mos e bëni këtë gjë, pasi është antiligjore! Do ta ndjekim në Gjykatë Administrative, do ta ndjekim në Gjykatën Kushtetuese, por ju do t'ju ngelet emri i keq që vratë albanologjinë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: raportimi vjetor i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022.

Ju lutem, kolegë, mbani pak qetësi në sallë!

Në bazë të nenit 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 53, datë

22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar”, raportimin vjetor të këtij institucioni do ta paraqesë drejtori i Përgjithshëm i këtij institucioni, zoti Genci Mamani.

Ftoj zotin Mamani të futet në sallë.

Shërbimet. Po vjen? Në rregull.

Faleminderit, zoti Mamani!

Koha në dispozicion, sipas nenit 103, pika 7 të Rregullores, është 20 minuta.

Sidoqoftë, unë do t’ju lutesha që të ishit sa më i përmbledhur në fjalën tuaj, në mënyrë që e gjitha të mund të kuptohet edhe më lehtësisht nga publiku.

Faleminderit!

**Genci Mamani** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni t’ju prezantoj raportin vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022.

Ky raport ju informon për ecurinë e depozitave të qytetarëve shqiptarë në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit për miradministrimin e fondeve të krijuara për kompensimin e depozitave të siguruara të qytetarëve dhe të bizneseve, si dhe për veprimtarinë e Agjencisë në funksion të përmbushjes së objektivave ligjorë, të cilët kanë si qëllim përfundimtar stabilitetin e sistemit bankar dhe financiar në vend, si dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve.

Në fillim më lejoni t’ju informoj se rekomandimet e rezolutës së Kuvendit, të cilat janë në fokusin e veprimtarisë sonë, janë realizuar plotësisht edhe përgjatë vitit 2022.

Në vijim, po ju bëj me dije disa nga treguesit kryesorë të sistemit të depozitave bankare dhe të shoqërive të kursim-kreditit, si dhe trendët përkatëse përgjatë vitit 2022.

Vlen të theksohet se parametrat e funksionimit të sistemit bankar dhe financiar mbetën të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm edhe përgjatë vitit 2022, pavarësisht situatave të krijuara si pasojë e eventeve globale, të cilat kanë dhënë ndikim edhe në vendin tonë.

Gjatë vitit 2022 kemi siguruar depozitat e depozituesve në 12 bankat e sistemit dhe në 9 shoqëri kursim-krediti. Nga muaji dhjetor i vitit 2022 numri i bankave, që sigurohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave u reduktua në 11 të tilla, si rezultat i bashkimit me përthithje të bankës “Alpha Albania” nga banka “OTP Albania”.

Në fund të vitit 2022 totali i depozitave në sistemin bankar ishte 1518 miliardë lekë me një rritje vjetore prej 5,9%, ndërsa totali i depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit ishte 10,3 miliardë lekë, duke pasur një rritje vjetore prej 8%.

Agjencia, sipas të dhënave për fundvitin 2022, ka detyrimin për kompensimin e 826,7 miliardë lekëve depozita në banka apo të 826108 depozituesve, si dhe detyrimin për kompensimin e 7,4 miliardë lekëve depozita në shoqëritë e kursim-kreditit apo të 21154 depozituesve.

Në totalin e detyrimeve të Agjencisë prej 834,4 miliardë lekësh ndaj depozituesve që kanë vendosur depozitat e tyre në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit, 99,1% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve në banka, ndërsa 0,9% e zë detyrimi i Agjencisë ndaj depozituesve në shoqëritë e kursim-kreditit. Ky raport është i njëjtë edhe me vitin pararendës.

Siç jeni në dijeni, me qëllim përmbushjen e objektivit ligjor për kompensimin e depozitave të siguruara, në rast se një bankë apo një shoqëri kursim-krediti nuk është në gjendje të përmbushë detyrimin ndaj depozituesve të saj, Agjencia mbledh prime nga këto institucione financiare. Këto prime janë burimi kryesor i fondeve të sigurimit të depozitave, të cilat ne i administrojmë në përputhje me parimet e sigurisë dhe të likuiditetit.

Në fund të vitit 2022 vlera kontabël e fondit të sigurimit të depozitave në banka ishte 57,8 miliardë lekë. Në krahasim me një vit më parë, ky fond është rritur me rreth 5,08 miliardë lekë ose me rreth 9,6%. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2022 ishin 3,99 miliardë lekë ose 6,06% më të larta se në vitin 2021. Të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka për vitin 2022

ishin 1,61 miliardë lekë ose 15,6% më të larta se në vitin 2021.

Rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare në vitet e fundit ka ardhur kryesisht si rezultat i diversifikimit të portofolit në maturitete mbi 2 vjet. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 normat e interesit kanë pasur një tendencë në rritje, krahasuar me vitin 2021, duke shënuar kështu një kthim të kënaqshëm ndaj investimit.

Agjencia investon më shumë se 90% të mjeteve financiare në lekë të fondit të sigurimit në banka, në Bankën e Shqipërisë dhe në letra me vlerë të qeverisë shqiptare. Ndërkohë, për sa u përket investimeve në monedhë të huaj, ato janë realizuar me eurobondet e qeverisë shqiptare në tregun e jashtëm.

Rritja e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka ka sjellë edhe një rritje të raportit të mbulimit, i cili nga 6,67% në vitin 2021, arriti në 7% në fund të vitit 2022.

Raporti i mbulimit të depozitave të siguruara tregon përqindjen e depozitave të siguruara të sistemit bankar që mbulohen nga Fondi i Sigurimit të Depozitave në banka. Ndërkohë, për sa i takon Fondit të Sigurimit të Depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit, në fund të vitit 2022 ai ishte 192,3 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 15,42%, krahasuar me vitin 2021. Të ardhurat vjetore nga primet e sigurimit për vitin 2022 ishin rreth 22 milionë lekë, ndërsa të ardhurat vjetore nga administrimi i mjeteve financiare të këtij fondi ishin në shumën rreth 5,3 milionë lekë.

Mjetet financiare të fondit të sigurimit të shoqërisë së kursim-kreditit janë 100% të investuara në letrat me vlerë të qeverisë shqiptare.

Së fundi, raporti i mbulimit që ofron Fondi i Sigurimit të Depozitave të shoqërive të kursim-kreditit përkundëjt depozitave të siguruara nga këto institucione financiare në fund të vitit 2022, ishte 2,61%.

Me ndryshimet ligjore të miratuara nga Kuvendi në vitin 2016 Agjencia e Sigurimit të Depozitave ushtron, gjithashtu, funksionin e administratorit të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky fond u krijua për zbatimin e

një a më shumë instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat që mund të kenë vështirësi financiare.

Më 31 dhjetor 2022 vlera kontabël e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ishte 3,526 miliardë lekë.

Në vijim, më lejoni shkurtimisht t'ju informoj për aktivitetet kryesore që Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka realizuar përgjatë vitit 2022. Me këtë rast ju bëj me dije se për realizimin e projekteve strategjike kemi pasur asistencën dhe bashkëpunimin e partnerëve ndërkombëtarë, si Banka Botërore, BERZH-i e të tjerë.

Të gjitha aktivitetet që kemi realizuar, kanë synuar rritjen e nivelit të gatishmërisë së Agjencisë për t'iu përgjigjur me efikasitet situatave, për të cilat kemi mandat ligjor t'i adresojmë. Për këtë qëllim, vendimmarrja e këshillit drejtues përgjatë vitit 2022 është udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë dhe transparencës.

Vendimet e këshillit drejtues, të cilat kanë synuar ruajtjen e standardeve të larta në mirëqeverisjen e Agjencisë, si dhe në konsolidimin e kapaciteteve të saj, janë përqendruar kryesisht në miratimin e akteve nënligjore, me qëllim miradministrimin e skemës së sigurimit të depozitave dhe mbarëvajtjet operacionale të Agjencisë. Më të rëndësishmet që mund të përmend, janë miratimi i dy ndryshimeve në dy akte nënligjore, që përcaktojnë kërkesat rregullatore për subjektet anëtare të skemës të cilat janë: udhëzimi "Për sigurimin e depozitave në banka", si dhe udhëzimi "Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit".

Dispozitat e këtyre akteve nënligjore u rishikuan në drejtim të mbajtjes dhe raportimit të të dhënave për depozitat dhe depozituesit në banka dhe në shoqëritë e kursim-kreditit, si dhe për përmirësimin e dispozitave që lidhen me procesin e verifikimit në banka dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Ndryshimet e propozuara nga Agjencia, pas konsultimit me subjektet anëtare të skemës, u miratuan nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës.

Gjithashtu, në drejtim të vendimmarrjes dhe bashkëpunimit efikas me institucionet rregullatore, një nga arritjet më të rëndësishme është dakordësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes REPO me Bankën e Shqipërisë. Kjo marrëveshje rregullon marrëdhëniet mes dy institucioneve për lidhjen e kontratave të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes. Ajo adreson një nga pengesat kryesore që institucionet e sigurimit të depozitave hasin në një rast ngjarjeje sigurimi, siç është kthimi në likuide i fonde në administrim. Marrëveshja na lejon që nëpërmjet mekanizmit REPO në një kohë të shkurtër dhe, duke mitiguar riskun e shitjes së letrave me vlerë me një çmim më të ulët, të kthejmë në likuide fondet që administrojmë ne.

Ne vlerësojmë se kjo marrëveshje është një hap i mëtejshëm në serinë e masave që ka ndërmarrë Agjencia në vijueshmëri për të rritur në këtë mënyrë besimin e qytetarëve në sistemin financiar edhe bankar në vend. Në lidhje me këtë, gjej rastin të falënderoj Bankën e Shqipërisë për gatishmërinë, profesionalizmin dhe nivelin e lartë të bashkëpunimit që dëshmoi për finalizimin e këtij projekti kaq të rëndësishëm për Agjencinë dhe për mbarëvajtjen e një procesi efikas kompensimi.

Gjatë vitit 2022 vend të rëndësishëm në gamën e veprimtarive që kemi kryer, kanë pa dyshim ushtrimet e simulimit që kemi realizuar me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave.

Në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit dhe planeve tona të punës, gjatë vitit 2022 kemi kryer ushtrime simulimi, simulime teknike me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, si dhe një simulim të dedikuar me një nga bankat agjente të përzgjedhura. Qëllimi i këtyre simulimeve është testimi i gatishmërisë teknike të sistemit të bankave dhe shoqërive të kursim-kreditit për të raportuar dhe për të gjeneruar raporte në përputhje me kërkesat e Agjencisë, si dhe testimi i procesit operacional në rastin e bankës agjente për përmbushjen me sukses të detyrimeve të saj në një rast ngjarjeje sigurimi.

Ju informoj se nga ushtrimet e realizuara deri më tani është vërejtur se bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit i kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të Agjencisë.

Po gjatë vitit 2022 kemi dhënë kontributin tonë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian si një nga institucionet pjesëmarrëse në grupin negociator për kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, krahas Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në kuadër të procesit *screening*, Agjencia ka punuar në mënyrë intensive për të kontribuar në përgatitjen e grupit negociator, me qëllim përfaqësimin në takimet bilaterale Shqipëri – BE. Në këtë drejtim mund t’ju informoj se legjislacioni shqiptar për sigurimin e depozitave është në pjesën më të madhe në përputhje me legjislacionin europian në këtë fushë.

Në lidhje me çështjet e identifikuara që ofrojnë mospërputhje, jemi duke punuar për t’i adresuar, me qëllim arritjen e një përputhshmërie sa më lartë me legjislacionin e Bashkimit Europian.

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke ju falënderuar për mundësinë për të prezantuar përpara jush raportin vjetor për vitin 2022, ju bëj me dije se edhe për vitin 2023 mbetemi të angazhuar të realizojmë me efikasitet rekomandimet e Kuvendit dhe të ushtrojmë të gjitha tagrat që na jep ligji për të përmbushur me sukses mandatin tonë ligjor për sa i takon mbrojtjes së interesave të depozituesve shqiptarë përmes kompensimit të depozitave, në qoftë se do të jetë e nevojshme, dhe ruajtjes së stabilitetit financiar në vend.

Duke ju falënderuar edhe një herë për vëmendjen, mbetem në dispozicionin tuaj për çdo pyetje, koment apo rekomandim lidhur me veprimtarinë e Agjencisë.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Mamani!

Suksese në veprimtarinë tuaj në institucionin që ju drejtoni!



Nuk e di, sekretaria, a ka pyetje nga deputetët?  
Nuk ka pyetje për ju, kështu që mund të largoheni.

Ndërkohë, çelim diskutimet.

Për këtë pikë të rendit të ditës është regjistruar deputeti Alban Xhelili.

Fjala është për ju, zoti Xhelili.  
10 minuta.

**Alban Xhelili** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Dua t'ju paraqes raportin e Komisionit të Ekonomisë ose vlerësimin për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29.05.2023, zhvilloi seancën dëgjimore për veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022. Kjo seancë dëgjimore u bë bazuar në nenin 7, pika 2 të ligjit nr. 53/14, datë 22.05.2014, “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar”.

Performanca e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave vlerësohet shumë e mirë për vitin 2022. Fondet e sigurimit të depozitave në banka dhe në shoqëritë e kursim – kreditit kanë pasur një rritje të qëndrueshme gjatë këtij viti. Të ardhurat kryesore, siç e tha edhe drejtori i përgjithshëm, që kontribuojnë në rritjen e këtyre fondeve janë të ardhura nga primi i sigurimit dhe të ardhura nga administrimi i mjeteve financiare. Rritja e të ardhurave nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka ka ardhur kryesisht si rezultat i zgjerimit të portofolit në obligacione me maturitet 2 dhe mbi 2 vjet. Gjatë vitit 2022 normat e interesit kanë pasur një tendencë në rritje, krahasuar me vitin 2021, kryesisht duke nisur nga tremujori i dytë i vitit 2022, duke sjellë një kthim të kënaqshëm nga investimi.

Gjatë viteve të fundit ASD-ja ka synuar të realizojë një diversifikim portofoli në disa maturitete, gjë e cila ka ndikuar në rritjen e të ardhurave. Në përputhje me parimet e likuiditetit,

sigurisë dhe normës së kthimit, Agjencia ka administruar me efikasitet mjetet financiare duke garantuar në të njëjtën kohë përmbushjen e nevojave për mjete likuide. Në përputhje me politikën e investimeve, Agjencia ka mbajtur jo më pak se 10% të portofolit në instrumente shumë likuide, konkretisht 13,28%.

Investimet në monedhë të huaj kanë qenë jo më pak se 5% e mjeteve financiare nën administrim, konkretisht 9,76%. Mbledhjet e këshillit drejtues gjatë vitit 2022 janë organizuar me një frekuencë të përnuajshme dhe vendimmarrja e këshillit drejtues ka prodhuar 39 vendime. Duke njohur dhe duke vlerësuar rolin e Agjencisë të Sigurimit të Depozitave për sigurimin/kompensimin e depozitave të qytetarëve të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë, Kuvendi ose Komisioni i Ekonomisë e ka vlerësuar pozitive punën e saj. Gjithashtu, ka vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe bankar duke mbështetur dhe zhvilluar bashkëpunimin me këtë Agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunim e saj me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Agjencia ka zbatuar rekomandimet e rezolutës së kaluar të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku ka vijuar kryerjen e simulimeve teknike me të gjitha subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, banka dhe shoqëri kursim- krediti. Nëpërmjet kontrolleve të kryera nga sistemi i saj informatik për raportim dhe kompensim, ka vlerësuar saktësinë e skedarëve për paraqitjen unike të depozituesve, me qëllim simulimin e një ngjarjeje sigurimi. Në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë së informacionit, Agjencia në bashkëpunim me BERZH-in, ka nisur punën për përmirësimin e sistemit informatik për raportim dhe kompensim (SIRK), si dhe zhvillimin e moduleve të reja, të cilat do të automatizojnë procesin e kryerjes së kompensimit.

Është kryer procesi i simulimit për testimin e gatishmërisë teknike të sistemit të bankës agjente, si dhe testimi i procesit operacional të bankës për

përmbushjen me sukses të detyrimeve të saj në rast ngjarjeje sigurimi. Agjencia ka miratuar “Planin e Vazhdimësisë së veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”. Ky dokument është pjesë përbërëse e sistemit të administrimit të rreziqeve në Agjenci. ASD-ja është përfshirë në procesin e shqyrtimit analitik të legjislacionit, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor vendas me direktivën e EU-së “Për skemat e garantimit të depozitave”.

Pas diskutimeve që u bënë në Komisionin e Ekonomisë, Kuvendi i rekomandon Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2023 ta përmirësojë punën në këto drejtime:

Të bashkëpunojë me anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave për kryerjen e simulimeve teknike në funksion të gatishmërisë së tyre në lidhje me mbajtjen dhe raportimin e të dhënave të depozituesve të siguruar, sipas kriterëve të përcaktuara nga Agjencia.

Të vijojë bashkëpunimin me bankat agjente të përzgjedhura nëpërmjet simulimit të një ngjarjeje sigurimi, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e sistemeve të bankave agjente dhe të Agjencisë për të realizuar me sukses një ngjarjeje sigurimi.

Të kujdeset për sigurimin e kapaciteteve mbështetëse, të nevojshme në rast ngjarjeje sigurimi, me qëllim rritjen e gatishmërisë operacionale dhe teknike për përgatitjen dhe kryerjen e procesit të kompensimit;

T’i diversifikojë mjetet e komunikimit për të rritur nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimin të publikut për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave, si dhe të vijojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar në vend dhe në funksion të procesit të integritetit europian.

Këto ishin rekomandimet që Komisioni i Ekonomisë (ia paraqet Kuvendit) ka bërë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, për aktivitetin e saj operacional dhe financiar gjatë vitit 2023.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Xhelili!

Nuk ka regjistrime të tjera nga ana e deputetëve për këtë pikë.

Dëshiroj t’ju kujtoj se ne kemi rënë dakord në Konferencën e Kryetarëve që në rastin e raportimeve vjetore të institucioneve të pavarura, qofshin ato kushtetuese, qofshin ato të krijuara me ligj, koha e debatit në dispozicion të kolegëve deputetë do të jetë 90 minuta. Kështu pra, kushdo që dëshiron të flasë në kohën maksimale, natyrisht që mund të regjistrohet paraprakisht. Kjo vlen edhe për pjesën tjetër të raportimeve që do të kemi në seancën në vijim.

Kalojmë te pika e tretë e rendi të ditës.

Vijojmë me raportimin vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022. Në bazë të nenit 103, pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe nenit 31 të ligjit 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, raportin vjetor për vitin 2022 do ta paraqesë Komisioneri, zoti Dervishi.

Zoti Dervishi, keni fjalën.

Edhe për ju koha në dispozicion është 20 minuta.

Faleminderit!

**Besnik Dervishi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në punën tonë gjatë vitit 2022 jemi udhëhequr nga katër parime kryesore: paanësia, integriteti, transparenca dhe bashkëpunimi. Në këtë kuptim, jemi përpjekur që ekspertizën, autoritetin dhe kompetencat tona t’i vendosim në shërbim të interesit publik për të garantuar që çdo subjekt juridik, ashtu edhe institucionet publike të respektojnë në praktikë parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe të së drejtës së informimit, të rritim ndërgjegjësimin për këto të drejta dhe të përqendrojmë vëmendjen tonë në fushat dhe sektorët që paraqesin rrisje më të rënda dhe që kanë ndikimin më të madh tek të drejtat e qytetarëve. Angazhimi ynë proaktiv pasqyrohet qartë në numrin e lartë të inspektimeve të kryera

me iniciativën tonë, edhe pse numri i ankesave vazhdon të rritet po njësoj. Në raport me vitet e mëparshme, synimi ynë gjatë këtij viti ka qenë që kompetencat tona sanksionuese të jenë po aq proporcionale, sa edhe korrigjuese, për përmbushjen e objektivit tonë kryesor të krijimit të një kulture trajtimi etik dhe të përgjegjshëm të të dhënave personale. Cilësia, rëndësia dhe shtrirja e aktiviteteve tona audituese dhe inspektuese, por edhe vendimmarrja në përfundim të tyre, janë po ashtu indikatorë domethënës të kësaj qasjeje të ligjzbatimit dhe të ndërgjegjësimit. Me ratifikimin e Konventës 108+ të Këshillit të Europës dhe me aspektet e tjera të modernizimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, që janë ende në proces miratimi, ne vijojmë të kryejmë përgatitje të konsiderueshme për nisjen e zbatimit të tij. Nga përditësimi paraprak i kuadrit nënligjor, riorganizimi i strukturës institucionale, te krijimi i rrjetit të nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave apo përforcimi i shkëmbimeve me autoritetet homologe dhe platformat e bashkëpunimit në nivel të Bashkimit Europian dhe më gjerë, çdo aktivitet është kryer pikërisht në perspektivën e legjisllacionit të modernizuar dhe plotësisht të përputhur me atë të Bashkimit Europian. Edhe në fushën e së drejtës për informim, përmirësimet e ligjit “Për të drejtën e informimit” që priten të miratohen, si dhe miratimi i ligjit “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, krahas ratifikimit të Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, janë shoqëruar me përgatitje në drejtim të hartimit të akteve nënligjore, të forcimit të kapaciteteve profesionale, të ndërgjegjësimit të autoriteteve publike dhe të rritjes së bashkëpunimit me grupet e interesit. Kjo vjen si rezultat i kuadrit të plotë ligjor, tashmë të realizuar me kontributin e Kuvendit.

Kemi luajtur rol aktiv, gjithashtu, edhe në bashkëpunimin me autoritetet dhe organizatat homologe ndërkombëtare të fushës së të drejtës së informimit, ku përveç anëtarësimit në disa grupe ndërkombëtare pune, do të organizojmë në

Shqipëri edhe Konferencën Botërore të Komisionerëve të Informimit në vitin 2024. Ky raport përkon me vitin e tetë të zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe vërejmë zhvillime të konsiderueshme si në spektrin e detyrimeve të autoriteteve publike për të qenë transparente, ashtu edhe në atë të ndërgjegjësimit të shoqërisë civile, medias, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit. Megjithatë, zbatimi në praktikë i ligjit ende përballet me sfida të ndryshme. Me ndërgjegjësimin e autoriteteve publike në lidhje me detyrimin për publikimin e informacioneve pa kërkesë, ose ndryshe transparencës proaktive, është rritur sasia e informacionit publik në programet e transparencës që ato publikojnë në faqet e tyre zyrtare, gjë që, në fundit të fundit, sjell lehtësi për publikun. Megjithatë, ky mbetet një proces i vazhdueshëm përmirësimi dhe sfide si në aspektin e transparencës proaktive, ashtu edhe në përgjigjen në kohë dhe cilësi të kërkesave për informim.

Për sa u përket zhvillimeve teknologjike, do të këmbëngulim të punojmë ngushtësisht me institucionet kompetente për të garantuar sisteme të sigurta dhe të qëndrueshme, në funksion të transparencës proaktive dhe për t’u ofruar qytetarëve akses më të shpejtë në informacion, pa qenë nevoja të paraqesin kërkesa pranë institucioneve publike. Qytetarët apo grupet e interesit e përqendruan kërkimin e informacionit apo dokumentacionit për fondet/procesin e rindërtimit, sistemin shëndetësor/pandeminë, për çështjet në arbitrazhin ndërkombëtar, koncensionet, prokurimet, vendimet e sistemit gjyqësor, të dhënat statistikore për veprimtarinë e autoriteteve publike e të tjera. Nga shqyrtimi i ankesave, zyra e Komisionerit ka konstatuar disa problematika, ku ndër më kryesoret mund të përmend vështirësitë e hasura në trajtimin e kërkesave për informim, si rezultat i sulmit kibernetik të ndodhur në faqet zyrtare të autoriteteve publike, që për rrjedhojë ka sjellë mosrespektimin e afateve.

Vijon paqartësia nga ana e autoriteteve publike në lidhje me parimin e konfidencialitetit në kontratat publike dhe sekretin tregtar, të cilat duhen trajtuar vetëm në përputhje me nenin 17 të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Janë konstatuar raste të delegimit të kërkesës për informacion nga njëri autoritet publik tek tjetri, edhe pse disponohet informacioni i kërkuar.

Kërkesit vijojnë të përdorin dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit” përtej objektivit dhe qëllimit të tij për çështje dhe praktika administrative me karakter individual, si aksesit në të dhënat personale, dokumentacioni lidhur me lejet e ndërimit, pasojat e tërmeteve, pronësia dhe procedura të tjera. Pra, nuk ka asnjë arsye pse autoritet publik t’i vonojnë përgjigjet ndaj qytetarëve dhe ata t’i drejtohen Komisionerit e të vihen në lëvizje pas ndërhyrje së Komisionerit.

Konstatohet shtimi i numrit të kërkesave nga avokatët për akses në dokumentacionin e njësuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë ligjin për avokatinë apo Kodin e Procedurave Administrative.

Vijojnë kërkesat për pyetje, intervista apo prononcime në media drejtuar autoriteteve publike, në tejkallim të qëllimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Gjithashtu, një fenomen jo pozitiv, që për fat të keq vijon të konstatohet, është ndryshimi i shpeshtë i koordinorit, caktimi i tij në nivel ekzekutiv apo të ulët drejtues, si dhe kufizimi i aksesit në strukturat e tjera të autoriteteve publike. Për shkak të rolit dhe përgjegjësisë që koordinatori ka në trajtimin e kërkesave për informacion, zyra e Komisionerit në mënyrë të vazhdueshme udhëzon autoritetet publike të marrin masa për forcimin e veçantë të rolit të tij. Shpresojmë që kjo do të realizohet nëpërmjet përmirësimeve, të cilat shpresojmë se do të miratohen së shpejti këtu në Kuvend me amendimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Si të dhëna statistikore, gjatë vitit 2022 janë trajtuar nga Zyra e Komisionerit 1081 ankesa, janë kryer 82 inspektime, janë zhvilluar 77 seanca dëgjimore, është marrë vendimmarrje urdhëruese

për 61 ankesa, si dhe janë dhënë 38 rekomandime. Gjithashtu, nga 374 autoritete publike, 374 prej tyre kanë caktuar dhe kanë funksional koordinatorin, mbase jo gjithmonë cilësor, por e kanë funksional. 350 prej tyre kanë regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve dhe 331 prej tyre kanë programin e transparencës, pra 3 elementet kryesore që plotësojnë kuadrin e zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Për sa më sipër, një pjesë e këtyre problematikave janë adresuar për zgjidhje me propozime për përmirësimin e ligjit. Megjithatë, veprimtaria jonë do të vazhdojë të fokusohet në procesin trajnues dhe ndërgjegjësues me të gjithë aktorët/faktorët e procesit të transparencës. Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcakton mënyrën e drejtë dhe legjitime të përdorimit të të dhënave personale të të gjithë individëve. Ai është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet publike dhe subjektet private. Fusha e tij është shumë e gjerë, pra shtrihet në mënyrë horizontale. Çdo organizatë, ndërmarrje, apo institucion që mbledh, përdor, shkëmben apo mban të dhëna personale duhet të ketë një strategji për mbrojtjen e tyre, e cila, nëse është e ndërtuar në mënyrën e duhur dhe të mirëmenduar, i ndihmon ata të parandalojnë humbjen, vjedhjen apo cenimin e të dhënave, si dhe të zvogëlojnë dëmet dhe pasojat që shkaktojnë shkeljet apo incidentet ndaj të dhënave personale.

Teksa digjitalizimi vijon të shtrihet në çdo sektor apo aspekt të veprimtarive të sferës publike e private, ku shërbimet për qytetarët dhe biznesin ofrohen në një pjesë të madhe vetëm në rrugë elektronike, jo gjithnjë këto zgjidhje dhe shërbime digjitale shoqërohen edhe me ndërgjegjësim, për sa u takon detyrimeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Platformat dhe teknologjitë moderne, që përdoren për të ofruar zgjidhje digjitale për qytetarët dhe bizneset, paraqesin sfida tepër kritike në fushën e sigurisë së informacionit. Në këtë kuptim, përfitimet e shumta që ato ofrojnë shoqërohen me risqe të shtuara për mbrojtjen e të dhënave, ose mund të ndërhyjnë rëndë në sferën private të individëve.

Për rrjedhojë, ato duhen identifikuar dhe duhen menaxhuar në mënyrë proaktive dhe etike. Sikurse të dhënat personale janë thelbësore për novacionin dhe zhvillimin teknologjik, edhe mbrojtja e tyre meriton të njëjtin vlerësim. Kësisoj lehtësohet qarkullimi i tyre, rritet besimi i publikut dhe përfitimet për të gjithë aktorët e përfshirë.

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit për vitin 2022, zyra e Komisionerit është angazhuar në zhvillimin e proceseve të hetimit administrativ në tri drejtime kryesore: për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale; për masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të lëna më herët nga vetë zyra e Komisionerit. Kjo veprimtari është shtrirë në kontrollues që për shkak të funksioneve apo shërbimeve që ofrojnë, përpunojnë kategori dhe sasi të mëdha të dhënash personale të qytetarëve. Nisur nga ky fakt, procedurat e hetimeve administrative kanë rezultuar komplekse dhe voluminoze, sidomos për trajtimin e çështjeve në raport e në harmoni me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Zyra e Komisionerit ka përmbyllur hetimet administrative që u zhvilluan pranë kontrolluesve për publikimin e databazës me të dhënat e pagave të qytetarëve dhe databazës me të dhënat e targave të automjeteve, duke dalë në këtë mënyrë edhe me vendimet përkatëse, të cilat janë bërë publike menjëherë në faqen zyrtare të Komisionerit, si dhe për subjektet apo kontrolluesit që kanë qenë objekt i hetimit administrativ. Në disa raste është zgjatur procedura administrative e hetimit. Kjo ka ardhur si pasojë e gjendjes së krijuar pas sulmeve kibernetike, investigimeve paralele të nisura nga organet ligjzbatuese apo hetimeve të tjera të kryera nga autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat zyra e Komisionerit është në ndjekje dhe në bashkërendim të vazhdueshëm, për aq sa i takon pjesës së mbrojtjes së të dhënave personale, sepse fusha në këtë rast është shumë më e gjerë.

Vëmendja e zyrës së Komisionerit në kontekstin e ngjarjeve të rënda të 2-3 viteve të

fundit me përhapjen masive të të dhënave, është fokusuar në zhvillimin e hetimeve administrative për domosdoshmërinë e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit në sektorin e sigurimeve, në sektorin financiar bankar dhe jobankar, si dhe në sektorin e marketingut të drejtpërdrejtë. Zyra e Komisionerit e konsideron shumë të rëndësishëm zbatimin rigoroz të parimit të mjaftueshmërisë në mbledhjen e të dhënave personale. Me këtë fokus, ne zhvilluam hetime administrative pranë kontrolluesve: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Objekti i procedurave të hetimit administrativ ishte verifikimi i procesit të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesit për aksesin që ata kanë në baza të dhënash të ndryshme shtetërore apo aksesin që u japin institucioneve shtetërore apo subjekteve të tjera që me ligj të posaçëm e kanë të drejtën për të pasur këtë akses.

Për sa u përket disa të dhënave, gjatë vitit 2022 zyra e Komisionerit ka trajtuar gjithsej 370 ankesa për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, ka kryer gjithsej 48 hetime administrative, 41 seanca dëgjimore, ka dalë me 17 vendime dhe me 63 sanksione administrative, si dhe me 9 rekomandime. Është ndjekur me përparësi monitorimi i procesit të transferimit ndërkombëtar në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve. Njëkohësisht, me indicie në rastet kur është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm, është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe më tej janë shqyrtuar praktikatat përkatëse të transferimeve ndërkombëtare, ku zyra e Komisionerit ka trajtuar 5 praktika të tilla.

Zyra e Komisionerit, gjithashtu, është pjesë e disa strategjive të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne jemi pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publik, ku japim kontributin tonë me realizimin plotësisht të indikatorit të ngarkuar. Gjithashtu,

jemi pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit, ku gjithashtu objektivi është i realizuar.

Te kontrata e suportit buxhetor për mirëqeverisjen, edhe këtu për sa i përket transparencës së aktivitetit shtetëror dhe aksesit në informacion, indikator i caktuar për zyrën e Komisionerit është realizuar plotësisht. Gjithashtu, jemi pjesë te Strategjia për Edukimin Ligjor të Publik dhe Planit të Veprimit, tek Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe Planin e Veprimit, te Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur, si dhe te Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Dua të përmend që vlerësimet nga audituesit ndërkombëtarë dhe nga vlerësuesit ndërkombëtarë kanë qenë maksimale për zyrën e Komisionerit për plotësimin dhe realizmin e këtyre indikatorëve.

Gjithashtu, zyra e Komisionerit ka në fokus dhe objektiv të saj realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere. Ashtu siç mund të konsultohet edhe në raportin saj, pa u ndalur në detaje, dua të them se ne kemi zhvilluar rreth 25 aktiviteteve ndërgjegjësuere, jo vetëm në Tiranë, por të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Gjithashtu, vendimet e zyrës së Komisionerit janë të ankimeshme në gjykatë dhe për këtë arsye ne kemi një fluks të madh procesesh gjyqësore. Gjatë vitit 2022 janë ndjekur rreth 60 procese gjyqësore në shkallë të parë. Natyrisht, ato më pas vazhdojnë edhe në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Gjithashtu, zyra e Komisionerit ka realizuar të gjitha detyrimet që burojnë nga progresraporti i Bashkimit Europian, por ajo që kërkohet dhe që është komfort detyrës së vendosur në progresraportin e Bashkimit Europian, është miratimi sa më parë i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Kjo nuk është gjë tjetër veçse transpozimi i rregullores, i asaj që quhet GDPR dhe i direktivës së policisë, gjë që çdo ditë e më tepër bëhet emergjente, sepse mospasja e standardeve të kësaj rregulloreje fillon të

penalizojë të gjitha aktivitetet, qofshin këto të sektorit privat, qofshin ato të sektorit publik.

Në fund, dua të them dy fjalë për natyrën e institucioneve të pavarura. Natyrisht, do të flas vetëm për ato të krijuara me ligj, sepse pikërisht vullneti dhe detyrimi për t’i krijuar konfirmon edhe rëndësinë e tyre. Këto institucione nuk bëjnë asgjë tjetër përveçse kryejnë të njëjtat detyra që ndahen nga ato të qeverisë dhe ministrive, pikërisht për t’u kryer nga institucione të tjera që strukturoren të tilla për të qenë të pavarura, të cilat për këtë shkak duhet të gëzojnë të njëjtën pozitë institucionale, veçanërisht të njëjtën mbështetje, jo të kondicionuar politikisht. Kjo është arsyeja pse nuk duhet të konsiderohen institucione të dorës së dytë apo edhe më keq, vegjetative. Nëse ka të tillë, është detyra e Kuvendit të marrë nismat e nevojshme. Ka një dokument shumë të mirë të Bashkimit Europian të administruar disa vite më parë, i cili mund të shërbejë si pikënisjeje për një reformim të tillë. Besoj se është në të mirën e të gjithëve, të Kuvendit, të qeverisë, të kujtdo deputeti, që si institucionet e pavarura kushtetuese, ashtu të përfshihen edhe ato të krijuara me ligj, sepse është në përfitimin e të gjithëve dhe të vetë atij që quhet “shtet”, pjesë e të cilit jemi të gjithë, që kushdo të ndihet i vlerësuar në pozicionin e tij kushtetues, ligjor dhe institucional.

Ne do të jemi të gatshëm si gjithmonë për çdo kontribut.

Ajo për të cilën dua ta shpenzoj këtë minutë të fundit, është që institucionet e pavarura kanë nevojë për kritika, kanë nevojë për vërejtje, por kanë nevojë edhe për mbështetje, për ta luajtura sa më mirë dhe sa më fort rolin e tyre të veçantë si një natyrë e veçantë pune.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Dervishi!

Nga shërbimet e Kuvendit më bëhet me dije se janë depozituar disa pyetje për ju nga ana e deputetes, zonjës Vokshi. Në qoftë se ju jeni gati për t’u përgjigjur, mund të vazhdoni.

Faleminderit!

**Besnik Dervishi** – Faleminderit!

Atëherë, janë depozituar disa pyetje me të cilat unë u njoha më ...

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju kërkoj përsëri ndjesë!

Ngaqë zoti Dervishi i ka marrë paraprakisht pyetjet me shkrim, mund të procedojmë me përgjigjet, por, nëse ju doni t'i bëni përsëri pyetjet...

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Dakord.

Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen, zoti Dervishi!

Fjala për ju, zonja Vokshi, për të bërë pyetjet.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Si?

Të mbarojë zonja Vokshi njëherë.

Vetëm, ju lutem, kujtohuni t'i bëni pyetjet paraprakisht në mënyrë që të menaxhojmë kohën.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë kam depozituar disa pyetje për Komisionerin, sepse në të gjitha raportet, ato që bëhen brenda vendit, por edhe ato të ndërkombëtarëve, ngrihet në mënyrë të përsëritur shqetësimi për nxjerrjen e të dhënave personale të çdo qytetari shqiptar. Mund të përmend rezolutën e fundit të Parlamentit Europian, ku përmendet, e para, mungesa e transparencës nga ana e institucioneve publike dhe, e dyta, dënohet rrjedhja e të gjitha të dhënave personale të qytetarëve. Kjo është rezoluta e fundit e Parlamentit Europian, tek e cila do të doja që Komisioneri t'u referohej pikave 33, 34 dhe 48, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me punën e tij.

Pyetja e parë që unë kam për Komisionerin është: a ka ndonjë të dhënë personale timen, tuajën, të çdonjërit prej deputetëve, çdonjërit prej votuesve, që ende nuk ka dalë? A na ka mbrojtur ne institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në zbatim të Kushtetutës, në zbatim të të gjithë bazës ligjore të përmendur edhe në raportin e Komisionerit? Po ashtu, pasi i thuren lavde punës së institucionit, në

rezolutë thuhet se institucioni i Komisionerit i ka përmbyllur të gjitha hetimet administrative për publikimin e bazës së të dhënave.

Kujtoj këtu se kanë dalë të gjitha bazat e të dhënave: të pagave, të llogarive bankare, të targave, e kështu me radhë. Ndërkohë, në faqen nr. 21 të raportit të Komisionerit thuhet se nuk janë përmbyllur të gjitha hetimet për sa i përket rrjedhjes së të dhënave, sepse mendohet se ka pasur sulm kibernetik, nga ana tjetër janë nisur paralelisht edhe hetime të autoriteteve vendase dhe të huaja.

Pra, për sa i përket rezolutës dhe raportit të komisionit, nuk e kanë lexuar raportin e Komisionerit, e kanë lexuar shkarazi, apo kanë bërë thjesht një *copy-paste*, pa i kushtuar vëmendje çështjes më të rëndësishme? Kjo çështje është aq e rëndësishme, saqë, nëse kjo që ka ndodhur në Shqipëri, do të ndodhte në një vend të Bashkimit Europian, qeveria e atij vendi do të kishte rënë menjëherë.

Unë bëra një kërkim në raportin e Komisionerit për fjalën “Aktivisti” dhe rezultati ishte zero. Pra, a është në dijeni Komisioneri për aplikacionin e famshëm “Aktivisti”, i përmendur gjerësisht në media dhe i denoncuar nga Partia Demokratike? Pra, ky aplikacion është kallëzuar nga Partia Demokratike, kurse Komisioneri nuk thotë asnjë fjalë ku të përmendë aplikacionin “Aktivisti”. Mendohet se janë mbi 70 mijë punonjës të administratës publike, të cilët janë detyruar të përdorin një aplikacion që menaxhohet nga Partia Socialiste. Nëse futeni tek aplikacioni, e para, nuk respektohen ligjet që ju implementoni; e dyta, kërkohet çdo e dhënë personale e punonjësve të administratës; e treta, nëse punonjësi i administratës refuzon ta instalojë aplikacionin, i shkojnë si bandë në zyrë, ia marrin celularin dhe ia instalojnë kompanitë e lidhura ngushtë me Kryeministrin. Nga ai aplikacion mund të futesh te celularët, tek të dhënat, te fotografitë, madje edhe te lokacioni. Pra, punonjësit e administratës, jo vetëm janë të detyruar të japin çdo të dhënë personale, por...

**Ermonela Felaj** – Zonja Vokshi, më fal, dua t’ju kujtoj ...!

**Albana Vokshi** – Po shpjegoj pyetjet.

**Ermonela Felaj** – Dakord, i bëni pyetjet, por ka një kohë të përcaktuar për pyetjet.

**Albana Vokshi** - Më fal, kam bërë pesë pyetje dhe secila prej tyre kërkon minimalisht 3 minuta. Ju lutem, më lejoni!

**Ermonela Felaj** - Koha maksimale që çdo deputet mund të flasë është 10 minuta. Ju e keni kaluar kohën prej 10 minutash, ndaj përmbliidheni mendimin.

**Albana Vokshi** - Si i kam kaluar 10 minuta?!

**Ermonela Felaj** - Unë po shikoj monitorin.

**Albana Vokshi** - E keni bërë gabim.

**Ermonela Felaj** – Jo, zemër, se është automatike.

**Albana Vokshi** – Unë kam bërë pesë pyetje për Komisionerin, të cilat dua t’i sqaroj.

**Ermonela Felaj** - E dashur Albana, më kupto drejt: më shumë se 10 minuta nuk mund t’ju lejoj për të bërë pyetje. Bëjini si të doni pyetjet, me komente ose pa komente, edhe pse e mira do të ishte pa komente, por, sidoqoftë, ju e keni vendosur kështu. Megjithatë, unë po ju kujtoj për kohën, ndaj, ju lutem, përfundojeni!

**Albana Vokshi** - Më lejoni të vazhdoj me pyetjet, sepse është një çështje shumë e rëndësishme, e cila duhej trajtuar më në detaje qoftë në komision, qoftë në seancë.

Pra, a është në dijeni Komisioneri për përdorimin e gjerë të aplikacionit “Aktivisti”, madje edhe vlerësimit të administratës publike, ndërkohë që i merr çdo të dhënë personale, dokumentet që ka në celular, përfshirë edhe lokacionin?

A është në dijeni Komisioneri për sistemin e patronazhimit, që hartohet, organizohet, merren të dhënat nga AKSHI, që jepen nga çdo institucion shtetëror, me urdhër dhe leje të Kryeministrit?

Kjo është njëra prej bazave të të dhënave ku jeni edhe ju, zoti Komisioner. Kjo bazë të dhënash është përdorur gjerësisht në çdo shtab elektorale të Partisë Socialiste, jo vetëm në zgjedhjet e vitit 2021, por edhe në zgjedhjet e vitit 2023 e

perfeksionuar. A jeni ju në dijeni që ky sistem përdoret në Bashkinë e Tiranës nga patronazhistët, të cilët kanë çdo informacion për ju, për mua dhe për çdo votues, sepse nuk është përmendur në asnjë fjalë në raportin tuaj?

E fundit, a do të ishte më mirë që ta ndryshonim emrin e ligjit nga “I mbrojtjes së të dhënave personale” në “I nxjerrjes së të dhënave personale”, sepse tashmë nuk ka mbetur më asgjë për t’u mbrojtur nga të dhënat personale të çdo votuesi apo qytetari?!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja Vokshi!

Fjala për ju, zoti Dervishi.

**Besnik Dervishi** – Faleminderit!

Unë do të përpiqem të mbetem në kontekstin institucional të një institucioni të pavarur. Natyrisht, çdo deputet ka të drejtë të bëjë pyetje dhe komente politike, për të cilat, jo se unë nuk e kam eksperiencën dhe përgatitjen për t’u përgjigjur, pozicioni institucional që mbuloj ma ndalon një gjë të tillë dhe prandaj do të përgjigjem thjesht në kontekstin institucional.

Nëse do të konsultojmë ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe legjislacionin europian në të cilin ai mbështetet (ligji është 100% i transpozuar me direktivën nr. 9546, e cila ka qenë në fuqi deri në vitin 2018), roli dhe funksioni i zyrës së Komisionerit nuk është ai i mbajtjes apo i përpunimit të të dhënave personale, sepse këtë e bëjnë kontrolluesit, siç quhen në terminologjinë e mbrojtjes së të dhënave personale, qoftë entet publike, qoftë edhe subjektet private, të cilat në aktivitetin e tyre përpunojnë të dhëna personale. Pra, të dhënat personale nuk i kanë dalë Komisionerit, por atyre që kanë pasur detyrimin për t’i mbrojtur ato dhe që, për fat të keq, reflektohet një nivel i ulët ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet, gjë e cila është bërë publike nga Komisioneri.

Gjithashtu, Komisioneri, siç edhe përkruhet në raport, ka zhvilluar hetimet përkatëse, dhe unë do t’ju lutesha të gjenit një rast për të cilin Komisioneri nuk ka hetuar, nuk ka marr vendim



apo nuk është shprehur në rastet kur nuk ka qenë e mundur të zhvillohet hetim, të cilat janë të gjitha publike në faqen zyrtare të Komisionerit.

Për sa u përket pyetjeve konkrete dhe përmbylljes së hetimeve, ne i kemi përmbyllur hetimet për sa i përket databazës së të dhënave të pagave të qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe privat, si dhe të databazës së automjeteve. Për këto, nëse nuk gabo, janë vendimet nr. 51 dhe nr. 52, të cilat janë publikuar në faqen e zyrës së Komisionerit, madje janë vendosur edhe sanksione ndaj subjekteve përkatëse, të cilat, në bazë të hetimit administrativ të Zyrës së Komisionerit, janë konsideruar përgjegjëse. Natyrisht, ato kanë të drejtën t'i ankimojnë në gjykatë, dhe çështja është ende duke u shqyrtuar në gjykatë. Për këtë arsye unë nuk mund të jap më tepër informacion, por ama vendimet e Komisionerit janë publike, janë në faqe dhe mund të konsultohen lehtësisht.

Për sa i përket pyetjes se cilat hetime të Komisionerit nuk kanë përfunduar ende, unë jua përmenda edhe në fjalën time, por është e shpjeguar gjerësisht edhe në raport, janë hetimet që lidhen me aksesin në databazat shtetërore. Ligjet këtu janë miratuar dhe të gjitha organet e reformës në drejtësi kanë akses në databazat shtetërore. Institucioni i pastrimit të parave ka akses në databazat shtetërore, doganat dhe tatimet kanë akses, por nuk mund të kenë akses të pakufizuar, duhet të kenë akses vetëm për atë që është objekt i veprimtarisë së tyre. Në këtë pikë janë konstatuar parregullsi, për të cilat Komisioneri ka ndërhyrë, ka marrë vendimet përkatëse, si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse, deri te regjistri i gjendjes civile, për një akses të kontrolluar.

Këtu po kaloj edhe te pyetja tjetër, për të ashtuquajturit “patronazhistët”. Natyrisht, aksesi në regjistrin e gjendjes civile nuk ndalohe, përkundrazi, ligjvënësi në nenin 60 të Kodit Zgjedhor ka vendosur që këtë të drejtë t'ia japë çdo subjekti politik apo çdo kandidati. A zbatohet legjislati ashtu siç duhet, apo jo? Në qoftë se ju keni prova apo indicie, mund t'i vini në

dispozicion të zyrës së Komisionerit dhe të jeni të bindur, që, ashtu si në çdo rast, ajo do të veprojë me shumë përgjegjësi.

Përpara fushatës zgjedhore të 14 majit, së bashku me KQZ-në, ne kemi prezantuar një udhëzues praktik se si duhet të veprohet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, por, natyrisht, të vetmet që nuk patën interes në këtë drejtim ishin partitë politike, të gjitha pa përjashtim. Megjithatë, ne jua kemi dërguar dhe urojmë të keni gjetur kohën për ta konsultuar dhe zbatuar atë! Fakti që në zyrën e Komisionerit nuk ka ardhur asnjë ankesë për procesin zgjedhor, tregon që ju e keni zbatuar atë me përpikmëri.

Për sa i përket patronazhimit, për të cilin nuk gjetët asnjë fjalë në raport, besoj se biem dakord në këtë pikë. Kjo gjë i përket vitit 2021 dhe e gjeni të trajtuar gjerësisht në raportin e vitit 2021. Nuk mund të jetë në raportin e vitit 2022, sepse është mbyllur në raportin e vitit 2021.

Për sa i përket aplikacionit “Aktivisti”, edhe për këtë ka një qëndrim publik në faqen e zyrës së Komisionerit, por i përket vitit 2023 dhe raportimi i vitit 2023 nuk bëhet këtë vit; ky raportim është për vitin 2022. Megjithatë, në qoftë se ju keni interes (disa kolegë tuajit të opozitës kanë treguar sensibilitet, që nga ana jonë është vlerësuar me shumë përgjegjësi), në faqen e zyrës së Komisionerit ne kemi dhënë një interpretim dhe vlerësim të asaj që kemi konstatuar, i cili mund të konsultohet lehtësisht. Nëse dëshironi, mund t'jua dërgojmë menjëherë.

Për sa u përket raporteve ndërkombëtare, ne jemi shumë të vëmendshëm ndaj tyre dhe i kemi lexuar të gjitha, përfshirë detyrat që lihen për zyrën e Komisionerit. Ne kemi një veçanti në ndryshim me institucionet e tjera të pavarura, sepse prej vitit 2016 zyra e Komisionerit është pranuar si anëtar vëzhgues i Bordit European të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku kemi fatin të marrim pjesë në të gjitha diskutimet dhe trajtimin e çështjeve në mënyrën më profesionale dhe bashkëkohore të mundshme. Ne kemi raportuar edhe për këtë çështje dhe në progresraportin e Bashkimit

European është vlerësuar puna dhe hetimi që ka zhvilluar Komisioneri. Bashkimi European ka lënë detyrë zbatimin nga të gjithë faktorët edhe nga qeveria të rekomandimeve të Komisionerit, për të cilat është hartuar një planveprimi dhe, në kuadrin e madh të sulmit kibernetik, po vijohet me zbatimin e marrjes së masave të sigurisë së informacionit apo ato që quhen *SMSI*.

E fundit, zonja Vokshi, ju i jeni drejtuar zyrës së Komisionerit për shkak se nuk keni marrë përgjigje për kërkesat që keni bërë ndaj autoriteteve publike, por, ashtu si edhe për mbi një mijë ankesa të tjera që vijnë pranë saj, zyra e Komisionerit ka një procedurë të caktuar, që ia imponon ligji dhe nuk mund ta ndryshojë atë.

Ju i jeni drejtuar zyrës së Komisionerit për ankesa ndaj autoriteteve publike në cilësinë e deputetit, por ne nuk mund të ndërhyjmë, sepse kemi një procedurë të caktuar dhe operojmë sipas ligjit nr. 119/2014. Ju jeni drejtuar në bazë të procedurave që përcakton ligji nr.8550, por ne nuk mund ta konkurrojmë këtë ligj, sepse ka një status të veçantë që i jepet deputetit dhe nuk mund të ndërhyjmë në këtë pikë.

Natyrisht, çdo kërkesë dhe ankesë juaja si qytetare është e mirëpritur dhe do të trajtohet njëllë si të gjitha ankesat e tjera. Është thjeshtë çështje procedurale.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Dervishi!

Meqenëse nuk ka pyetje të tjera për ju, mund të largoheni.

Suksese në aktivitetin tuaj, zoti Dervishi!

**Besnik Dervishi** - Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Fjalën e ka zoti Taulant Balla. Të përgatitet zonja Ina Zhupa.

Koha në dispozicion për zotin Balla është 10 minuta.

**Taulant Balla** – Nuk besoj se do t'i harxhoj 10 minuta.

Është bërë e udhës që opozita, e cila humb zgjedhje pas zgjedhjesh, e shikon arsyen e humbjes të struktura organizative të Partisë Socialiste. Dëgjova zonjën Vokshi të përmendte patronazhistët apo aktivistët e Partisë Socialiste,

një strukturë ose organizim që e kanë të gjitha partitë politike fituese në Europë.

Ju (jo ju, bishti, por flas për ata që janë Partia Demokratike me letra), jeni parti simotër e kristian-demokratëve gjermanë, ndaj mund t'i pyesni ata nëse kanë një aplikacion të vetin. Pa dyshim që e kanë.

Të thuash në sallën e Kuvendit të Shqipërisë pse Partia Socialiste ka një aplikacion të vetin dhe ky është dhunim i të dhënave personale, minimalisht është idiotësi dhe, meqenëse ju vazhdoni ngulni këmbë në këtë idiotësi, ne do vazhdojmë t'ju mundim përsëri.

Dua të sqaroj opinionin publik se organizimi ynë, qoftë përmes atyre që quhen patronazhistë, që e kanë të gjitha partitë dhe Partia Demokratike amerikane është modeli më i mirë i këtij organizimi, qoftë aplikacionit "Aktivisti", është diçka që, falë edhe institucioneve, dhe këtu përmend edhe Komisionerin, bëhet me vullnet të lirë të qytetarit, të shtetasit dhe nuk ka asnjë kundërvajtje ligjore me atë që përcakton i gjithë legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë.

Ardhja këtu për të sulmuar, për të intimiduar, madje një tjetër ka bërë edhe kallëzime, se nuk e shikoj atë të vulës këtu, Alibeajn, është keqardhje shumë e madhe. E vërteta është që tek aplikacioni "Aktivisti" hyn me vullnet të lirë dhe jep miratimin paraprak për të dhënat personale që adreson, që janë minimale, si adresa e *email*-it. Juve mirë t'ju bëhet dhe nuk keni për të vënë mend kurrë (po flisja për bishtin e sallës, për zonjën Vokshi), por ne do të vazhdojmë të respektojmë ligjin.

Dua të them edhe diçka tjetër, meqenëse është raportimi i një institucioni me rëndësi. Nëse do të ishim në sallën e Parlamentit European, raportimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të ishte një prej raportimeve më të rëndësishme në kushtet kur Shqipëria si sot një vit më parë ka qenë një ndër vendet që është vënë nën një sulm kibernetik, tashmë e provuar se pas të cilit qëndronte Republika Islamike e Iranit.

E vërteta është që secili prej nesh duhet të gjejë rastin për të falënderuar aleatët tanë strategjikë, në mënyrë të veçantë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët po bashkëveprojnë me Shqipërinë për të rritur kapacitetet tona mbrojtëse ndaj këtyre sulmeve. Keqardhja më e madhe është se nga ajo që ka mbetur në këmbë nga dikur Partia Demokratike ende nuk ka një qëndrim zyrtar për të mbështetur të gjithë reagimin institucional ndaj këtij sulmi nga Kryeministri, te qeveria dhe të gjitha institucionet e tjera, përfshirë këtu edhe ato të sigurisë. Neve si Kuvend na takon të bëjmë rolin tonë për të përmirësuar kuadrin tonë ligjor përkundrejt situatave të tilla.

Sulmet ndaj të dhënave personale janë të rënda dhe na kanë treguar se legjislacioni ynë nuk është ende adekuat për t'ju përgjigjur kësaj situatë. Këtu shikoj edhe nevojën që rezolutat që bëjmë ne, si Kuvend, dhe këtë e kam ngritur sot edhe në Konferencën e Kryetarëve, nuk mund të jenë një qokë që ne ia bëjmë një institucioni, por duhet të jenë një qëndrim i Kuvendit të Shqipërisë ndaj problemit. Institucioni zbaton ato që i themi ne, atë që ka ligji, kurse fokusi i rezolutave tona duhet të jetë fenomeni ose i gjithë sektori.

E vërteta është që e kam parë rezolutën dhe mirë do të ishte që në të të kishim vënë edhe diçka për reagimin që patëm për sulmin, sepse, në fund të fundit, sulmi kibernetik kishte si objekt dhunimin e të dhënave personale të shqiptarëve, bllokimin e infrastrukturës sonë kritike të komunikimit.

Duke e lidhur me atë që thashë në Konferencën e Kryetarëve, raportimet në Kuvendin e Shqipërisë nuk mund të bëhen institucion për institucion, por Kuvendi i Shqipërisë duhet të jetë kupola në kuptimin e piramidës institucionale ku merren fushat.

Do të kemi katër raportime për drejtësinë: nga KLGJ-ja, KLP-ja, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por qëndrimi i Kuvendit duhet të jetë për të katërta së bashku.

Gjithsesi, ky është një opinion që e kemi diskutuar sot në Konferencën e Kryetarëve dhe, natyrshëm, duhet të gjejmë të gjitha instrumentet për ta adresuar, në mënyrë që të kemi mundësi të rrisim forcën monitoruese dhe udhëheqësinë që Kuvendi i Shqipërisë ka në secilën prej këtyre. Të mos harrojmë se jemi një Republikë Parlamentare, ku Kuvendi luan një rol të rëndësishëm.

E fundit që kam, meqë hyri në sallë një bashkëpunëtor i vjetër shkencor i atyre që kanë interesa të kundërta me interesat e Shqipërisë dhe shqiptarëve, e kam thënë në seancën e kaluar dhe mendoj se brenda seancës së ardhshme duhet ta kalojmë në Kuvendin e Shqipërisë vendimin për ngritjen e një komisioni të posaçëm për ndërhyrjet e huaja në proceset demokratike dhe jo vetëm, ku Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndjekë modelin e Kongresit Amerikan, por edhe të Parlamentit Europian për të mbledhur informacion për të gjitha financimet e paligjshme ruse që kanë penetruar në parti të caktuara politike në Shqipëri apo në individë të caktuar, por edhe për të përmirësuar legjislacionin për të parandaluar raste të tilla të financimeve dhe të ndërhyrjeve të huaja në parti politike apo në procese, qofshim këto edhe financime në media të caktuara.

Meqenëse këta gjoja e hetuan brenda Partisë Demokratike duke ngritur edhe një komision hetimor për të ashtuquajturat financime ruse, ti, udhëheqësi i foltores, nxore ndonjë raport nga kjo apo ishte ti ai që i solle dhe ia ngece Lulit, si gjithmonë?

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

Të përgatitet zoti Leskaj.

Koha në dispozicion për zonjën Zhupa është 10 minuta.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, e nderuar zonja drejtuese e seancës!

Sot kemi raportimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne duhet ta kishim sa më të hapur informacionin dhe sa më të mbyllura të dhënat

personale por, në fakt, kemi të kundërtën, kemi shumë të hapura dhe jashtëzakonisht shumë publike të dhënat personale dhe kemi të mbyllur informacionin.

Kur them se e kemi informacionin të mbyllur, nuk e kam fjalën për informacionet që një qytetar i thjeshtë kërkon të marrë nga institucionet publike, por ne deputetët, që kemi një status të veçantë, e kemi të pamundur të marrim informacion nga ministritë për kërkesat tona të përsëritura. Komisioneri nuk mund të bëjë asgjë tjetër, vetëm t'u rithotë ministrive që t'i dërgojnë.

Këtu lind detyra jonë, në fakt, sepse, në qoftë se kemi një detyrë, ajo lidhet me ligjëbërjen. Duhet të vendosim sanksionime, zoti Balla, për ato ministri që nuk u kthejnë përgjigje deputetëve për informacion që ata kërkojnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

E kemi ligjin “Për statusin e deputetit”, por nuk zbatohet. Çfarë ndodh kur ata nuk e zbatojnë? Ja një rast konkret i Ministrisë së Kulturës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Qeshni me kulturën, se ju duket qesharake!

I kam dërguar pesë kërkesa me të njëjtin objekt: vënien në dispozicion të mënyrës si janë marrë dokumentacionet, dosja e zgjedhjes së Richard Hodges-it dhe të gjitha komunikimet me UNESCO-n. Gjykata Kushtetuese ka thënë se informacionet duhen dërguar, por Ministria e Kulturës nuk i nis. Të gjitha kërkesat i kam me data dhe numër protokoll: Nr. prot. 3008, datë 13.09.2022; nr. prot. 3009, datë 13.09.2022; nr. prot. 3008/2, datë 18.10.2022, për të ardhur në vitin 2023 me kërkesat e fundit.

E ke në ligj, thotë. E kam në ligj që mund ta kërkoj, por nuk e kam në ligj çfarë ndodh nëse një ministri nuk kthen përgjigje. Nuk besoj se jam rasti i vetëm, sepse ky është rast i përsëritur i kolegëve të opozitës, të cilët dërgojnë kërkesa për të marrë informacion, por informacioni nuk dërgohet. E drejta e informimit nuk zbatohet, sepse me siguri në këtë informacion fshihen shkelje, sepse, në qoftë se nuk do të fshiheshin shkelje, informacionet do të ishin dërguar dhe madje mund të ishin publikuar.

Nga ana tjetër, kemi të dhënat personale që, në fakt, duhet të jenë të paaksesueshme.

Zoti Balla, i cili sapo iku, tha se të dhënat personale i nxorën sulmet e huaja. Edhe pse sulmet e huaja ishin, kjo është e pavërtetë, sepse të dhënat personale kishin dalë shumë më përpara nga sulmet e brendshme, nga sulmet e kësaj qeverie, e cila i dorëzoi të gjithë databazën e *e-Albania-s* strukturave të Partisë Socialiste për të ndërtuar databazën e patronazhistëve, që nga karta e identitetit dhe të gjitha elementet e tjera të sigurisë, që duhet të ishin të mbrojtura me ligj. Jo vetëm kaq, por ndërtoi aplikacionin “Aktivisti”, duke i lejuar akses në celular Partisë Socialiste për të marrë dhe për të kontrolluar të dhënat personale të punonjëseve të administratës publike, të cilët, siç më kanë pohuar vetë, nuk e bënë me dëshirë, por me detyrim. Brenda çdo institucioni ka një koordinator që shikon sa persona e kanë shkarkuar aplikacionin “Aktivisti”, sa janë duke e shpërndarë, sa pikë kanë dhe i krahasojnë punonjësit me njëri-tjetrin për të matur performancën në punë. Pra, performanca në punë matet me sa *share* dhe *like* i bëhen Edi Ramës, ministre apo ministrave.

Aplikacioni “Aktivisti” ishte për të bërë propagandën e fushatës në të gjitha rrjetet sociale. duke i detyruar punonjësit t'i bënin *like*, *share* dhe koment propagandës suaj qeveritare dhe tallavasë suaj qytet më qytet.

Për sa u përket listave të Partisë Socialiste, unë kam aksesuar një listë të Partisë Socialiste për një grup-seksion në Sarandë, e cila kishte të dhëna të çuditshme, si, për shembull, të aktiviteteve që bënte qytetari. Pra, kishte të dhëna sa banorë ishin në familje, ku punonin fëmijët, ku shkonte kryefamiljari dhe çfarë preferonte, që në këtë rast ishte shahu. Në fakt, ne si qytet kemi edhe kampion shahu. Ishte e tmerrshme! Një sistem kontrolli i ngjashëm me ish- Sigurimin e Shtetit, ku dinin edhe sa lugë ka në familje, dhe të gjitha në funksion të votës, të gjitha në funksion të blerjes së votës.

Nëse do të ishin të dhëna, të cilat merren me dëshirë nga qytetarët, dhe qytetarët i përgjigjen

një pyetësori të Partisë Socialiste, do të ishte plotësisht e ligjshme, por në momentin kur ju i merrni të dhënat nga sisteme shtetërore dhe kur i detyroni punonjësit e administratës publike të shkarkojnë aplikacionin, se ndryshe do të pushohen nga puna, të maten pikët, atëherë kjo është totalisht e paligjshme. Kur shteti shkrihet me partinë dhe kur fushatën nuk e bën më partia, por e bën shteti, atëherë ne kemi një deformim të sistemit politik dhe të vullnetit të qytetarëve, sepse ju arrini të shkelni jo një, jo dy ligje, por të shkelni të drejtat kushtetuese të individëve.

Së fundi, diskutojmë këtu si mund të mbrohemi nga sulmet e shteteve të huaja, kur nuk ka më të rrezikshme se kjo qeveri dhe sjellja e saj prej pushtuesi dhe prej arroganti ndaj ligjeve. Shkelja në mënyrë masive e ligjeve me filozofinë enveriste “Pse ligjet tona do të na ndalojnë ne?!”, na ka bërë të jemi këtu ku jemi, në një situatë ku e drejta e informimit është zero dhe mbrojtja e të dhënave personale është po aq zero.

Unë nuk mund të gjykoj gjerësisht mbi rolin e Komisionerit, kur, në fakt, shkeljet i bën qeveria dhe hapësira ligjore është e tillë, që Komisioneri është vetëm në parametrat e tij rekomandues dhe në nivelin e ulët të iniciojë një proces ndjekjeje për të; asnjë gjë për Kryeministrin, asnjë gjë për ministrat, të cilët janë të parët, madje me urdhrin e tyre shkelet e drejta e informimit për të mos i dhënë informacion opozitës për vjedhjet dhe për shkeljen e ligjeve.

Listat e Partisë Socialiste, në fakt, u shpërndanë masivisht edhe në medie, dhe patëm mundësi t’i aksesonim të gjithë, ashtu siç më pas dolën listat, po ashtu shtetërore, siç ishin targat, pagat, të cilat me siguri nuk kishin funksion fushatën elektorale, por kishin funksion për të treguar se sa shtet të dobët kemi ne, shteti që nuk pyet për të dhënat personale të individëve në Shqipëri, ku individit sot është shumë më i pasigurt se ç’ ishte për shkak të këtij shteti që, në fakt, ka harxhuar miliona euro. Shikoni tenderët e AKSHI-t, shikoni kush i merr ato tenderë, dhe kuptoni nivelin e sigurisë kibernetike në Shqipëri! Nuk është rastësi. Kur ti i përdor këto edhe si qoka

për të kapur politikisht dhe për të pasuruar klientët, sigurisht ky do të jetë niveli i mbrojtjes kibernetike dhe, sigurisht, ky do të jetë shteti prej kartoni, që i vë të gjitha si në një vitrinë, ku gjithsecili mund të dijë gjithçka për të tjerët.

I vetmi sistem që ka shpëtuar deri tani është ai i bankave, edhe këtë ju doni, në fakt, ta shkatërroni me planin e ri, që edhe bankat t’i fusni brenda e-*Albania-s*, që dhe bankat, meqë nuk janë hakëruar dot deri tani kursimet e shqiptarëve, me sistemin e-*Albania* t’i aksesoni edhe paratë e shqiptarëve.

Në përfundim të fjalës sime, dëshiroj të bashkohemi për ndryshimet ligjore për të forcuar të drejtën e informimit dhe për të vendosur sanksione të rrepta edhe financiare, duke filluar që nga Kryeministri dhe ministrat, kur shkelin të drejtën e informimit të deputetëve dhe të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja Zhupa!

Zoti Leskaj, fjala është për ju.

Të përgatiten zoti Berisha dhe zoti Bylykbashi!

Zoti Leskaj dëshiron të flasë nga vendi, ju lutem, 10 minuta për zotin Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Faleminderit!

Raportin vjetor për vitin 2022 i zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, po ta shikosh nga ana formale, është në rregull. Edhe të dhënat që jep nga ana sasiore janë të konsiderueshme. Megjithatë, për mendimin tim, ky lloj konceptimi i raportit nuk e jep të qartë atë realitet që ekziston në Shqipëri, raportet që kanë institucionet tona publike, dhe jo vetëm, me të drejtën e informimit dhe me mbrojtjen e të dhënave personale. Realiteti në vend është i trishtë. Unë mendoj se ka ardhur koha që Komisioneri të mos mjaftohet me treguesit sasiorë, por ndoshta në të ardhmen analizën e tij duhet ta formatojë, ta paraqesë si një analizë të tipit *SWOT*, ku të japë fuqitë, dobësitë e institucionit, mundësitë dhe kërcënimet për institucionin dhe fushat që ai mbulon. Megjithatë,

kjo është një e drejtë që ligji ia njih Komisionerit dhe ne duhet ta respektojmë pavarësinë e tij.

Nga ana tjetër, pozicioni i deputetit nuk më pengon mua të shpreh mendimet e mia, që më tepër janë në trajtën e një mendimi oponent, jo mendimi opozitar.

Në mendimin tim misioni i Komisionerit është i përcaktuar, por, kur lexon në faqet 12-13 të raportit për indeksat e transparencës, të krijuhet përshtypja se nga niveli i objektivave të arritur, duhet të jemi vendi model në Europë dhe ndoshta në botë, vend që duhet të marrin shembull. Kjo më kujton një praktikë të vjetër të paraardhësve tuaj, në vitet 1989, kur morëm çmimin për vendin me ushqyerje më të mirë në botë.

Të ndalemi tani te Komisioneri. Ne e dimë që realiteti nuk është kështu. Në radhë të parë, theksoj faktin që institucionin e Komisionerit duhet ta ndihmojmë të gjithë ne të tjerët, qoftë me përmirësime ligjore si ligjvënës, por edhe me mbështetje të drejtpërdrejtë. Në këtë raport janë dy pyetje, që nuk marrin përgjigje të qartë:

1. A e ka realizuar zyra e Komisionerit misionin e saj të mbikëqyrjes efektive të zbatimit të kuadrit ligjor të mbrojtjes së të dhënave dhe të së drejtës për informim, të garantimit të ushtrimit të efektshëm të të drejtave të qytetarit në epokën digjitale? A ka kërkuar përmirësime ligjore për këtë?

2. A ka arritur zyra të rritë përgjegjësinë dhe ndërgjegjësimin e autoriteteve publike dhe kontrolluesve të të dhënave në sektorin publik dhe atë privat, i cili sjell përmirësimin e mendësisë dhe kulturës së shoqërisë, në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut?

Këto janë dy pyetje, që mendoj unë se Komisioneri dhe zyra e tij duhet t'u japin përgjigje të drejtë, ashtu siç bazohen në parimet e paanshmërisë, integritetit, transparencës, që Komisioneri i përmendi, pra bazuar në këto parime duhet të kthejë përgjigje për këto dy pyetje.

Nga ana tjetër, në veprimtarinë e zyrës së Komisionerit shikojmë se në realitet, pavarësisht përpjekjeve që Komisioneri ka bërë, nuk ka asgjë

për të luftuar me efektivitet stereotipin e përgjigjes formale dhe në fshehje të së vërtetës. Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që, për çështje sensitive ose që shqetësojnë opinionin publik, përgjigjet e institucioneve publike ndaj kërkesave për informim janë formale, me një formulim tërësisht burokratik dhe në tërësi fshehin të vërtetën, duke qenë joshteruese. Në ankesat që i drejtohen zyrës së Komisionerit, kjo zyrë, me të drejtë, pranon të drejtën e qytetarit për t'u informuar, përcjell shkresën e vet, por në praktikë bën shumë pak përpjekje reale për të garantuar zbatimin e kësaj të drejte tek institucioni publik, që e ka shkelur atë me mospërfilljen apo dhënien e një përgjigjeje joshteruese.

Vetëm 17 vendime me 63 sanksione administrative të dhëna në vit (faqe 25 e raportit) për një institucion me një staf rreth 50 punonjës, janë shumë pak, në nivel të treguesit sasior të mbrojtjes reale të së drejtës për informim të qytetarit, ndaj aktivitetit të enteve publike. Lind pyetja: sa nga këto 17 vendime janë bërë publike nga zyra e Komisionerit? Jo thjesht të vendosen në faqen e *web-it*, por të bëhen publike, të përcillen në media dhe zyra ta përdorë shembullin e presionit dhe shembullin pozitiv të sanksionimit publik përmes publikimit të vendimeve të saj dhe shpërndarjes së tyre me anë të mediave, dhe të gjejnë mundësinë të shkojnë te qytetarët.

Së treti, ne nuk shikojmë asnjë përpjekje, ose shumë pak përpjekje, që të jem i saktë dhe unë, se përpjekje janë bërë, për të nxjerrë përgjegjësit dhe për të sanksionuar institucionet që lejuan rrjedhjen e të dhënave sensitive të qytetarëve në dhjetor të 2021-it. Ne jemi të gjithë dëshmitarë të atij realiteti dhe në faqen 32 të raportit ne mësojmë për vetëm 2 vendime të marra nga zyra në muajt nëntor - dhjetor të vitit 2022, si rrjedhojë e kërkesës së Kuvendit.

Sa hetime të thelluara administrative ka realizuar zyra e Komisionerit, pas publikimit të skandaleve, pranë institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e bazës së të dhënave për pagat dhe për targat e automjeteve? Sa u ka shkuar ajo deri në fund? Vërtet kanë nisur

hetimet, por zyra e Komisionerit duhet të punojë me këmbëngulje dhe përkushtim për rritjen e imazhit, besueshmërisë dhe potencës së saj në publik. Gjykoj se janë me qindra, në mos mijëra raste në vit, të shkeljes së të drejtës për informim dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat nuk i raportohen zyrës vetëm nga mungesa e kredibilitetit të saj apo ajo ndjenjë e pesimizmit që ka kapur qytetarët shqiptarë.

Në raportin vjetor mungon, gjithashtu, treguesi i nivelit të plotësimit të rekomandimeve të dhëna nga zyra e Komisionerit në aspektin cilësor, jo thjesht në aspektin sasior. Në të gjithë raportin zyra është treguar e kujdesshme, kjo flet për punë të saj, por është treguar e kujdesshme vetëm për të dhënë aspektet sasiore të saj.

Zyra duhet të adresojë me seriozitet dhe të japë propozime për përmirësim ligjor ndaj problematikës së hasur dëndur, lidhur me mënyrat e dhënies së informacionit të kërkuar nga ana e autoritetit publik. Aktualisht ligji i lë “dorë të lirë” autoritetit publik për të vendosur ndaj formës së dhënies së informacionit, që nuk ka të bëjë me një dokument të shkruar dhe kjo e vështirëson marrjen e informacionit të kërkuar nga qytetari.

Zyra duhet të japë zgjidhje për problematikën ligjore të zbatimit të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi ligji në këtë pikë parashikon se informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Çfarë do të thotë kjo, që ky informacion të jepet me kosto më të lartë për qytetarin apo për institucionin e interesuar?!

Së fundi, unë mendoj që zyra do të bëjë përpjekje në këtë drejtim, por duhet të marrë fuqishëm dhe mbështetjen tonë; zyra duhet të punojë si lokomotivë, nuk duhet të pranojë klauzola konfidenciale në kontratat publike.

Në faqet 15-16 të raportit vjetor përshkruhen disa problematika të hasura gjatë marrjes së ankesave nga zyra, ku me të drejtë zyra cilëson si ndër kryesoret, po citoj: “Vijon paqartësia nga ana e autoriteteve publike, në lidhje me parimin e konfidencialitetit në kontratat publike dhe sekretin tregtar, trajtuar jo në përputhje me

parashikimet e nenit 17 të ligjit për informimin publik. Në kontratat publike shpesh parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me to dhe në rast të moszbatimit të tyre parashikohen sanksione ndaj autoriteteve publike”.

Gjykoj se adresimi i këtij shqetësimi duhet të përbëjë një kalë beteje për zyrën për vitin 2023. Autoriteti i mbrojtjes së të drejtës për informim duhet të bëjë objektiv parësor të punës së tij, që të mos kemi klauzola konfidencialiteti në kontratat për punët publike apo në kontrata të përfitimeve të pronës publike. Autoriteti duhet të argumentojë dhe të fitojë betejën ligjore, ta nisë këtë betejë, ku interesi publik të prevalojë mbi interesin e mbrojtjes së sekretit tregtar, në rastin e kontratave publike me pasurinë shtetërore, me të cilin abuzohet shumë dëndur për të shmangur dhënien e informacionit të kërkuar dhe për të fshehur të vërtetën.

Zyra e Komisionerit, në thelb, është dhe duhet të mbetet avokate e transparencës dhe e së drejtës për informim dhe, në këtë fushë, unë e inkurajoj aktivitetin e saj.

Nisur nga fjalia që tha në fillim Komisioneri, besoj të jem i mirëkuptuar në këto vërejtje që i bëra, që ta kalojë zyrën në një pozicion më dinamik, ne kemi nevojë për institucione që të jenë në pozicione dinamike, jo në pozicione statike.

Për analizën *SWOT* nuk kam kohë, por ia rekomandoj Komisionerit ta përdorë në raportet e tij dhe do të shikojë që do të jetë shumë më e dobishme për të, për institucionin, por mbi të gjitha për qytetarët dhe për institucionet shqiptare.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Fjala për zotin Berisha. 5 minuta në dispozicion për zotin Berisha.

Të përgatiten zoti Bylykbashi dhe zoti Petrit Vasili.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)*

Po, është jashtë grupit.

**Sali Berisha**- Ky raport, të nderuara deputete dhe deputetë, zonja kryesuese e seancës, mund të quhet raporti i Komisionerit të shitjes së të

dhënave personale të qytetarëve shqiptarë. Komisioneri, i ngarkuar me ligjin për mbrojtjen e këtyre të dhënave, është figura zyrtare më qesharake e globit.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)*

Prit se do të kthehem edhe ty tani, se ti vendin e ke te Gjushi, se je ti që njoftove Gjushin katër ditë përpara dhe dekonspirove dhe tani i thonë “S’KAP-it”, kush ta nxori sekretin? Ulsi Manja e nxori sekretin. Ky është njeriu i pazareve me Edi Ramën. Ky merr përsipër të gjitha pazaret. Kush ia tha Gjushit? Ti ia the. I gjithë Durrësi flet për ty, ke nxjerrë sekretin. Se je ti njëlloj Jagoje, që ke vetëm veten shok, dhe mos më ndërpre, të lutem shumë!

Ky është Komisioneri i shitjes së të dhënave, figura zyrtare më qesharake e planetit, që pretendon se ka një ligj dhe zbaton një ligj, por që ligji i thyhet, jo një apo dy, por 1 milion herë, dhe ligji shkëlmohe për të ndihmuar, së pari, armiqet e Shqipërisë, duke nxjerrë në shesh të gjithë organigramën dhe të dhënat e Shërbimit Informativ Kombëtar.

Ligji thyhet për të ndihmuar klanet e tmerrshme të krimit dhe mafies shqiptare në Shqipëri, në Ballkan, në Lindjen e Mesme, në Europë, pra në të gjithë botën. Të gjitha targarat u nxorën në treg, ja nga këta që rrinë mbrapa shpine, sepse duhet t’i mësonin kriminelët për të kalibruar nishanin e tyre.

Çfarë Komisioneri je ti, më thuaj mua pak? Ligji mbron të dhënat personale të qytetarëve, por 1 milion qytetarëve ua nxorën të dhënat personale dhe ua dhanë terroristëve të kuq, të quajtur patronazhistë, për përdorur këto për manipulime zgjedhore. A e dini ju se këta patronazhistë, edhe në zgjedhjet e fundit, kërcënuan burra e gra, të rinj dhe të reja, se “do t’ju bëjmë copa, do t’jua marrim shpirtin”?

A e dini ju se kriminelët elektoralë, të armatosur me këto të dhëna, ushtruan një terror të përgjithshëm mbi votuesit shqiptarë?

Çfarë Komisioneri je ti? Komisioneri i shitjes së të dhënave. Ti nuk mund të vije në parlament,

ti duhet të ishe te Gjushi, te Shullazi, atje e ke vendin ti!

Pra, a ka seancë me qesharake se kjo? Raportojnë një raport funeral të të dhënave, që qytetarët në mirëbesim ia japin një shteti, që nuk ka as ligj dhe as moral, një banditokracie. Në cilin shtet ka ndodhur kjo në botë? Jo, mor jo! Të dhënat më sensitive i keni nxjerrë ju vetë. Irani bëri atë që bëri, por dy vite para Iranit ju nxorët patronazhistët, nxorët targarat, nxorët Shërbimin Informativ Kombëtar. Kush e theu TIMS-in, më thoni ju mua?

**Ermonela Felaj** - Përfundoni, zoti Berisha!

**Sali Berisha** - Vetëm policia.

Tani, për ta mbyllur, dy fjalë për këtë *bodyguard*-in e Edi Ramës, se në qeveri punë *bodyguard*-i je, çfarë je ti aty, më kupton, apo jo? Ke kryer një zinxhir krimesh të tmerrshme elektorale gjatë këtij sezoni. Dhe ja, po ta them këtu, do të përgatisim një dosje ndërkombëtare, kombëtare kundër teje.

**Ermonela Felaj** - Jua kam ndërprerë fjalën, ju lutem, sepse kaq është koha, e kam sqaruar, por ju bëni gjithmonë të njëjtën histori me kohën.

*(Zoti Berisha vazhdon të flasë pa mikrofon)*

Mund të përdorni instrumente të tjera parlamentare për të zgjatur kohën e fjalës suaj, zoti Berisha, dhe ju e dini këtë gjë.

Zoti Manja, keni fjalën për replikë.

**Ulsi Manja** - Nuk e di pse je shqetësuar, Sali, se të shoh shumë të shqetësuar, në fakt. Zgjedhjet e 14 majit mbaruan, të pres në betejën tjetër, në vitin 2025, por sa herë do të dal në betejë elektorale do të të mund ty dhe këdo që është pas teje.

Së dyti, sa për drejtësinë, Sali, jam shumë i lumtur që e arritëm këtë ditë, që unë edhe ti të shkojmë para drejtësisë, mezi e pres këtë ditë. Kam përshtypjen se ti do të shkosh para meje, por unë mezi e pres këtë ditë.

Më në fund, reforma në drejtësi, ajo për të cilën ky parlament në vitin 2016 votoi me 140 vota, po prodhon rezultate të prekshme për qytetarët shqiptarë. Unë për këtë ditë kam pritur dhe shoh që sot më i shqetësuar je ti se unë për



këtë drejtësinë e re, por këtu do të jemi dhe do të shohim se kush do ta ketë raportin me drejtësinë. Unë gjithë jetën kam luftuar për drejtësinë, Sali, sepse vij nga ajo fushë dhe e kam vokacion personal drejtësinë, sepse për atë jam shkolluar, ndërsa ti në profesion je mjek, tani raportin me drejtësinë do ta shohim të dy bashkë.

Sa për të tjerat, për betejat elektorale dhe të tjerat, jam i hapur, por sa herë të dal me ty në shesh të mejdanit, kur të na thërrasin qytetarët për zgjedhjet në mes meje dhe teje, do të të mund ty dhe këdo tjetër.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Ministër i Drejtësisë!

Fjalën e ka zoti Oerd Bylykbashi, 5 minuta.

Të përgatitet zoti Vasili dhe me diskutimin e zotit Vasili do të mbyllet diskutimet për këtë pikë.

**Oerd Bylykbashi** - Në vitin 2021 ODIHR-i vuri vulën me rekomandimin kryesor që bëri, ku kërkoi të merren masa për të mbrojtur sekretin dhe lirinë e votës. Më keq se kaq nuk mund të shkonin zgjedhjet dhe besoj se nuk keni ndonjë opinion të ndryshëm. Të cenosh sekretin dhe lirinë e votës, është të godasësh themelin e parimeve bazë për zgjedhje, por që ta bësh këtë duhet të krijosh edhe një mekanizëm, i cili, për të qenë efikas, duhet të jetë i gjerë, i shtrirë në territor, të jetë i mirëfurnizuar me njerëz, por, mbi të gjitha, me informacion. Dhe këtë gjë mund ta bëjë vetëm shteti, vetëm qeveria, vetëm ajo i ka të gjitha resurset, bazat e të dhënave dhe njerëzit për t'i shpërndarë kudo, për të krijuar sistemin e profilizimit të çdo zgjedhësi. Të profilizosh atë, që në vende të tjera u përpoqën dhe e arritën me vështirësi, dhe për të pati edhe hetime, edhe skandale, siç ishte ai i "Kembrixh Analitika" në zgjedhjet amerikane, këtu nuk ka nevojë të marrësh kompani, është shteti, e bën ai, është shteti i gjithi në këmbët e Edi Ramës, edhe të gjitha institucionet, edhe të pavarurat.

Të gjitha bazat e të dhënave të shtetit janë vënë në dispozicion të Partisë Socialiste, dhe nuk është hera e parë, dhe nuk ka pse çuditet as Komisioneri për këtë gjë. Nuk po bie sot nga qielli kjo, është e

provuar që në vitin 2021. Janë marrë të gjitha të dhënat personale sa u përket të dhënave bazë nga gjendja civile, nga çdo bazë të dhënash, nga tatimet, nga taksat, nga çdo gjë përmes së cilës kuptohet çfarë halli, interesi dhe dobësie ka çdo zgjedhës.

Nëse në një vend normal, me shumë zgjedhës, maksimumi i profilizimit arrihet te grupet dhe u ofrohet pensionistëve, u ofrohet punonjësve të kategorive të ndryshme ofertë politike, ju arrini, në një vend që zbrazet për ditë (rreth 170 mijë veta kanë ikur nga ky vend midis viteve 2021-2023, sipas të dhënave zyrtare të Bashkimit Europian), pra ju profilizoni çdo individ dhe këtë e bëni në shkelje brutale dhe flagrante të kornizës kushtetuese dhe ligjore, sepse ju e dini çfarë halli ka secili, çfarë nevojë ka, çfarë do t'i ofroni, si do t'ia blini votën, pra si do ta blini që të mos votojë, dhe, nëse të gjitha këto nuk i arrini, u bëni presion me banditë, që të qëndrojnë në shtëpi. Që ta bëni këtë, ju duhet informacion, sepse administratën publike e keni. Pra, ja si vjen bashkë me diçka tjetër, me atë që në vitin 1990 u lodh kot OSBE-ja dhe e shkroi në dokumentin e Kopenhagënit, edhe ne jemi shtet anëtar, se duhet ndarje e qartë midis shtetit dhe partive politike, në mënyrë të veçantë partitë nuk duhet të shkrihen me shtetin. Zgjedhjet e 14 majit janë prova më skandaloze e një shkrirjeje totale të shtetit te Partia Socialiste, pra, jo Partia Socialiste te shteti, shteti te Partia Socialiste, me të gjitha bazat e të dhënave. Tani, a ka bazë të dhënash që ka mbetur pa e ditur kushdo në këtë Republikë? Kështu që, edhe raporti i Komisionerit sot është krejt i kithët me realitetin për sa i përket kësaj.

Ta kuptojmë: po të jetë e nevojshme e bëjmë amendament në Kushtetutë dhe e heqim atë nen. Nuk ka fare nevojë të bëjmë *aproximim* me BE-në, me direktivën. Pse? Koncepti juaj është koncept nudist për të dhënat: çfarë na duhen neve?! Pse duhet të mbrohemi ne me të dhënat personale?! Ato janë krejtësisht të hapura. E ka Kryeministri këtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Besoj ta bën asosacioni, koleg, apo jo?

Pse duhen të dhënat? Duhet që të gjitha të jenë në shesh, të gjitha t'i ketë partia në pushtet. Kështu që, në këtë aspekt është e kotë që lodhet ODIHR-i duke shkruar. BE-ja është gati të miratojë një rezolutë, ku thotë: “Dënojmë përdorimin e paautorizuar të të dhënave private, përfshirë këtu partitë politike dhe u bëjmë thirrje autoriteteve të marrin masa urgjente”. ODIHR-i thotë se duhet të merren sanksione, të hetohet dhe të merren sanksione. Çfarë hetimesh dhe sanksionesh kemi ne? Zero. Askush nuk është para drejtësisë për këtë gjë.

Kështu që, me të gjithë këtë situatë skandaloze, e cila dëmin e ka të drejtpërdrejtë mbi të drejtat bazë të zgjedhësve, dhe me një sistem patronazhimi, që Edi Rama e falënderon publikisht për të legalizuar një nga krimet më të rënda elektorale, ne kemi ato zgjedhje që shkuan për dreq, ashtu siç shkuan më 14 maj, dhe ju prisni vetëm raportin përfundimtar të ODIHR-it, se deklarata paraprake i dha sinjalet e para.

Por në të gjithë këtë histori, meqë ne sot po flasim për raportin e Komisionerit, pyetja ime është: për çfarë duhet më sot ky institucion?

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjala për zotin Vasili, 5 minuta, ju lutem!

**Petrit Vasili** - E nderuar drejtuese e seancës,  
Të nderuar kolegë,

Absolutisht do të kishte qenë një ditë me goxha debat sot, nëse do të kishim pasur një raport tjetër e nuk do të kishim këtë rutinën e vazhdueshme, që ne dëgjojmë nga institucionet e pavarura, të cilat qartësisht, me mënyrën si raportojnë, me mënyrën si i drejtohen Kuvendit, tregojnë se fjala pavarësi për ta është e ndaluar, ndërsa varësia absolute, e hapur, pa asnjë hezitim nga ata që zgjedhin është pikërisht misioni i vetëm i tyre.

Në tërë botën e qytetëruar, por edhe në këtë Ballkanin tonë të vogël, të tëra këto institucione janë gjithmonë ballë për ballë qeverive, se, në fund të fundit, ato janë që kanë kompetencat e mëdha, administrojnë prona të mëdha, administrojnë interesa të mëdha të shtetit, e natyrshëm janë ato që janë në vëmendjen

kryesore. Ndërsa ne këtu kemi institucione të pazëshme, nuk i prishin punë njeriu, si e thotë populli: “Hanë përshesh”, nuk bëjnë asnjë dëm.

Në një situatë ku një nga problemet më të mëdha është transparenca zero, sepse transparenca zero është pikërisht aleati më i madh i korrupsionit, e ku duhej të gjëmonte e bubullonte evokimi i kësaj të drejte dhe mbrojtja e saj, të qëndruarit shumë fort e qeverisë për çdo herë që e mohon këtë të drejtë, përkundrazi qeveria ka një aleat ligjor të mrekullueshëm që nuk i krijon asnjë shqetësim dhe e lë të jetë fare e qetë. Me kërkesat pa fund që bëhen për informim, për të hedhur dritë mbi atë korrupsion të tmerrshëm, për të cilin na vjen lajmi nga Europa, por ne duam ta zbulojmë këtu, nuk kemi pse t'i marrim lajmet që andej, nuk ndodh asgjë.

Shikojmë një raport, patjetër rutinor, mbushur me lafe plot. Janë gjëra që nuk kanë as ngjarje dhe as lajme, sepse në fund ka një shumatore: e drejta e informimit dhe transparenca në këtë vend janë një pikiatë, që shkon poshtë e më poshtë.

Është fare e vërtetë, që ne e pamë edhe në zgjedhjet e fundit, të gjithë e mbajnë mend, pas një batërdie në përdorimin e të dhënave personale, por batërdis që iku nga kufijtë e Shqipërisë dhe mbushi parlamente europiane, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bë një ngjarje botërore, komisioneri reagoi më 11 maj për mesazhet e kandidatit të opozitës në Tiranë. Ishte shqetësim i madh, sepse kishin vajtur disa mesazhe, ndërkohë që batërdis mesazhesh vinin nga pjesëtarë të mazhorancës në fushatën elektorale, më 11 maj u bë reagimi. Ky ishte shqetësimi, se mos ky mesazhi krijonte ndonjë shqetësim në ecurinë e zgjedhjeve. Në fund të ditës, a besohet më kjo lloj gjëje?

Po vij te rrethanat konkrete. Konkretisht, unë kam pasur vetë një histori personale me këtë institucion. I jam drejtuar në mënyrë shumë të rregullt për një vonesë të pajustificuar dhe skandaloze që më bëhej për t'u informuar nga Bashkia e Tiranës, nga kryetari i Bashkisë. Iu drejtova institucionit, i cili në raport me ligjin, shumë mirë, unë i duartrokas ata që zbatojnë

ligjin, më kërkuan të mbush edhe një formular, korrekt, siç e kërkonte ligji, së bashku me ankesën përkatëse. Patjetër që, me durim, e përmbusha edhe këtë gjë. Vonesa dhe mosdhënia e informacionit ishin skandaloze, të gjitha afatet u dhunuan në mënyrë të turpshme. Pasi e dërgova kërkesën, që atëherë një heshtje e tmerrshme, heshtje varri ka rënë dhe asnjë gjë nuk ndodhi, prisja me padurim që të kishte një reagim të rreptë. Çfarë është kjo? Deputeti, i cili ka dy mundësi, për statusin e tij dhe për ligjin e informimit, të kërkojë një informacion dhe nuk i jepet ky informacion dhe Komisioneri nuk shqetësohet, ndonëse ligji e ka vënë që të jetë çobani i kësaj gjëje! Po këtij çobani, siç duket, ato dhitë e ligjit i kanë ikur tutje dhe e rëndësishme është që të mos e shqetësojnë.

Pyetja është shumë e thjeshtë: po çfarë mund të arrijë media? Çfarë mund të arrijë qytetari i thjeshtë? Po çfarë mund të arrijnë të marrin subjekte të tjera të interesuara, kur fare qartë dhe pacipësisht deputetit i rezervohet një qëndrim i tillë?! Ndaj është e qartë, aleanca e institucioneve të varura kokë e këmbë, servile kokë e këmbë, të përkatësuar partiakisht, pra ajo parti që më zgjodhi mua, unë e kam për zemër dhe nuk i krijoj as shqetësimin më të vogël, është sigurisht misioni, mënyra, mesazhi më i shëmtuar dhe më i keq që mund të jepet për ato të ashtuquajtura institucione të pavarura, të cilat duhet të ishin edhe zëdhënese të qytetarit të thjeshtë për mbrojtjen e të drejtës së tyre për të qenë të informuar.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Vasili!

Kalojmë në një tjetër raportim. Raporti i veprimtarisë vjetore të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri gjatë vitit 2022. Në bazë të nenit 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 11, pika 1/g, të ligjit nr. 10 242, të vitit 2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar”, këtë raport sot do ta paraqesë drejtori ekzekutiv, zoti Çelo Hoxha, të cilin e ftoj të hyjë në sallë.

Zoti Hoxha, mirë se erdhët!

Fjala për ju.

Koha që keni në dispozicion është 20 minuta. Faleminderit!

**Çelo Hoxha** – E nderuar drejtuese e seancës, Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë dhe anëtarë të qeverisë,

E ushtruar në përputhje me kornizën ligjore, veprimtaria e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit gjatë vitit të kaluar u përqendrua kryesisht në këto çështje: dokumentimin e dhunës së ushtruar ndaj qytetarëve nga Divizioni i Mbrojtjes së Popullit në periudhën 1945-1946, 2 vjetët e parë të ardhjes në pushtet të regjimit komunist dhe informimin e publikut për veprimtarinë e kësaj strukture të armatosur dhe të paligjshme. Dokumentet e mbledhura në një botim voluminoz, që doli në dhjetor të vitit të kaluar, botohen në masën 95%, për herë të parë.

Ka një fakt interesant, që kjo strukturë e dhunshme e regjimit komunist nuk është përfshirë në përkufizimet e organeve të diktaturës në ligjin për institucionin tonë, dhe për këtë, ne do të paraqesim një raport dhe kërkesë për amendimin e tij.

Sa për krahasim, kjo strukturë ka vrarë, në bazë të statistikave që kemi mbledhur tani, gjatë 2 vjetëve të parë në kohë paqeje, më shumë qytetarë shqiptarë se sa ka vrarë ushtria fashiste në gjendje pushtimi. Janë statistika të krahasueshme dhe të evidentuara nga institucionet tashmë.

Dokumentimi i veprimtarisë së paligjshme të Sigurimit të Shtetit

Përmes një hulumtimi të gjerë u realizua një botim i posaçëm i platformave të punës së Sigurimit të Shtetit dhe të Ministrisë së Brendshme, të cilat nuk bazoheshin në ligj. Platformat e Sigurimit janë, faktikisht, pas vitit 1948, ato quhen platformat e Ministrisë së Brendshme, por realisht ato ishin platformat e Sigurimit të Shtetit, shumë pak punë kishte Ministria e Brendshme me këto platforma. Pra, janë botuar platformat, procesverbalet e mbledhjeve të Byrosë, sepse platformat

prodhoheshin nga Byroja Politike, e cila nuk kishte asnjë tagër ligjor për një gjë të tillë.

Në librin që ne kemi botuar, në procesverbalet e mbledhjeve të Byrosë, pranohen nga anëtarët e Byrosë shkeljet kushtetuese që bënte Sigurimi i Shtetit (të gjitha këto janë të botuara dhe të evidentuara); evidentimin e viktimave të regjimit komunist dhe informimin e publikut me përmbajtjen e gjetjeve tona, përmbledhjen e ligjeve respektive të regjimit komunist, si dëshmi e dhunës së strukturuar shtetërore ndaj qytetarëve; dokumentimin dhe publikimin e të gjitha marrëveshjeve ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në vitet 1945-1948.

Ky është një botim i rëndësishëm për dy arsye:

E para, për herë të parë i jepet publikut informacion i plotë dhe i detajuar për marrëdhëniet ekonomike të Shqipërisë me Jugosllavinë. Ne mendojmë se kjo është e nevojshme për studiuesit e të gjitha fushave dhe për publikun në tërësi.

E dyta, raporti artikulon qëllimet e shtetit jugosllav në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, të cilat, referuar raportit, nuk ishin marrëdhënie reciprociteti. Raporti është bërë në vitin 1949, pasi ishin prishur marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe regjimi ishte më i çliruar për folur për ato marrëdhënie. Raporti është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe është miratuar nga qeveria.

Në raport përdoren fjalët, që në vitet 1945-1946, "Shqipëria u kthye në një koloni ekonomike e Jugosllavisë".

Studimi i politikave të brendshme të regjimit komunist për periudhën 1960-1980

Ky punim rrëzon mitin e zhdukjes së vdekshmërisë foshnjore dhe mitin e papunësisë gjatë regjimit komunist, duke ofruar statistika reale, të cilat mbaheshin sekret për publikun. Pra, gjatë regjimit komunist thuhej se vdekshmëria foshnjore është zero, papunësia është zero e të tjerë, por dokumentet që ne kemi botuar në studim flasin për të kundërtën.

Botimin e artikujve studimorë për çështjet ekonomike gjatë regjimit komunist, që trajtojnë

çështje, si legjislacioni ekonomik, reformat, abuzimi i shtetit me pronën private, izolimi i ekonomisë, mbulimi për hapjen e ekonomisë në dekadën e fundit e të tjera.

Realizimin e një konference shkencore për arkitekturën gjatë regjimit komunist, ku u trajtuan aspekte të rëndësishme të tipologjisë, stilistikës, estetikës së arkitekturës shqiptare gjatë komunizmit, shfaqjen e nevojave të regjimit për propagandë dhe pamundësinë materiale për të ndërtuar; tiparet e zhvillimit urban të kësaj periudhe; kushtet e jetesës; konceptimi i jetës urbane, si dhe problemet ekonomike dhe varfërinë gjatë kësaj periudhe; vizioni totalitar mbi arkitekturën, estetikën dhe propagandën, komunikimi përmes ndërtesave; përcimi i mesazheve totalitare përmes ndërtimit; mbledhjen e dëshmimeve të të dënuarve për arsye politike, botimin e tyre dhe informimin e publikut për jetën në burgje, internim, dëbim dhe forma të tjera persekutimi; përgatitjen e materialeve didaktike për mësuesit e historisë, për mënyrën e dhënies së temave mbi regjimin komunist në lëndën e Historisë; njohja e të rinjve dhe informimi i publikut të gjerë me aspektet ideologjike të arkitekturës në komunizëm; përkujtimi i ngjarjeve të rëndësishme, të ndryshme; njohja e publikut me përmbajtjen e këtyre ngjarjeve e të tjera; rritjen e aksesit publik mbi historinë e komunizmit në Shqipëri përmes publikimit *online* të botimeve të Institutit dhe publikimit të aktiviteteve në faqen zyrtare në rrjetet sociale dhe në mediet në përgjithësi; rritjen e aksesit përmes promovimit të gjerë të veprave të institucionit dhe shpërndarjen e tyre falas në të gjitha bibliotekat e vendit; bashkëpunimin me institucionet e tjera homologe jashtë vendit përmes aktiviteteve të përbashkëta; rritjen e efikasitetit të aktivitetit të institucionit përmes zgjerimit të bashkëveprimit me institucione të tjera, universitete apo qendra studimore; ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri, përmes zgjerimit të rrjetit të aktiviteteve me partnerët ndërkombëtarë; pasurimin e databazës me të dhëna statistikore dhe cilësore për viktimat e komunizmit në

Shqipëri në të gjitha kategoritë, ekzekutim, burgim, internim, dëbim dhe në forma të tjera.

Dua t'ju bëj edhe një përmbledhje statistikash të aktiviteteve që ka kryer instituti gjatë vitit të kaluar. Konferenca shkencore, 1; ekspozitë dokumentare, 1; ekspozita, *work shop*-e në bashkëpunim, 2; pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta, konferenca, trajnime dhe leksione, 13; projekte studimore, 3; projekte dokumentare dhe arkivore, 4; projekte informuese dhe sensibilizuese, 6; projekte dëshmuese 1; projekte promovuese, 3; botime studimesh, kujtimesh, albume e me radhë, 14; pasqyrimi në media, tituj të evidentuar, 16. Buxheti është realizuar në masën 89%; ankesa nga publiku asnjë, dhe rekomandime që ka dhënë instituti për institucione të tjera, 4.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Hoxha!

A ka pyetje nga shërbimet apo nga salla për zotin Hoxha?

Po, zonja Tabaku, ka pyetje.

**Jorida Tabaku** – Unë nuk kam asnjë pyetje, por kam një vlerësim për Institutin dhe për punën e zotit Hoxha. Unë besoj se puna që ata po bëjnë, megjithëse e vonuar, sepse duhet ta kishin bërë shumë kohë më parë, është duke ndihmuar që ne të kemi më shumë informacion dhe të hedhim dritë mbi krimet e komunizmit.

Personalisht, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, dua ta vlerësoj dhe t'i tregoj mbështetjen!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Faleminderit, edhe juve, zoti Hoxha!

Mund të na ndiqni nga lozha.

Ne do të fillojmë debatin në lidhje me këtë raportim.

Fjalën e ka deputeti Denis Deliu.

Të përgatitet zonja Açka.

**Denis Deliu** - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Projektrezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2022

“Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri; duke njohur bashkëpunimin e këtij institucioni me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së institutit; duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive, Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, për vitin 2022, në këto drejtime: angazhimin për rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor me gjetjen e formave interaktive të përcjelljes të historisë së komunizmit, si dhe trajnimin e mësuesve për mënyrën e informimit mbi komunizmin; realizimin e konferencës ndërkombëtare “Arkitektura gjatë regjimit komunist në Shqipëri 1945-1990”, me qëllim njohjen e të rinjve dhe informimin e publikut të gjerë me aspekte ideologjike të arkitekturës në komunizëm; shpërndarjen e botimeve të ISKK-së në 38 biblioteka bashkë dhe universitetesh në gjithë Shqipërinë; rinovimin e marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për Arsimin me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor të informacionit për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri; mbledhjen e dëshmimeve të dënuarve për arsye politike, botimin e tyre dhe informimin e publikut për jetën në burgje, internim, dëbim dhe forma të tjera të persekutimit.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Në deklasifikimin e dokumenteve të Sigurimit të Shtetit. Të fokusohet te kjo pjesë e historisë së komunizmit, për të zbardhur mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Sigurimit të Shtetit.

2. Të intensifikojë bashkëpunimin me shoqatat vendase dhe të diasporës për mbledhjen e dëshmimeve që janë jashtë kufijve, si një burim potencial për zgjerimin e arkivës audio-vizuale apo kolanës së botimeve.

3. Të angazhohet për zhvillimin e aktivitete në kuadër të edukimit qytetar, duke nxitur reflektim dhe diskutim tek të rinjtë për krimet dhe pasojat e komunizmit në vendin tonë, përmes përdorimit të formave inovative të informimit.

4. Të bashkëpunojë me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë të aksesueshme për qytetarët.

5. Në funksion të transparencës dhe të informimit të bëhet publike në faqen *online* e gjithë procedura e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe vendimarrja e këtij Këshilli.”

Në përfundim të kësaj projektrezolute, dua të falënderoj kolegen time, zonjën Tabaku, për mbështetjen që i dha këtij institucioni, si dhe zotin Çelo Hoxha si drejtues i këtij institucioni, duke i ftuar të gjithë kolegët ta miratojmë!

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, Denis!

Fjalën e ka zonja Aça.

Keni 10 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Leskaj.

**Flutura Aça** – Faleminderit!

Faleminderit, i nderuari zoti Hoxha!

Të nderuar shqiptarë,

Unë më shumë do të merrem me një qasje tjetër, jo drejtpërdrejt me informacionin që morëm, që është shembullor dhe, sigurisht, ka nevojë për mbështetjen e të gjithëve ne për ta përmirësuar të gjithë punën, por, mbi të gjitha, ka nevojë për fonde, sepse mbi të gjitha ky Institut

nuk ka fonde të mjaftueshme për të bërë gjithë këtë barrë të madhe pune që ka.

Dua t'ju them se nuk është ndonjë gjë e re që t'ju quaj “mjeshër” të *soft* diplomacisë, gjë, që e dëshmuat edhe këto ditë me mbylljen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke e quajtur diasporën shqiptare një *soft* diplomaci, kur në fakt, duam apo nuk duam ne, doni apo nuk doni ju, është gjysma jonë, mbase, po e them mbase, më e mirë edhe kulturalisht, edhe etiketisht, edhe profesionalisht, pse jo edhe politikisht, prandaj nuk e duam dhe e mbyllëm këtë agjenci të rëndësishme.

Me të njëjtën lloj butësie keni filluar të operoni prej kohësh edhe me qasjen ndaj diktaturës, dhe, meqenëse sot kemi bujtës këtë Institut shumë të rëndësishëm, Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, kam rastin t'i kujtoj këtij institucioni këtë trend që më duket i pandershem, manipulativ dhe me pasoja shumë të rënda në studimin e kohës së diktaturës. Ky *soft approach* po bën rehabilitimin dhe zbutjen e të gjitha vrageve, vrajave, vromave, vuajtjeve vrastare të diktaturës, duke ua deformuar (po, kjo është gjuha ime) lakmuesin e ndjeshmërisë shqiptarëve, në mos duke ia zhdukur atë krejtësisht. Ju, kur të jeni këtu, mund të flisni ndryshe, me fjalorin tuaj më modern.

Ndaj, zoti Hoxha, keni detyrimin t'i kërkonit, t'i gjeni dhe t'i denonconi të gjitha rastet e këtij deformimi. Duke jua kërkuar këtë, nuk marr fare anën politike, pasi, siç është tashmë e vërtetuar përgjegjës në një parti, ke rrëshqitur thujse në gjysmë diktaturë, dhe unë nuk e kam këtë lloj përgjegjësie, për fat.

Më lejoni ta shpreh me shembuj këtë rehabilitim të butë që po i ndodh diktaturës. Fillon drejt e nga shkatërrimi i akrepave të së drejtës morale se kujt i takon çfarë dhe kush të marrë flamurin, në fakt, të studimit të diktaturës. Aksioni që si socialistë keni nisur, të përdëllyer për ish-të përndjekurit, nis që nga vizita e fundit që keni bërë në vendin e dëshmisë e të kujtesës në

Shkodër, pasi i bëtë dajren qytetit, sigurisht. Ju, që në Shtëpinë e Gjethëve i fshehët në dokumentet e ekspozuara me të bardhë vrasësit e viktimave, hiqini fashat e bardha që të vrarët të gjejnë paqe; ju, që kur vizitoni minierën e Spaçit nga zyrat luksoze, që tashmë e kanë zënë hapësirën, ngjisni fuoristradën pa e kthyer kokën te muret e shembura të burgut të tmerrshëm dhe i fshini me gomat e makinave të shtrenjta ato tragat ku dikur njerëzit kanë kaluar për në miniera, ku njerëzit kanë vdekur rrugëve ose kanë dhënë shpirt te “Lëndina e Shpirtrave” ngjitur; ju, që Piramidën e kthyer në një shkallare me gunga e me ngjyra, duke bërë një nga dëmet më të mëdha mbi historinë e diktaturës, ia hoqët asaj ngadalë zgjyrën e ferrit komunist. Kështu do të bëni pa dyshim edhe me vilën e Enverit, që duhej të ishte tani Muzeu i Frikës. Po, more po, Muzeu i Frikës.

Edhe ju, edhe ne, nuk e përjashtoj veten tonë, se kemi pasur edhe 30 vjet kohë edhe ne, dhe nuk e kemi bërë; kështu që mos e merrni aq personale, sepse e kam edhe për veten time.

Ju, që ligjin për t’i kthyer në muze burgun e Spaçit dhe të kampit të Tepelenës, po i zë viti i depozitimit në parlament, ndërkohë keni kaluar këtu fonde deri edhe për vaksinën e pestë të Covidit, sigurisht, nuk janë arsye financat, por tjetër gjë; ju që sabotuat një konferencë të thjeshtë të këtij Kuvendi, që e ka për detyrë ta ndalojë me instrumente juridike promovimin e Partisë së Punës dhe të Partisë Komuniste, pra e ka për ligj dhe e ka me ligj të bëjë ligje për ta shpenguar këtë shoqëri nga diktatura komuniste; ju, që keni nisur gjuetinë e shtrigave me ligjin e dosjeve, që naivisht dhe me sentimentin e duhur ne e votuam, por ju po e përdorni në sensin perfid të tij.

Ju sjell në vëmendje çfarë ka ndodhur në komisionin tonë, komisionin që drejtoj unë me disa prej të zgjedhurve, i dini vetë, hapni arkivat.

Ju, që me një investim të padukshëm, që i ka habitur edhe agjentët nëpër botë, vini në shërbim të kësaj kauze libra, ku diktatura ka fytyrën e bukur të një vaje të vogël, për të thënë që gijotina e diktaturës që më pak vrasëse se baruti i demokracisë Por asnjëra prej tyre nuk e kalon

katastrofën që po ndodh me tekstet shkollore dhe programet për sensibilizimin e brezave të rinj ndaj regjimit të diktaturës.

Po ju them disa raste, të cilat dua t’jua jap edhe juve, zoti Hoxha, duke jua sjellë në vëmendje, pavarësisht se ju patjetër që i dini. Kur flitet për opozitën shqiptare kundër vendosjes së komunizmit në Shqipëri, flitet njëherësh edhe për luftën politike brenda Partisë së Punës së Shqipërisë, pra në një ditë, në një leksion; kur flitet për terrorin komunist për indokrimin e arsimit dhe të kulturës, ti gjen të atilla foto që të japin përshtypjen se arsimimi i fëmijëve në diktaturë, madje edhe vetë jeta e shqiptarëve në diktaturë ishte një zenit i plotë. Aty gjen thagma të heroizmit të zhdukjes së malaries në Myzeqe, por nuk flitet asnjë fjalë për kampet e punës në Plug, në Savër, në fshatin Adriatik, a gjetkë, ku degdiseshin shqiptarët e papreferuar nga regjimi.

Po shkoj edhe më tej, në ngritjen e një fryme ekzotike për të shkuarën përmes kinse festivaleve që organizonin, duke përdorur hapur simbolet, veshjet dhe këngët komuniste, të mos flas më pastaj, vaj medet, për shamitë e kuqe që u vinin, grushtin që ngrinin nëpër ceremonitë tuaja me kinse se po respektoni veteranët, ku keni përfshirë edhe veten. Zoti e di se në cilën luftë keni marrë pjesë për të qenë edhe ju veteranë.

Ne kemi nevojë për një hartë të plotë të institucioneve të diktaturës që ajo të jetë pjesë e turizmit historik të shqiptarëve, si dhe pjesë detyruese për t’u mësuar nëpër shkollat shqiptare. I zi ka qenë ai fat për ne, por ka qenë fati ynë dhe shenjat e tij duhen ruajtur për të mos u përsëritur më.

Përqendrimi në një dorë, në një zyrë, në një qendër, i procesit të historizimit të diktaturës shqiptare, që tani është shumë e dukshme dhe madje po përgatitet së shpejti për t’u sjellë edhe në parlament, nuk ka lidhje vetëm me përqendrimin e buxheteve, por edhe me kontrollin e plotë të procesit, sepse po ata bablokë që përjetuan dikur si djelmosha fitoret e socializmit, janë po ata që duan ta shkruajnë edhe historinë shqiptare.

Institucioni juaj, pra Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, zoti Hoxha, ka detyrimin të denoncojë se çfarë ndodh me këtë *soft approach* të frikshëm që po u ndodh shqiptarëve. Mjafton t'ju përmend rastin e Polonisë ku një pjesë e historisë po deformohet prej këtij përqendrimi që po kontrollon totalisht politika.

Ju lutem, bëjeni këtë vrojtim publik në të gjitha nivelet sa më shpejt dhe sa më saktë!

Pra, edhe sitet ku orientohen fëmijët në bazë të atyre kontratave, që gjoja janë bërë me Ministrinë e Arsimit, të jenë të qarta dhe të orientohen qartë sitet, të mos vihen emra që nuk kanë fare lidhje, sepse thjesht i çorientojnë edhe më keq fëmijët, por të bëhen qarta. E para, diktatura, *streat to the point*, jo të kamufluara e të stërzgjatura.

Ngrini zërin dhe sillni propozimin në parlament mbi projektin për memorialin e viktimave të diktaturës, që është urgjente; sillni në parlament shpalljen e ditës kombëtare të viktimave të diktaturës, ndryshe, nëse nuk e bëjmë këtë, siç thotë edhe Çurçilli: “Diktaturat që vijnë dhe sillen si tigra, pa dyshim ngaqë janë tigra, një ditë do t'i zërë uria.”

Mallkuar ajo ditë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Leskaj, 10 minuta.

Të përgatitet zoti Berisha.

**Bujar Leskaj** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Në fakt, diskutimin e sotëm unë e mbaj në nderim dhe në përkujtim të jetës dhe veprës së një prej simboleve të qëndresës antikomuniste në Vlorë, i cili u nda para disa ditësh nga jeta, zotit Enver Shaqiri. Zoti Enver Shaqiri, në kohën e diktaturës ka bërë 25 vjet burg politik në dy periudha të ndryshme, burg politik vetë dhe vëllai, një njeri me karakter të fortë, që hyn tek ajo që ne vlonjatët i quajmë, madje edhe ata që nuk dinë anglisht, *strong man*, burra të fortë, burra të hekurt, për karakterin që ka treguar në burgjet e

diktaturës, por edhe për karakterin dhe integritetin që ka treguar më vonë pas viteve '90-të.

Për kuriozitetin e atyre që më dëgjojnë, është proverbiale dhe ka ngelur në histori, jo vetëm qëndresa, por edhe një fjali apo një mesazh i dhënë nga zoti Enver Shaqiri në vitin 1989, në burgun e Burrelit apo të Spaçit, në mos gaboj (emocionet bëjnë të tyren), kur kanë shkuar zëvendësministrat e Mbrojtjes dhe të Drejtësisë, në kuadër të “pseudohapjes” që bënte Ramizi nën trysninë e Kofi Ananit të Kombeve të Bashkuar, në burg dhe zhvilluan një bisedë (kuptohet që terrori vazhdonte dhe ishte i pranishëm, sepse jemi në ato vite ku 5 vjet para ishte shtypur edhe kryengritja në Qafë-Bari, 15 vjet më parë ajo e Spaçit), ndërkohë që bilbilosnin zëvendësministrat e Ramiz Alisë, ndërmjet të tjerave u thonë, ata ishin edhe pak oportunistë, ndoshta ndonjë nga ju ka bërë burg edhe pa të drejtë. Ngrihet Ramiz Shaqiri dhe u thotë këto fjalë: “Shumë mirë që i thatë këto fjalë, por për burgun e padrejtë që kemi bërë, meqenëse ne do të dalim, duhet të vini ju këtu”.

Me të vërtetë ka qenë një njeri me karakter shumë të fortë.

Sot mund të flasim pa pushim.

Në radhë të parë, dua të vlerësoj veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, drejtorin e tij, zotin Çelo Hoxha, dhe t'i inkurajoj me mbështetjen tonë modeste, kuptohet që nuk do t'u mungojë asnjëherë, që të vazhdojnë në këtë rrugë, pasi kemi shumë probleme, të cilat janë ende të pazgjidhura, probleme që janë në mes të rrugës, problematika sa i përket dekomunistizimit të Shqipërisë, si dhe problematika sa i takon rehabilitimit të ish-të përndjekurve politikë të diktaturës, nderimit dhe vlerësimit të tyre.

Një nga vlerësimet ku ne duhet të fokusohemi fort gjatë vitit 2023, vit, i cili përkon edhe me 50-vjetorin e kryengritjes së Spaçit, duhet të jetë pikërisht ajo që kërkuan me të drejtë ish-të përndjekurit politikë në janar të vitit 2023, që viti 2023, të jetë viti i kujtesës kombëtare në nderim të revoltës së Spaçit. Po çfarë u bë në përkujtimin



e saj më 21 maj? U zhvilluan 2-3 aktivitete modeste; u zhvillua edhe një aktivitet në Spaç me defekte në organizim; Presidenti i Republikës i nderoi të përndjekurit me pjesëmarrjen dhe mesazhin që ai dha, pavarësisht se nga organizatorët edhe Presidenti u vu në pozitë. Nuk mund të organizosh një veprimtari për përkujtimin e ngjarjeve historike dhe të mos të flasin ata që janë gjallë, heronjtë e gjallë. Nuk mund të organizosh një veprimtari dhe të mos flasin fëmijët, nipërit dhe mbesat e heronjve. Kjo ka ndodhur në Spaç.

Unë i rekomandoj Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit që ata ta kenë në fokus, edhe ne të vazhdojmë ta kemi seriozisht në vëmendje këtë vit, si viti i kujtesës historike, përkujtimin e 50-vjetorit të revoltës së Spaçit dhe heronjtë e saj.

Pse jo, unë do t'ju propozoja, zonja drejtuese e seancës, që ta diskutoni edhe me Kryetaren, që në sensibilitet e respekt të plotë ne të organizojmë një seancë të veçantë këtu, në Kuvendin e Shqipërisë, ku ne deputetët të dëgjojmë heronjtë e gjallë të Spaçit, që të na flasin për atë kryengritje, për rezistencën në burgjet e diktaturës dhe do të jetë në nderin tonë, nëse këtu, në Kuvend, do të ftojme dhe do të flasin ish-të dënuarit, simbole si: Fatos Lubonja, Bedri Blloshmi, Bedri Çoku, Demir Pojani, Gëzim Çela, Qemal Demiri, Hysen Haxhia, Astrit Xhaferrri, Kujtim Murati e shumë e shumë të tjerë, madje të vijnë të flasin në Kuvend edhe fëmijët e tyre, Nardi Bejko, djali i heroit Dervish Bejko, që u pushkatua në Spaç në vitin 1973, mbesa e heroit të madh Xhelal Koprencka, vajza e Mersin Vlashit, vajza e Demir Pojanit, e Agim Mustës e shumë e shumë të tjerë, pse jo edhe Vilson Bedri Blloshmi, i cili ka marrë emrin e xhaxhait të tij, si dhe Henri Haxhi Baçinovski.

Megjithatë, për mendimin tim, të mos e vlerësosh sa duhet 21 majin e vitit 1973, kryengritjen e Spaçit, është njësoj si të harrosh të kaluarën diktatoriale, që ndonëse mund të bëhet pa dashje nga institucionet studimore apo publike, është një shërbim ndaj persekutoreve të djeshëm.

I nderuar zoti drejtor i institutit,

Nuk e di nëse do të më mjaftojnë minutat për të bërë disa vlerësime për punën tuaj, por dua të përforcoj këtu atë që e kam ngritur me kohë. Ne kemi një përvojë të mirë, që 21 maji i vitit 2006 (kam pasur nderin të jem iniciator) u shpall "ditë e përkujtimit publik" dhe kremtohej njësoj si 8 Dhjetori, Dita Kombëtare e Rinisë, 4 dhjetori, dita e ushtrisë, apo edhe ditë të tjera përkujtimore publike, dhe duhet ta kthejmë në agjendë dhe të llojmë fort të gjithë për të vendosur memorialin e qëndresës dhe të qëndrestarëve në qendër të Tiranës dhe të vazhdojmë punën tonë, të konsultohemi me Ministrinë e Kulturës, me qeverinë dhe me institucionet përgjegjëse, që muzeu i Spaçit të shpallet muze kombëtar dhe të plotësohet e të konfigurohet si një i tillë, si muze i dëshmisë së qëndresës antikomuniste.

Në vitin 1973, në Spaç, shqiptarët kanë ngritur flamurin kombëtar pa yllin komunist për tre ditë.

Ish-të persekutuarit politikë të diktaturës janë dhe do të mbeten nderi i kombit dhe kujtesa jonë për ta është nderim për moralin tonë politik e shoqëror, ndërsa harresa për ta është e pafalshme për ne dhe është ndëshkim për të ardhmen tonë e të fëmijëve tanë.

Për herë të parë në Spaç u hodh parulla që e përsëritën studentët e dhjetorit 15 vjet më vonë: "E duam Shqipërinë si gjithë Europa!"; për herë të parë në Spaç, në mënyrë të organizuar, ata iu kundërvunë diktaturës, ku 4 veta u pushkatuan dhe 66 të tjerë, "heronj të gjallë", siç i quaj unë, të cilët kanë mbijetuar, vazhdojnë të qëndrojnë fort në mbrojtje të lirisë, të vlerave, të demokracisë e principeve të tyre.

Minutat nuk mjaftojnë për të folur për institutin, por ndoshta do të kem rastin ta përcjell këtë edhe në ndonjë forum tjetër.

Meqenëse fola për Spaçin, dua të përmend këtu një poezi të heroit Havzi Nela, që ka shkruar në ato vite për Spaçin, në të cilën ai stigmatizonte dy kriminelët e regjimit, Feçor Shehun dhe Kasëm Kaçin, një gjerark i burgjeve, kriminel si Feçori, ku lexuesi mund të kuptojë se bëhet fjalë edhe për diktatorët në Tiranë, Enver Hoxhën dhe Mehmet

Shehun. Poezinë do ta lexoj me dialektin me të cilin është shkruar:

“Dy xhelat që ka Tirana,  
Dy xhelat, dy sytë iu plaqin  
Nuk menduen për nanat tona  
Nuk menduen i shiftoft zana!”

Tani do të kthehem te veprimtaria e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

Personalisht e vlerësoj shumë veprimtarinë e Institutit; e vlerësoj shumë ekspozitën me rastin e 45-vjetorit të ekzekutimit të poetëve Vilson Blloshmi dhe Genc Leka.

Kam një vërejtje për ekspozitën që keni bërë ju, si ISKPK, në bashkëpunim me Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë, në mos gaboj, lidhur me fytyrat e diktaturës. Për mua keni bërë një zgjedhje të gabuar. Ju, kuptohet, do t'i shkruanit me të zeze e mbi të zeze emrat e këtyre kriminelëve, por për mua ekspozimi i fotove ishte i pakuptimtë. Me foto ekspozohen heronjtë, kurse fytyrat e diktaturës ju duhet t'i ekspozonit përgjatë kryerjes së krimeve të tyre ndaj popullit shqiptar, por edhe ndaj njëri-tjetrit.

Megjithatë, është për t'u përmendur e për t'u vlerësuar konferenca shkencore “Qasje mbi historinë e Shqipërisë në vitet 1945-1990”, dhe bashkëpunimi juaj me institutin polak duhet të thellohet.

Ekspozita “Laboratori i kujtesës” është një punë shumë e lavdërueshme e Institutit në përpilimin e Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist, është vazhdimi, vëllimi i dytë shtesë.

Botimet e ISKPK-së janë të gjitha për t'u vlerësuar, por unë kam zgjedhur të përmend: “Ligje dhe akte represive gjatë viteve të komunizmit në Shqipëri ‘45-‘90” me autor Leka Ndojën; librin “Molla e vjetit të ri” me autor Filip Guraziun; revistën studimore “Memorie”, që është një revistë me nivel të lartë shkencor.

Janë tri vëllime që mua më kanë bërë përshtypje, dhe dëshiroj të falënderoj veçanërisht zotin Hoxha, ku përfshihet libri “Dosja formulare 2/a, nr.1594 për të dënuarin Bedri Blloshmi”. Ky

libër është jo vetëm një biografi për vuajtjen në diktaturë të autorit e familjes së tij, shoqëruar me dokumente arkivore, por edhe një analizë për dënimet në diktaturë dhe për terrorin që ushtrohej në burgjet e komunizmit. Autori, një njeri vital (Bedri Blloshmi është hero i gjallë, pranohet nga të gjithë), pas viteve '90, me një qëndrueshmëri stoike, zbulon varret e vëllezërve të tij, i vendos në pedestal; nderohen nga Presidenti Berisha dhe më tej nga të gjithë; botohet vepra e tyre e plotë nga Bedriu dhe studiuesi, profesor Sadik Bejko; përurohet një memorial në qendër të Librazhdit nga skulptori i shquar Sadik Spahia; vazhdon vlerësimi i tyre si “Nderi i kombit” nga Presidenti Bamir Topi, për të përfunduar një detyrë që kemi ne, zoti Çelo, zonja Kryetare dhe të gjithë deputetët, që shtëpia e Vilson Blloshmit, një shtëpi e fundit e viteve 1800, të bëhet monument kulture, të jetë një muze, të marrë statusin e monumentit, të marrë statusit e muzeut, ku të mblidhen shkrimtarë, poetë, artistë e të tjerë.

Një ndër dy veprat e tjera që më kanë bërë shumë përshtypje dhe mendoj se meritojnë vlerësimin tonë është libri i studiuesit vlonjat Enver Memishaj Lepenica “Kthimi i borxhit të madh”, që është një analizë dhe vështrim kritik për veprat e të dënuarve dhe të burgosurve politikë, ku si mesazhe të librit janë drejtësia dhe humanizmi, dhe veprat që autori analizon janë një himn dhe homazh për ata që u pushkatuan apo vuajtën nën terrorin komunist.

Libri më interesant që ka botuar Instituti përgjatë vitit 2022 është ai i studiuesit Kastriot Dervishi, i cili, në fakt, nuk ka titull shkencor, por për mua meriton edhe titullin, edhe gradën “profesor doktor”, “Platformat e fshehta të punës operative të ish-Ministrit të Punëve të Brendshme, dokumente nga Kastriot Dervishi”. Autori sjell në vëmendje platformat e fshehta të punës operative të ish-Ministrit të Punëve të Brendshme për vitet 1948, 1954, 1958, 1966, 1977 dhe 1985, të shoqëruar edhe me një analizë studimore. Këtu jepet platforma e fshehtë e ish-Sigurimit të Shtetit dhe shumë analiza të tjera.

Natyrisht, është për t'u vlerësuar revista "Memorie" që ju botoni, në të cilën mendoj se edhe ne si deputetë, edhe ju, zonja Kryetare, duhet të përcjellim mesazhet tona, po ashtu edhe Presidenti i Republikës, të cilin përfitoj nga rasti për ta falënderuar për prezencën në Spaç!

I dashur drejtor,

Vitin 2023, ju, në radhë të parë, dhe ne të gjithë bashkë, duhet ta kthejmë vërtet në vit kremtimi, ku t'i kthehemi historisë, t'i kthehemi qëndresës antikomuniste dhe të kremtojmë 50-vjetorin e kryengritjes, revoltës së Spaçit, me veprimtari në të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe me një veprimtari model këtu, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ju faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)*

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te raporti vjetor i zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022.

Në bazë të nenit 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 26 të ligjit nr.10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", sot do ta paraqesë raportin vjetor për vitin 2022 Komisioneri, zoti Robert Gajda. Koha në dispozicion është deri në 20 minuta.

**Robert Gajda** – E nderuar Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Këshillit të Ministrave,

Shkurtimisht, do t'i përmbledh në disa pika gjetjet e raportit të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022, për të kaluar më pas në evidentimin e disa shqetësimeve më me rëndësi dhe propozimet për përballjen me to.

Në vitin 2022 ka pasur një vazhdimësi konstante të indikatorëve që lidhen me punën e përditshme të Komisionerit, në lidhje me ankesat, vendimmarrjen, me çështjet gjyqësore si në gjykatat e juridiksionit administrativ, ashtu edhe në gjykatat e juridiksionit civil.

Lajmi i mirë është që shohim më shumë aktorë të përfshirë në çështjet e diskriminimit, siç janë organizatat kombëtare të shoqërisë civile, përfshirë edhe ato lokale; avokatia, ku shohim një numër të madh të çështjeve që përfaqësohen nga avokatë; shërbimi ligjor falas; gjykatat, por edhe institucione të tjera publike, siç është Kuvendi i Shqipërisë.

Më shumë shkaqet e pretenduara kanë qenë në lidhje me aftësinë e kufizuar, racën dhe etninë, bindjet politike, gjendjen ekonomike e shëndetësore dhe gjininë.

Këtë vit është shënuar një numër akoma më i lartë i ankesave që lidhen me aftësinë e kufizuar, të cilat kanë qenë më shumë të fokusuara në aksesueshmërinë fizike nëpër institucione, por edhe në transportin publik, qytetas dhe ndërqytetas.

Si emërues të përbashkët të ndërthurur me shkaqet e tjera të diskriminimit gjejmë gjendjen ekonomike, çka do të thotë se pamundësia ekonomike është një nga faktorët kryesorë, që i ekspozon personat kundrejt sjelljeve diskriminuese.

Për sa u përket subjekteve kundrejt të cilave adresohen ankesat, ka një rritje konsistente kundrejt njësisive të vetëqeverisjes vendore, si dhe kundrejt subjekteve private, kryesisht bizneseve.

Në lidhje me fushat më të pretenduara, mbi 50% e çështjeve lidhen me marrëdhëniet e punësimit, ku akoma prevalojnë shkarkimet nga puna për shkak të bindjeve politike.

Në lidhje me të dhënat e raportit vjetor evidentohen disa problematika, të cilat qëndrojnë ndër vite.

Së pari, mosimplementimi i ligjeve me karakter social, si nëpërmjet vonesave në nxjerrjen e akteve nënligjore, si nëpërmjet moszbatimit nga ana e administratës dhe jo nën frymën e Kushtetutës dhe të konventave në mbrojtje të drejtave të njeriut, ashtu edhe nëpërmjet mosbashkëpunimit midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

Së dyti, shpeshherë mosrealizimi i të drejtave të qytetarëve nuk lidhet më shumë me

pamundësinë buxhetore, por me mospasjen e të dhënave të sakta dhe të mbajtura në modele të unifikuara, për rrjedhojë, ka mangësi në planifikimin e duhur të politikave dhe, për këtë shkak, evidentohet mosorganizim në nivelin dhe standardin e duhur për ofrimin e shërbimeve të shumta publike.

Së treti, edhe pse ka një rritje të rasteve ku organet publike i zgjidhin vetë rastet e pretenduara të diskriminimit apo të cenimit të të drejtave, mbetet ende frymë e përgjithshme moszbatimi i rekomandimeve dhe i vendimeve të KMD-së, dhe për rrjedhojë nivel i ulët i pranimit dhe i zbatimit të këtyre akteve.

Së katërti, edhe pse mekanizmi i kontrollit që Kuvendi ushtron mbi pushtetin qendror në lidhje me zbatueshmërinë e vendimeve dhe rekomandimeve ka filluar të japë rezultate të prekshme, shqetësim vijon të mbetet zbatimi i vendimeve nga pushteti vendor.

Së pesti, edhe vetë Kuvendi nuk tregon aktivizim për propozimet për ndryshim legjislativ, që dërgohen nga KMD-ja, për ligjet të cilat rezultojnë cenuese të parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Së fundi, jo rrallëherë është sjellja dhe gjuha e përdorur nga eksponentë të lartë të politikës, të organeve shtetërore, dhe e vetë Kuvendit, që rezultojnë diskriminuese.

Në lidhje me disa nga propozimet që konsiderohen si të nevojshme nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për t'u mbajtur parasysh nga Kuvendi dhe qeveria e Shqipërisë janë:

krijimi i sistemeve të unifikuara të mbledhjes, sistemimit dhe komunikimit të të dhënave ndërmjet organeve publike me njëra-tjetrën, si dhe me subjektet e ndryshme shoqërore;

kryerja e analizave të thelluara në miratimin e ligjeve me karakter social dhe respektimi i afateve ligjore për miratimin e akteve nënligjore;

vëmendje e shtuar për personat me aftësi të kufizuara, sidomos në aksesueshmëri dhe në përshtatjen e shërbimeve sipas aftësive të ndryshme. Nevojitet që të kemi një vit të dedikuar

vetëm për aftësinë e kufizuar, pasi evidentohet që në shumë institucione publike si me karakter vendor, ashtu edhe me karakter qendror nuk ekzistojnë as kushtet minimale të aksesueshmërisë fizike, por edhe të ofrimit të shërbimeve të dedikuara.

Po ashtu, duhet mbajtur parasysh marrja e masave pozitive nga ana e pushtetit qendror dhe hartimi i politikave të përkohshme me qëllim nxitjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuara. Është mendim i institucionit se pushteti qendror dhe ai vendor mund të kthehen në një model pozitiv në këtë aspekt, duke thyer stigma e paragjykitjeve, por edhe duke nxitur biznesin privat në punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Gjatë një monitorimi të bërë gjatë vitit 2022 na rezultoi se vetë organet publike nuk janë në zbatim të ligjit për nxitjen e punësimit, sidomos në lidhje me personat me aftësi të kufizuara.

Duhet përfshirje në administratën publike të të rinjve romë dhe egjiptianë, që kanë përfunduar studimet e larta. Një nga situatat që është vënë re, është që shpeshherë institucionet nuk i kuptojnë këto komunitete. Punësimi i të rinjve romë dhe egjiptianë do të ndihmonte në lehtësimin dhe ndërmjetësimin për shërbime më të dedikuara dhe për një vëmendje më të madhe të institucioneve.

Duhet pasur në vëmendje rikonsiderimi i legjislativitetit për heqjen e kufizimeve gjinore mbi të drejtën e çdo njeriu për të pasur familje, në një formë të njohur me ligj, që mund të jetë ajo e bashkëjetesës; dedikimi i masave konkrete për heqjen e barrierave sociale, kulturore dhe ekonomike ndaj gruas dhe pozicionit të saj në familje dhe shoqëri; nxitja e strehimit, në mënyrë dinjitoze, për grupet shoqërore më të pamundura (parimi, sipas të cilit kjo përpjekje duhet bërë me biznesin privat, duhet të jetë prevalente dhe të implementohet me efikasitet dhe eficientë); rikonsiderimi i teksteve shkollorë, pasi janë të mbushura me stereotipe të ndryshme dhe nuk reflektojnë diversitetin përfshirës.

Në lidhje me fëmijët, institucionet publike, gjithmonë dhe pa ekuivok, duhet të kenë si parim të palëkundur interesin më të lartë të fëmijës (jo

rrallëherë kemi parë larje duarsh nga institucionet, në situata që lidhen sidomos me fëmijët e grupeve më të pamundura).

Në lidhje me fëmijët, ju bëj me dije edhe një vendim të para një viti të Gjykatës së Strasburgut, ku për herë të parë Shqipëria është quajtur në shkelje të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke e formësuar këtë shkelje në formën e segregimit në shkolla. Është evidentuar nga institucionet e Komisionerit jo vetëm rasti që është trajtuar nga Gjykata e Strasburgut, i cili ishte trajtuar nga ana e institucionit të Komisionerit, që kishte vënë në dijeni autoritetet publike për problematikën, por edhe në vitet e mëvonshme janë evidentuar raste segregimi edhe në shkolla të tjera. Ajo që është kërkuar së bashku me Ministrinë e Arsimit është që zgjidhja e problemit të mos shikohet vetëm në fokusin e rastit që është trajtuar nga Gjykata e Strasburgut, por të shikohet në nivel kombëtar, sepse, përveç rasteve të segregimit që ka konstatuar Komisioneri, ne jemi në dijeni edhe të rasteve të tjera të shkollave në rrezik segregimi, çka do të thotë se marrja e këtyre masave duhet parë në të gjitha shkollat e Shqipërisë dhe jo vetëm të dedikohet në një shkollë.

Së fundi, duhen pasur gjithmonë në vëmendje, gjatë hartimit të politikave dhe implementimit të tyre, grupet më të pamundura dhe pakicat shoqërore.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Gajda!

Vijojmë me diskutimet.

Fjala për zonjën Klotilda Bushka.

Të përgatitet zoti Taulant Balla.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ndjesë! Keni të drejtë!

A ka pyetje për Komisionerin?

Po, zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – A nuk e konsideron Komisioneri si diskriminim ndaj koncepteve të familjes dhe ndaj koncepteve tona klasifikimin dhe futjen në shkolla të nocioneve “prindi 1” dhe “prindi 2”? A nuk është kjo diçka që shkel atë që është thelbësore në jetë, konceptin thelbësor të

familjes, i përbërë nga gruaja dhe burri, me shpresën e Zotit, dhe fëmijët?

Fatkeqësisht, shoh që tashmë ka disa elemente të tjera që po futen në tekstet tona dhe unë këtë e konsideroj si diskriminim ndaj shoqërisë njerëzore, ndaj parimeve thelbësore mbi të cilat është ndërtuar shoqëria njerëzore, jeta vetë, zhvillimi dhe ekzistenca jonë. Pra, të futësh konceptet “prindi 1” dhe “prindi 2” është të godasësh një nga themelet kryesore të jetës dhe shoqërisë njerëzore, dhe mendoj se nuk ka diskriminim më të madh sesa ky për vlerat e shoqërisë, për vlerat e ekzistencës, për vlerat tona.

Ndaj, zoti Komisioner, mendoj se ju i keni anashkaluar shumë gjëra dhe i keni rënë shkurt.

Gjithashtu, edhe në konceptin e bashkëjetesës kam një pyetje: çfarë kuptoni ju me “bashkëjetesë”? Mendoni se bashkëjetesa mund të zëvendësojë familjen, kur familja është e shenjtë dhe kjo është e shkruar në Kodin e Familjes? Bashkëjetesa mund të futet në Kodin Civil, sa të duash, por jo të zëvendësojë familjen apo të jetë një alternativë e saj.

Këto janë elemente të cilat duhet t’i shikoni me më shumë seriozitet, për të mos folur më pas për konceptin lidhur me adoptimin e fëmijëve. Cili është koncepti juaj për adoptimin e fëmijëve? Kush mund të adoptojë fëmijë? A mendoni ju se çiftet homoseksuale mund të adoptojnë fëmijë? E bëj këtë pyetje, sepse kjo diskriminon fëmijët, nëse futemi në këtë rrugë, diskriminon familjen, pra bie ndesh, dhe këto janë gjëra që ju, si Komisioner, duhet t’i shikoni gjerësisht, jo vetëm në një plan të ngushtë.

Faleminderit!

**Robert Gajda** - Faleminderit për pyetjet dhe për ngritjen e argumentit!

Në radhë të parë, dua t’ju evidentoj që, kryesisht institucionet e të drejtave të njeriut, por sidomos Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është i ndërtuar në mënyrë të tillë për të mbrojtur pakicat në një shoqëri, sepse në një shoqëri kryesisht rezultojnë të diskriminuara pakicat dhe jo shumicat.

Në lidhje me konceptet “prindi 1”, “prindi 2” unë nuk di të ketë sot në tekste shkollore lëvrim të këtyre termave për fëmijët, por di vetëm që është përfolur shumë mediatikisht, është ngritur edhe një tymnajë e madhe e dezinformimit të shoqërisë sonë në lidhje me të drejtat e njeriut, sidomos me të drejtat dhe liritë individuale, të cilat, në këndvështrimin tim, mbeten ende të papërcaktuara drejt nga ana e shoqërisë, dhe për rrjedhojë të këtij dezinformimi ndryshen të drejtat e shumë individëve dhe të pakicave në shoqërinë tonë. Mendoj se gjithmonë një debat dhe një diskutim për çfarëdolloj aspekti që lidhet me të drejtat e njeriut është i shëndetshëm të ndodhë, por duhet të ndodhë në disa baza të shëndetshme dhe jo duke përdorur gjuhë urrejtjeje shpeshherë për pakicat e ndryshme që ndodhen në shoqërinë tonë.

Për informacionin tuaj, Shqipëria është një nga vendet, e cila ka miratuar një shumëllojshmëri të madhe konventash në mbrojtje të të drejtave të njeriut, kryesisht në mbrojtje të atyre grupeve shoqërore që na rezultojnë nga më të diskriminuarat sot në Shqipëri. Fryma e të gjitha këtyre konventave, sidomos në lidhje me të drejtat e personave që konsiderohen pas konceptit LGBTI, është që të paktën Shqipëria rezulton diskriminuese dhe moszbatuese e këtyre konventave, si të frymës së tyre, në ideimin e tyre origjinar, si të rekomandimeve të komiteteve mbikëqyrëse të këtyre konventave dhe si të jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, sidomos në lidhje me bashkëjetesën. Dhe këtu flasim për bashkëjetesën. Bashkëjetesa është koncept kushtetues dhe çdo njeri në këtë vend ka të drejtë të ketë familje. Nga ana tjetër, patjetër që garantimi i të drejtave do të duhet të balancohet me disa faktorë, ndër të cilët hyjnë edhe faktorët tradicionalë apo edhe kulturorë të një vendi.

Për hir të këtyre faktorëve ekziston një institut në Kodin e Familjes, i cili gëzon mbrojtje edhe nga Kushtetuta, që është ai i martesës, por, nga ana tjetër, ekziston edhe një institut shumë i ri, që është ai i bashkëjetesës, i cili nuk ka asnjë lloj lidhjeje me traditën dhe kulturën e vendit tonë, por

është ideuar pikërisht për t’ua zgjeruar dhe për t’ua dhënë të drejtën e familjes edhe atyre personave, të cilët nuk duan të përdorin instrumentin e martesës, por që do të duhet t’ua zgjerohet kjo e drejtë.

Pasja e kufizimeve gjinore, sidomos në lidhje me bashkëjetesën, po jua përsëris, në frymën e konventave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku Shqipëria ka aderuar plotësisht dhe pa rezervë dhe sidomos në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, sot në ligj rezultojnë diskriminuese dhe për këtë (nuk e them unë) mjafton të hulumtoni një jurisprudencë 20-vjeçare, tashmë të maturuar nga ana e Strasburgut, e cila e tregon qartë se aspektet gjinore nuk mund të jenë kufizuese në krijimin e familjes. Kjo është ajo që ne kemi pranuar si shtet, kjo është ajo që frymëzon bërjen e ligjeve në Shqipëri, kjo është ajo që frymëzon interpretimin e Kushtetutës në Shqipëri dhe kjo është ajo që duhet të ndodhë herët ose vonë, nëse do të duhet të jemi në përputhje me këto të drejta, ose propozoni ta nxirrni Shqipërinë nga Konventa e të Drejtave të Njeriut dhe atëherë mund të jeni në përputhje.

Në lidhje me adoptimin e fëmijëve, të personave, unë jam i bindur dhe mendoj që patjetër një shoqërie do t’i duhet koha e saj për t’u përballur me disa realitete të tjera, sidomos në lidhje me liritë dhe të drejtat individuale. Pa diskutim që debati duhet bërë dhe duhet të jetë paraprakisht shumë i gjerë, duke përfshirë Kuvendin e Shqipërisë, duke përfshirë aktorë të ndryshëm shoqërorë, duke i dëgjuar të gjitha pakicat shoqërore, duke i përfshirë të gjitha institucionet publike dhe ato ndërkombëtare, por konstatoj me keqardhje që ne sot jemi në një nivel të lartë keqinformimi të shoqërisë, e cila jo vetëm që nuk zhbën shumë paragjykime dhe shumë stereotipe të formuara jo vetëm në shoqërinë shqiptare, por në të gjitha shoqëritë europiane, por ndikon në krijimin e stereotipeve të reja dhe të stigmave të reja kundrejt subjekteve të ndryshme; sot janë personat LGBTI, por nesër mund të jenë pakica të ndryshme, të cilat mund të targetohen

nga këto steriotipe që nuk adresohen dhe vazhdojnë ende.

Unë jam për një zgjerim gradual, të pranuar, nga një shoqëri e informuar, sidomos në lidhje me natyrën e të drejtave, ku gjithnjë parimi duhet të jetë që të drejtat e njeriut janë për të gjithë dhe jo vetëm për shumicën në një shoqëri.

Faleminderit!

(Ndërhyje pa mikrofon)

**Lindita Nikolla** - Po, zoti Shehu.

Pyetjet nuk i kishit depozituar më parë dhe bëtë komente gjatë pyetjeve, kështu që, ju lutem, shkurtimisht, zoti Shehu, se jemi në shkelje të Rregullores!

**Tritan Shehu** - Ju kërkoj ndjesë që nuk e respektova procedurën!

Ju falënderoj që ma dhatë mundësinë!

Së pari, Komisioneri po dezinformon Kuvendin në lidhje me konventat ndërkombëtare. Nuk ka asnjë konventë ndërkombëtare që mund të na detyrojë të ndryshojmë konceptin e familjes.

Së dyti, Komisioneri është këtu për të mbrojtur Kushtetutën dhe ligjet shqiptare. Në Kodin e Familjes thuhet qartësisht se familja në Shqipëri është “burrë” dhe “grua”. Bashkëjetesa nuk është e njëjtë me familjen.

**Lindita Nikolla** - Zoti Shehu, ju po bëni komente mbi komentin tuaj. Ju lutem, bëtë pyetjet, i morët përgjigjet...

**Tritan Shehu** – Unë mendoj se Komisioneri duhet të jetë i orientuar mbi këto elemente dhe jo mbi elemente të tjera, që mund të jenë koncepte, dëshira apo mendime të tij. Kjo është esenca dhe ndaj ka ardhur në Kuvend, që të jetë konform Kushtetutës dhe legjisllacionit shqiptar, që është shumë i qartë për këtë element të rëndësishëm dhe jetik për shoqërinë njerëzore.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Viojmë me diskutimet.

Fjala për zonjën Klotilda Bushka.

Faleminderit, zoti Gajda!

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në këtë seancë, deri tani, jemi duke kryer ushtrimin e veprimtarisë së mbikëqyrjes parlamentare nëpërmjet një mekanizmi, që është rezoluta përkatëse me rekomandimet për raportimin e veprimtarisë vjetore të institucioneve të pavarura, ku konkretisht deri tani kanë raportuar 3 institucione: institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, dhe tashmë sapo dëgjuam Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në radhë të parë, do të doja të thosha dy fjalë për këtë procedurë parlamentare, e cila është nga më të rëndësishmet, në fakt, dhe është një nga dy funksionet themelore që ushtron Kuvendi: funksioni ligjvënës dhe funksioni i mbikëqyrjes parlamentare për zbatimin e ligjit, si dhe për të kontrolluar nëse veprimtaria e institucioneve të pavarura është në përputhje me ligjin dhe po u shërben interesave të përgjithshme të shoqërisë.

Rezolutat janë një mekanizëm i mbikëqyrjes parlamentare dhe rekomandimet synojnë, në bazë të manualit të mbikëqyrjes parlamentare, të japin të mira publike për shoqërinë në dy drejtime: njëri ka të bëjë me një performancë më të mirë të institucioneve, me nxitjen dhe zhvillimin e një aktiviteti shtetëror më të mirë, në interes të publikut, dhe tjetri ka të bëjë me udhëzimin dhe nxitjen e trajtimit të çështjeve për të cilat shoqëria ka nevojë të jenë prioritare për zgjidhje. Ky aktivitet ushtrohet në kuadër të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, por edhe në kuadër të një manuali të *update*-uar para dy vjetësh nga Kuvendi i Shqipërisë me ndihmën e OSBE-së për të gjithë mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare.

Shihet që ka përmirësim vit pas viti, por ka ende vend për të bërë punë më shumë. Është e nevojshme të kemi një qasje ndoshta ndryshe dhe të shohim si mund t'i shërbejë më mirë shoqërisë ky lloj mekanizmi parlamentar i mbikëqyrjes. Ne duhet të reflektojmë të gjithë së bashku, duhet të bëjmë një debat të gjerë se si duhet ta ridimensionojmë edhe mbikëqyrjen parlamentare në këtë drejtim, por duke pasur në konsideratë që,

siç e thashë, rezolutat dhe seancat dëgjimore për veprimtarinë vjetore janë një mekanizëm.

Ne kemi edhe shumë mekanizma të tjerë këtu, siç janë dëgjesat e posaçme, ushtrimi i pyetjeve, diskutimi në lidhje me amendamente të caktuara, dhe të gjitha këto janë në dispozicion të deputetëve për t'i përdorur, me qëllim që interesi publik të shërbehet nga Kuvendi, sa më mirë të jetë e mundur. Kemi raste dhe shembuj pozitivë sesi rekomandime të rezolutave të Kuvendit e kanë përmirësuar punën e institucioneve dhe kanë adresuar për zgjidhje më shpejt fenomene shqetësuese në shoqëri, ashtu sikundër kemi raste kur institucione të pavarura nuk i kanë zbatuar rekomandimet e Kuvendit dhe për këto Kuvendi duhet të marrë masat përkatëse, gjithashtu, në përputhje me dispozitat ligjore. Duhet parë se sa mundësi të tilla parashikojnë dispozitat ligjore, në mënyrë që roli i Kuvendit të jetë ashtu siç e parashikojnë Kushtetuta, ligjet, por, më së pari, interesi publik.

Po ndalem tek 3 institucionet që raportuan sot. Në fakt, të tria institucionet kanë marrë një vlerësim gjatë dëgjesave në Komisionin e Ligjeve, ku, përveç indikatorëve të performancës së punës së institucionit, është diskutuar edhe për çështjet që e shqetësojnë shoqërinë.

Do të ndalem te 2-3 rekomandime për secilin institucion, duke filluar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Është diskutuar në Komision dhe gjen adresim në rezolutë nevoja për një studim tërësor, për të kuptuar nëse është konsoliduar praktika e ankesave për rastet e diskriminimit dhe për këtë arsye njerëzit kanë besim tek institucioni dhe i referojnë atje rastet përkatëse, apo janë shtuar rastet e diskriminimit në shoqërinë tonë? Ne kemi kërkuar të bëhet një studim i posaçëm në këtë drejtim, në mënyrë që Kuvendi të jetë në gjendje të marrë masat e përshtatshme për të luftuar fenomenet e diskriminimit në shoqëri.

Gjithashtu, në rezolutë ne kemi kërkuar të adresohet fenomeni i bullizmit nëpër shkolla dhe guha e urrejtjes të fëmijët. Duhet të bëjmë një studim tematik të thelluar në lidhje me këto

çështje dhe Komisioneri e ka për detyrë të zbatojë mekanizmat që i jep ligji në dispozicion për t'i trajtuar këto çështje.

Duhet të kemi parasysh, kolegë, se në rekomandimet që ne bëjmë në rezolutat e Kuvendit, jemi brenda caqeve të Kushtetutës dhe të ligjit, por na duhet, si Kuvend, t'i orientojmë dhe t'i nxisim institucionet që të punojnë për çështjet që janë fenomene shqetësuese në shoqëri, dhe kjo jo më kot, por, sepse ne jemi deputetë të zgjedhur nga qytetarët dhe ne jemi çdo ditë në kontakt me ta. Duke parë shpeshësinë e problematikave, na duhet t'i ngremë dhe një nga mekanizmat që na lejon t'i ngremë këto çështje është pikërisht raportimi vjetor apo diskutimi i çështjeve të punës së institucioneve të pavarura. Në këtë drejtim ne kemi kërkuar nga Komisioneri që të bëjë një studim dhe të adresojë shkaqet e guhës së urrejtjes të fëmijët dhe rastet e bullizmit nëpër shkolla, si dhe rekomandimet se si duhet të punojnë institucionet për t'i parandaluar apo për t'i adresuar këto probleme.

Në lidhje me Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Kuvendi, e gjithë shoqëria shqiptare, vendosën që tashmë dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të jenë të deklasifikuara, që do të thotë të jenë të hapura për publikun. Duhet që ky institucion të fokusohet në vijim të studimi i punës se si funksiononte ish-Sigurimi i Shtetit, cilat ishin metodat e tyre, cilët ishin mekanizmat që bien ndesh me të drejtat e njeriut sot në demokraci, por që atëherë përdoreshin, pikërisht për t'i shërbyer atij që quhet "institucioni i kujtesës", që e kërkojnë edhe aktet ndërkombëtare, por edhe shoqëria shqiptare. Na duhet ta mbajmë gjallë kujtesën për të kaluarën tonë të dhimbshme, në mënyrë që, së pari, brezat ta dinë, ta njohin të vërtetën ashtu siç është, jo me perceptime apo me abuzime në dhënien e informacionit, por edhe për të lejuar që në të ardhmen brezat e tjerë të mos përsërisin të njëjtat gabime.

Në lidhje me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky institucion dje ka festuar



përvjetorin. Edhe në raportet ndërkombëtare ka një vlerësim për konsolidimin e punës së tij, edhe sa u takon hetimeve administrative, por fokusi do të ngelet te dy fusha shumë të rëndësishme, që vijnë edhe nga anëtarësimi i Shqipërisë në dy konventa të Këshillit të Europës: Konventa për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Konventa për Garantimin e Aksesit në Informacionet Zyrtare. Këto dy konventa japin detyra për Shqipërinë dhe autoritetet përgjegjëse është vetë Komisioneri. Do të duhet të punohet për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtyre konventave.

Në të njëjtën kohë, duhet të nxitet në të gjitha institucionet tona publike regjistri i transparencës dhe të trajnohen më së miri koordinatorët e të drejtës për informim publik në çdo institucion. Është zgjeruar rrjeti i një regjistri elektronik në shumë institucione në këtë drejtim, por duhet të plotësohet në të gjitha institucionet dhe kjo është një çështje që duhet të shihet me prioritet nga Komisioneri.

Nga ana tjetër, edhe numri i çështjeve dhe i ankesave, që paraqiten te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, ka qenë në rritje, çka do të thotë që na duhet të kuptojmë se cilat janë shkaqet e këtyre ankesave, cilat janë fenomenet që hasen më shpesh në shoqëri, cilat janë rekomandimet dhe si duhet t'i trajtojmë ato më së miri.

Të gjitha këto çështje janë diskutuar në Komisionin e Ligjeve gjatë raportimit vjetor të tre institucioneve dhe janë çështje që kanë qenë në dispozicionin e kolegëve deputetë për të bërë pyetje, por edhe në seancën e Kuvendit të gjithë kolegët e nderuar kanë mundësi, në kuadër të ushtrimit të së drejtës dhe të detyrës së mbikëqyrjes parlamentare, të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje për çështje të tjera, të cilat ndoshta nuk janë prekur, por, gjithashtu, të paraqesin amendamente për rekomandimet e rezolutave.

Ky është një proces që kërkon përfshirjen e të gjithëve. Edhe unë do të doja që të ridimensionohej, pra veprimtaria e raportimit

vjetor të mos ngelej e izoluar, si një nga elementet e mbikëqyrjes parlamentare, vetëm në komisionet përgjegjëse, por të ishte një *domain*, të ishte një mundësi për të gjithë seancën plenare të Kuvendit, për të gjithë deputetët e Republikës së Shqipërisë në këtë sallë, që të ngrinin çështjet, shqetësimet dhe të bëheshin diskutime për çështje konkrete, që do ta ndihmonin interesin publik.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala është për zotin Asllan Dogjani.

**Asllan Dogjani** – Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të falënderoj Arbër Hajdarin dhe organizatën e tij “Fundjavë ndryshe”, që i erdhën në ndihmë familjes së Edlira Kovaçit, nënës me 5 vajza të sëmura, duke e furnizuar me ushqime, veshmbathje dhe ilaçe, duke zbutur në këtë mënyrë sadopak diskriminimin ndaj saj, për shkak të ngjyrës. Arbër Hajdari ka marrë përsipër t'i paguajë për 1 vit qiranë e shtëpisë dhe t'i plotësojë të gjitha nevojat për ushqim, për ilaçe dhe për rroba kësaj nëne.

Gjithashtu, dua të falënderoj edhe Alfred Muharremin, drejtorin e Shërbimit Social, i cili ka reaguar në faqen time në *Facebook*, ka kontaktuar me nënën dhe po e trajton me seriozitet këtë çështje, për t'i siguruar shërbimet e munguara.

Një falënderim kam edhe për miqtë e mi në *Facebook*, që me komentet e tyre bënë të mundur të ketë reagime dhe të ndihmohet kjo nënë me 5 vajza të sëmura.

Për diskriminimin nuk duhet të flasim vetëm kur vjen Komisioneri në Kuvend, por duhet të flasim çdo ditë, çdo orë, sa herë që na jepet mundësia, kudo dhe kurdo që mundemi. Duhet të jemi shumë të hapur me njëri-tjetrin, të flasim pa dorashka, të jemi transparentë, të mos e fshehim, por ta pranojmë të vërtetën, se ndihemi të diskriminuar. Vetëm duke qenë transparentë dhe duke pranuar realitetin, ne do të kemi më pak qytetarë të diskriminuar për shkak të origjinës, të bindjes, të krahinës apo të fesë.

Së pari, duhet të japim shembullin tonë këtu në parlament. Pyetja që më shkon ndërmend dhe dua ta bëj sot është: po ne, si deputetë, a ndihemi të diskriminuar? Sigurisht që po. Konkretisht, në seancën e kaluar unë u diskriminova nga drejtuesja e seancës, kur po flisja për nënën me 5 vajza të sëmura, e cila e siguronte bukën e përditshme në kazanët e plehrave. Drejtuesja e seancës ma ndërpreu fjalën. Po të ishte një deputet i mazhorancës në vendin tim, a do t'i ndërpritej fjala? Sigurisht që jo. E mora këtë shembull jo për t'u ankuar, por për të treguar se, kur diskriminohemi ne, si deputetë të opozitës, çfarë bëhet me qytetarët e thjeshtë?!

Nganjëherë diskriminimi nuk vjen për keq, sepse, nga debati që bëmë në seancën e kaluar me drejtuesen e seancës, erdhi e mira dhe pati reagime, pasi, siç e thashë, Arbër Hajdari e furnizoi me ushqime dhe i shkoi menjëherë në ndihmë kësaj nëne.

Në jetën e përditshme diskriminimet janë bërë të zakonshme jo se qytetarët e pranojnë një gjë të tillë, por nuk kanë mundësi të reagojnë. Kush ka pasur mundësi, edhe për shkak të diskriminimit, është larguar nga Shqipëria dhe e ka braktisur këtë vend, duke marrë rrugët e kurbetit. Mendoj se jemi populli më i diskriminuar jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë, kudo ku shkojmë. A ka diskriminim më të madh, kur dëgjon Kryeministrin, madje edhe në këto zgjedhje, që u thoshte qytetarëve se, nëse do të votojnë PD-në, nuk do të kenë asnjë investim dhe “do të marrin Ndoc Rrokun”? Pra, ky është diskriminimi për shkak të bindjeve. Apo kur u thoshte të mos u jepnin votën atyre që kanë parë gjithë jetën malin dhe për herë të parë po shohin bregdetin?

Diskriminimi është kudo: për t'u emëruar në një vend pune, për të marrë shërbimin shëndetësor, arsimin cilësor, për të marrë një shërbim, një legalizim, një certifikatë pronësie, një notë në provim. Duhet të paguash para ose duhet të jesh “yni” nga origjina ose nga bindjet politike. Një ditë një doganier i thoshte shoferit të kamionit: “Ik ore, se ti vjen nga mali”, apo “vjen nga fusha!”. Është bërë zhargon i përditshëm: “hë

mo, se një copë shoferi je”, “u bëtë ju”, “jevge!” apo lloj-lloj epitimesh përdoren nga administrata e këtij vendi, e cila paguhet nga taksat e shqiptarëve. Kjo ishte për burrat, ndërsa për gratë, po të emërohesh në një vend pune, duhet të përshtatesh sipas shefit, ndryshe nuk të marrin në punë.

Edhe ne vetë e diskriminojmë veten si shoqëri. Për shembull, jo në pak raste i diskriminojmë njerëzit në qytetarë apo fshatarë, të ardhur, vendali, tanët, të tyrët, për shkak të origjinës dhe bindjes politike.

Një ditë, një polic më tha mua personalisht, kur kisha parkuar gabim: “E kemi marrë ne, vëlla”, a thua se ne jemi armiq me njëri-tjetrin.

Përpara disa ditësh takova një polic, që ka punuar me mua në Fier, i cili më tha: “Më larguan nga puna, sepse mendonin se jam i djathtë. Edhe pse u futa në një kompani private *security*, më larguan sërish kur e morën vesh që nuk do të votoja për Ramën. Unë jam pa bukë, gruan e kam të paralizuar, por edhe fëmijët me diabet”.

Zotërinj deputetë,

Ne nuk vuajmë nga mungesa e ligjeve apo e njohurive, sepse e kemi të parashikuar në Kushtetutë, në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Deklaratën Universale, në direktivat e Bashkimit Europian, që është i ndaluar me ligj diskriminimi, por qytetarët shqiptarë janë të diskriminuar, pavarësisht këtyre ligjeve, sepse nuk po punohet për ndalimin e diskriminimit në Shqipëri. Kjo është një nga arsyt kryesore që mbi 1 milion shqiptarë e kanë braktisur vendin. Kemi mbi 1 milion shqiptarë që e kanë braktisur vendin për shkak të këtyre diskriminimeve politike, ekonomike, shoqërore që bëhen nga administrata e këtij vendi, ndaj këtyre qytetarëve për shkak të bindjeve, të origjinës, të krahinës, të fesë apo të idesë. Ne nuk duhet të fshihemi, por të jemi sa më transparentë.

Duke përfunduar, dua t'i bëj thirrje Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të mos mjaftohet me raportin që sjell këtu, duke na treguar konventat e të tjera, por të marrë masa të përditshme për sensibilizimin e opinionit

publik, të punojë me administratën dhe të vendosë përpara përgjegjësisë të gjithë ata që diskriminojnë qytetarët shqiptarë. Në radhë të parë, të ndalojë diskriminimin e Kryeministrit, kudo ku shkon, ndaj qytetarëve për shkak të bindjeve, për shkak të krahinës, për shkak të origjinës apo edhe për shkak të gjuhës.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Sali Berisha. Të përgatitet zoti Flamur Noka. Keni 5 minuta në dispozicion.

Zoti Noka, ju nuk do të flisni?

**Sali Berisha** – Sa minuta kam?

**Lindita Nikolla** – 5 minuta.

**Sali Berisha** – 5 minuta apo 10 minuta?

**Lindita Nikolla** – Keni 5 minuta ju dhe 5 minuta zoti Noka. Nëse zoti Noka nuk do të flasë, keni 10 minuta ju, zoti Berisha.

**Sali Berisha** – Të diskutosh për diskriminimin në këtë parlament është hipokrizi e madhe, është shaka bajate, pasi, në rast se pranohet që Kushtetuta dhe ligjet janë garancia e qytetarëve për barazi përpara tyre, në Shqipëri Kushtetuta është një letër pa vlerë dhe ligjet, sipas kreut të këtij regjimi mafioz, janë kinezëri.

Natyrisht, nuk mund të injorohet se në këtë piramidë diskriminimi, ata që e pësojnë më shumë se të gjithë të tjerët janë pakicat dhe nuk mund të ndodhë ndryshe, sepse pabarazia para ligjit dhe dhunimi i Kushtetutës nxitin të gjitha format e racizmit, të gjitha format e diskriminimit. Është e sigurt se romët, egjiptianët dhe anëtarët e pakicave të tjera, në shumë aspekte, janë qytetarët më të diskriminuar të Europës, por, e thashë edhe një herë, ky shtet është shteti mafioz i piramidës së diskriminimit, i trajtimit me 2-3 standarde të qytetarëve shqiptarë. Nëse i hedhim një sy luftës kundër korrupsionit, ajo është një shkallare turpi.

Edi Rama firmos aferën prej 420 milionë eurosh të djegësve, në fakt shumë më tepër se kaq, dhe e shet këtë aferë në takime e stërtakime si sukses të Shqipërisë, në fakt të xhepit të tij; Edi Rama firmos në kundërshtim flagrant me ligjin e prokurimeve këtë aferë, që ua shet shqiptarëve si për garanci poliretanin,

Edi Rama shpall, për shkak të ndërmarrjes së tij, ndryshimin e strategjisë së vendit për plehrat, bën demagogun dhe hiqet sikur drejton luftën kundër korrupsionit, në një kohë kur ai është gjeneratori numër 1 i korrupsionit në Shqipëri, në një kohë kur ai është arkitekti i sistemit të korrupsionit në këtë vend.

Ata nëpunës dhe ish-punonjës, që janë në burg për shkelje të ligjit, sigurisht që e meritojnë dënimin, por shkalla e diskriminimit të tyre, në raport me Edi Ramën, është sa Everesti, është e jashtëzakonshme. Kjo nuk është vetëm me Edi Ramën. Nëse një punonjëse dënohet se ka marrë 30 mijë euro për një tender dhe e meriton plotësisht dënimin, Olta Xhaçka, që ka marrë investimin strategjik prej dhjetëra milionë eurosh, në shkelmim flagrant të ligjit dhe Kushtetutës, mbrohet nga hajdutët e këtij parlamenti, sepse normat morale të tyre janë normat e hajdutëve. Ligji dhe Kushtetuta për këta nuk ekzistojnë.

Ku nuk figurojnë emrat e këtyre ministrave në aferat e turpshme korruptive! Gjushi arrestohet dhe burgoset për një tender, me meritë të plotë i arrestuar, për një pallat, me meritë të plotë. Po ky “Gjushi” i Tiranës, i cili mashtroi, i cili ka vjedhur faturat e 1 milion fidanëve, çfarë po pëson ky?! Çfarë flasim këtu për diskriminimin?! Gjushi burgoset për një pallat, se janë shtuar disa kate dhe e meriton plotësisht, kurse ky “Gjushi” i Tiranës, që ka jo një, por dhjetëra pallate, kate mbi kate, kalon pa i hyrë ferra në këmbë. Gjushi, ky kriminel elektoral, që meriton vetëm për këtë çdo dënim, dënohet për një tender se e ka shumëfishuar shumën, po “Gjushi” i Tiranës, që u vjedh qytetarëve të Tiranës, për ndërmarrjen e tij dhe të Edi Ramës, në çdo ton plehra nga 11 euro, që është në kontratë 29 euro, u vjedh 18 euro? Ky shtron darka, dreka, pritje, përcjellje. Ky është vendi i diskriminimeve më të tmerrshme!

Punonjësja e shëndetësisë, që mori 30 mijë euro ryshfet, e meriton plotësisht dënimin. Po shefja e saj, që me vjedhjet në dhjetëra tenderë është shkak madhor i 20 mijë jetëve të humbura nga Covid-i?

A e dini ju se Kontrolli i Lartë i Shtetit, prej muajsh e muajsh, i ka dorëzuar zonzës, e cila nuk është këtu dhe mirë bën që ikën, se kur më rri këtu mbrapa shpinës nxin fare, ma prish peizazhin... Po, e vërteta, ia mbyll Edi Rama, ia ka dorëzuar SKAP-it, por SKAP-in e programon Edi Rama, është aktakuzë me dirigjencë, me regji. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka gjetur zonzën abuzive në shkallën më ekstreme, por e mbron Edi Rama.

Po “Ballukja”, që është hajdutja më e madhe bashkë me Edi Ramën në fushën e energjisë, në Ballkan dhe në Europë, që zbraz digat, shet energji me çmim 3-4 herë më të lirë se në bursë...

**Lindita Nikolla** – Mbaroi koha, zoti Berisha.

**Sali Berisha** – A po flasim për diskriminimin? Të lutem! Nëse këto nuk janë të vërteta, po, por të gjitha janë të vërteta.

**Lindita Nikolla** – Të mos diskriminojmë Rregulloren e Kuvendit!

**Sali Berisha** – Ja pra, këto janë! Keni ndërtuar piramidën e diskriminimit në këtë vend, piramidë turpi.

Është në kërkim Gentian Sharra, Gentiani tjetër këtu drejton grupin parlamentar. A nuk është ky një diskriminim i turpshëm?! 54 bileta udhëtimesh me kapon e trafikeve, Begon! A nuk është ky një diskriminim?! Me dhjetëra gjykatës kanë dorëzuar mandatet, se janë ulur e kanë pirë kafe me ndonjërin prej tyre. Pse i bëni këto seanca me kaq hipokrizi, kur e dini që dilni më të zinj sesa më nuk bëhet? Pse i fusni në rendin e ditës këto çështje? Gjoja e keni preokupim të madh diskriminimin, në një kohë që keni ndërtuar piramidën më të zezë të diskriminimit në këtë vend.

Flisni pak! Ku janë këta të tjerët? Ku janë? Njëlloj dalin, njëlloj jeni.

**Lindita Nikolla** – Koha juaj mbaroi, zoti Berisha.

*(Zoti Berisha flet pa mikrofon.)*

Fjala është për zotin Taulant Balla.

**Taulant Balla** – Ironia më e madhe e kësaj foltoreje, e kësaj salle është që të vijë Sali Berisha

dhe të thotë: “Drejtësia vonon, por nuk harron”, që Sali Berisha të marrë nëpër gojë edhe Vangjush Dakon, se ka shpërdoruar detyrën për një leje pallati (dhe unë nuk u hyj kurrë komenteve të vendimeve të drejtësisë, e kemi marrë këtë vendim një herë e përgjithmonë ne, krahu këtej, drejtësia të bëjë detyrën e vet, por mirë është që drejtësia ta bëjë detyrën e saj njësoj për të gjithë), kur Sali Berisha ka vrarë duke shpërdoruar detyrën. Unë nuk e di çfarë bën Prokuroria e Tiranës, meqenëse atje mbahet peng dosja e vrasjes së Aleks Nikës, një dosje, në të cilën sot, sipas Prokurorisë së Tiranës, thuhet se është vrasje pa autor, kur Sali Berisha ka dalë këtu, në këtë foltore, në çdo studio dhe ka thënë: “E kam vrarë unë. Kam dhënë unë urdhër të qëllohet.” Të vijë këtu Sali Berisha dhe të marrë nëpër gojë njerëz që sot janë përpara drejtësisë, të vijë këtu Sali Berisha dhe të thotë se sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë, e arrestuar për 3 milionë lekë të vjetër rryshfet, dhe shumë mirë, sepse e kam përshëndetur dhe do ta përshëndes gjithmonë punën që bën drejtësia, SPAK-u, ndaj kujtdo, pra ky të vijë këtu dhe të ngrejë akuza, kur sot në orën 11:00 duhet të ishte përballë meje, përballë prokurorit dhe përballë gjyqtarës, se e kam çuar dhe e kam paditur në Gjykatën për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shpifje, padi penale! Ky nuk vjen atje, ky bën gjithçka, madje e komplekson edhe SPAK-un, sepse nuk i thotë rastësisht “SKAP”, është thjesht një kompleks që mundohet ta bëjë siç e ka bërë këtu e 30 vjet me radhë. Po e thirrën një ditë në SPAK, ky nuk shkon, do të bëjë të sëmurin, do të bëjë gjithçka, por ky këllqë dhe prapanicë që të shkojë para prokurorëve nuk ka. Ky është një i vdekur që vazhdon të ecë në këmbë dhe fundi më ekzemplar i gjithë kësaj fjale që dëgjuat këtu. “E patë?” - tha. Flet në emër të drejtësisë amerikane ky, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë shpallur me vulë dhe me firmë se nuk hyn dot në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; ky që është *non grata* për Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Për çfarë? Për korrupsion të nivelit të lartë dhe minim të demokracisë.

Po ashtu, është publik fakti që Britania e Madhe, një aleat tjetër, ia ka dhënë me fakte, me emra. Unë nuk e di se çfarë pret drejtësia në këtë vend, përpara se t'u drejtohet edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe Britanisë së Madhe e t'u thotë: dëgjoni, Sali Berisha ka dalë dhe ka lexuar vendimin e Britanisë së Madhe, që e akuzon për vepra korruptive me emra, për bashkëpunim me Damir Fazlliqin për 1,2,3 gjëra. Për çfarë flasim këtu?! Flasim për këtë 3-milionëshin e vjetër të sekretares së Përgjithshme?! Patjetër, shumë mirë, po për këtë historinë e 408 milionë eurove të privatizimit të kompanisë OSSH, e cila u privatizua si i vetmi objekt shtetëror, ose në pronësi shtetërore që, kur u shit, ata që e shitën nuk kishin përcaktuar vlerën se sa kushton dhe sot e kësaj dite nuk ka njeri, edhe në qeverinë time dhe tonën që të thotë sa është shitur kompania OSSH, sepse u kthye mbrapsht, ndërkohë që ky Kuvend, me vendimin e vet të muajit mars të vitit 2017 ka përcaktuar se nën dirigjimin e Sali Berishës shteti shqiptar ka humbur 408 milionë euro. Dosja është në prokurori, se në cilën prej prokurorive unë nuk e di, nuk e them dot më. Më ka humbur durimi, sepse shkon aty, të pyesin...

Ndërkohë që atë, që e kam natyrshëm merakun e meraqeve, është dosja e "Gërdecit". Edhe ajo patjetër që shpresoj që të jetë mamaja, babai i të gjithë asaj afere, që është familja e Sali Berishës. A e mbani mend se si raportonte ministri i Drejtësisë, Aldoja, te koka e letrës "për Shkëlzen Berishën"? Aldo Bumçi raportonte tek i biri i Sali Berishës! Prapë pastaj kthehem te "21 janari", sepse pyesin, ose shpresojnë që është parashkruar, por nuk parashkruhet vrasja. Cili është efekti i shpërdorimit të detyrës së Sali Berishës në vrasjen e "21 janarit"? Ka shpërdoruar detyrën me pasojë vrasjen e protestuesve. Tani vjen ky dhe thotë se Vangjush Dako, i cili do të përballet vetë me drejtësinë, paskësh shpërdoruar detyrën për një leje pallati para 12 vjetësh! Po ky që e ka shpërdoruar detyrën për vrasje shtetërore, që e ka shpërdoruar detyrën të privatizimi i kompanisë OSSH, ku u pagua

ryshfeti 2 javë para zgjedhjeve të 28 qershorit të vitit 2009 në një bankë të nivelit të dytë, mu në qendër të Tiranës dhe drejtuesi i bankës, kur ne kërkua dokumentacionin, tha: "Nuk besoja kurrë që një ditë kjo çështje do të hetohet". Nuk e hetoi prokuroria, por e hetoi Kuvendi. 6,8 milionë euro janë tërhequr nga sekseri i aferës, që për turpin e Policisë së Shtetit, nëse doni, e keni në Prizren; është në Prizren dhe mbjell patate: Nuel Nikë Kalaj. Merreni, silleni këtu që të dëshmojë se 6,8 milionë eurot janë ryshfeti, sepse edhe kompania CEZ e ka shkruar në bilancet e veta: "Succes fee", "pagesë sukcesi", "tarifë sukcesi" për privatizimin, për blerjen e kompanisë. Sukses me kë?! Me qeverinë shqiptare. Prandaj, kjo është e rëndë.

E fundit: erdhi ky individ (po mbaj gojën, sepse e di unë çfarë meriton ai) dhe tha: "Hajdutët e kësaj pjese", por ti, Sali, kësaj pjese do të vazhdosh t'ia hash gjithmonë, gjithmonë, sa herë të të jepet mundësia, sepse ti këtij krahu i vjen anës.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ai zotëria e akuzoi këtë krah të sallës për hajdut dhe prandaj do t'i them: kësaj salle dhe kësaj ane i vjen anash ti, Sali, edhe këta që të vijnë nga mbrapa.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Dakord. Ju kërkoi të gjithëve të respektoni Kodin e Etikës.

Vijojmë me çështjen tjetër: projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar". Referuar nenit 73, pika 2 të Rregullores, a ka pyetje?!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Noka, për procedurë.

**Flamur Noka** – Zonjë, unë besoj se ju jeni edhe deputete e Kuvendit të Shqipërisë, jeni edhe një zonjë, jeni edhe një nënë, tashmë jeni bërë edhe gjyshe, dhe nuk besoj se jeni shurdhe, të paktën kështu kam informacion. Fjala e përdorur nga parafolësi është një zhargon i vulgut ordiner të rrugës. Nuk është fjalë që mund të përdoret në këtë Kuvend, sepse këtu emri "Kuvend" është për

të kuvenduar burrat dhe gratë për hallet e këtij vendi dhe të kësaj shoqërie. Ndërhyni e merrni masa! Unë kërkoj që parafolësi të përjashtohet urgjentisht, si një halabak ordiner dhe të bëhet shembull edhe për të tjerët për të përdorur gjuhën e komunikimit! Gjuha e rrugës dhe gjuha e vulgut nuk mund të prevalojë në parlament. Unë e kuptoj që ju mund të jeni mësuar, por kjo është e papranueshme.

**Lindita Nikolla** – Zoti Braçe ka kërkuar fjalën për procedurë.

**Erion Braçe** – Kryetare, në fakt, ishim në seancën e diskutimit për raportin e Komisionerit kundër Diskriminimit dhe, me thënë të drejtën, unë e dëgjova me shumë vëmendje dhe nuk e ndërpreva asnjëherë zotërinë kur foli, e kam fjalën për Sali Berishën. Nga fillimi deri në fund ishte një fjalë diskriminuese, fyese, akuzuese, agresive përkundrejt të tjerëve jashtë kësaj sale dhe përkundrejt deputetëve në këtë sallë. E nisi me popullin e madh dhe vëlla kinez, i fyeu ata në radhë të parë, sepse çdo gjë që u diskutua këtu deri në momentin që ai foli, e quajti “kinezëri”. Unë mendoj se njerëzit në Kinë nuk i kanë asnjë borxh zotërisë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Të gjithë, moj zonjë, që e përdorin, e diskriminojnë, por, sidomos, ata që në kohën e marrëdhënieve të shkëlqyera shqiptaro-kineze kanë përfituar, nuk e kam fjalën për oriz, por kanë përfituar shkollim, përvojë, eksperiencë e të tjera me radhë, duhet të përmbahen, sepse, me thënë të drejtën, përveç ne të rinjve në këtë sallë, ka edhe disa të lashtë, si puna e zotërisë, që e kanë pasur këtë marrëdhënie me popullin vëlla kinez. Me thënë të drejtën, më shumë se sa kanë luftuar kinezët për liri, nuk ka luftuar ai zotëria këtu në Shqipëri, sepse jemi tamam në përvjetorin e demonstratave kur kinezët kërkonin liri atje matanë dhe u shtypën me tanke dhe zotëria i duartrokiste. Dakord?!

Së dyti, që është po kaq e rëndësishme, kur u thuhet të tjerëve këtu në këtë sallë “hajdutë”, unë nuk e di se çfarë gjuhe është, por politike nuk është. Gjuhë e poshtër, ordinere dhe, çfarë doni ju,

po, patjetër, edhe mund të jetë. Pra, në qoftë se kërkohet standard, të mbahet standardi nga fillimi e deri në fund, edhe për popullin vëlla kinez, por edhe për çdokënd tjetër që këtu në këtë sallë hyn vetëm për të nxjerrë mllëfin dhe marazin e tij të gjithë ditës. Unë e kuptoj që në këtë moshë kjo të ngelet, por, me thënë të drejtën, s’ia ka për borxh kurkush.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Noka.

**Flamur Noka** – Unë e kuptoj shqetësimin e parafolësit, e kuptoj edhe ndjeshmërinë që ka për popullin, por ne nuk e kemi popull vëlla, sepse ne popull vëlla kemi vetëm popullin shqiptar të Kosovës. Popull vëlla mund ta ketë “Rilindja” Kinën, por jo ne të tjerët. Duhet t’i ndajmë disa gjëra.

Së pari, në qoftë se u shqetësua për shprehjen “kinezëria”, duhej të ishte shqetësuar kur Kryeministri i vendit, Kodit Elektoral iu adresua: “Mos i konsideroni ato, sepse janë kinezëria”, pra ligjit të zgjedhjeve. Mbi bazën e këtij artikulimi të Kryeministrit u bë gjithë kjo farsë e batërdisë, që u turrën ushtri, polici, administratë, kriminelë, para droge, para krimi për të masakruar vullnetin e shqiptarëve, por në atë kohë kolegu im parafolës nuk reagoi asnjëherë.

Së dyti, për sa i takon perifraximit “hajdut”, po, sepse kilometri i rrugës në Shqipëri është 23 milionë euro, kur në Greqi, nga Janina deri në Kakavijë, me standarde europiane është 4,5 milionë euro, nuk ka emër tjetër vetëm “hajdutë”. Ata që vjedhin vota...

**Lindita Nikolla** – Zoti Noka, nuk është procedurë kjo, ju lutem!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

E ka kërkuar fjalën edhe zoti Balla për procedurë.

Po, zoti Braçe.

**Erion Braçe** – Edhe një herë, për t’i konfirmuar diçka zotit Noka. Kur iu referova popullit vëlla dhe të madh kinez, iu referova pikërisht asaj që, kur unë kam qenë në kopsht, ai zotëria na edukonte, jo zoti Noka, por ai tjetri përpara zotit Noka. Ai na edukonte me këtë gjë.

Unë për vete nuk kam vëlla, kam vetëm motra: Amerikën, Gjermaninë, Italinë, Francën, Spanjën. Këto kam unë, ndërsa për pjesën tjetër është ekzakt ajo që thashë, kush e ka pasur, le ta mbajë motër, vëlla e çfarë ta ketë. Kosovën unë nuk e quaj vëlla, e kam timen, e kam aty, jemi një. Kjo për Kosovën, ndërsa për pjesën tjetër është histori tjetër.

Zoti Noka, po ta them edhe një herë tjetër: kur flisni për kilometra, metra, kile, tonë e të tjera me radhë dhe çoheni atje e u drejtoheni deputetëve me gisht, mirë është që ta provoni. Nëse nuk e provoni dot, mirë është që të tërhiqeni nga ajo që thoni.

*(Zoti Noka flet nga salla pa mikrofon.)*

Si është e vërteta?

*(Zoti Noka flet nga salla pa mikrofon.)*

Zoti Noka, unë di shumë, por, po fillova me ato të miat, pastaj nuk mbarojmë.

**Lindita Nikolla** – Zoti Balla.

**Taulant Balla** – Zonja Kryetare, unë e kuptoj reagimin e atyre që janë ngjitur pas këpucës së Saliut dhe u shkon mendja te ndonjë fjalë që është fjalë joetike, por unë në fjalën time nuk kam përdorur ndonjë fjalë joetike. Atyre që u shkon mendja tek ajo fjalë, kanë problemet e tyre mendore. Ajo që unë po ju them, është që Sali Berisha, Partisë Socialiste të Shqipërisë, dhjetë vjet kanë kaluar, edhe dhjetë të tjera do të kalojnë, do të vazhdojë t'i bëjë atë që ka marrë si përgjigje në këta dhjetë vjet që kanë kaluar. Kaq ishte e gjithë shprehja.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Viojmë.

Referuar nenit 73, pika 2 të Rregullores, a ka pyetje për projektligjin? Nuk ka. Atëherë, ministrja e Financave dhe Ekonomisë prezanton projektligjin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Respektoni Rregulloren, zotëri! Mund t'i drejtoheni Komisionit të Etikës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jam Kryetare e Kuvendit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, fare, ju dëgjova me vëmendje, ashtu siç dëgjova me vëmendje parafolësin në sqarimet që bëri. Nuk pati asnjë moment që cedoi në fjalën e tij.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A ka mundësi të vijojmë qetësisht me seancën?!

Zonja Ibrahimaj, fjala për ju.

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Vij sot para jush për të prezantuar projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”, të cilin po e paraqesim sot për miratim. Kjo vjen si një nismë e qeverisë shqiptare për të mbrojtur prodhimin vendas, për ruajtjen e sigurisë ushqimore, si dhe për mbështetjen e eksportuesve tanë për t’iu drejtuar tregjeve ndërkombëtare me çmime sa më konkurruese.

Kjo nismë e ka zanafillën në paketën fiskale të hartuar në vitin 2021 dhe i përkiste vitit 2022, kur ne vendosëm ta ndryshonim kuadrin ligjor duke vendosur një taksë ekstra për qumështin pluhur dhe nënproduktet e tij, si pijet e homogjenizuara, pasi në atë periudhë ishte konstatuar një rritje e importit të qumështit pluhur në treg, e cila u konsiderua shqetësuese si nga ana jonë, ashtu edhe nga biznesi. Qëllimi i kësaj politike ishte vendosja e një takse, me qëllim rritjen e prodhimit vendas dhe shtimin e sigurisë ushqimore. Unë dua të theksoj se kjo politikë i dha efektet e saj, sepse pas zbatimit të ligjit u vu re ulja e sasisë së importit të qumështit pluhur, ndërsa të ardhurat u rritën.

Megjithatë, në zbatimin e këtij ligji patëm disa shqetësime të ndryshme nga palë të ndryshme interesi, të cilët na argumentuan se hirra nuk përdorej për qumësht, por përdorej për disa procese teknologjike dhe vendosja e kësaj takse ndikonte në prodhimin vendas, si të biskotave, çokollatave etj., pjesë e të cilave shkonin edhe për eksport.

Në të gjitha takimet që kemi pasur me grupet e interesit dhe me Shoqatën e Prodhuesve jemi

njohur me shqetësimet e tyre, të cilat kryesisht kishin të bënin me rritjen e kostove të produkteve për kompanitë eksportuese deri në 5%, të cilat për prodhimin e produkteve të tyre përdornin si lëndë të parë hurrën e qumështit. Kjo rritje e kostove ka bërë që produktet shqiptare të mos jenë më konkurruese, kryesisht në tregjet ndërkombëtare, si rrjedhim u pa e arsyeshme të propozohej heqja e taksës së importit dhe prodhimit për produktin hurrë qumështi dhe të taksës për krem qumështi.

Ligji parashikonte, gjithashtu, edhe përjashtimin nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrën e qumështit dhe taksës për kremin e qumështit për fabrikat e prodhimit dhe përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat në etiketën e miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kanë evidentuar sasinë në përqindje të këtyre produkteve që janë trupëzuar në produktin përfundimtar. Arsyetimi, mbi të cilën u mbështet një vit më parë Këshilli i Ministrave për propozimin dhe miratimin e vendosjes së këtyre taksave, ishte që të nxisnim në mënyrë me efektive prodhimin vendas të qumështit dhe nënprodukteve të tij. Vendosja e taksave për hurrën e qumështit pluhur dhe qumështin e homogjenizuar pluhur/krem qumështi, i njohur ndryshe si krem “Barista”, u kundërshtua nga grupet e interesit. Për këtë arsye qeveria shqiptare nëpërmjet institucioneve përgjegjëse analizoi efektet e derivuara nga aplikimi i taksave për hurrën e qumështit dhe atë të kremit të qumështit, si dhe efektet negative të pretenduara nga prodhuesit e linjave të prodhimit të produkteve për eksport.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave referon se gjatë vitit 2021 janë importuar 589 265 kg pije të homogjenizuara, ku përfshihet edhe kremi i qumështit pluhur, si dhe 432 962 kg hurrë. Të njëjtat produkte në vitin 2022, pas vendosjes së taksave rezultojnë të jenë importuar gati në gjysmën e sasisë së tyre, pra 262 807 kg pije e homogjenizuar/krem qumështi pluhur dhe 357 199 kg hurrë qumështi pluhur.

Për ne, si qeveri, synimi është ta lehtësojmë barrën fiskale për këto dy produkte për

importuesit, të cilët i përdorin kryesisht për prodhimin e produkteve të tjera të kësaj natyre për eksport për t'i mbështetur dhe për t'i nxitur këta prodhues.

Për të përmirësuar politikën tona kemi bashkëpunuar intensivisht me grupet e interesit, me Komisionin parlamentar të Ekonomisë, me Ministrinë e Bujqësisë, ashtu siç ka ndodhur edhe me projektligjin që po ju paraqesim.

Vlen të theksojmë se nga diskutimet e projektligjit të propozuar, u morën parasysh edhe ankesat e prodhuesve vendas, që përveç eksportuesve të shtoheshin edhe prodhuesit vendas të qumështit dhe nënprodukteve të qumështit.

Projektligji që kemi sot për miratim, parashikon të heqë taksën për produktin e hurrës së qumështit dhe taksën për kremin e qumështit për eksportuesit, si dhe për prodhuesit vendas, të cilët e përdorin atë për eksport, por edhe për tregun vendas për procese të teknologjisë dhe procese industriale.

Faleminderit!

E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse jam këtu dhe kam fjalën, dua të paraqes para jush një tjetër projektligj shumë të rëndësishëm, të cilin e paraqesim për miratim: atë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Në një kohë kur sapo kanë përfunduar zgjedhjet e 14 majit dhe ne arritëm të fitojmë pjesën më të madhe të bashkive, vijojmë të paraqesim projektligje, të cilat synojnë miradministrimin e financave vendore. Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore mbetet një prioritet yni, pasi në thelb të tij garantohet përmirësimi i jetës së qytetarëve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve që u ofrohen atyre.

Për ne disiplina financiare e bashkive është tejet e rëndësishme, jo vetëm për sa i përket zbatimit të proceseve të decentralizimit, por edhe në kontekstin e situatës ekonomike, në të cilën po jetojmë, ku na duhet ta menaxhojmë me



përgjegjësi maksimale paranë publike dhe të ardhurat.

Ecuria e treguesve fiskalë të pushtetit vendor gjatë vitit 2022 ka rezultuar pozitive si në mbledhjen e të ardhurave, ashtu edhe në realizimin e shpenzimeve të financuara nga këto të ardhura. Pushteti vendor i ka siguruar të ardhurat e veta në vlerën rreth 30,9 miliardë lekë në total, shifër kjo 5% më e lartë se ajo e një viti më parë. Ndërsa, për sa i përket përfitimit në formën e transfertave, ai ishte rreth 29,8 miliard lekë ose rreth 1,7% më shumë se një vit më parë. Më konkretisht, duke iu referuar periudhës së para reformës së decentralizimit, nga viti 2015 deri në vitin 2022, por edhe të ardhurat e planifikuara për vitin 2023, janë rritur me rreth 2,5 herë, ndërkohë që shpenzimet, ku bëjnë pjesë edhe investimet, janë rritur me rreth 72%. Në total, nga 2,4% e produktit të brendshëm bruto, që përbënin të ardhurat përpara reformës, sot ato përbëjnë 2,7% të PBB-së.

Sot edhe struktura e shpenzimeve të bashkive ka shënuar një ndryshim cilësor, duke u dhënë më shumë peshë shpenzimeve që kanë të bëjnë me shërbimet dhe investimet publike, sesa atyre për shpenzime operative, pra kryesisht për paga të administratës.

Nëse 10 vjet më parë, 40% e bashkive shpenzonin më shumë se 90 % të të ardhurave të tyre për pagat, sot kjo shifër në mestare është 34%. Sot ne kemi arritur të rritim disiplinën financiare. Bashkitë sot arrijnë të sigurojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të buxhetit nga burimet e tyre. Kështu, dua të marr shembullin e Bashkisë së Tiranës, e cila 70% të buxhetit e siguron nga të ardhurat e veta, ndërkohë që bashkitë e qendrës sigurojnë rreth 50%-60% të buxhetit, ndërsa bashkitë e vogla sigurojnë 30% të buxhetit.

Në vitin 2016, kur bashkitë gjendeshin në një situatë të vështirë financiare, në kuadër të masave të marra, stoku i detyrimeve të prapambetura që ato kishin në atë kohë ishte 12,9 miliardë lekë, ndërkohë që, me të gjitha masat e ndërmarra në vite si pasojë e reformës së decentralizimit, por

edhe si pasojë e ndërhyrjeve të shpeshta ligjore që kemi bërë, me qëllim disiplinimin e financave publike të bashkive, stoku i detyrimeve të prapambetura ka shkuar në 5,4 miliardë lekë në fund të vitit 2022. Pra, detyrimet e prapambetura janë ulur rreth 60%, gjë që tregon për një përgjegjshmëri në menaxhimin e të ardhurave dhe për një përgjegjësi në mosakumulimin e detyrimeve të reja të prapambetura për pjesën më të madhe të bashkive. Këtu dua të theksoj se stoku i vitit 2016 prej 12,9 miliardë lekësh ishte një stok i akumuluar nga detyrimet e prapambetura të ish-komunave, pra nuk ishte një stok i akumuluar nga bashkitë. Bashkitë kishin detyrim që të zeronin një detyrim që nuk vinte nga keqmenaxhimi i tyre, por nga keqmenaxhimi i strukturës administrative të mëparshme, pra para reformës territoriale.

Objektivi ynë primar është të arrijmë mirëqeverisjen vendore. Natyrisht që në këtë përpjekje, bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore është kyç. Për këtë qëllim, për herë të parë, në ligjin e buxhetit të vitit 2018 ne vendosëm një klauzolë, e cila i jepte të drejtë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si autoritet fiskal, të ndërhynte sa herë që shikonte disbalancime, pa cenuar autonominë lokale, në mënyrë që autonomia lokale të mos cenonte ecurinë dhe unitetin ekonomik të vendit, pra balancimin midis shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale, me investimet, me ato shpenzime që shkojnë në shërbim të qytetarëve. Për këtë ne kemi marrë në konsideratë dhe kemi ndjekur me rigorozitet parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, të cilat na kanë ndihmuar të forcojmë rolin financiar të pushtetit vendor.

Me anë të reformës administrativo-territoriale ne kemi synuar mirëqeverisjen. Reformimi dhe modernizimi i menaxhimit të financave publike vendore mori një dimension të ri zhvillimi pas miratimit dhe fillimit të zbatimit të reformës dhe shifrat janë të qarta: të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore, siç thashë, janë dy herë më të larta; investimet vendore nga të ardhurat e pushtetit vendor janë 3 herë më të larta; rritja e

eficiencës ka sjellë më shumë cilësi në ofrimin e shërbimeve ndaj publikut; është ulur pabarazia midis njësive të vetëqeverisjes vendore; burimet financiare në dispozicion, kryesisht nëpërmjet transfertave, janë rritur.

Pjesë e kësaj reforme ishte edhe ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili u miratua në vitin 2017, i cili synonte disiplinimin financiar të bashkive. Një gjë e tillë është reflektuar edhe tek transparencja dhe llogaridhënia, që kanë sjellë një rritje të përgjegjshmërisë së njësive vendore në ushtrimin e funksioneve mbi bazën e karakteristikave të secilës prej tyre. Pra, ne sot flasim për një standard sipas nevojave dhe profileve të njësive vendore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa masa të rëndësishme për mbështetjen e reformave decentralizuese, duke kontribuar direkt në autonominë financiare të qeverisjes vendore nëpërmjet konsolidimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar.

Sikundër theksova më lart, ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i miratuar në muajin prill, ka rritur ndjeshëm autonominë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Unë dëshiroj ta vendos theksin në disa elemente:

Dua t’u rikthehem detyrimeve të prapambetura, që janë një ndër risqet potenciale fiskale dhe rritja e nivelit të tyre mund të shoqërohet me probleme likuiditeti për njësitë vendore, ndaj edhe ne synojmë që përmes këtij projektligji të nxitim shlyerjen e këtyre detyrimeve. Dua të theksoj se ka disa bashki që kanë performuar shumë mirë, ku kanë pasur në fund të vitit 2022 një stok detyrimesh të prapambetura më të vogël se 5%, ku hyn Bashkia e Tiranës, ajo e Korçës, ajo e Elbasanit e të tjerë.

Gjatë këtyre viteve, në disa njësi të vetëqeverisjes vendore janë evidentuar parashikime tejet optimiste për sa i përket rritjes së të ardhurave, gjë e cila potencialisht sjell pasoja në stimulimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Duke planifikuar më shumë të ardhura, sigurisht që planifikohen më shumë shpenzime e investime, si dhe rritet potenciali i

detyrimeve të prapambetura kur të ardhurat nuk realizohen.

Nëpërmjet aktit që ne propozojmë për miratim, propozojmë që llogaritja e vështirësisë së gjendjes financiare të bashkive të mos bëhet më mbi bazë të planifikimit të të ardhurave, por të bëhet në bazë të realizimit faktik të tyre. Në këtë këndvështrim, ne i kemi analizuar me kujdes faktorët dhe aktorët që kanë ndikuar në realizimin dhe mosrealizimin e treguesve kryesorë financiarë dhe buxhetorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikoi për herë të parë në vitin 2021 raportin për gjendjen financiare të bashkive, i cili do të jetë një raport që do të publikohet me bazë vjetore, për ta analizuar sa më mirë situatën e bashkive dhe për të evidentuar problematikat që ato kanë në lidhje me mirëmenaxhimin financiar. Në këtë frymë, në vijim të publikimit të raportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, çdo vit bashkëharton një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Edhe pse kemi vënë re përmirësime në këtë drejtim dhe shifrat tregojnë qartësisht përmirësimin e eficiencës dhe mirëmenaxhimit, ne mendojmë se ka ende hapësirë për përmirësim.

Përveç këtij mekanizmi, pra një plani të detajuar, ku bashkëveprojmë me njësitë vendore, në mënyrë që detyrimet e prapambetura të ulen, ne kemi menduar krijimin e një mekanizmi, i cili do t’i orientojë njësitë e vetëqeverisjes vendore drejt shlyerjes së këtyre detyrimeve në një kohë akoma më të shkurtër. Duke evidentuar rritjen e fondeve të trashëguara nga viti në vit, ne propozojmë që jo më pak se 30% e atyre fondeve, të cilat trashëgohen dhe nuk janë të obliguara, të përdoren për të paguar detyrimet e prapambetura, ose, nëse nuk ka, për të paguar nënhuat, që njësitë lokale i kanë qeverisjes qendrore. Ky përcaktim, pra jo më pak se 30% e tyre, vendos një nivel dysHEME për përdorimin për këtë qëllim, por nuk e kufizon atë, pra bashkitë janë të lira që të

përdorin më shumë se 30% të fondeve që trashëgojnë dhe nuk janë të obliguara.

Për këto arsye që ju parashtrova më sipër, ne morëm iniciativën ligjore, që stoku i borxhit të matet me buxhetin faktik dhe jo me planin, në mënyrë që të mos lejojmë akumulime të shpenzimeve të parashikuara dhe papaguara gjatë vitit, gjithashtu, të vëmë një limit për trashëgimin e fondeve, me qëllim disiplinimin e përdorimit të fondeve publike dhe nxitjen e bashkive që fondet, të cilat janë të planifikuara për atë vit, të disbursohen brenda atij viti.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është e angazhuar që financat e pushtetit vendor, si pjesë e objektivave të konsolidimit të financave publike, t'i zhvillojë dhe t'i modernizojë duke shfrytëzuar eksperiencat dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera. Sigurisht, jemi të ndërgjegjshëm që ka ende shumë punë për të bërë në drejtim të rritjes së autonomisë financiare dhe fiskale të pushtetit vendor, dhe projektligji që ju paraqesim sot, shkon në këtë drejtim, si dhe në drejtim të rritjes së eficiencës së përdorimit të fondeve publike.

Ndaj, ju ftoj që t'i miratoni të dyja projektligjet që prezantova.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Hapim debatin.

Fjalën e ka zoti Vullnet Sinaj.

Të përgatiten zonja Jorida Tabaku dhe më pas zoti Erion Braçe.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ia kam dhënë fjalën kolegut.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Të mbarojë dhe më pas mund ta merrni fjalën.

**Vullnet Sinaj** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Dua të sqaroj se projektligji “Për taksat kombëtare”, të cilin po e diskutojmë sot në parlament, fillimisht ka ardhur në Komisionin e Ekonomisë si propozim i Këshillit të Ministrave, i cili synonte heqjen e taksës për produktin e hurrës

së qumështit dhe taksën për kremin e qumështit. Në fakt, sot në diskutim do të kemi këtë projektligj, por edhe një amendim të bërë nga ne si anëtarë të Komisionit të Ekonomisë.

Të bëjmë pak histori. Taksimi për produktet e hurrës së qumështit dhe për kremin e qumështit u vendos në vitin 2021 si pjesë e paketës fiskale të vitit 2022, kur për hurrën e qumështit u vendos taksa në nivelin 150 lekë për kilogram. Ky parashikim për taksimin e hurrës së qumështit dhe të kremit kishte si qëllim nxitjen e prodhimit vendas të qumështit natyral dhe mbështetjen e fermerëve vendas. Ndërsa fabrikat e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij u përjashtuan nga kjo taksë, fabrikat e produkteve ushqimore të ambalazuara që prodhojnë kroasantë, biskota e të tjera, të cilat kanë në bazën e tyre këto lëndë të para, nuk u përjashtuan. Kjo është arsyeja e propozimit nga Këshilli i Ministrave për heqjen e këtyre dy taksave, i cili erdhi si rezultat i shqetësimit të ngritur nga këto kompani, të cilat për prodhimin e këtyre produkteve përdorin si lëndë të parë hurrën e qumështit dhe kremin e qumështit. Taksimi sillte rritjen e kostove të këtyre produkteve dhe krijonte probleme në eksportet e këtyre produkteve në treg.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e zhvilluar në datën 24 janar 2023 e mori në shqyrtim dhe e miratoi këtë projektligj për t'u ardhur në ndihmë kompanive eksportuese të këtyre produkteve ushqimore, pra e hoqi taksën për hurrën dhe për kremin e qumështit.

Nisur nga informacioni i marrë në media, një grup fermerësh, përfaqësues të prodhuesve më të mëdhenj të qumështit, kërkuan një takim urgjent me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Gjatë këtij takimi fermerët ngritën shqetësimin se heqja e taksës së hurrës së qumështit dhe e kremit të qumështit, do të bënte që të rritej në mënyrë të pakontrolluar përdorimi i këtyre produkteve në prodhimet e bulmetit. Kjo do të sillte rënien e kërkesës për qumështin natyral të prodhuar nga fermerët, rrjedhimisht do të ulej çmimi i qumështit në fermat tona.

Komisioni i Ekonomisë i dha rëndësinë e duhur. Prandaj dua ta falënderoj kryetarin e komisionit që këmbënguli për ta çuar deri në fund zgjidhjen e problemit të fermerëve dhe në muajin shkurt të këtij viti organizoi një takim të përbashkët ndërmjet fermerëve, prodhuesve të nënprodukteve të qumështit, që janë fabrikat e qumështit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave. Pasi u bë një ballafaqim midis fermerëve dhe prodhuesve të nënprodukteve të qumështit që ishin fabrikat, duke u dakordësuar me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë, u vendos për të bërë një amendim të projektligjit për t'u dhënë zgjidhje të gjitha shqetësimeve të grupeve të interesit, njëkohësisht, duke ruajtur interesin e konsumatorëve në treg për cilësinë dhe për rritjen e çmimit.

Në muajin prill, unë dhe një grup deputetësh, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë, kemi paraqitur një amendament këtu në seancë, i cili propozon lënien e taksës së importit për prodhimin e hurrës dhe për kremin e qumështit, duke i dhënë zgjidhje shqetësimit të fermerëve, njëkohësisht, për t'i dhënë zgjidhje edhe shqetësimit të bizneseve, të cilat prodhojnë produkte të ambalazhuara, si: kroasantë, biskota, panetone, ëmbëlsira e të tjera. Për bizneset e tjera që prodhojnë nënprodukte të qumështit, të cilat janë fabrikat e qumështit, kemi propozuar që të përjashtohen nga taksimi vetëm subjektet e prodhimit të produkteve ushqimore të ambalazhuara, si dhe subjektet e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të cilat kanë në përbërje të tyre qumësht pluhur, hurrë qumështi dhe krem qumështi, pra për sasinë që është miratuar nga AKU-ja në kartën teknologjike të produkteve.

Gjithashtu, në amendamentin e paraqitur subjektet e përpunimit dhe prodhimit të këtyre produkteve do të detyrohen të paguajnë të gjithë vlerën e taksës për secilën sasi të këtyre lëndëve të importuara, të cilat nuk figurojnë se janë përdorur për prodhimin e këtyre produkteve, në bazë të kartës teknologjike të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Në të njëjtën

kohë, kemi parashikuar në amendim kontrollin periodik nga Ministria e Financave në kompanitë që përpunojnë qumështin dhe që prodhojnë produkte ushqimore të paketuara, ashtu edhe në dogana për sasi të importuara, duke mos lejuar që të hyjnë këto produkte në sasi dhe të përdoren për produkte, të cilat nuk kanë vlerat e caktuara ushqimore në treg.

Duke qenë se me anë të këtij amendamenti i jepet zgjidhje shqetësimit të fermerëve, shqetësimit të bizneseve prodhuese dhe mbrohet konsumatori si për cilësinë e produktit, edhe për çmimin në treg, duhet që amendimin në ligjin “Për taksat kombëtare” ta miratojmë të gjithë së bashku.

Faleminderit!

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Po, për procedurë.

**Edmond Spaho** – Zonja Kryetare, do të jetë në seriozitetin e këtij parlamenti që gjatë shqyrtimit të këtij propozimi të jetë prezente edhe ministrja e Bujqësisë, pasi...

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

Ku është, sepse nuk po e shikoj?

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

Dilni te vendi juaj!

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

Ndjesë, në rregull. Pashë vendin bosh atje ku rri gjithmonë, prandaj kërkova që të ishte ministrja.

Së dyti, dëshiroj të them se amendamenti nuk është propozim i anëtarëve të Komisionit të Ekonomisë. Në Komisionin e Ekonomisë nuk është shqyrtuar fare amendamenti.

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

Ndoshta e keni shqyrtuar ju amendamentin?

*(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)*

Ju e dorëzoni sipas rregullave, patjetër, por dua të sqaroj se opozita nuk ka marrë pjesë në asnjë takim konsultativ me fermerë dhe me prodhues të qumështit për këtë amendament. Ky amendament është propozuar nga ju dhe e keni votuar siç keni dashur ju, kurse opozita nuk është pjesë e këtij propozimi, madje e ka kundërshtuar.

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zonja Jorida Tabaku.

Të përgatitet zoti Erion Braçe.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot përpara nesh vjen një ndryshim legjislativ për të hequr taksën që është vendosur padrejtësisht mbi hurrën e qumështit. Besoj se është një korigjim, sepse qeveria gaboi pak vjet më parë, kur e vuri, dhe unë nuk besoj se këtu ka vend që të përgëzojmë qeverinë, sepse një gabim të pak vjetëve më parë e sjell sot për ta ndryshuar, por ka vend për të përgëzuar procesin që ndodhi në Komisionin e Ekonomisë. Deputetët e Komisionit të Ekonomisë, sidomos ata që kanë mbuluar dhe kanë ndjekur zonat të cilat kanë fermerë, e kanë parë me seriozitet, kanë dëgjuar grupe interesi, kanë bërë ndryshimet përkatëse dhe besoj se kjo gjë nuk ndodh shpesh, por ndodh rrallë.

Unë do ta mbështes ndryshimin që kanë sjellë kolegët deputetë, pavarësisht se nuk është miratuar nga e gjithë opozita, por ka ardhur nga një grup kolegësh dhe shpresoj që kolegët, pa pasur asnjë kompleks, në raste të tjera, kur ta gjykojnë që edhe ne themi ndonjë gjë me mend dhe bëjmë ndonjë amendimin me mend, të ofrojnë të njëjtën mbështetje.

Në këtë rast dua të ndaloj dy minuta për të diskutuar disa probleme për sistemin fiskal që ne i kemi diskutuar gjerësisht. Në parlament shpesh kanë ardhur ligje, të cilat kanë favorizuar sektorë të veçantë, ose kanë penalizuar sektorë të veçantë. Është fatkeqësi që në Parlamentin e Shqipërisë, në mënyrë selektive janë bërë përjashtime nga taksa, të cilat kanë penalizuar një masë të madhe biznesesh dhe janë pothuajse 10 ligje të tilla, të cilat mund t'i marr dhe t'i diskutoj me radhë. Ky është një fakt ndërkombëtarisht i njohur, që nuk i bën ndër këtëj parlamenti. Kur diskutojmë për kapje të shtetit, ky është problemi kryesor, sepse në këtë parlament kalojnë ligje, të cilat nuk janë për të gjithë qytetarët, por janë për disa grupe të caktuara. Ky është një shqetësim që besoj se duhet ta adresojmë. Kolegët socialistë nuk duhet të kenë

komplekse për të mos i votuar këto ligje. Ky është një shembull! Sigurisht, sot po rikuperohet dëmi që u është shkaktuar bizneseve, por selektiviteti në këtë rast, njëkohësisht edhe mënyra sesi është prezantuar, besoj se kanë pikëpyetje të mëdha.

Arkitektura fiskale, për të cilën unë kam folur muaj e muaj me radhë dhe vite e vite me radhë, dhe nuk do të ndalem për ta diskutuar këtu, ka probleme serioze, të cilat mendoj se duhet të zgjidhen me një kod fiskal që vendos disa parime, ku të gjithë biem dakord që këtyre parimeve universale të mos u lëvizim, kushdo që e qeveris këtë vend. Sigurisht, politika e taksave, është politikë taksash dhe i takon qeverisë. Mendoj që në situatën ku ndodhemi është i mangët dhe i cunguar një ndryshim, i cili vjen në mbështetje të një grupi të caktuar të fermerëve, por edhe të disa eksportuesve ose prodhuesve dhe fabrikave, nëse ne nuk flasim për bujqësinë në përgjithësi. Këtu ka probleme jashtëzakonisht të mëdha, të cilat sektori po i vuan sot si rezultat i politikave të qeverisë. Sektori i bujqësisë është një nga shembujt më të mirë se si qeveria e penalizon atë.

Sigurisht, në këtë stinë, kur fermerët mund t'i eksportojnë produktet e tyre, kam qenë në kontakt edhe me kolegë socialistë për të diskutuar se si ka ndikuar përfshirja e fermerëve në skemën e TVSH-së, në rritjen e kostove të tyre, sa kompetitivë janë ata sot në tregjet ndërkombëtare. Janë pyetje që fatkeqësisht ne nuk i diskutojmë gjerësisht në komisionet përkatëse. Këto lidhen me skemën që ka vendosur sot qeveria: penalizuese për fermerët, për sektorin e bujqësisë, të cilët me shumë mund e vështirësi, me gjithë taksat e shtuara, po ia dalin, por jo si rezultat i ndihmës dhe mbështetjes së qeverisë.

Dua të ndalem në zhvillimet e ditëve të fundit, të cilat lidhen me reformën në drejtësi, me arrestimin e fundit që ka ndodhur dy ditë më parë, kur ne ziheshim me njëri-tjetrin, të ish-kryetarit të bashkisë, zotit Vangjush Dako.

Në vitin 2016, Parlamenti i Shqipërisë ka votuar disa ndryshime rrënjësore kushtetuese, të cilat do ta ndryshonin njëherë e mirë qasjen e gjyqësorit me politikën, qasjen e gjyqësorit me

pandëshkueshmërinë. Nga ligjet që u propozuan në këtë sallë, PD-ja votoi vetëm një: ligjin që lidhëj (me dakordësi atëherë) me krijimin e SPAK-ut. Në fakt, si rezultat i një diskutimi të gjatë ramë dakord që ligji, i cili mbështeste krijimin e SPAK-ut dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, patjetër që duhej të kishte mbështetjen tonë. Natyrisht, pritishtëritë janë të larta, madje mund të them, jo vetëm të politikës, por edhe të qytetarëve. Në një vend ku korrupsioni nuk është më ai i banakëve, por një sëmundje që sot po e vuajmë që të gjithë; po e vuajmë kur largohen të rinjtë; po e vuajmë këtu në politikë, në biznes dhe po vuajmë me një sistem, i cili fatkeqësisht është i kalbur dhe është vështirë ta ndryshosh, në një vend ku qeveria është kthyer në një notere e ligjeve favorizuese dhe e ligjeve selektive, duket sikur ekzistenca e SPAK-ut është jetike. Nuk ka politikanë që kanë shkuar në dyert e SPAK-ut më shumë së unë. Sigurisht, jo për ato arsye që shkojnë e duhet të shkojnë të tjerët. Kam çuar një numër shumë të madh dosjesh, që shpresoj të shikojnë dritën e diellit, të shqyrtohen e të investigohen.

Në fakt, ne në politikë e kemi banalizuar pak fjalën “korrupsion”, u themi të gjithëve “je hajdut, je i korruptuar, ti vjedh”; edhe për qytetarët kemi krijuar një imazh jopozitiv për sa i përket funksionit dhe rolit që ka një deputet. Por arrestimi para pak ditësh i ish-kryetarit të Bashkisë së Durrësit, zotit Vagjush Dako, i bën nder SPAK-ut. Unë do të kisha preferuar që ai të arrestohej për arsye të tjera, pak rëndësi ka se për çfarë shkon përpara drejtësisë, rëndësi ka që shkon përpara drejtësisë. Unë shpresoj që krimet elektorale, dosja 339, akuzat për korrupsion, për pastrim parash dhe për shumë elemente të tjera të hetohen, jo se akuzon politika, jo se vijnë këtu politikanët e hedhin një lumë akuzash kundër njëri-tjetrit, të cilat pas një viti i shkelin me këmbë e thonë se nuk ishin të vërteta, por të hetohen nëse ka prova dhe dosje reale.

Ndërkohë, dosje të tjera flenë në SPAK, të cilat lidhen me koncesione, me prokurime, lidhen me hetimin e zgjedhjeve, lidhen me rindërtimin,

lidhen me tërmetin dhe me shumë elemente që unë besoj se i bëjnë nder SPAK-ut të hetohen. Ajo që nuk i bën nder SPAK-ut, dhe ishte ulëritëse, është fakti që kishin tri ditë që mediat dhe portalet flisnin për arrestimin që do të ndodhte pak ditë më pas; është ulëritës fakti që lajmërohet arrestimi i sekretares së Përgjithshme nga Kryeministri; është ulëritës fakti që sot drejtësia e re është po aq e aksesueshme sa drejtësia e vjetër nga pikëpamja e informacionit; është ulëritës fakti sot që këto informacione, të cilat duhej të ishin të privileguara, janë në *domain*-in e kujtdo.

Unë mendoj se kemi arritur në një moment kthese për politikën shqiptare. Ne duhet të kemi frikë nga ligji; ne duhet t’ia dimë frikën ligjit; ne duhet të kemi konsideratë për ligjin; nga ligji duhet të kemi frikë ne, duhet të ketë SPAK-u dhe kushdo. Unë besoj se duhet të thejtmë mitin që sot drejtësia nuk çon përpara drejtësisë ata që e shkelin ligjin; duhet ta thejtmë pak nga pak; duhet ta thejtmë me ata që janë në pushtet, me ata që kanë qenë në pushtet dhe me këdo që është i korruptuar, jo se e themi ne politikanët, por sepse provat janë atje. Vetëm kështu mund ta kthejmë besimin te shqiptarët dhe tek të rinjtë. Vetëm kështu mund të besojmë që sistemi i drejtësisë, sado që mund të jetë i kalbur, sado persona të ketë që nuk na pëlqejnë, që mbështesin një kah politik apo një tjetër, mund të krijojë besimin te qytetarët që ligjet, të cilat miratohen këtu kanë vlerë, që edhe ne politikanët kemi frikë nga këto ligje.

Dua ta mbyll me disa komente, të cilat lidhen me zhvillimet brenda forcës sime politike. Është shumë e vështirë sot të bësh opozitë; është e vështirë që fjala të ketë vlerë dhe është shumë e vështirë që t’i bindësh njerëzit se e nesërmja do të jetë ndryshe. Është e vështirë edhe të shkosh të flasësh me qytetarët, të flasësh me votuesit, me bizneset dhe t’u tregosh që ti mund ta bësh më mirë, sepse jemi lodhur në këtë sallë duke treguar që këta e bëjnë keq. Po, e bëjnë keq; unë e di që mund të bëhet shumë më mirë dhe ne dimë ta bëjmë më mirë, por, pavarësisht çdo gjëje, pavarësisht se çfarë problemesh kemi ne, se si i bëjmë ne mbledhjet e grupit, se si e bëjmë ne

mbledhjen e Kryesisë, një gjë është e sigurt: të paktën ne nuk po i bëjmë në burg, ashtu siç po i bën sot mazhoranca dhe rreziku është që do të kenë më shumë andej sesa këtej.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Erion Braçe.

Të përgatitet Isuf Çelaj.

**Erion Braçe** – Në fakt, mua më bie gjithmonë të dal nga tema për të cilën duhet të flasim, sepse gjithmonë para meje flet dikush që del nga tema, për të cilën duhet të flasim. Meqenëse jemi në këtë pikë, kam një pyetje: pse është kaq e lehtë të arrestosh në të majtë dhe pse është kaq e pamundur të arrestosh në të djathtë?! Pse? Ka një diferencë të madhe, e cila qëndron te kultura e ligjit, jo te frika ndaj ligjit: sa ti ke kapacitetin të përshtatësh, të zbatosh dhe të mos cedosh asnjë sekondë në raport me ligjin, nga këtu buron edhe kultura e marrëdhënieve me institucionet e drejtësisë. Që pas reformës në drejtësi, me të gjitha të mirat dhe të metat e saj, kam vendosur të mos flas këtu për vendimet e gjyqësorit, në respekt të institucioneve të drejtësisë, natyrisht për të përmbushur një angazhim, i cili besoj unë se duhet të jetë angazhim edhe i Kuvendit.

Me atë reformë u dhanë mundësi jo të flasin, por të veprojnë prokurorët dhe gjykatësit, nga ana tjetër iu dhanë mundësi politikanëve që thjesht të dëgjojnë, jo të komentojnë. Në qoftë se ka një gjë, që nuk i bën nder asnjë institucioni drejtësie, është parada e politikanëve, veçanërisht e atyre të zhytër deri në fyt me kallëzime në dyert e organeve të drejtësisë dhe ky është një problem shumë i madh, sepse presioni që vjen nga politika mbi organet e drejtësisë, nuk lejon që të bëhet drejtësi. Në qoftë se ka pasur një pyetje, që mund të ishte pyetje e pamundur, por që u bë në Komisionin e Ligjeve dhe, natyrisht, ishte një pyetje që ta shpif dhe të neverit, ishte: a e ndieni ju presionin e politikanëve? Përgjigjja ishte ajo që u tha atje, që nuk ndihej presion fare. Në qoftë se do të vazhdojë kjo këngë, patjetër që nuk do të këtë drejtësi asnjëherë.

Megjithatë, të kthehemi te çështja që kishim për sot. Natyrisht, për këtë çështje është diskutuar shumë. Pa diskutim, është në nderin e Kuvendit, të qeverisë dhe të cilitdo deputeti që nënshkruan një amendim, për të korrigjuar një akt dhe një vendim të bërë gabim më herët dhe nuk është as turp për të korrigjuar, nuk është as e pamundur për të reflektuar. Unë patjetër që e vlerësoj aktin e ndërmarrë nga kolegët e mi në Komisionin e Ekonomisë për të korrigjuar një dëm që po i shkaktohej një industrie të caktuar. Në fakt, janë prodhues dhe eksportues të produkteve, të cilët pa diskutim kanë origjinë shqiptare.

Nga ana tjetër, kur flasim për historinë, historia ka disa dimensione. Unë po shkoj në vitin 2021, kur u vendos që të kishte taksë mbi produktet për të cilat bëhet fjalë, duke përfshirë qumështin pluhur, duke përfshirë qumështin pluhur të hirrës, vajin e palmës e kështu me radhë, gjithashtu edhe niseshtenë. Ishte një politikë që unë e mbështeta, nga ana tjetër, pa diskutim që nuk mbështeta, dhe nuk më vjen turp fare, zonja Tabaku, që nuk e mbështeta faktin që nga ky taksim u përjashtuan produktet që përdorehin nga industria vendase e përpunimit të qumështit dhe kam arsye pse. Arsyet lidhen me një pyetje: ne do të kemi bulmet që ka bazë, natyrisht, në të gjithë produktin, qumështin e freskët, apo edhe faktorë të tjerë plotësues? Kjo do të thotë se do të kemi bulmet me yndyrën që vjen nga qumështi i lopës, i deles, i dhisë, e kështu me radhë, apo do të kemi bulmet që vjen edhe nga faktorë të tjerë plotësues yndyre, siç janë këto që folëm?

Ky është diskutimi. Në qoftë se bëjmë këtë diskutim, kemi përmbushur edhe interesat e bujqve prodhues, e blegtorëve prodhues, por edhe të të gjithë të tjerëve, por besoj se kemi përmbushur edhe interesin e të gjithëve, që është një interes publik: të kemi produkte sa më afër produktit origjinal për t'i konsumuar për vete dhe për fëmijët tanë. A ka ardhur koha ta bëjmë këtë diskutim?! Mendoj se ka ardhur koha ta bëjmë këtë diskutim. Në një informacion që i kam kërkuar Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, nuk janë pak, por janë 125 etiketa, pra produkte, të

cilat sot kanë në përbërje të tyre vaj palme, vajra të tjera bimore, qumësht pluhur, qumësht pluhur të hirrës dhe përbërës të tjerë. Kur flas për etiketa të miratuara nga një agjenci shtetërore, patjetër që besoj fort se këto etiketa dhe këto produkte janë të kontrolluara.

Në krahun tjetër ia vlen që të themi, dhe vijmë të diskutimi që po shtroj: a do të vazhdojmë të kemi djathë me vaj palme, sepse nga informacioni që kam këtu, po, ka. A do të vazhdojmë të kemi gjizë më vaj palme, sepse, ja ky është, është këtu? A do të vazhdojmë të kemi qumësht “Barista” me vaj palme dhe me qumësht pluhur, sepse, ja, e kemi këtu? Ky është problemi për të cilin duhet të diskutojmë. Domethënë, a do të shkojmë drejt origjinës së produktit që është lëndë e parë, edhe në produktin fundor, apo jo?

Shqetësimi i dytë akoma më i madh është: a ka ndonjë institucion që verifikon dhe mat në fund përqindjen e këtyre produkteve, të elementeve shtesë në produktin bazë që del në treg? Pra, dakord që në një përqindje të caktuar është e lejuar dhe lejohet në të gjithë botën, por cila është sasia që hidhet këtu, sepse vaji i palmës është një produkt që listohet në bursë, tregtohet atje dhe nuk e diskutoj këtë pjesë, por përqindja e përdorimit brenda këtyre produkteve patjetër që i bën dëm jo vetëm konsumatorit, por edhe prodhuesit, që është bujku, është blegtori, të cilin pa diskutim që e kemi futur në siklet, e kemi shtyrë në hall, sepse pa më të voglin diskutim ky bujku, ky blegtori duhet të mbështetet i pari pikërisht për këtë gjë. Sigurisht që ka, edhe sot që flasim ka skema mbështetëse, por jo për të gjithë. Patjetër ne duhet ta ndryshojmë atë skemë mbështetëse, siç e kërkojnë edhe vetë prodhuesit, por edhe vetë përpunuesit janë ndërgjegjësuar për ta kërkuar, për të shkuar te subvencioni për litër, aq para sa kemi; nuk po them të japim sot maksimumin, por aq para sa kemi ta ndajmë për litër, ta ndajmë edhe për cilësi të qumështit, sepse na duhet edhe rendimenti, edhe cilësia. E kemi të gjithë mundësinë të ndërtojmë një skemë që favorizon pikërisht blegtorin në këto dy elemente shumë të rëndësishme: te rendimenti i prodhimit

të qumështit, nga ana tjetër, edhe te cilësia, duke përfshirë yndyrën brenda, duke përfshirë ngarkesën e vogël bakteriale apo edhe përqindjen e ujit që ka në të. Pra, është momenti për ta bërë këtë gjë, që të mbrojmë produktin vendas.

Kur flas për produktin vendas, nuk e kam fjalën thjesht dhe vetëm për qumështin, por e kam edhe për atë që është halli më i madh tani, që është gruri. Deri tani, nga informacioni që kam marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kanë hyrë 54 mijë e 279 tonë grurë nga importi (nga janari deri tani), ndërkohë që po vjen një superprodhim gruri. Nga ana tjetër, kemi një problem shumë të madh që gruri, i cili po vjen nga Ukraina, është shumë më i lirë, dhe ky nuk është halli vetëm për ne. Këtu përpara kam një diskutim të bërë në Komisionin Evropian dhe njoftimet për shtyp që kanë dal prej andej, ku Bullgaria, Polonia, Rumania, Hungaria dhe Sllovenia kanë ngritur shqetësimin e madh të mbrojtjes së prodhimit të tyre nga çmimi i lirë me të cilin po vjen gruri i Ukrainës. Këta e kanë shoqëruar me një rregullore për të mbrojtur grurin e këtyre vendeve; kanë ndaluar grurin e Ukrainës që të tregtohet në këto vende, për të mos i konkurruar prodhuesit vendas me çmimet e lira të grurit që po vjen që andej. Nga ana tjetër, kanë lejuar që të kalojë tranzit për vendet që nuk janë të Bashkimit Evropian.

Po ne ku jemi?! Kemi një hall shumë të madh: kemi mbështetur prodhimin e grurit të këtij viti masivisht, por deri në 1/3-tën e asaj që presim. Janë të gjitha, rreth 14 mijë e 890 hektarë të mbështetura me fonde buxhetore që me 50 kuintalë grurë për hektar shkojnë diku 74 mijë e 450 tonë, por kjo është vetëm 1/3-ta e prodhimit që po presim, është shumë më tepër prodhimi që po presim. Si do ta mbrojmë, sepse jemi nën agresionin e pastrimit të magazinave në vendet fqinje dhe të krijimit të hapësirave në ato vende për prodhimin e ri atje, ndërkohë që ne këtu po zëmë edhe kapacitetet magazinuese, duke krijuar një problem shumë të madh për bujqit tanë. Nga ana tjetër, jemi në agresionin e çmimeve të lira që po vijnë prej andej.



Prandaj, përtej gjithçkaje që na ndan, mendoj se është mirë që të bashkohemi në një pikë, që është shumë e rëndësishme, të mbrojmë bujkun dhe të mbrojmë prodhimin vendas. Jua kam thënë një herë në këtë sallë, që sot me vendet fqinjë na ndajnë vetëm 5 euro pagesë për ditë pune. Në qoftë se dita e punës së një bujku këtu po rritet dhe po konkurron atë të një bujku shqiptar, që shkon bën argatin në Greqi, atëherë duhet t'i plotësojmë kushtet këtu që ata njerëz ato 5 euro t'i marrin këtu, të mos i marrin atje dhe e gjitha është e mundur po të mbrojmë prodhimin vendas.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zonja Tabaku, për çfarë e kërkoni fjalën?

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Replikë.

**Jorida Tabaku** – Zonja Kryetare,

Zoti Braçe,

Të nderuar kolegë,

Unë kam frikë nga ligji, zoti Braçe. Nuk mbaj përgjegjësi për askënd tjetër përveç vetes sime. Unë kam frikë nga ligji dhe besoj se në këtë duhet të thyejmë sot: që deputetët dhe politikanët të kenë frikë nga ligji. Pastaj se si vepron drejtësia, nuk është në dorën time dhe nuk ka qenë kurrë, as e kam sulmuar, as e kam mbrojtur dhe as e kam gjykuar asnjëherë. Gjithmonë, kam kërkuar më shumë dhe e kam inkurajuar. Në këtë duhet të arrijmë sot në parlament, më pas nuk ka rëndësi se në cilin kah të politikës.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Isuf Çelaj.

Të përgatitet zoti Kastriot Piroli.

**Isuf Çelaj** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit dhe Kukësit,

Të nderuar kolegë,

Ky projektligj ishte i përfshirë në rendin e ditës të seancës së datës 13 shkurt, por çuditërisht u tërhoq nga ju si mazhorancë, pa na u dhënë asnjë shpjegim. Ky projektligj ka si qëllim heqjen e taksës mbi hurrën e qumështit dhe të kemit të qumështit dhe tani keni shtuar edhe qumështin pluhur, me qëllim që të favorizoni klientët tuaj, të

cilët zhvillojnë biznes me Serbinë, duke çuar në falimentimin e fermave të blegtorëve vendas, të cilët janë të detyruar t'i therin ose t'i shesin bagëtitë e tyre.

Kjo taksë u vendos një vit më parë nga ana juaj si mazhorancë, megjithëse u kundërshtua nga ana jonë si opozitë. Zbatimi i kësaj takse prej 1 viti në praktikë, ndaj bizneseve të këtyre produkteve ka sjellë kontestime dhe ankesa nga eksportuesit, sepse po u shkakton rritje të kostove, gjë për të cilën, edhe vetë ju, si qeveri, në relacion shpreheni se kompanitë eksportuese e kanë vuajtur konkurrencën në tregjet e vendeve të tjera.

Pra, sot na paraqitet një projektligj thjesht për të hequr një taksë të vendosur padrejtësisht 1 vit më parë nga ana juaj dhe miratuar nga ju, duke përdorur fuqinë e kartonit. Ky taksim qesharak, me një efekt financiar 150 mijë euro në vit, është pjesë e paradokseve dhe e mënyrës se si ju i trajtoni taksat e tjera kombëtare, të cilat, nëse do të trajtoheshin me përgjegjësi, me synim uljen apo heqjen e disa prej tyre, do të jepnin efekte pozitive në përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe do të kishin ndikime të qenësishme në standardin jetësor të qytetarëve shqiptarë dhe jo vetëm, por ju bëni ulje e ndryshime sipas interesave klienteliste dhe lidhjeve tuaja okulte me biznese të caktuara.

Dy janë taksat kombëtare kryesore: taksa e qarkullimit dhe taksa e rentës minerare dhe e prodhimit të energjisë.

Për taksën e qarkullimit ka pasur kërkesa të vazhdueshme edhe nga qytetarët, sipërmarrësit dhe deputetët e opozitës, të cilët kanë kërkuar uljen e saj në nivelet e mëparshme, ato të vitit 2013.

Arroganca e qeverisë dhe juaja, si mazhorancë, lidhur me mosndryshimin e këtyre taksave (heqjen ose uljen e tyre) tregohet qartazi, pasi në paketën fiskale të vitit 2023, të diskutuar dhe të miratuar gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, ju, si mazhorancë qeverisëse, nuk pranuat asnjë ndryshim në të gjitha amendamentet e paraqitura nga opozita, madje as atë që u paraqit nga një kolegu juaj i mazhorancës, deputeti

Braçe, duke manifestuar shfaqjen e arrogancës dhe arbitraritetit, që ju karakterizojnë, cilësi këto të një regjimi, i cili në këta 10 vjet vetëm i ka varfëruar dhe vjedhur shqiptarët në të gjitha nivelet e pushtetit, atij qendror dhe atij vendor!

Qarku i Kukësit (Kukës, Has, Tropojë) është listuar si qarku më i varfër në vend, edhe pse ka burime natyrore me shumicë, si: burimet hidrike të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et, kryesisht ai i Fierzës, nga i cili furnizohet i gjithë vendi; nëntokën e pasur me mineralet e kromit e hekur-nikelit, që prej vitesh shfrytëzohen sistematikisht, shumicën e rasteve në mënyrë gjysmëprimitive, me teknologjinë e viteve '80-'90, çka bëhet shkak për shumë humbje jetësh njerëzore, të cilët janë të detyruar të punojnë në të tilla kushte vetëm e vetëm për të siguruar disa të ardhura për të mbajtur familjen. Po ashtu në këtë qark ndodhen edhe perlat e Alpeve shqiptare, si Lugina e bukur e Valbonës apo Bjeshkët e Malësisë së Gjakovës, ato të Kallabakut, të Shtegut të Ngjyrave dhe të Gjallicës, të cilat presin turistë e vizitorë nga e gjithë bota.

Gjatë dekadës së fundit, varfëria në këtë qark vetëm është shtuar dhe thelluar më shumë në krahasim me pjesën tjetër të vendit, duke pësuar një rënie ekonomike gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit. Kjo rënie ekonomike ka sjellë thellim të varfërisë, detyrimisht edhe rënie të ndjeshme të konsumit nga qytetarët e këtij qarku, ku tregjet e këtyre qyteteve sot kryesisht janë kthyer në vende të ekspozimit të mallrave, pasi çmimet kanë shkuar në stratosferë dhe nuk ka kush t'i blejë, sepse të rinjtë dhe moshat e afta për punë kanë ikur. Ata që kanë mbetur janë pensionistët dhe familjet me ndihmë ekonomike, që e kanë të pamundur t'i përballojnë.

Ecuria ekonomike e qarkut të Kukësit tregon më së miri sesi shfrytëzohen pa kriter burimet natyrore, ku të ardhurat nuk shkojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kukësit, të Hasit e të Tropojës, por shkojnë si të ardhura në buxhetin e vendit, si dhe për një grusht të vogël njerëzish të lidhur me qeverinë qendrore e vendore!

Qytetet, si: Kukësi, Tropoja e Hasi në kushte të tilla në Europë do të ishin më të pasura krahasuar me qytetet e tjera, që nuk i kanë këto pasuri mbi e nëntokësore, për shkak se do të përfitonin nëpërmjet rentës minerare e burimeve hidrike, pasi atje shfrytëzohen me kriter dhe sipas një strategjie afatgjatë e të mirëstudiuar. Por realiteti është krejtësisht tjetër, pasi Veriu i Shqipërisë është më i varfëri në Europë, që konsumon sa 25% e mesatares së BE-së.

Sipas studimit të revistës "Monitor", për vitet 2014-2020 ekonomia e qarkut të Kukësit ka pësuar rënie me 11%, rënie kjo e barabartë sikur në këtë qark të ketë ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe natyrore, por, në fakt, për banorët e këtij qarku fatkeqësia më e madhe është keqqeverisja e regjimit të "Rilindjes", e cila është shkaktarja kryesore e gjendjes së rëndë ekonomike dhe varfërisë së thellë, me pasojë shpopullimin masiv të këtyre zonave, pasi kjo mazhorancë, në shenjë hakmarrjeje politike, në këta 10 vjet të drejtimin të saj vetëm sa e ka diskriminuar në vazhdimësi këtë qark!

Po sipas revistës "Monitor", gjatë viteve 2002-2012 ekonomia e qarkut të Kukësit u rrit me 59%. Duke e krahasuar me periudhën 10-vjeçare të qeverisjes suaj (siç e theksova më lart), kjo ekonomi pësoi rënie me 11%. Mjafton kjo për të evidentuar atë që ju, si mazhorancë, keni bërë për banorët e këtij qarku.

Shkaqet e kësaj rënie lidhen me:

- Mungesën e politikave të qëndrueshme zhvillimore për shfrytëzimin e pasurive mbi e nëntokësore, zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor, si dhe të zhvillimit të blegtorisë.

- Emigracionin e migracionin masiv të potencialeve njerëzore. Ky është një tregues i humbjes së shpresës së të rinjve, gjë që tregohet edhe në shkrimin e britanikes "The Telegraph" e cila shkruan se ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë i ka dorëzuar një studim, që tregon se shumë të rinj shqiptarë synojnë që të shkojnë drejt Britanisë gjatë kësaj vere.

Sipas këtij sondazhi, për të cilin thuhet se është bërë në 1800 familje në Kukës, gjysma e të

rinjve, të moshave nga 17 deri në 22 vjeç, dëshirojnë të emigrojnë drejt Britanisë së Madhe, pavarësisht rreziqeve të rrugës.

- Mungesën e investimeve me kapital publik, ku prioritet duhet të kishte ndërtimi i rrjetit rrugor rural, i cili është pothuajse totalisht i dëmtuar, po ashtu edhe investimi në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, pasi është tejet i amortizuar, në pjesën më të madhe të fshatrave është ai i viteve '70. Për ironi të fatit, gati të gjitha familjet e Tropojës, Kukësit dhe Hasit janë debitorë të energjisë elektrike tek OSHEE-ja në vlerën e miliona lekëve, ku shumë prej tyre janë përballur me ndërprerjen e energjisë elektrike, për shkak se nuk kanë mundësi ta paguajnë si rezultat i mungesës së të ardhurave, pasojë e papunësisë. Unë nga kjo foltore ju kam parashtruar disa herë kërkesën për faljen e këtyre detyrimeve për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në të cilën ndodhen këto familje!

Prandaj, ajo që kërkohet nga ana juaj, si mazhorancë, është të rrisni masën e përfitimit nga shfrytëzimi i këtyre pasurive të këtij qarku, që këto të ardhura të përkthehen në investime nga pushteti vendor për banorët e këtyre rretheve, kryesisht në infrastrukturë, dhe në zbutjen sadopak të varfërisë!

Popullit i keni lënë vetëm hurrën, pasi djathin e gjalpën e keni mbajtur për vete, por jam i bindur se mllëfi dhe pakënaqësia e shqiptarëve shumë shpejt ka për t'ju ngecur në fyt, duke ju përmbysur nga pushteti, pasi me këto që u keni bërë shqiptarëve në këta 10 vjet, duke i vjedhur e varfëruar, do të duhen nëntëdhjetë vjet për t'i riparuar!

Ju si qeveri, me politikën tuajë i keni përzënë nga shtëpitë e tyre kuksianët, hasjanët dhe tropojanët, duke i degdisur rrugëve të botës me shpresën e një jete më të mirë!

Ajo që dua t'ju them është se, merruni edhe pak kohë me hurrën derisa të vijë dita që populli të merret ashtu siç e meriton qeverisja juaj, e cila është kthyer në një regjim!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Piroli.

Të përgatitet zoti Bujar Leskaj.

**Kastriot Piroli** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Uroj të gëzoni shëndet!

Në vendin tonë, si pasojë e politikave të kësaj qeverie që po varfëron të varfrit e po ngop të pasurit, taksat që paguhen nuk shkojnë për investime apo të mira publike, nuk përdoren për të nxitur sipërmarrjen, edukimin dhe zhvillimin e ekonomisë, por qeveritarët i përdorin këto para për hesapin e tyre dhe të miqve të pushtetit.

Pasi shkatërruat blegtorinë dhe mbyllët me qindra ferma me bagëti, tashmë i keni shtruar autostradën qumështit pluhur, duke ulur taksat dhe duke dëmtuar seriozisht shëndetin e qytetarëve.

Këto politika fiskale janë të gabuara, dashakeqe dhe do ta dëmtojnë rëndë ekonominë e brishtë të Shqipërisë, ashtu siç shkatërruat edhe zgjedhjet e 14 majit.

Me përlujtë dua të falënderoj votuesit e Behar Haxhiut në Kurbin, të Pashk Gjonit në Lezhë dhe Albert Mëlyshit në Mirditë! Mirënjohje për çdo komisioner, vëzhgues, numërues e çdo individ, që në mënyrë vullnetare dhanë kontribut në zgjedhjet e 14 majit!

Si një qytetar që besoj tek institucionet dhe organet e drejtësisë së Shqipërisë, kam pritur që, me gjithë këtë përfshirje të shtetit në këto zgjedhje, mandatet e shumë prej bashkive nuk do të certifikoheshin.

Dua t'ju tregoj arsyt pse kam menduar dhe shpresuar për një reagim zyrtar të organeve ligjzbatuese. Po ju parashtror farsën elektorale në zgjedhjet e 14 majit:

- Qytetarëve të Kurbinut iu konfiskua vota nga narkoshteti.

- Blerësi i votave ka vetëm një emër, i cili është Edi Rama.

- Bashkia e Kurbinut hodhi qindra milionë lekë për asfalt elektoral, zhavorr elektoral, transformatorë elektoralë, si dhe shtylla e linja elektrike të reja në këmbim të votës.

- Kryetarja e bashkisë kërcënoi dhe shantazhoi për largime nga puna, kërcënoi dhe shantazhoi për moslegalizime të shtëpive.

- Kryetarja e bashkisë ka shfrytëzuar listat e familjeve, të cilat kanë përfituar nga rindërtimi apo presin të përfitojnë. Këto familje janë mbajtur peng për shtëpitë dhe dyqanet. Administrata e bashkisë telefononte qytetarët, që prisnin një përgjigje për shtëpitë dhe, për t'i mbajtur peng për votën, talleshin me ta, duke u thënë: “Si e doni shtëpinë, me soletë apo me çati”?! , pra talleshin me qytetarët e Kurbinit.

- Kjo kryetare nuk ka pasur nevojë për patronazhistë dhe as për aktivistë, sepse ka pasur listat e personave që marrin ndihmë ekonomike, të cilët i shantazhoi se do t'ua hiqte këtë të drejtë.

Një pyetje kam për kryetaren e Bashkisë së Kurbinit, me vota të blera: ku i gjete gjithë këto para që shleve borxhet në dyqane e markete, që shtrove dhjetëra dreka e darka luksoze para zgjedhjeve, që shpërndave mijëra litra naftë, ku mjafton të kishë logon e PS-së në makinë ose të thoshe që jam votuesi juaj?! Ku i gjete gjithë ato para që bëre festën e pseudofitores, ku birra derdhej lum në shesh dhe shtrove darka luksoze me nga 500 veta në restorantet më luksoze?

I bëj thirrje SPAK-ut të hetojë pasurinë dhe të ardhurat e kryetares së bashkisë me vota të blera.

Ka qenë një situatë e pazakontë: ka pasur punonjës policie që kërkonin vota, pra ishte një polici e tërë në shërbim të Partisë Socialiste, ku javën e fundit të zgjedhjeve dhanë edhe armët e gjahut, të cilat ishin sekuestruar për konflikte të ndryshme.

Pati biznesmenë të shantazhuar, të cilët më shumë ishin të angazhuar për votat e kandidatës së PS-së se për biznesin e tyre, ndërsa për biznesmenët e vegjël ndieja frikë dhe trishtim kur i takoja, sepse më thoshin: “Aman, ju lutem, të mos na shohin me ju, se na mbyllin biznesin!”.

Këto arsye duhet të mjaftojnë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian të kërkojnë dhe të vërtetojnë se çfarë ka ndodhur në qarkun e Lezhës, sidomos në Kurbin, sepse atje

kanë përdorur çdo mekanizëm antiligjor dhe antidemokratik.

Këto mandate nuk do t'i gëzoni, se nuk jeni kryetar bashkish, por marioneta, marioneta të atyre që ju kanë përdorur në fushatë.

U bëj thirrje Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të reagojnë para se të jetë tepër vonë! Kur një Kryeministër arrin të korruptojë shefin e kundërbulimit të FBI-së, imagjinoni çfarë mund të bëjë ndaj drejtuesve të institucioneve në Shqipëri.

Kam një pyetje dhe një kërkesë për ministrin e Brendshëm:

Kërkesë

Zoti Ministër i Brendshëm, edhe pse nuk je në seancë, lehtësojua udhëtimin qytetarëve që aksesojnë rrugën nga Miloti në dalje të Lezhës, lehtësojua rrugën qytetarëve që lëvizin nga Thumana deri në Fushë Krujë, sepse çdo ditë janë katër postbllloqe policie: një në Fushë Krujë dhe tjetri në Thumanë, një në Milot dhe tjetri në Lezhë, që e kanë mendjen vetëm te gjobat dhe jo t'u vijnë në ndihmë qytetarëve. Zëvendësoi këto postbllloqe me motoçikleta, që të lëvizin lirshëm dhe të lehtësojnë trafikun në udhëtimin e qytetarëve të këtyre zonave dhe të gjithë Veriut.

Pyetje

Përse kur kalon Kryeministri apo personalitete të ndryshme angazhohet e gjithë policia dhe nuk ka trafik? Pra, policia është vetëm në shërbim të këtyre rasteve, të Kryeministrit dhe të personaliteteve, dhe jo për t'ua lehtësuar udhëtimin qytetarëve.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Bujar Leskaj.

Të përgatitet zoti Luan Baçi.

**Bujar Leskaj** – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Nuk është për Kryetaren kjo fjalia e parë, por ju, me një hile tipike tuajën, sollët projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, “Për taksat kombëtare”, ku, krahas propozimeve për heqjen e taksës për hurrën e qumështit dhe taksës për kremin qumësht, që edhe pse të vonuara janë të

drejta, propozoni edhe heqjen e taksës për qumështin pluhur. Pra, ju shkoni në dy drejtime të kundërta, duke i paraqitur përmes një ndryshimi në projektligj.

Taksa për qumështin pluhur të importit ndihmon rritjen e prodhimit të qumështit natyror nga fermerët tanë dhe dekurajon përpunuesit e qumështit në vend që të përdorin me shumicë qumësht pluhur në produktet e tyre, duke jua ulur cilësinë dhe vlerën ushqyese.

Në nëntor të vitit 2021, pra pak më shumë se një vit e gjysmë më parë, ju vendosët taksën e hirrës së qumështit dhe taksën për kremen e qumështit. I vendosët këto taksa mbi prodhuesit vendas me papërgjegjshmëri, pa studiuar paraprakisht efektet që ato taksa do të jepnin mbi prodhimin tonë, duke treguar paqëndrueshmëri në politikat dhe vendimmarrjet tuaja fiskale. Me taksën e hirrës së qumështit dhe taksën për kremen e qumështit, të dyja në vlerën e 150 lekëve për kilogramë, ju keni rritur kostot deri në 5% për linjat e prodhimit të çokolllatave dhe biskotave e të tjera produkte të kësaj natyre, duke i bërë kompanitë eksportuese jo konkurruese në treg; shtuat barrën e prodhuesve vendas, ndërkohë që importuesit e kroasantëve apo biskotave (këtu fle lepuri) i përjashtuat nga taksat e hirrës dhe të kremenit të qumështit apo të qumështit pluhur që ata importonin.

Për më shumë se një vit e gjysmë u sorollatëm, nën dirigjimin tuaj, me diskutime për muaj me radhë në Kuvend dhe në komision për të ndryshuar diçka, që mund të ndryshohej brenda pak orëve. Madje në shkurt të këtij viti ne u bëmë edhe qesharakë, ku ju, pasi do të hulumtonit, do të vrojtonit apo nuk e di se çfarë drejtin do të bënit, do ta risillnit përsëri, të paktën kështu na premtuat. Ju po e risillni, por po e risillni tashmë të përmbysur.

Çdo propozim për ndryshime të ligjeve fiskale, përpara se të formalizohet dhe të miratohet, duhet të shoqërohet me një analizë për nevojat e të gjithë nënsektorëve të ekonomisë dhe për efektet e propozimit mbi to, për të vlerësuar nëse ndërhyrja apo ndryshimet duhen në një

sektor në veçanti apo prekin, favorizojnë dhe dëmtojnë paralelisht disa sektorë dhe nënsektorë.

Unë kam një pyetje: ju, kur e ndryshuat ligjin “Për taksat kombëtare” në vitin 2021 a bëtë një analizë, për të marrë në shqyrtim parametrat fiskalë? A realizuat një vlerësim mbi qëndrueshmërinë e këtyre ndryshimeve dhe na garantoni se nuk do të ketë nevojë për ndryshime të tjera, që sjellin efekte negative në buxhetin e shtetit, si dhe konfuzojnë e mbjellin pasiguri te veprimtarët në treg? Po tani a e keni analizuar sa, duke treguar, në njërin anë, si kur hiqni taksën e prodhuesve në vend, i godisni me këtë incentivë fiskale që ju jepni edhe për importuesit?

Në fakt, politika juaj fiskale ka shembuj të tjerë edhe më të rëndësishëm, por në thelb kjo tregon, që të mos përsërit shprehjen e të madhit Pjetër Arbnori, se sa të vegjël jeni ju që shkoni edhe te këto lloj taksash, tek ajo mbështetje që duhet t’u jepni prodhuesve vendas.

Rastet e tjera janë edhe më skandaloze. Për shembull, kandidati ynë i opozitës, i koalicionit “Bashkë fitojmë” në Durrës, në një fushatë model që zhvilloi në qytetin e tij për zgjedhjet vendore të 14 majit, sollti në vëmendje një nga humbjet më të mëdha për qytetarët e Durrësit dhe për Bashkinë e Durrësit, humbjen e taksës së pushtetit lokal prej 231 milionë eurosh nga projekti Alabar. 231 milionë euro mungesë janë shumë për qytetin e Durrësit, sepse kjo shumë duhej të derdhej në arkat e bashkisë para fillimit të ndërtimit, vlerë kjo e konsiderueshme për ndërtime shkollash, ndërtime rrugësh, infrastrukturë, gjelbërim, pastrim e të tjerë.

Ky nuk është rasti i vetëm. Në seancën e fundit plenare të vitit 2020 ju miratuat përjashtimin nga taksa e rentës minerare të gjitha grupet e mineraleve metalorë: kromin, bakrin, nikelin, zinkun e të tjerë, për tre vjet. Keni tre vjet që të ardhurat nga kromi i Bulqizës apo nga bitumi i Selenicës nuk i çoni aty ku janë më të nevojshme, te financat e bashkive përkatëse, pavarësisht se ligji në fjalë më 2020-ën u kthye nga Presidenti, pasi, sipas arsyesimit të Presidentit, bie në kundërshtim me parimet dhe dispozitat

kushtetuese, që mbrojnë sigurinë juridike, lirinë ekonomike, barazinë para ligjit, autonominë e pushtetit vendor, si dhe dëmton hapur interesin publik dhe pasurinë kombëtare, ju përsëri e miratuat. Sipas relacionit shpjegues të ligjit që ju miratuat në Kuvend, lehtësitë fiskale për një periudhë 3-vjeçare do të kishin një efekt negativ prej afro 500 milionë lekësh në buxhetin e shtetit, në buxhetin e këtyre bashkive, rreth 4,6 milionë euro më pak, çka në këto bashki, si: Selenica dhe Bulqiza, ishin dhe janë shumë të nevojshme.

Unë mund t'ju jap plot shembuj, por në thelb kjo është filozofia juaj.

Unë po e shkurtoj diskutimin tim, në respekt të kohës së tepërt që Kryetarja e Kuvendit përcolli gjatë diskutimit tim për përkujtimin që duhet t'i bëjmë në kryengritjes së Spaçit të 21 majit 1973.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Luan Baçi.

Të përgatitet zoti Eduard Shalsi.

**Luan Baçi** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndryshimet e ligjit “Për taksat kombëtare” po i sillni në një kohë kur ekonomia prodhuese e vendit po përballlet me problematika dhe shqetësime nga më të shumtat dhe nga më të ndryshmet. Këto problematika janë të mbartura dhe nuk zgjidhen për shkak të keqqeverisjes suaj qendrore dhe lokale prej shumë vitesh.

Kanë kaluar pak javë nga rezultati i pseudozgjedhjeve vendore dhe asnjëri prej jush nuk ka sjellë këtu për diskutim serioz asnjë nga konkluzionet e përballjes me realitetin në terren gjatë fushatës zgjedhore, përveç disa batutave bajate e me mburrje të disave nga ju.

Në fakt, ju zotërinj të mazhorancës, u morët me çdo gjë në këto zgjedhje, nuk latë gjë pa bërë për t'i uzurpuar përsëri bashkitë dhe vetëm me hallet dhe problematikat e qytetarëve nuk u morët, nuk folët për to dhe as nuk u përballët me to.

Ju hytë në historinë e zgjedhjeve si e vetmja forcë politike, që nuk u përballët me një program elektorale, por kënduat tallava gjithë ditën, si dhe u

morët me presione, blerje dhe manipulime gjatë gjithë natës.

Ju rezultatin nuk e morët nga votat e qytetarëve, por nga vjedhjet, shantazhet, punësimet e paligjshme, investimet elektorale, përdorimi i makinerisë shtet në favor të pushtetit tuaj, sulmet e pandalshme dhe përdorimi i pushtetit tuaj të gjithanshëm kundër opozitës, duke dashur ta eliminonit atë pa hyrë në zgjedhje, si dhe duke i hequr, në mënyrë të padrejtë dhe të paprecedentë, të gjitha të drejtat që duhet të ketë opozita e një vendi.

Qëllimi juaj në këto zgjedhje ishte eliminimi i opozitës dhe krijimi i një opozite false; në këtë drejtim jeni ju humbësit e mëdhenj të këtij procesi. Një gjë të tillë nuk do ta arrini dot, pavarësisht metodave dhe mënyrave të pamoralshme dhe të paligjshme që keni përdorur dhe vazhdoni të përdorni.

Gjithsesi, për çështjet e rëndësishme të zgjedhjeve, për këtë masakër zgjedhore, për këtë blerje masive të votave, për këtë deformim të rezultatit zgjedhor tashmë qytetarët janë të bindur se me Ramën Kryeministër nuk ka zgjedhje dhe se pa zgjedhje të lira, nuk ka zgjidhje në këtë vend.

Po i kthehem projektligjit që do të votoni sot, atij “Për taksat kombëtare”. Kjo ka të bëjë me realitetin e vështirë të prodhimit të produkteve të qumështit dhe të bulmetit në tërësi, që po përjetojnë krizë në shumë drejtime.

Sot blegtorët shqiptarë vuajnë një ulje të ndjeshme të numrit të gjedhëve, dhe të bagëtive në tërësi, sepse ushqimet për ta janë rritur ndjeshëm, blegtorët kanë ikur, shteti i ka braktisur, për pasojë jemi në një faliment të madh të qindra fermave në Jug dhe në Veri të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT-it vetëm brenda 4-vjeçarit të fundit Shqipëria ka gjysmë milioni krerë dhi me pak, ka 100 mijë krerë lopë më pak dhe mbi 500 mijë dele më pak.

Ekspertët e blegtorisë, fermerët dhe qytetarët tashmë janë të qartë se përgjegjëse për këtë situatë janë politikat e gabuara të qeverisë dhe të

Ministrisë së Bujqësisë për subvencionimin dhe mungesën totale të mbështetjes ndaj tyre.

Fermerët e vendit tonë, ata të Fierit në veçanti, me të cilat kam kontakte, janë shprehur qartë se skema e duhur mbështetëse, që do ta nxjerrë nga ngërçi këtë sektor të rëndësishëm, është sa lekë për litër qumësht duhet të marrë fermeri dhe jo subvencioni për krerë bagëtie, me shumë kushte dhe i padrejtë që ju kenë vendosur. Subvencionimi për kokë lopë është i gabuar dhe një larje goje, kanë deklaruar shumë herë blegtorët tanë. Në këtë mënyrë ju plotësoni vetëm kërkesat e industrialistëve dhe jo të atyre që vuajnë dhe sakrifikojnë, të fermerëve dhe të blegtorëve të thjeshtë dhe të nderuar.

Ministrja e Bujqësisë dhe shefi i saj nuk i përfillin fermerët dhe blegtorët, sepse qëllimi i kësaj qeverie është të falimentojë produktin kombëtar, të prodhuar me aq mund e sakrificë nga fermerët shqiptarë. Në këtë mënyrë, duke i falimentuar këta të fundit, hap trarët e doganës për importin e qumështit pluhur dhe produkteve të tjera të kësaj natyre, për të favorizuar industrialistët, ortakë të qeverisë.

Për muajt e parë të vitit 2023 ka një rritje të ndjeshme, me 48%, të importeve të qumështit, që kryesohet nga Italia, 30% nga Serbia dhe 10% nga Kosova. Sipas importuesve, kemi rritje të sasisë së qumështit dhe hirrës, të importuar në trefishim, sepse stallat e bagëtime shqiptare po boshatisen dhe për pasojë shqiptarët po hanë produktet e importit, sigurisht produkte që vlerat ushqyese të tyre janë shumë herë më të ndryshme nga produktet vendase, duke e lënë qumështin e fermerëve tanë stok dhe të pashitur, por, edhe po u shit, çmimi tashmë nuk e përballon as koston e prodhimit.

Sigurisht, heqja e taksës për qumështin pluhur dhe disa produkteve të qumështit, të parashikuara në ligj, që është sot për miratim, i nxit edhe më shumë importuesit t'i mbushin plot marketet dhe dyqanet shqiptare dhe të çojnë në faliment fermerët dhe blegtorët tanë. Dëshpërim dhe keqardhje e madhe që një vend që e ka bujqësinë

sektor strategjik, të katandiset në një magazinë të produkteve OMGJ të importuara!

Por, po të vëmë re, edhe në këtë situatë, në dukje "bollëk" nga importi, çfarë po na ndodh? Ndodh pikërisht ajo, që shqiptarët e varfër dhe të gënjyer nga Rama për rritje pagash, që, në fakt, i rriti pagat, por e filloi nga vetja dhe nga deputetët, bien sërish viktimë e rritjes së çmimeve në mënyrë të pandërprerë. Aktualisht një kilogramë djathë dhie, dikur blihej 900 lekë, kushton 1 200 lekë, ndërsa djathi i deles kushton rreth 30% më tepër; qumështi i deles ka arritur afro në 200 lekë litri, kur jashtë çmimi i qumështit është shumë më i lirë.

Nga ana tjetër, kolegë deputetë, ky ligj duhet të ketë një vëzhgim të shtuar të ekspertëve të ushqimit në fabrikat e prodhimit të bulmeteve. Hirra, edhe pse ka veti ushqyese, që të përdoret në produktet e bulmetit, këtë e thonë ekspertët, duhet të shtohen elemente të tjera, si, për shembull, vaji i palmës, i cili mund të shkaktojë probleme shëndetësore për konsumatorët nëse nuk është në sasi të që lejon ligji.

Edhe pse ligji detyron etiketimin e produkteve, që konsumatorët t'i kuptojnë elementet përbërëse, në këtë pikë përdorimi i vajit të palmës është problematik në tregun tonë ushqimor. Ka ekspertë të sigurisë ushqimore që japin zgjidhje duke stimuluar shtimin e gjësë së gjallë në tregun vendas. Për të shtuar numrin e gjësë së gjallë është emergjente ta mbështesim fermerin, siç e përmendëm më lart, duke i dhënë subvencionim lekë për litër qumësht dhe lekë për kilogram mish, që do të dorëzohet për treg dhe jo me skemën tuaj korruptive dhe të padrejtë, që kontestohet fort nga fermerët, por ju nuk dëgjoni që nuk dëgjoni.

Kolegë deputetë,

Mendoj se ndryshimet ligjore do të përkrahin në mënyrë të padrejtë importin e produkteve blegtorale, duke qenë një goditje tjetër e fortë për mundin dhe vetëmohimin e fermerëve dhe blegtorëve tanë të nderuar në punën e tyre. Ju vazhdoni ta shikoni pushtetin në mënyrë joligjore edhe po e mbështetni fshatin duke manipuluar

vetëdijen e tyre me premtime false dhe të pambajtura.

Tani keni rastin që të lani sadopak ndërgjegjen tuaj, pasi u keni hyrë në hak fermerëve dhe fshatit prej 10 vjetësh, duke i çuar ata në faliment të plotë dhe duke i detyruar të braktisin shtëpitë e tyre dhe të largohen pa kthim: mos e votoni këtë ligj, bëjeni për të mirën e fermerëve dhe blegtorëve të vendit tonë, jepni mbështetje për blegtorët tanë, mos jepni gjithmonë mbështetje për oligarkët dhe përfaqësuesit e kartelit të qumështit apo për të mbështetur pronarët e fabrikave të kroasantëve, që janë të interesuar për këtë ligj, pasi këto produkte, që ju i favorizoni, jo vetëm janë të dëmshme për shëndetin, por përdoren për të dëmtuar edhe ekonominë e fermerit vendas nga konkurrenca e pandershme.

Blegtorët tanë paguajnë 20% TVSH për pajisjet e fermës, 20% TVSH dhe 10% taksë garancie për mëshqerrat barsë, për shtimin e tufave të tyre; paguajnë 10% për plehrat fertilizues, juve ju shtoni edhe konkurrencën e pandershme dhe si përfundim, patjetër, do të kemi faliment total të tyre.

Ndaloni së bëri ligje në interes të oligarkëve, që bashkëpunojnë dhe ndajnë fitimet me ju! Mendoni edhe për qytetarët e këtij vendi, që po i largoni të gjithë dhe po humbni shpresën që ky vend mund të bëhet ndonjëherë!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Shalsi.

Të përgatitet zonja Andia Ulliri.

**Eduard Shalsi** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Parafolësi kishte shumë pasaktësi, që besoj se vijnë nga moskuptimi i thelbit të amendimeve të ligjit, pa lënë pa përmendur faktin se litri i qumështit nuk është 200 lekë; litri i qumështit i nderuar nuk e di sa vite ka...

Çfarë po bëjmë sot? Po, është e vërtetë, ne po korrigjojmë një gabim të bërë në paketën fiskale të vitit 2021, një lapsus, sepse gjatë aplikimit të paketës u konstatua që prekeshin padrejtësisht

disa sipërmarrës, njërin prej të cilëve e përmendi edhe zotëria parafolës.

Vlerësoj disa nga diskutimet konstruktive të deputetëve të opozitës, që ishin në mbështetje të ndryshimeve të sotme. Në fakt, jemi të vonuar në korrigjimin e atyre lapsuseve që u bënë një vit e ca më parë, kur drafti i miratuar në qeveri erdhi në komision dhe ne e miratuam ashtu siç ishte. Por çfarë ndodhi? Këtu dua të falënderoj kolegët deputetë, këtu shikoj Erionin, Netën, Vullnetin, por ka edhe të tjerë që janë të lidhur shumë me zonat e tyre, të cilët morën një kërkesë nga Genti, Toni, Ina, Martini, Mondi, Beni, që janë fermerë nga Lezha, nga Lushnja, pra nga mbarë Shqipëria, të cilët ishin të alarmuar.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, për dëgjesat që kemi bërë, ju e dini shumë mirë që njoftohen të gjithë anëtarët e komisionit, disa përgjigjen dhe disa nuk përgjigjen, por ftesa nuk ka munguar për asnjërin prej jush. Pra, kemi bërë një dëgjesë ku kemi qëndruar nga ora 19:00 deri në orën 12:00 të natës. Ndaj ky është një moment reflektimi për ne, për qeverinë, se sa e rëndësishme është që një shqetësim të na lërë pa gjumë gjithë natën, sepse një lapsus mund t'u kushtojë shumë atyre njerëzve që punojnë 24 orë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ajo fabrika e kroasantëve, të cilën po e përmend deputeti nga vendi...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Shko bëj një vizitë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ata punojnë 24 në 24 orë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Në fakt, është shumë komod pozicioni nga i cili flet, por shko e shiko se si punojnë.

Fermerët erdhën të alarmuar, sepse ashtu siç ishte prezantuar drafti linte shteg për t'u keqpërdorur. Kjo ishte arsyeja se përse ne me amendimet e sotme të draftit të qeverisë, i përjashtuam tregtarët dhe lamë prodhuesit dhe përpunuesit. Janë disa biznese që janë afektuar padrejtësisht, ndaj po t'i dëgjonit dhe po të shkoni t'i shihni se si punojnë, me sa sakrifica, atëherë do



të kuptoni se sa e padrejtë është kjo sjellje që bën një pjesë prej jush, sepse një pjesë tjetër sot e kuptoi.

Arsyeja e reagimit tonë erdhi pas dëgjesës së parë, të dytë, të tretë, të katërt, të pestë dhe pas vizitave në fermat e tyre, ku morëm në konsideratë vërejtjet e tyre. Ky është një mësim për ministren e Bujqësisë, për ministren e Financave, për ne vetë, që e pamë se sa e rëndësishme është të dëgjojmë këta njerëz që punojnë dhe prodhojnë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju nuk e keni idenë për çfarë flisni! E dini se çfarë vura re? Vura re se një pjesë racionale juaja ia vlen për t'u përshëndetur dhe përgëzuar, sepse fjalimet e tyre ishin shumë të arsyeshme dhe të argumentuara, ndërsa një pjesë tjetër që flet është krejtësisht jashtë realitetit.

Dua të them edhe një gjë. Bisedat me këta fermerë më ndriçuan për gjëra që nuk i dija, sepse i kuptova më mirë shqetësimet e tyre dhe bashkë me anëtarët, kolegët e mi të Komisionit të Ekonomisë, kemi marrë një angazhim përpara tyre dhe nuk do të jemi të qetë derisa kërkesat e tyre të plotësohen. Ne me ta nuk mbaruam, do të vazhdojmë, sepse, ndryshe nga ju, që çdo gjë e keni për retorikë politike, jemi shumë të vetëdijshëm dhe shumë krenarë për atë që kemi bërë për bujqësinë, gjë që as imagjinohej në kohën tuaj. Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se kemi shumë punë për të bërë për t'iu përgjigjur nevojave të këtyre njerëzve, për t'iu përgjigjur aspiratave të tyre, të cilët nuk kanë se çfarë të kërkojnë nga ju, por kërkojnë nga ne, sepse ne kemi bërë dhe duhet të bëjmë akoma më shumë.

Meraku im është që pas këtyre dëgjesave, fatmirësisht, një pjesë e fermerëve, ata që kishin lopë, po organizonin një shoqatë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Kështu ata do të jenë më të organizuar, më të artikuluar dhe më të qartë në kërkesat e tyre. Angazhimi dhe premtimi ynë është se do të vazhdojmë të interesohemi me të njëjtin preokupim e shqetësim për problemet e tyre. Pavarësisht se me këtë ligj korrigjojmë diçka, ne

do të vazhdojmë t'i ndjekim, sepse kjo na shërbeu për të reflektuar më mirë dhe për të kuptuar disa problematika, të cilat një pjesë e kolegëve të mi i dinin shumë mirë, ndërsa unë i mora vesh vonë. Ndryshe nga ju, ne kemi një filozofi: në momentin që një biznesmen apo një individ troket në derën tonë, në komision, në ministri, në qeveri, nga ai moment problemi nuk është më i tij, por është yni. Siç bëjmë ne individualisht në jetët tona për të zgjidhur hallet e problemet personale, ashtu kemi për të luftuar dhe punuar për këta njerëz. Këtë nuk mund ta bëjmë me retorikë politike.

Ky ligj, që një pjesë juaja do ta votojë, mund të shërbejë si një proces bashkimi, sepse ca gjëra janë shqetësim, nuk flas për ata që duan të bëjnë vetëm retorikë politike, por po flas për ata që realisht janë të shqetësuar. Unë besoj se brenda grupit tuaj parlamentar, ashtu siç jeni, ka zëra racionale, ka zëra që duhen dëgjuar dhe dera jonë është e hapur. Në çdo dëgjesë të komisionit kanë qenë të ftuar deputetët demokratë, socialistë dhe të tjerë, por ama nëse doni të tregoni seriozitet, ejani me ne kur bëjmë dëgjesa deri në orën 12:00 të natës. Ku ishit ju ditën e shtunë?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ku ishit ditën e diel, kur po vizitonim fermat?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju ishit nëpër ato...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Muli, kam një këshillë...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Kështu siç jeni katandisur, ende nuk keni zënë mend.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Nuk keni zënë mend fare dhe nuk duhet të ndjej keqardhje, por nganjëherë natyra njerëzore të bën të ndiesh keqardhje, por ju përsëri....

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Unë besoj se sa më e shëndetshme të jetë një opozitë, aq më mirë është demokracia e një vendi. Por çfarë t'ju bëjmë? Të paktën ejani në dëgjesa, në konsultime dhe në debate! Ju nuk keni ardhur dhe tani flisni!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Fabrika e kroasantëve, thotë, bën miliona me eksport...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Edhe Ballkani i Hapur, por disa gjëra do t'i kuptoni më vonë...

Gjithsesi, thashë që kemi marrë një angazhim me disa kolegë deputetë dhe së bashku me ministren e Financave dhe ministren e Bujqësisë do të vijojmë të ndjekim shqetësimet e tyre, sepse ka gjëra që duhet me doemos t'i përmirësojmë. Ndaj nuk do ta bëjmë gjumin të qetë, që ta dish, deri sa të kemi adresuar problematikat e tyre.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Halli juaj është tjetër, halli ynë është halli i atyre njerëzve që përfaqësojmë. Tashmë na ka rënë barra që të kujdesemi edhe për elektoratin tuaj.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Andia Ulliri.

Nuk është.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit!

Edi, ky është një shembull tipik i vjedhjes me lezet.

**Lindita Nikolla** – Fjala për ministren Krifca.

**Frida Krifca** – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Është e trishtë të bësh politikë me ushqimin, me bujqësinë, me fermerët dhe t'i përdorësh ata si mish për top. Nisma e qeverisë shqiptare është në mbrojtje të prodhimit vendas, në ruajtje të sigurisë ushqimore dhe në mbështetje të eksportuesve tanë për t'iu drejtuar tregjeve ndërkombëtare me çmime konkurruese.

Ka një shifër që hedh poshtë të gjithë llumin që hidhet këtu, që është fakti se blegtorët tanë për vitin 2022 kanë prodhuar mbi 1 milion litra qumësht nga gjedhët, nga delet dhe dhitë. Nëse shikojmë shifrat e importit të qumështit pluhur, që paska shpëlarë tregjet vendase, po ju them se për vitin 2022 qumështi pluhur ishte 1900 tonë. Pra, po krahasojmë 1 milion litra qumësht me 1900 tonë qumësht pluhur, i cili nuk shkon

domosdoshmërisht për prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve blegtorale, por shkon edhe për arsye të tjera të industrisë. Ndërsa hirra e qumështit, vetëm për vitin 2022, ka qenë 1000 tonë. Këto lloj njerëzish i dëgjojnë, ju dëgjojnë ju, por shohin edhe statistikat dhe të dhënat.

Sigurisht, blegtorja është një sektor që përballet me shumë vështirësi, pra është një sektor sfidues, por në vend që ta mbështesim dhe ta inkurajojmë rininë tonë, që të vazhdojë të merret me këtë sektor, çfarë bëni ju duke hedhur baltë?

Unë nuk e kuptoj se si përballet ju me zgjedhësit tuaj, kur shkoni në zonë, çfarë u thoni atyre, si i frymëzoni ju ata, sepse njerëzit kanë nevojë për inkurajim. Sigurisht që ka sfida të mjedisit, të ndryshimeve të klimës, të cilat kanë ndikim te blegtorët tanë, për nëse ka një qeveri që e ka mbështetur blegtorinë është vetëm qeveria socialiste. Ne këtë vit po mbështesim 8500 blegtorë. Të gjithë ata që kanë aplikuar në skemën kombëtare të mbështetjes, do të marrin financim. Ata, që prej vitit 2018, aplikimin e bëjnë *online* në e-Albania, ndaj nuk ka asnjë mundësi se si të kryhet korrupsion në këtë proces, sepse ai që aplikon me vetëdeklarim merr mbështetje për çdo kre që ka të matrikulluar në vesh dhe personi që ka vendosur firmën për ata krerë që nuk ekzistojnë, kryen vepër penale dhe shkon në burg. Nëse keni raste të tilla, m'i sillni dhe të jeni të sigurt që do të ndiqen deri në fund, por fakti është që blegtorët këtë gjë e dinë.

Ne vërtet nuk kemi mundësi ta rrisim aq sa duam mbështetjen dhe aq sa e meritojnë blegtorët tanë, sepse kemi kaluar sfida shumë të mëdha, kemi nevojë dhe arsye për të mbështetur edhe sektorë të tjerë si, për shembull, bujqësinë, e cila ka një shifër tjetër të patjetërsueshme të suksesit të kësaj qeverie, ku vjet kemi eksportuar 500 milionë dollarë eksporte të bujqësisë. A e dini me sa e gjetëm kur erdhëm? Me pak më shumë se 100 milionë. Si ka ndodhur kjo? Ka ndodhur rastësisht? Ka ndodhur se bujqësia po vdes, se është në zgrip, se njerëzit nuk dinë se çfarë hanë?! Si ka ndodhur? Shikoni statistikat e këtyre 5 muajve dhe mos e jani këtu të bëni politikë me

bujqësinë dhe me ushqimin! Ne duhet ta mbështesim këtë sektor dhe pikërisht këtë gjë po bëjmë, po e mbështesim shumë herë më shumë. Nuk mund të krahasohemi, sepse kemi dyfishin e buxhetit të bujqësisë në krahasim me atë që kishit ju.

Ejani këtu të debatojmë me shifra dhe në mënyrë konstruktive, se nuk funksionon bujqësia në sistem alerti. Me problematikat që ndodhin, nuk duhet të bëhet politikë. Për këtë proces AKU-ja ka një kartë teknologjike dhe nëse prodhuesi mashtron me etiketën, ai përbën një vepër penale dhe ndiqet penalisht. Kaq, nuk po bëhet ndonjë çudi. Mos jepni alarme kot, të cilat krijojnë destabilitet dhe problematika të prodhuesit, përpunuesit dhe frikë të konsumatori, që nuk i vlen askujt.

**Lindita Nikolla** – Zoti Noka, për çfarë e doni fjalën?

**Flamur Noka** – Dëgjova zonjën ministre që tregoi për sfidat e bujqësisë. Ajo tha se e kanë mbështetur blegtorinë me subvencione. Po, militantë rilindas që jetojnë në qytet marrin miliarda subvencione si banorë në fshat...

**Lindita Nikolla** – Zoti Noka, për çfarë e keni marrë fjalën, për replikë, për procedurë apo për çfarë, sepse ka të tjerë në radhë që do të diskutojnë, nuk jeni ju?

**Flamur Noka** – Zonjë, jam duke folur për procedurë, të lutem! Unë po ju them një gjë, në Shqipëri gjëja e gjallë po shfaroset, sepse është sfida e qeverisë. Gjatë fushatës unë isha në Elbasan për dy muaj, po çfarë pashë? Vaji i ullirit, zonjë, ishte një nga problemet më të mëdha, ata kishin bllokuar dhomat e gjumit se nuk kishin ku ta çonin, ngaqë qeveria juaj kujdeset!

Pashë edhe një gjë tjetër, në çdo fshat, ku kishte 100 shtëpi, maksimumi 2 lopë mbanin. Pse? Sepse qumështi pluhur që vjen këtu e ka falimentuar fermerin shqiptar.

E tha edhe kolegu Braçe, Myzeqeja është në hall. Pse? Sepse depot dhe magazinat e Serbisë zbrazen dhe vijnë këtu dhe ne hamë atë që nuk e hanë as bagëtitë e Serbisë. Po, po edhe kjo është sfida e qeverisë!

Shikoni se çfarë po ndodh...

**Lindita Nikolla** – Kjo nuk është për procedurë, por është diskutim.

**Flamur Noka** – Edhe një sekondë.

**Lindita Nikolla** – Jo tani, sepse ka edhe të tjerë që duan të flasin.

**Flamur Noka** – Po jua them unë se deri në fund të mandatit tuaj qeverisë nuk do të gjeni as 100 krerë lopë në të gjithë Shqipërinë....

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Tritan Shehu. Të përgatitet zoti Edmond Spaho.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare! Kolegë të nderuar,

Së pari, sot po dëgjojmë çudira. Dua t'ua drejtohem blegtorëve, sepse u tha këtu se ata janë më të lumturit ngaqë ne do ta mbushim Shqipërinë me qumësht pluhur. Kështu tha kolegu pak më parë, i cili ka bërë dëgjesa pas dëgjesash dhe ëndrra e madhe e blegtorëve është që të mbushim Shqipërinë me qumësht pluhur. Blegtorë, e keni thënë këtë gjë? Pra, deri këtu arritët.

Së dyti, të nderuar kolegë, gjendja është shumë serioze. Ky ligj që ka ardhur këtu (duhet të jemi shumë realistë), ka ardhur i kamufluar, i fshehur, sepse qeveria ka frikë të thotë realitetin. Me amendamentin e paraqitur nga një grup i mazhorancës kërkohet të arrihen qëllimet e mbrapshta që sjell ky ligj. Qeveria nuk ka guxuar të jetë transparente dhe të vendosë materialin e plotë, por ka ngritur, ka krijuar, ka shtyrë dhe është fshehur pas një grupi deputetësh, të cilët e kanë bërë këtë ligj, jo paçavure, por të rrezikshëm.

Nëse do të ishte vetëm në nivelin e qeverisë, nivelin e hirrës, ta mbajnë, nuk është ndonjë gjë e madhe, sepse xhiroja e saj aq është, por këtu me qëllim u tërhoq herën e parë dhe u soll sot që të kalohet dhe të futet fjala “qumësht pluhur” te ky ligj dhe të vijë qumështi pluhur nga Serbia, në suazën e Ballkanit të Hapur dhe të falimentojnë fermerët shqiptarë.

Zonja Ministre, kur ishit në Beograd jua kërkuan që ta vendosnit në ligj këtë gjë dhe t'ua thoshit deputetëve? Në këtë mënyrë, ky ligj duket sikur duhet ta miratonte parlamenti serb dhe jo ky parlament.

Ju thatë se po ndihmoni bujqësinë. Po jua them unë se si po e ndihmoni bujqësinë dhe blegtorinë. Serbia e ka subvencionin 2,6% të GDP-së së saj, Maqedonia e Veriut e ka 2% të GDP-së, po Shqipëria sa e ka subvencionin? E ka 0,34% të GDP-së. Në vlerë absolute ju e dini se si shkon.

Në vitin 2023 subvencionet në Kosovë ishin 100 milionë euro, në Maqedoninë e Veriut 150 milionë euro, në Shqipëri 29 milionë euro. Atëherë unë ju pyes: si do të jetë kostoja e blegtorëve shqiptarë e tillë që të përballojë konkurrencën e qumështit pluhur që vjen nga Serbia pa taksa, në një moment kur nuk ka as kompensim të humbjeve doganore? Si është? Kjo bëhet pikërisht për hir të Ballkanit të Hapur të Vuçitit.

Ne duhet të jemi shumë të sigurtë, ky ligj ka përmbajtje të thellë politike. Kush thotë të kundërtën, kush fshihet pas hurrës, gënjen. Ky ka përmbajtje të thellë politike dhe është një nga kolonat e Ballkanit të Hapur të Vuçitit. Po jua them unë shumë shqetësim, se ata e kanë kërkuar këtë gjë, siç kanë kërkuar edhe për artikuj të tjerë për hir të Ballkanit Hapur, pa asnjë kompensim për humbjet doganore.

Procesi i Berlinit, që ju e anatemoni dhe përpiqeni ta largoni, e ka faturën 9 miliardë euro për humbjet doganore dhe për investimet. Kështu ndodh dhe në Bashkimin Europian kur lëvizin dhe hiqen tarifatat doganore, pa dyshim vendet që e pësojnë marrin kompensim. Kështu duhet të ndodhë edhe te ne, sepse ndryshe shkojmë në falimentim të plotë të blegtorisë shqiptare.

Ju e dini se në qarkun e Gjirokastrës numri i krerëve është ulur 40% dhe ka rënë prodhimi blegtoral, ndërsa ju flisni për subvencione në ndihmë të blegtorisë. Çfarë subvencioni është ky me 0,34% të GDP-së së Shqipërisë?

Unë ju them se ky ligj është antikombëtar, sepse është i kamufluar nga qeveria për të mos thënë të vërtetën, ndaj ju bëj thirrje të mos e miratoni. Të mos ta miratojmë, sepse prek interesat tona ekonomike të vendit, të një shtrese shumë të gjerë fermerësh, blegtorësh dhe të prodhimit!

A keni shkuar atje ku prodhohet djathë sot? A e keni parë se si dominojnë thasët me qumësht pluhur, nuk shihen të vijnë botët me qumësht. Shikoni se si vijnë kamionët e ngarkuar me thasë me qumësht pluhur nga Serbia, sepse është bërë kjo marrëveshje e mbrapshtë brenda Ballkanit të Hapur, e kësaj qeverie me qeverinë e Serbisë, e cila synon t'i japë asaj supremacinë ekonomike dhe politike në rajonin tonë dhe kjo shprehet kudo, shprehet edhe në politikë.

Sot dëgjova Kryeministrin, i cili tha se i ka dorëzuar platformën për asociacionin e Veriut të Kosovës, Kancelarit gjerman dhe Presidentit të Francës. Kush është Kryeministri shqiptar, guvernatori i Kosovës? E ka emëruar njeri? Nuk ka bërë asnjë konsultim me qeverinë e Kosovës. Çfarë do të tregojë ai? Do të tregojë që nuk ka Kosovë, por vetëm Serbi të madhe? Çfarë do të tregojë ai kur e neglizhon në këtë mënyrë parlamentin e Kosovës, qeverinë e Kosovës, Presidentin e Kosovës, misionet e Kosovës, që nuk ka Kosovë, që serbët kanë të drejtë që kërkojnë ta gllabërojnë Kosovën?! Kjo është një histori e vjetër dhe jo e re, e cila ka filluar që me marrëveshjen e Nishit, për të marrë forma konkrete, mes Ramës dhe Vuçitit, e cila për hir të së vërtetës nuk ka dalë asnjëherë e hapur dhe vazhdoi pastaj me Ballkanin e Hapur, i cili sjell sot mbushjen e Shqipërisë me qumësht pluhur nga Serbia dhe shkatërrimin e fermerëve e blegtorëve shqiptarë, sepse duke u shkatërruar blegtorët shkatërrohet edhe ushqimi për blegtorinë, se janë të lidhura bashkë.

Atëherë unë ju pyes: si do të veprojmë? Përse nuk e tha hapur qeveria që në fillim dhe ta sillte materialin ashtu siç ishte, por u fsheh pas hurrës? Pse vendosi deputetët ta propozojnë dhe nuk e propozoi vetë? Sepse nuk ka guxim ta pranojë këtë gjë. Kjo është e lidhur me një projekt që ka dalë nga marrëveshja e Nishit dhe vazhdon me Ballkanin e Hapur, i cili i krijon këto probleme dhe shkon deri aty sa Kryeministri ynë del edhe thotë: "E bëj unë marrëveshjen, statusin e asociimit të Veriut të Kosovës, nuk ka nevojë për Kosovën, ia çoj unë". Ku është parë kjo gjë? A

keni dëgjuar të ndodhë një gjë e tillë mes dy vendeve sovraane? Kjo e shpëlan Vuçiçin nga mëngjesi deri në darkë dhe anatemon Kosovën.

E gjitha kjo është një histori e rrezikshme. Kjo histori i dha Vuçiçit rolin lider në Ballkan për stabilitetin në rajon, që të jemi të qartë, fatkeqësisht, kështu jemi sot. Shqipëria e ka humbur rolin lider që ka pasur në vitin 2013. Ky rol iu dha me qëllim Vuçiçit, duke bërë heroin dhe kampionin e demokracisë për stabilitetin e rajonit. Por nuk është kjo, është e kundërta, sepse ne e dimë historinë se si është.

Ne nuk guxojmë të sjellim në parlamentin shqiptar për të diskutuar, në kundërshtim të plotë me Rregulloren, zonja Kryetare, e kam me ju tani, mocionin me debat dhe rezolutën për gjenocidin serb në rajon. Po e shkëlmi kaq rëndë Rregulloren dhe çdo parim të parlamentarizmit, sepse nuk po e diskutoni as në Konferencën e Kryetarëve dhe nuk po e sillni as në seancë plenare për ta miratuar ose jo. Silleni këtu, votojeni kundër dhe të paktën jeni brenda Rregullores, por kështu jeni moralisht të shkatërruar, politikisht *dizastër*, nga ana demokratike shumë larg dhe krejtësisht të papajtueshëm me rregullat e këtij parlamenti.

Pse i them të gjitha këto? I them, sepse këtu jemi në një zinxhir elementesh, të cilat të çojnë në një vend, në dhënien e rolit prioritar ekonomik dhe politik Vuçiçit dhe Serbisë në rajon, te varësia e plotë ndaj tij, frika se mos ai zemërohet, po themi ne, për gjenocidin, kur vetë Bashkimi Europian e quan të domosdoshëm pranimin e gjenocideve dhe dënimin e tyre që të mos përsëriten dhe pastaj lëshime kaq të mëdha ekonomike, siç është ky i sotmi, që shkatërron krejtësisht dhe i jep grushtin e fundit, *colpo di gracia*, blegtorisë sonë për të mbushur tregun me qumështin pluhur të Vuçiçit dhe për të forcuar superioritetin ekonomik të Serbisë në rajonin tonë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Bylykbashi.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

E ka kërkuar fjalën zoti Bylykbashi për procedurë.

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Kryetare, ky projektligj ka kohë që ka ardhur në parlament, nëse nuk gaboj ka ardhur që në nëntor. Kur erdhi për herë të parë, shkaktoi një buzëqeshje, duke u nisur jo vetëm nga titulli që kishte, por edhe për vlerën për të cilën bëhet fjalë. Ndoshta për ekonomi të caktuara edhe 150 mijë euro (aq vlerësohej atëherë në vlerë totale ndikimi që kishte ky projektligj), që mund të përfitonin, ndoshta ishin të rëndësishme, por me atë që përballëshim ishte diçka që dukej qesharake, duke nisur nga titulli: projektligj për hurrën.

Në atë kohë mua më u kujtua diçka. Diku nga vitet '80 në bulmetoren e lagjes ishte një pankartë që na shpjegonte vlerat e jashtëzakonshme ushqyese...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, përmbajuni procedurës!

**Oerd Bylykbashi** – Për procedurë e kam.

... vlerat e jashtëzakonshme të hurrës që duhet të përdorim, sepse nuk kishte gjëra të tjera. Po e kapërcej këtë histori, sepse nuk ishte këtu, pra sot, me sa duket, i ka dalë hirra kësaj historie.

Cila është procedura? Zonja Kryetare, është i njohur edhe korrupsioni parlamentar. Unë nuk i heq presjen gjithë asaj që tha kolegu Shehu, por shpeshherë nën këto histori fshihet edhe korrupsioni. Një projektligj që nuk e kishte të parashikuar, sot pritet të amendohet për të hequr taksën doganore për qumështin pluhur. Kolegu e tha shumë mirë, por e thanë të gjithë me radhë, që po i hapet porta qumështit pluhur nga Serbia, me dëmin kolosal për fermerët shqiptarë.

Pse flas për korrupsion në këtë histori? Sepse vjen fshehtëzi dhe futet, pra duket qartë që historia e hurrës është histori e vërtetë hirre. Në fakt, ky është dëmi korruptiv që u bëhet mijëra e mijëra fermerëve shqiptarë me një ndërhyrje në momentin e fundit nga deputetët socialistë.

**Lindita Nikolla** – Po, zonja Ministre.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Edhe zonja ka kërkuar fjalën, i kam të renditura në ekran.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Për procedurë e ka kërkuar edhe ministrja.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, se janë të renditura në ekran.

**Frida Krifca** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Dua të nënvizoj edhe një herë shifrën e prodhimit të qumështit për vitin 2022, që është 1 milion tonë qumësht, ndërkohë që importi i qumështit pluhur është 1900 tonë gjatë vitit 2022 dhe hirra e qumështit të importuar është 1000 tonë. Ndërkohë që po shikoja shifrat, për t'i kthyer përgjigje edhe deputetit për deficitin tregtar dhe tregtinë e jashtme me Serbinë, nëse shohim vitin 2011, ne eksportuam 1 dhe importuam 12,4 njësi nga Serbia, ndërkohë që në vitin 2022, dhe ky qenë një trend në rënie, ne eksportuam 1 dhe importuam 1,4 njësi. Pra, nuk kemi me çfarë të krahasohemi. Flasim për dy botë dhe për dy qasje të ndryshme në drejtim të ndërtimit të marrëdhënieve dhe zhvillimit të këtij sektori.

**Lindita Nikolla** – Zoti Dogjani.

Përmbajuni procedurës, ju lutem!

**Asllan Dogjani** – Ti nuk e di se për çfarë do të flas unë! Sigurisht, për procedurë do të flas, mos më paralajmëro përpara! Në qoftë se nuk flas për procedurë, atëherë është tjetër gjë.

**Lindita Nikolla** – Mund të më drejtoheni me “ju”, se ju drejtova me “ju”, zoti Dogjani!

**Asllan Dogjani** – Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

Marr shkas nga fjala e deputetit, zotit Shehu, që na informoi se Kryeministri paska dalë me një platformë për asociacionin e komunave në Veri të Kosovës, të cilën ua paska paraqitur francezëve dhe gjermanëve. Megjithëse, për momentin, unë jam deputet i ri në këtë parlament, do të kërkoja që një qëndrim të tillë zyrtar ndaj vëllezërve tanë në Kosovë ta mbajë Kuvendi i Shqipërisë dhe jo Kryeministri. Duke marrë shkas nga kjo, i bëj thirrje Komisionit për Politikën e Jashtme që, në fund të kësaj seance, të dalë me një rezolutë dhe të dënojë dhunën e ushtruar nga paramilitarët serbë dhe grupet kriminale në Veri të Kosovës ndaj KFOR-it, ndaj policisë dhe ndaj qytetarëve të Kosovës, pra se cili është qëndrimi ynë për sa i

përket situatës në Kosovë, sepse të gjithë e kemi ndjekur dhe nuk flasim.

*(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)*

Një minutë, zotëri!

Të gjithë e kemi ndjekur situatën në Veri të Kosovës, që është tejet e tensionuar. Prandaj, është detyrë e Kuvendit të Shqipërisë të dalë me një qëndrim në fund të kësaj seance dhe të dënojë dhunën e ushtruar ndaj qytetarëve të Kosovës, ndaj KFOR-it dhe jo ta bëjë vetë Kryeministri këtë gjë. Pra, nuk mund të dalë Kryeministri me një qëndrim, por duhet të dalë Kuvendi.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Dakord.

Vijojmë!

Fjalën e ka zoti Edmond Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja Kryetare!

I bëra thirrje ministres së Bujqësisë të mos ikte, por të më dëgjonte, sepse nuk ka mbaruar debati, dhe të përballej me shifrat, sepse rrahu gjoksin për arritjet e mëdha që paska sektori i saj! Ajo na akuzoi që ne po llomotitim dhe po hedhim baltë. Në fakt, ajo gënjen dhe llomotit; është ministrja më gënjeshtare në raport me parlamentin. Një vit e gjysmë më përpara kjo ministre, që iku tani me bisht ndër shalë, solli projektligjin për të vënë taksa mbi hirrën dhe kremin e qumështit. I thamë: “jo”, por i vendosi! Pas një viti vjen dhe propozon t'i heqë. Atëherë, pse të mos mendoj unë që ka marrë ryshfet? I bëri presion industrisë, mori ryshfet dhe tani po i heq, dhe jo vetëm kaq, por shton edhe qumështin pluhur. Këtu dalin dhe thonë se blegtorët me të cilët janë konsultuar i brohoritën dhe i falënderuan për këtë masë lehtësuese që po ndërmarrin. Ju gënjeni, por të paktën gënjeni me lezet, jo kaq shumë! Ky është lobim i importuesve të qumështit pluhur, siç ka ardhur e lobuar në qeveri. Qeveria këto politika po zbaton, politikat e lobimit.

5% është rritur ekonomia sipas INSTAT-it në vitin 2022. A e dini sa është rritur dega e kësaj? Është rritur 0,06%, dhe këtë e kanë rregulluar me marifete, se deri në shtator të vitit 2022 dilte me

humbje, me rënie prodhimi. Kjo mburret duke thënë: “Kemi rritur eksportet”, në një kohë kur në vitin 2021 dega e kësaj është rritur me 1,8%. Ku është puna e mirë këtu, nga 1,8% në 0,05%?!

20% të PBB-së jep bujqësia; 40% e të punësuarve janë në bujqësi; 0,7% merret nga buxheti i shtetit për bujqësinë, blegtorinë, peshkimin dhe pylltarinë.

FAO ka kryer një studim për të gjithë bujqësinë shqiptare dhe rekomandimi i parë që ka dhënë është që të rriten financimet, të rritet mbështetja monetare nga buxheti i shtetit, por asnjëri nuk e vë ujën në zjarr.

Kjo mburret për prodhimin e qumështit të lopës në vitin 2022. “A e dini sa kemi prodhuar? Kemi prodhuar 1 milion ton” – thotë. Prodhimi i qumështit ka rënë me 0,7%. Në vitin 2022, që mburret kjo, ka marrë më pak qumësht se në vitin 2021. Prandaj them se ajo gënjen! Vetëm qumështi i deles është rritur, ndërkohë që prodhimi i qumështit të lopës dhe të dhisë ka rënë.

42 litra qumësht natyral prodhon Shqipëria për frymë të popullsisë; 150 Greqia; 326 Italia; 404 Gjermania; 2000 Irlanda. A e dini pse jemi në këtë gjendje? Sepse ka rënë numri i krerëve.

Nga viti 2013 e deri sot kemi 50% më pak krerë. Kjo që mburret, nga viti 2017 deri në vitin 2023, ka 138 mijë krerë më pak lopë, dele dhe dhi. Mburret kjo dhe rreh gjoksin: “Po bëjmë punë të shkëlqyer”! Masakër është bërë me lopët. Shkoni dhe shikojini në Fier, në Elbasan dhe në Korçë, që janë 3 rrethet ku mbarështohen gjerësisht lopët!

Në vitin 2022 ka importuar 2% më shumë qumësht kjo zonja! Në periudhën janar-shkurt 2023 është importuar 9% më shumë qumësht. Ajo mburret e thotë: “Kemi prodhuar 1 milion ton”. Është importuar 9% më shumë. A e dini se nga vjen kryesisht? Vjen nga Italia dhe nga Serbia. Vetëm në periudhën janar-shkurt të vitit 2023 importi i qumështit nga Serbia është rritur në nivelin 28 mijë tonë, nga 20 mijë tonë, që ka qenë për këtë dymujor në vitin 2021. Përsëri kjo rreh gjoksin për punën e mirë! Kjo e shkatërroi bujqësinë, blegtorinë e gjithçka tjetër në këtë sektor.

Çmimi i qumështit, që e dorëzon fermeri sot, për shkak të rritjes së çmimeve është 75 cent për litër, në Francë është 50 cent për litër. Çmimi i qumështit shqiptar në markatë është 27% më shtrenjtë se çmimi i qumështit të importuar. Si do të blejmë ne qumësht vendas dhe të shkojnë të ardhurat te fermeri, kur qumështi i importit është më lirë?! Pse ndodh kjo? Ndodh ajo që tha Erion Braçe: fermerin po e mbysim me taksa dhe çmimet e lëndëve të para dhe të lëndëve ushqimore po rriten në mënyrë të pakontrolluar.

1 kilogram misër në vitin 2019 kushtonte 250 lekë të vjetër, në pranverë kushton 380-400 lekë, ndërsa në dimër shkon 450-500 lekë; soja ka kushtuar 600 lekë për kilogram në vitin 2019, në pranverë është 980 lekë, ndërsa në dimër, kur nuk ka prodhim, shkon 1050-1100 lekë; krundja e grurit ka kushtuar 150 lekë për kilogram, 300 lekë është sot, ndërsa në periudhën e dimrit shkon 350 lekë; elbi në vitin 2019 ka qenë 300 lekë për kilogram, sot është 400 lekë, ndërsa në dimër shkon 600 lekë; jonxha, me 14 kilogramë dengu, është 5000 lekë, 7000 lekë është sot, ndërsa në dimër shkon 12 mijë lekë; nitrati në vitin 2019 ka qenë 40 mijë lekë për kuintal, ndërsa sot është 90 mijë lekë për kuintal; një thes dap ka qenë 60 mijë lekë për kuintal, ndërsa sot është 120 mijë lekë të vjetër për kuintal, dhe këta thonë që blegtorët na priten me brohoritje!

33% e taksave për prodhimin e qumështit dhe të prodhimeve të tjera bujqësore dhe blegtorale janë taksa qendrore dhe lokale, ndërsa 20% është TVSH-ja për farat, pesticidet dhe karburantet. E hoqi rimbursimin prej 6% në bujqësi, kjo që jep subvencione më pak se çdo shtet tjetër në Europë. Shtoi 10% TVSH-në për importet e inpueteve bujqësore dhe blegtorale, dhe thotë: “Po krijojmë ambient të favorshëm, po i stimulojmë, po i zhvillojmë”! Le të vijë këtu dhe të kundërshtojë qoftë edhe një nga këto shifra! Të gjitha janë shifrat e INSTAT-it.

Kështu që ajo pjesa e heqjes së taksës së importit të qumështit pluhur është një nga veprimet më të gabuara dhe më të poshtra që po bëhet për të mbështetur një lob të caktuar që

importon qumësht pluhur dhe për të shkatërruar blegtorët shqiptarë.

Ndaj, thirrini mendjes dhe mos e votoni!

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Ermonela Felaj)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Spaho!

Po, zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit!

E kam strikte, për procedurë, sepse janë disa shkelje të normave themelore të parlamentarizmit dhe të respektit ndaj parlamentit. Midis kolegëve të grupit parlamentar të mazhorancës ka deputetë të vjetër, jeni ju, është zoti Balla, është zoti Majko e të tjerë, që kanë një eksperiencë shumë të gjatë parlamentare, ndaj mendoj dhe ju sugjeroj që t'i orientoni ministrat që duhet respektuar parlamenti. Nuk mund të largohet ministri nga parlamenti në kulmin e debatit për çështjen që ai mbron. Në momentin kur opozita ngre akuza kaq të forta kundër këtij ligji, jam dakord, le t'i kundërshtojë, por nuk mund të largohet në mënyrë demonstrative nga parlamenti një ministër. Kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës, në asnjë parlament demokratik të botës nuk ndodh një gjë e tillë, ju siguroj unë për këtë gjë. Me të vërtetë është një sjellje që i kalon kufijtë e parlamentarizmit, të respektit reciprok, si dhe të përgjegjësisë që kemi midis nesh, absolutisht, edhe të një jete të përbashkët që kemi prej shumë kohësh në parlamentin shqiptar.

Prandaj, me shumë sinqeritet, po u them kolegëve të mi të mazhorancës që të reagojnë, sepse këtu po kalojmë në një situatë ku vetëm parlamenti nuk vlen.

Vetëm zoti Ulsi është atje dhe, absolutisht, e falënderoj, kurse ministri përkatës, që ka çështjen në dorë, largohet nga parlamenti në kulmin e debatit, në mënyrë shumë demonstrative, ndërkohë që ne të gjithë këtu rrimë si..., nuk dua të përdor fjalë të keqe.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehu!

Zonja Vokshi, të njëjtën ndërhyrje keni edhe ju apo keni ndërhyrje tjetër për procedurë?

**Albana Vokshi** – Kam një propozim, në fakt, sepse, përveç Kryeministrit, i cili ka kohë që nuk vjen më në seancat plenare, duke dëshmuar se sa e vlerëson parlamentin, tashmë është bërë normale që as kabineti dhe as ministrat nuk qëndrojnë më. Edhe sot, në pjesën më të madhe të seancës, nuk ka qenë asnjë ministër. Unë propozoj ta mbyllni seancën; thirrini ministrat që të vazhdojmë, se kujt po i flasim?! Për çfarë po flasim, kur ministrja ka ikur?!

Në bazë të Rregullores, thirrini ministrat që të vijnë dhe të qëndrojnë këtu, se nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa jeta parlamentare, dhe është një herë në javë. Kështu që le të vijë ministrja e Bujqësisë, të vijnë edhe ministrat e tjerë dhe të vijojmë me seancën.

**Ermonela Felaj**- Faleminderit, zonja Vokshi!

Për fatin tuaj, kjo pikë e rendit të ditës sapo përfundoi me diskutimin e zotit Spaho, kështu që do të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.80/2020 “Për Policinë e Burgjeve””. Ministri i Drejtësisë është prezent, kështu që, referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, a ka pyetje për të?

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Ju lutem, kemi kaluar në pikën tjetër të rendit të ditës. Atë që ndodhi dhe për të cilën ju patët pretendime, nuk e kthejmë dot më. Tani jemi në këtë pikë të rendit të ditës dhe ministri përgjegjës është prezent.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Unë jam drejtuese e seancës në këtë moment dhe ju e dini shumë mirë që nuk ka një rregull të prerë në Rregullore, që të detyrojë një ministër të qëndrojë në seancë nga fillimi deri në fund.

*(Ndërhyje pa mikrofon)*

Atëherë, a ka pyetje për ministrin? Nuk ka.

Fjala është për ministrin e Drejtësisë, zotin Manja.

Ju lutem, zoti Ministër, keni fjalën, sipas Rregullores, për të prezantuar projektligjin. Koha juaj për të folur është pa kufizim. Sigurisht, mund të ndërhyni në çdo kohë dhe këtë prioritet jua jep Rregullorja.



**Ulsi Manja** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot vij në këtë seancë plenare si propozues i disa ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”.

Siç jeni në dijeni, në vitin 2020 ne ndërmorëm një nga reformat më të rëndësishme të sistemit të burgjeve, duke miratuar një paketë ligjesh që rregullonin të gjithë sistemin penitenciar, që nga rregullat për trajtimin e të dënuarve, ekzekutimin e vendimeve penale, deri edhe në rregullimin e një mënyrë të re të statusit të Policisë së Burgjeve.

Sigurisht, pas miratimit të kësaj pakete në Kuvendin e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë nxori të gjitha aktet rregullatore në zbatim të kësaj pakete ligjesh, që u miratuan në vitin 2020, për të gjithë sistemin e burgjeve. Kjo reformë që ne bëmë në vitin 2020 prekte jo vetëm sistemin në tërësi, jo vetëm punonjësit e Policisë së Burgjeve, por edhe stafet civile të burgjeve. Paketa në atë kohë synonte një trajtim dinjitoz financiar edhe për punonjësit e burgjeve, kryesisht për punonjësit e Policisë së Burgjeve. Sot që flasim, jemi dëshmitarë që punonjësit e Policisë së Burgjeve, më në fund, marrin atë që u takon sipas ligjit: marrin pagë dhe përfitime të tjera financiare, njëlloj si edhe kolegët e tyre në Policinë e Shtetit.

Unë, si ministër i Drejtësisë, jam përpjekur t’i bëjmë pozicionet e punës edhe në sistemin penitenciar një vend ku të mund të tërheqim kandidatët më të mirë, për t’i shërbyer këtij sistemi. Kemi luftuar fort që punonjësit e sistemit penitenciar ta shohin sistemin si një vend ku mund të bëjnë një karrierë të ndershme, të bazuar në meritat dhe aftësitë profesionale dhe jam i sigurt se deri më sot, falë mbështetjes së qeverisë shqiptare, por edhe të Kuvendit të Shqipërisë, ia kemi dalë me sukses kësaj sfide. Sigurisht, problemet e burimeve njerëzore të sistemit nuk zgjidhen dot brenda ditës. Ne kemi shumë punë përpara dhe unë jam i ndërgjegjshëm për këtë. Prandaj, po punojmë fort për t’i zgjidhur këto

probleme që kemi, sidomos në drejtim të burimeve njerëzore.

Pikërisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve””, që unë kam sjellë sot në Kuvendin e Shqipërisë, synon të zgjidhë një pjesë të këtyre problemeve që ne kemi në sistemin tonë penitenciar.

Para se të filloj të prezantoj ndryshimet që kemi sjellë për ligjin “Për Policinë e Burgjeve”, e gjej të udhës të falënderoj kolegët deputetë të Komisionit të Ligjeve, si komision për dhënie mendimi, si dhe kolegët e Komisionit të Sigurisë, si komision përgjegjës, për të gjithë mbështetjen që na kanë dhënë gjatë diskutimit të këtyre ndryshimeve!

Falënderimi shkon për të gjithë kolegët, pa dallim kahesh politike, sepse ka qenë një paketë ndryshimesh që në komisione është mbështetur jo vetëm nga kolegët e mazhorancës, por edhe nga kolegët e opozitës! Unë jam i bindur se edhe vota sot në këtë seancë do të jetë në mbështetje të kësaj pakete dhe të këtyre ndryshimeve.

Të nderuar kolegë,

Sot në sistemin e Policisë së Burgjeve kemi rreth 400 vakanca në 22 institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në vend. Ka shumë shkaqe pse i kemi këto vakanca, por, për fat të keq, shumë janë krijuar edhe për shkak të disa kriterëve shumë të ngurta që ligji ka vendosur në vitin 2020, si, për shembull: kufiri i moshës i vendosur në ligj, deri në 35 vjeç, për të kandiduar si punonjës i Policisë së Burgjeve; mosrregullimi në ligj i rasteve të rikthimit në Policinë e Burgjeve të personave të liruar nga detyra vullnetarisht apo për shkak të mbylljes së pozicionit përkatës me ristrukturim.

Një shkak tjetër është mungesa e rregullimit në ligj e pranimit me përparësi, në radhët e punonjësve të Policisë së Burgjeve, të punonjësve që vijnë nga struktura të tjera policore, kur ata janë liruar për shkak të ristrukturimit të institucionit apo për shkak se janë larguar me dorëheqje.

Nëpërmjet këtyre propozimeve, i jepet zgjidhje problematikës së krijuar për vakancat në strukturën e Policisë së Burgjeve në të gjitha nivelet.

Së pari, ndryshimet që propozojmë sot e heqin kriterin e moshës për të kandiduar në Policinë e Burgjeve. Kriteret kufizuese që kanë të bëjnë me moshën, natyrisht, edhe në të gjitha rekomandimet e Gjykatës Europiane të Strasburgut, por edhe të jurisprudencës sonë të brendshme, janë kritere diskriminuese. Pra, ne propozojmë që të hiqet kriteri i moshës në ligj.

Po ashtu, janë parashikuar rregulla për rikthimin në detyrë të punonjësve që kanë shërbyer më parë në Policinë e Burgjeve. Këtu është rasti t'u bëj thirrje nga kjo foltore e Kuvendit të gjithë punonjësve të Policisë së Burgjeve, të cilët janë larguar nga struktura vullnetarisht apo për arsye të shkurtimit të funksionit organik, për shkak të ristrukturimeve që kanë ndodhur herë pas here, se ndryshimet që votojmë sot u hapin një dritare dhe krijojnë një mundësi që ata të rikthehen përsëri në Policinë e Burgjeve.

Po ashtu, ndryshimet që propozojmë sot parashikojnë rregulla mbi pranimin me përparësi të punonjësve me grada ekuivalente. Ka qenë një propozim në Komisionin e Sigurisë, që ish-punonjësit e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura, të Gardës së Republikës apo ish-punonjës, që kanë shërbyer në repartet e zjarrfikësve, pra që kanë zotëruar një gradë policore, me këto ndryshime që ne propozojmë sot, kanë një mundësi, në rast se ka vende vakante në Policinë e Burgjeve, të pranohen në këtë strukturë, sigurisht, sipas rregullave që janë përcaktuar në ligj.

Gjithashtu, janë parashikuar kritere të qarta në rastet e pezullimit të punonjësit të Policisë së Burgjeve për shkak të nisjes së një procedimi penal, si dhe është rishikuar përbërja e gradave të Policisë së Burgjeve, duke suprimuar gradën e rolit bazë "nëninspektor".

Lidhur me kriteret e qarta në rastet e pezullimit të punonjësit të Policisë së Burgjeve për shkak të nisjes së një procedimi penal,

sigurisht, deri tani standardi ka qenë që, sapo organi i prokurorisë fillonte hetimin penal ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve, ata pezulloheshin nga detyra, merrnin 50% të pagës, dhe në rast se më vonë merrnin pafajësinë ata riktheheshin në strukturë, duke marrë edhe diferencën e pagës. Me ndryshimet që ne propozojmë sot, gjithmonë duke marrë në konsideratë garancitë procedurale kushtetuese për personat që i nënshtrohen hetimit dhe ndjekjes penale, ne e lidhim momentin e pezullimit me rastin e njoftimit të akuzës apo marrjes së cilësisë së të pandehurit. Mosrregullimi si duhet në ligj i këtyre rasteve ka krijuar kosto financiare për sistemin e burgjeve.

Po ashtu, për shkak të sistemit hierarkik të karrierës, që vendoste ligji që kemi në fuqi, deri tani ne jemi përballur edhe me pamundësinë për të pasur punonjës të rolit të mesëm në strukturën e Policisë së Burgjeve. Ju e dini që, njëlloj si në Policinë e Shtetit, kemi grada të rolit të ulët, kemi grada të rolit të mesëm, kemi edhe grada të larta. Kemi pasur një pamundësi të gradat e mesme, sidomos të gradat "nëninspektor", "nënkomisar" deri në "kryekomisar", sepse, duke e konsideruar sistemin e karriere, nuk kishte përparim nga gradat e ulëta në drejtim të gradave të mesme, çka na ka krijuar një vështirësi në menaxhimin e sistemit të burgjeve sa u takon gradave të mesme. Me ligjin e ri ne i japim zgjidhje kësaj çështjeje, nëpërmjet një ndryshimi ligjor, duke krijuar mundësinë që punonjësit të marrin gradën "nënkomisar", në rast se i plotësojnë në mënyrë kumulative kushtet, që lidhen me arsimin e lartë, arritjet profesionale dhe vlerësimin në punë, me synim nxitjen për një performancë më të lartë të punës. E thënë më qartë: në rast se një punonjës në Policinë e Burgjeve, në rolin e ulët, ka edhe arsimin e lartë (këtu, sigurisht, kemi pasur një diskutim në komision, ku kemi thënë të zotërojmë një diplomë të nivelit të dytë) dhe shërben jo më pak se dy vjet në një gradë të ulët, ai mund të konkurrojë për gradën e mesme "nënkomisar" e lart, gjithmonë në rast se i plotëson në mënyrë kumulative këto kushte. Ka pasur diskutime nëse do të duhej të

ishte me arsim të lartë, pra vetëm *bachelor*, apo duhej të kishte edhe një diplomë të nivelit të dytë. Sigurisht, në draftin që ne kemi propozuar varianti ka ardhur “me diplomë të nivelit të dytë”. Gjithsesi, ne mendojmë se kjo do të na e zgjidhë situatën sa i takon përparimit në gradat e mesme.

Një çështje tjetër, për të cilën unë ndihem mirë që e propozoj sot përpara jush, dhe kërkoj mbështetjen tuaj me votë, është e drejta për të përfutuar kredi për strehim. Pra, me këto ndryshime që ne propozojmë sot, u krijojmë mundësinë edhe punonjësve të Policisë së Burgjeve, njëlloj si kolegët e tyre në Policinë e Shtetit, që të përfitojnë marrjen e kredive me kushte lehtësuese për strehim, ku një pjesë e mirë e interesave të kredisë do të mbulohen nga buxheti i shtetit. Kjo masë është domosdoshmëri, në kuadër të trajtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve, për shkak të detyrës së veçantë që kryejnë dhe nevojës për të rritur qëndrueshmërinë dhe profesionalizimin në strukturat e Policisë së Burgjeve.

Duke marr shkas nga vakancat e krijuara dhe problematikat mbi ecurinë në gradë në Policinë e Burgjeve, bazuar edhe në diskutimet e gjera që janë zhvilluar në të dyja komisionet parlamentare, unë kam mbështetur edhe propozimin e kryetarit të Komisionit të Sigurisë, kolegut tim Naço, për eliminimin e gradës “nëninspektor”, si grada më e ulët e rolit bazë në Policinë e Burgjeve.

Punonjësit që aktualisht mbajnë gradën më të ulët, “nëninspektor”, me ndryshimin e ligjit do të përfitojnë gradën “inspektor”. Kjo bëhet për përputhjen e detyrave dhe përgjegjësi të punës me gradat e rolit bazë. Krijimi i vetëm dy gradave të ulëta, “inspektor” dhe “kryeinspektor” për rolin bazë, është një masë e përshtatshme për të përmbushur si duhet misionin e Policisë së Burgjeve nga punonjësit aktualë, por edhe nga punonjësit që do të rekrutohen në të ardhmen.

Unë besoj fort, të nderuar kolegë, se me miratimin e këtyre ndryshimeve, ne do t'i japim një shtysë rekrutimit të burimeve njerëzore cilësore në Policinë e Burgjeve, duke siguruar, nga njëra anë, trajtim financiar dinjitoz, të cilin ata

e marrin sot, dhe, nga ana tjetër, duke siguruar ecurinë në karrierë, të bazuar në meritë, profesionalizëm dhe në aftësitë e tyre.

Me këto ndryshime, unë jam i bindur se e bëjmë Policinë e Burgjeve një polici moderne, në gjendje për t'u shërbyer nevojave të sistemit penitenciar. Për këtë shkak, unë ju ftoj, të nderuar kolegë, që t'i mbështesni me votë këto ndryshime që ne kemi sjellë sot në seancë plenare.

Gjithashtu, dua të bëj me dije për kolegët e mi deputetë, që, sa i përket premimit që unë bëra në Komisionin e Sigurisë dhe në Komisionin e Ligjeve lidhur me zgjidhjen përfundimisht të transportit të punonjësve të Policisë së Burgjeve, një problematikë e bartur 30 vjet në sistem, do ta zgjidhim brenda këtij sesioni parlamentar. Dua t'ju bëj me dije dhe e them me kënaqësi se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shumë shpejt do të ketë një flotë të re me rreth 20 furgonë, që do të marrin përsipër transportin e punonjësve të Policisë së Burgjeve nga shtëpia në vendin e shërbimit dhe nga vendi i shërbimit, kur të lënë turnin, në drejtim të banesave të tyre.

Dua të falënderoj secilin prej jush, sidomos qeverinë shqiptare, që e ka kthyer vëmendjen në drejtim të këtij institucioni dhe të këtij sistemi shumë të rëndësishëm në një nga institucionet e sigurisë kombëtare, që është institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale.

Duke besuar fort te vota juaj, shumë faleminderit që patët durimin të më dëgjonit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Ministër!

Çelim diskutimet për projektligjin.

Fjalën e ka zoti Xhemal Qefalia.

Të përgatitet Ervin Salianji.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Dua të falënderoj nënkryetaren e Kuvendit, në cilësinë e ish-kryetares së komisionit, sepse ky ligj është miratuar në vitin 2020 (unë kam qenë relator), dhe është shumë bashkëkohor!

Ministri i përmendi arsytet pse kërkohen të bëhen sërish ndryshime në këtë ligj. Fakti që në

22 institucionet penitenciare ka një vakancë prej rreth 400 e ca personash, tregon se jo kushdo ka qenë i interesuar për të punuar në këtë shërbim. Arsyja është e thjeshtë: një punonjës policie, që punon në sistemin penenciar, në sistemin e burgjeve, në një kohë pune prej 20 vjetësh, 1/3-ën e kohës kryen shërbim pranë njerëzve të cilëve u është privuar liria. Kjo do të thotë se për rreth 7 vjet të jetës së tij në punë, i hiqet liria. Kjo ka qenë një ndër arsye pse nuk ka pasur prurje dhe njerëz të interesuar për të punuar në këtë sistem. Po ashtu, kjo është edhe arsyeja pse ne jemi sot këtu për të hequr kufizimin e moshës deri në 35 vjeç.

Si deputet i mazhorancës, në fakt, duket sikur kam konflikt interesi që po e përgëzoj ministrin e Drejtësisë.

Zoti Manja, unë ju përgëzoj ju personalisht dhe ekipin e Ministrisë së Drejtësisë, sepse e njoh shumë mirë këtë sistem dhe keni bërë shumë gjëra që më parë nuk ishin menduar të bëheshin dhe tani po realizohen.

Çfarë është bërë konkretisht? Falë vullnetit të kësaj qeverie dhe insistimit të ekipit tuaj është bërë i mundur barazimi i pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve me pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit, dhe kjo nuk është pak.

Tjetra, që vlen të përmendet, zoti Ministër, është përkujdesi që keni treguar ndaj kësaj kategorie. Cili është përkujdesi? Sikurse e dimë, punonjësit e kësaj kategorie janë parë si punonjës të dorës së dytë, madje edhe në uniforma. Në kohën kur qeverisnin këta, shumë nga punonjësit që rekrutoheshin për t'u punësuar i merrnin uniformat tek i ashtuquajturit "gabi", ndërkohë që sot fondi i qeverisë shqiptare është i dedikuar për të pasur një polici dinjitoze, me standardet e policive të vendeve të tjera. Ky është një realitet. Po ashtu, nuk ndodh më që punonjësit e Policisë së Burgjeve të dalin në rrugë duke ngritur dorën për të shkuar në banesat e tyre. Në atë kohë ka pasur jo pak raste kur punonjësit e policisë hipnin në makinën e një kriminelit, pa e ditur se cili ishte. Unë kam qenë mosbesues për vendimin që ju thatë sot, zoti Ministër, jua kam thënë edhe në komision, por mezi pres ta shikoj të konkretizuar,

që punonjësi i policisë do të ketë transport të garantuar, nuk do të qëndrojë gjithë ditën pranë dikujt që ka kryer një vepër penale, ka vrarë apo është prapa hekurave, dhe në darkë, në orën dymbëdhjetë, të hipë në makinën e atij që e ka ruajtur para disa kohësh. Kjo është shumë pozitive.

Zoti Ministër, tjetër gjë që evidentohet sot dhe mbetet për t'u vlerësuar është që ju keni bërë të mundur që të sigurohet trajtimi i punonjësve të policisë me strehim, pra mundësia që u jepet atyre për të marrë kredi, në mënyrë që kjo kategori të ketë akses njësoj si kategoritë e tjera. Kjo po bëhet realitet sot, falë investimit dhe punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në përgatitjen dhe në sugjerimin e kërkesave të kësaj natyre.

Gjithashtu, zoti Ministër, është për t'u vlerësuar vendimi i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për trajtimin njerëzor të të burgosurve, dhe dua të falënderoj posaçërisht zotin Arbrija për këtë nismë! Vërtet ka individë të cilëve u është privuar liria, por është shumë pozitive që këta, më së fundi, pavarësisht kimit që kanë kryer, të kenë trajtim njerëzor, pasi, herët apo vonë, ata janë pjesë e shoqërisë, dhe për problemin social që krijojnë në familje nuk ka përse të robtohet e gjithë familja apo i gjithë farefisi. Është krijuar dramë familjare kur një qytetari i privohej liria dhe familjarët zinin radhën në orën 04:00 të mëngjesit me çanta dhe trasta me ushqime. Kjo gjë është zgjidhur shumë mirë tashmë dhe besoj se, duke iu bashkëngjitur edhe të gjitha elementet e tjera, më në fund, do të kemi të drejtë të përthithim kontigjentë dhe njerëz të apasionuar për të shërbyer në këtë sistem.

Tjetër gjë pozitive, ndoshta kjo vjen edhe nga karriera ime ushtarake, është prioriteti që ju do t'u jepni individëve që dalin nga Forcat e Armatosura, pa kaluar në kritere të tjera. Një punonjësi të Forcave të Armatosura, që del nga forcat komando apo ka marrë pjesë në dhjetëra e dhjetëra misione, ju i jepni prioritet me këtë ligj, që të jetë pjesë e kësaj strukture, i veshur mirë dhe i trajtuar në mënyrë dinjitoze.

Dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit të Sigurisë, pavarësisht kaheve politike dhe debateve, të cilët e kanë mbështetur këtë draft dhe shpresoj që këtë ta konkretizojmë edhe me votë, kur të jetë momenti i votimit!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Salianji nuk është në sallë. Konsiderohet që ka hequr dorë nga fjala.

Fjalën e ka zonja Dhima.

Të përgatitet zoti Çela.

**Antoneta Dhima** – E nderuar zonja Nënkyetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është mbështetur dhe njëkohësisht ka qenë në qendër të vëmendjes së qeverisë dhe të Kryeministrit Rama për sa i përket ristrukturimit të kësaj force dhe modernizimit të kapaciteteve të saj. Tashmë nuk ka asnjë dallim mes kolegëve që punojnë dhe kontribuojnë në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike pranë Policisë së Shtetit dhe punonjësve të Policisë së Burgjeve, pasi do të kenë të njëjtin trajtim financiar si për funksionin, edhe për vështirësinë.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për kontributin dhe vështirësinë që kanë në ushtrimin e detyrës së tyre punonjësit e Policisë së Burgjeve. Vendimmarrjet e qeverisë për trajtimin me pagë, shtesën mbi pagë, shtesën për natyrë të veçantë pune, shtesën për çdo vit vjetërsie shërbimi, kompensimet e shpenzimeve të udhëtimit, kompensimet për qiranë e banesës dhe për trajtimin me ushqim pa pagesë kanë sjellë një trajtim dinjitoz dhe njëkohësisht të merituar për të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve” e ushtron aktivitetin e vet nga Veriu në Jug në 22 institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Kanë kaluar më shumë se 2 vjet nga zbatimi i ligjit organik të Policisë së Burgjeve dhe janë konstatuar disa problematika për pranimin, pezullimin, rikthimin apo

përparësitë e pranimit në radhët e Policisë së Burgjeve, të cilat sollën domosdoshmërinë e reflektimit dhe të ndryshimeve të këtij ligji. Këto problematika kanë sjellë mungesa në strukturën e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe me reflektimin e tyre në projektligjin që ne po diskutojmë do të bëhet e mundur dhe do të sigurohet shmangia e situatave që mund të cenojnë rendin dhe sigurinë në këto institucione.

Me ndryshimet e propozuara dhe njëkohësisht të reflektuara në projektligj do të përmirësohen kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve; do të rishikohen kriteret e ecures në karrierë të punonjësve të Policisë së Burgjeve; do të krijohet një status dhe një staf i motivuar, me integritet, i aftë profesionalisht për të garantuar sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; do të parashikohen kriteret për rikthimin dhe njëkohësisht përparësitë për pranimin e strukturave të Policisë së Burgjeve; do të rishikohen rastet e pezullimit nga detyra të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe do të parashikohet e drejta e marrjes së kredisë me kushte lehtësuese për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Procesi i rekrutimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk mund të realizohet nga Drejtoria e Policisë së Burgjeve, pasi numri i pjesëmarrësve ka qenë disa herë më i ulët se numri i vendeve të lira. Njëkohësisht, duhet theksuar edhe fakti që u përmend edhe nga kolegët parafolës, që pjesëmarrësit janë penalizuar për arsye të kriterit të moshës deri në 35 vjeç.

Ndryshimet e propozuara në projektligj sjellin një vlerësim të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të cilëve duhet t’u njihen me ligj të drejtat e mësipërme, njësoj si strukturat e tjera, që kryejnë detyra të ngjashme, siç janë: Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Forcat e Armatosura, oficerët e Policisë Gjyqësore e të tjera.

Sipas informacionit, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ka një numër relativisht të lartë të vendeve vakante, që, nëpërmjet ndryshimeve ligjore që ne do të miratojmë sot, patjetër që do të marrë zgjidhje.

Vendosja e kufizimeve të moshës në ligjin ekzistues është një kriter diskriminues, dhe me heqjen e kufirit të moshës deri në 35 vjeç për t'u bërë pjesë e Policisë së Burgjeve do të bëhet i mundur plotësimi i strukturës dhe i vakancave në të gjitha IEVP-të në të gjithë vendin.

Po kështu, në projektligj janë përcaktuar rregulla të qarta për ripranimin në Policinë e Burgjeve të ish-punonjësve të larguar me dorëheqje dhe jo me masa disiplinore, si dhe do të hapet një mundësi për pranimin në Policinë e Burgjeve edhe për kandidatët që janë pjesë e strukturave policore ose ushtarake dhe plotësojnë kriteret e specifikuar në këtë ligj.

Shumë i rëndësishëm është edhe propozimi i ndryshimeve për të drejtën e strehimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Ndryshimi tjetër i propozuar ka të bëjë me rregullimin e sistemit të gradave më të ulëta dhe të mesme në Policinë e Burgjeve, pasi sot kemi një problem me gradat e mesme. Duke pasur mungesë të punonjësve të policisë, të rolit bazë, është bllokuar efekti i zinxhirit të gradave në nivelin e mesëm dhe të lartë. Me këtë ndryshim synohet të rregullohet sistemi i gradave në Policinë e Burgjeve, duke u bërë një sistem karriere. Pra, çdokush që vjen nga jeta civile, mund të bëhet pjesë e Policisë së Burgjeve, por tashmë përparimi në gradë dhe ngritja në detyrë në Policinë e Burgjeve do të ketë efekt zinxhir, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

Gjithashtu, me ndryshimet e propozuara, punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk do t'u lejohet mbajtja e armatimit pasi ata largohen nga orari i shërbimit.

Angazhimi, mbështetja jonë dhe e qeverisë për Policinë e Burgjeve do të vijojë duke realizuar çdo objektiv të reformës penitenciare, duke vijuar me përmirësimin e kapaciteteve të stafit policor, garantimin e karrierës, rritjen e sigurisë në burgje, përmirësimin e kushteve për trajtimin, respektimin e të drejtave të të burgosurve dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

Theksoj faktin se projektligji për të cilin po diskutojmë, dhe patjetër që do të ketë miratimin

nga të gjithë kolegët deputetë, nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Në kushtet kur ligji jep saktësime ligjore për kriteret e pranimit, për kriteret e pezullimit, për rikthimin apo për përparësitë e pranimit në radhët e Policisë së Burgjeve, për strehimin dhe mbajtjen e armatimit, të nderuar kolegë dhe kolege deputete, ju ftoj ta miratojmë atë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka zoti Dogjani.

Të përgatitet zoti Deliu.

**Asllan Dogjani** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë projektligj parashikohen disa kushte lehtësuese për punonjësit e Policisë së Burgjeve, lidhur me: marrjen e kredive, të drejtën për të mbajtur armë, rikthimin, përparësinë, pranimin në strukturat e Policisë së Burgjeve e të tjera. Parimisht, ne jemi dakord me këto shtesa, por unë, duke parë gjendjen e krijuar në burgje dhe kushtet e tyre, do të kërkoj që në këtë projektligj, siç e tha edhe ministri, të përfshihen edhe disa lehtësira të tjera, si: transporti nga ana e institucioneve të burgjeve për policët e tyre, të cilët janë bërë gangrenë, duke u dalë makinave përpara për të shkuar në shtëpi apo për të ardhur në punë; pagesa për bashkëshortet që nuk janë në punë, si dhe përmirësimi i kushteve të punës. Unë i kam parë vetë kushtet në burgje, pasi kam punuar si avokat deri dje; i kam parë kushtet në të cilat punojnë policët e burgjeve dhe kushtet në të cilat ndodhen të burgosurit. Sot policët e burgjeve, për shkak të pagave të ulëta dhe kushteve mizerabël të punës, detyrohen të largohen nga puna ose të bashkëpunojnë me të burgosurit dhe të përfitojnë prej tyre. Kjo ka bërë që situata në burgje të dalë jashtë kontrollit. Burgjet sot janë të tejmbushur, kushtet janë mizerabël, ushqimi nuk konsumohet nga të burgosurit, sepse, sipas tyre, ato janë të kalbura dhe të skaduara. Kjo ka bërë që shumë familje të qëndrojnë prapa dyerve të burgjeve me çanta mbi shpinë për t'u çuar ushqim çdo fundjavë

fëmijëve të tyre. Nëse doni, mund të shkoni t'i shikoni.

Një tjetër problem është që në burgjet tona futet drogë, sepse, siç e thashë, polici, për shkak të kushteve dhe pagave të ulëta, bashkëpunon me ata që e bëjnë këtë dhe e lejon.

Të burgosurit dhunohen psikologjikisht dhe fizikisht nga njëri-tjetri, nga grupet dhe institucioni i burgut nuk është në gjendje të parandalojë si dhunën fizike, ashtu edhe atë psikologjike. Kur arrestohet një person, pavarësisht veprës penale që ka kryer, familjarët ia dorëzojnë institucionit të burgut, i cili ka për detyrë ushqimin, veshmbathjen, riedukimin e tij dhe të kujdeset që të mos bullizohet, që, kur ai të dalë nesër, të riedukohet, t'i rikthehet shoqërisë dhe jo të bëjë të njëjtat gabime dhe të hyjë sërish në burg.

Por çfarë ndodh në të vërtetë? Çfarë ka rezultuar? A është bërë ndonjë analizë? Praktika ka treguar se, kush ka hyrë në burg, ka përsëritur të njëjtën gjë, pasi këta individë nuk riedukohen, megjithëse qytetarët shqiptarë paguajnë taksa për psikologë dhe për mjek, për të bërë riedukimin e tyre.

Ngjarjet e fundit, jo të pakta, kanë treguar edhe diçka më të rëndë, që në burgje po vdesin shumë të rinj. Së fundi kemi rastin e vdekjes së 38-vjeçarit Renald Tahiri, i arrestuar për vjedhjen e një biçiklete. Raste të tjera kemi pasur në burgjet e Lushnjës, të Fierit, të Kavajës, po ashtu rasti i Leart Kurtit në komisarriatin nr. 3 të policisë dhe shumë e shumë të tjera. Nëse do të shikoni veprat penale për të cilat janë dënuar, për shembull, ai i Fierit kishte përshtatur oficinën për mbjelljen e kanabisit, në një kohë kur e gjithë Shqipëria u mbush me drogë nën mbikëqyrjen e policisë dhe droga u pre nga policët; ka edhe raste të tjera, si ata që futen në burg për 2 gramë hashash. Njëri në Elbasan është dënuar me 5 vjet burg për 1,5 gramë hashash, në një kohë kur sipërfaqet në Shqipëri janë mbuluar me drogë. Është edhe rasti i Zija Hidrit, me të cilin jam marrë vetë, që vdiq në burg nga plasja e tëmthit. Ai kishte kërkuar disa herë të shkonte në spital, ndërsa drejtuesit e burgut e

paragjykonin: “Nuk ka asgjë ky”, dhe nuk e dërguan në spital. Atij i plasi tëmthi dhe vdiq. Sot vajza dhe djali i tij qëndrojnë dyerve të gjykatave për të kërkuar të drejtën dhe për t'i vendosur autorët përpara përgjegjesisë penale. A e kanë gjetur të drejtën? Sigurisht që jo, sepse nuk bëhet luftë me shtetin, pasi mjeku ligjor paguhet nga shteti, eksperti paguhet nga shteti, drejtori është i shtetit. Si mund t'i dënojë gjyqtari apo prokurori ata për mosmarrjen e masave për ofrimin e shërbimit shëndetësor?! A kemi ne mjek në spitale? Si mund të vdiste nga infarkti personi me masë sigurie në Fier, që kishte kërkuar, për shkak të sëmundjes, lehtësimin e masës së sigurimit, që ta zëvendësonte, por nuk iu lejua? Ai vdiq!

E shikoni ku ndodhemi me burgjet tona? E shikoni çfarë bëhet? Një person mund të ketë kryer çfarëdolloj vepre penale, por prindi nuk e ka sjellë për ta vrarë dhe ai nuk arrestohet për këtë qëllim, por për ta riedukuar. Kemi kritikuar vendet fqinje kur kanë vdekur shqiptarë, si Greqinë dhe Gjermaninë. Në Greqi kanë vdekur 27 shqiptarë në burgje për 29 muaj. Tashmë po vdesin edhe këtu, dhe kjo është e patolerueshme. Ne jemi një vend i vogël dhe duhet të marrim masa urgjente që, të paktën, t'u ofrohet ndihma mjekësore. Zotërinj, ka mjekë në burgje; t'i jepet ndihma mjekësore në momentin kur e kërkon i dënuari. Në momentin kur personi i dënuar me masë sigurimi kërkon të shkojë në spital, të shoqërohet për mjekim, jo të vdesë nga infarkti. Të vdesësh sot nga infarkti, do të thotë se nuk është marrë asnjë masë.

Gjithashtu, nuk kam dëgjuar asnjëherë të jetë bërë një analizë për shkaqet, për arsyet pse ndodhin këto vrasje dhe çfarë masash ka marrë Drejtorja e Burgjeve për t'i parandaluar, për të mos hyrë në detaje se sa dhe si respektohen të drejtat e të burgosurve në burgje. Vdekje të tilla janë të paprecedenta dhe nuk mund të lejohet më që në dhomat e paraburgimit të humbasin jetën të dënuar ose individë nën masa sigurie.

Për ta përfunduar, ju bëj thirrje që në këtë projektligj të përfshihen, jo brenda mandatit, por tani: transporti i policëve të burgjeve; pagesa e

bashkëshorteve; rritja e pagës dhe përmirësimi i kushteve të punës; të merren urgjentisht masa për ushqimin, që qytetarët të mos rrinë më pas dyerve të burgjeve me thasë mbi shpinë, siç ndodh 1 herë në javë në burgjet e Shqipërisë, për t'u çuar bukë, por të ofrohet ushqim me standarde për njerëzit, jo për kafshët; të merren masa për parandalimin e dhunës brenda grupeve apo individëve të caktuar, qoftë kjo dhunë psikologjike apo fizike, brenda institucionit të burgut; të merren masa në mënyrë urgjente, që në çdo burg të ketë mjek dhe kur një i dënuar të kërkojë shërbim mjekësor, edhe sikur të shtiret si i sëmurë, të dërgohet, që të parandalojmë vdekjet dhe të mos vdesin më të burgosur, sepse shumë të rinj kanë vdekur. Kjo është detyra jonë, është detyrë e Drejtorisë së Burgjeve që të kujdeset për jetën e këtyre të rinjve, të cilët me të vërtetë mund të kenë kryer një vepër penale, por nuk i kemi çuar atje për të vdekur.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Fjala për zotin Deliu.

**Denis Deliu** – E nderuar Nënkryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Projektligji që po diskutojmë sot ka si qëllim përmirësimin e Policisë së Burgjeve dhe adresimin e problematikave të dala nga zbatimi i ligjit në fuqi, në lidhje me pranimin në Policinë e Burgjeve, pezullimin, rikthimin apo përparësinë në pranim, të cilat kanë sjellë mungesa në plotësimin organik të strukturës së Policisë së Burgjeve dhe vështirësi në kryerjen e detyrave të sigurisë nga ana e tyre.

Ndryshimet që propozohen synojnë shmangien e mëtejshme të vakancave dhe situatave të vështira në strukturën e Policisë së Burgjeve, duke i dhënë fund cenimit të rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Këto ndryshime mundësojnë krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; përmirësimin e

kritereve për pranimin në Policinë e Burgjeve dhe ecurinë në karrierë; parashikimin e kritereve për rikthimin dhe përparësinë për pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve; rishikimin e rasteve të pezullimit nga detyra dhe parashikimin e së drejtës së kredisë me kushte lehtësuese për strehim.

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve të planifikuara për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2023, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për shqyrtim gjatë vitit 2023. Kjo është një nismë ligjore e arsyeshme dhe e domosdoshme, që i shërben perfeksionimit dhe kryerjes sa më mirë të misionit nga Policia e Burgjeve.

Ligji aktual e reformoi në tërësi Policinë e Burgjeve, përcaktoi rregulla të qarta për organizimin dhe funksionimin e saj, për të drejtat dhe detyrat e punonjësve të Policisë së Burgjeve, si dhe për marrëdhëniet e punës e statusin e veçantë që gëzojnë punonjësit e këtij shërbimi sipas këtij ligji. Fakti që gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji janë shfaqur problematika, kryesisht në rekrutimin e punonjësve, ku në 3 proceset e fundit të rekrutimit të punonjësve të rolit bazë në Policinë e Burgjeve, numri i pjesëmarrësve ka qenë disa herë më i ulët se numri i vendeve të lira që kishte shpallur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka sjellë si pasojë zhvlerësimin e procesit të konkurrimit. Gjithashtu, shumë konkurrentë janë skualifikuar nga e drejta për konkurrim, për shkak të kriterit të moshës nën 35 vjeç.

Referuar gjendjes aktuale, sot në strukturën e Policisë së Burgjeve rezultojnë rreth 400 vende vakante në disa institucione, si: në Fier, në Peqin dhe në Reç, që kanë përkatësisht 70-80 mungesa secili. Këto vakanca, shoqëruar me lejet vjetore dhe mungesat për paafhtësi të përkohshme kanë ndikuar që një pjesë e IEVP-ve të kryejnë detyrat e sigurisë me 25%–30% mungesa në staf, duke ndeshur vështirësi serioze në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë, si dhe duke sjellë ulje të cilësisë së shërbimit dhe dobësim të vigjilencës.



Për t'u dhënë fund këtyre problematikave serioze, projektligji ofron një kornizë të plotë lidhur me kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve, të drejtën për të mbajtur armë, ecurinë në karrierë, pezullimin nga detyra dhe rikthimin apo përparësinë për pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve. Në kuadër të trajtimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve në mënyrë të posaçme, për shkak të detyrës së posaçme që kryejnë, njësoj si Policia e Shtetit, Garda e Republikës, Forcat e Armatosura dhe oficerët e Policisë Gjyqësore, projektligji i ri jep të drejtën e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese për banim për punonjësit që nuk zotërojnë një banesë apo pasuri të tjera, të luajtshme apo të paluajtshme, duke u mundësuar atyre strehim.

Ky projektligj nuk ka efekte financiare, sepse lidhet vetëm me saktësime ligjore për kriteret e pranimit, të drejtën që punonjësit e Policisë së Burgjeve të mbajnë armë dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës, për shkak të natyrës së punës së tyre gjatë kryerjes së saj; saktëson kriteret e pranimit për pastërtinë e figurës, të arsimimit dhe shfuqizon kufizimin e moshës deri në 35 vjeç.

Projektligji i jep të drejtë punonjësit të rolit bazë të marrë gradën "Nënkomisar" kur zotëron një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose zotëron një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë Ministrisë përgjegjëse për Arsimin; kur ka mbi 2 vjet si punonjës i rolit bazë, që ka përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës "Nënkomisar"; kur ka vlerësim vjetor pozitiv të punës, për periudhën kur ka qëndruar në gradën që mban, si dhe është shpallur fitues në procedurat konkurruese për ngritjen në gradën "Nënkomisar".

Për pezullimin saktësohen këto kritere: kur ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" apo "arrest në shtëpi" për kryerjen e një veprë penale ose kur merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje, por e rëndësishme

është se gjatë periudhës së pezullimit, punonjësi i policisë do të përfitojë 50% të pagës për gradë. Nëse punonjësi i Policisë së Burgjeve do të shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë, mund të rikthehet në punë dhe do të kompensohet për pjesën e mbetur të pagës që duhej të përfitonte nëse nuk do të ishte pezulluar, ndërsa rikthimi në Policinë e Burgjeve mund të bëhet në çdo kohë vetëm për nevoja të Policisë së Burgjeve për plotësimin e organikës dhe me gradën që ka pasur në kohën e lirimit, ose me pëlqimin e tij dhe me gradë më të ulët, kur nuk ka vend vakant me gradën e tij.

Këtu dua ta përfundoj fjalën time për këtë projektligj. Më besoni, si një ish-ushtarak, ju them se ky është një projektligj i shkëlqyer.

Dëshiroj të falënderoj ministrin e Drejtësisë dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Burgjeve për punimin e këtij projektligji!

Gjithashtu, i falënderoj të gjithë kolegët, edhe për pjesëmarrjen në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, dhe kërkoj një mbështetje sa më të madhe me votë për këtë projektligj, sepse me të vërtetë mbështet burimet njerëzore në Policinë e Burgjeve, mbështet të gjithë anëtarët e larguar nga Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit apo Garda e Republikës, që njerëzit me vlera të mos i shërbejnë krimit, por t'i shërbejnë shtetit!

Duke ju falënderuar, kërkoj miratimin e këtij projektligji me të gjitha votat.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Deliu!

Zoti Berisha nuk është i pranishëm në sallë.

Zoti Noka, fjala për ju.

**Flamur Noka** – Faleminderit!

Keni sjellë këtë projektligj, i cili në aparençë duket sikur keni vënë "dorën në zemër" dhe jeni kujtuar për punonjësit e Policisë së Burgjeve, ndërkohë që gjendja dhe situata sesi e keni trajtuar Shqipërinë deri tani është sikur të jetë një burg i madh. Më ironikja është se ministri që drejton burgjet, në bazë të dosjes nr.184 po edhe të kësaj fushate zgjedhore që bëri në Lezhë, duhej të ishte sot një nga kandidatët për të qenë i burgosur dhe

jo ministër që të na japë leksione për demokracinë.

Gjendja e burgjeve në Shqipëri është katastrofike. Punonjësit shihen nga “Rilindja” thjesht si militantë partie dhe jo si punonjës shteti. Ky është trajtimi i punonjësve të burgjeve. Të burgosurit kanë një lumturi të çuditshme dhe kanë një dashuri të pakufishme për Partinë Socialiste. Votimet e 14 majit, jo zgjedhjet, e demonstuan qartësisht këtë gjë. Edhe në kohën e “qoftëlargut”, pra edhe në atë kohë kur u rrinin xhelatët te koka, 2 për qindësh e të gjithë të burgosurve ose abstenonin, ose votonin kundër, sot na vijnë informacione se të burgosurit e Ulsiut janë të lumtur, duartrokasin dhe bëjnë këngë për “babëlokun” dhe për Ulsiun që i do, i respekton, i mban dhe i vlerëson...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do ta them unë këngën, Ulsi. Lexo dosjen nr. 184, se aty e ke këngën.

Të gjithë të burgosurit duke shkuar dhe duke votuar për Partinë Socialiste dhe për udhëheqësin e madh, Edi Ramën! Kjo është e tmerrshme dhe është një ironi therëse! Po ku ka të burgosur të një vendi, qoftë të botës së tretë apo të vendeve të zhvilluara, që voton qeverinë? Ju dhe Ulsi vetëm me këtë histori e keni nxjerrë zbuluar farsën e 14 majit.

Krimineli elektoral, Kol Kuka, këshilltar i Erion Veliajt, nga këshilltar bëhet drejtor burgu në Rrogozhinë, ku me urdhër dhe nën terror u kërkohet të burgosurve të votonin hapur për “Rilindjen”, sepse pastaj nuk do t’i takonin familjarët, siç e lejon ligji, nuk do t’u lejohej asnjë akses, madje as të dilnin në dritën e diellit. Çfarë bëri krimineli elektoral, Kol Kuka?! Të burgosurit e Ulsiut në Rrogozhinë e nxorën fituese “Rilindjen”. Ata votuan si kurrë ndonjëherë: 100 për qind të dashuruar me partinë e pushtetit, me “babëlokun” Kryeministër dhe me Ulsiun. Ishin të dashuruar, sepse është i vetmi ministër Drejtësie që ka shëtitur gjatë gjithë kohës me kontingjentë të krimit në Lezhë dhe në Laç. Po, po Ulsi. Po të shihje makinat që shoqëronin ministrin, nuk ishin të Gardës së Republikës, por njëri ishte trafikant

droge, tjetri ishte vrasës, tjetri ishte i burgosur në Itali për vjedhje, tjetri ishte për përdhunim. Këta ishin shoqëruesit e ministrit të Drejtësisë në Lezhë apo edhe në Kurbin. Domsdo del se krimineli elektoral Apostol Luca, të cilit Ulsi i ka dhënë gradën e Drejtorit në burgun e Kosovës në Lushnjë, na i zgjedh me “kokrra” se cili nga të burgosurit që ishte atje do të votonte. Krimineli elektoral, Apostol Luca, nuk i la të gjithë të votonin. Megjithëse asnjë i burgosur nuk ishte nga Belshi, tha se vetëm 23 persona do të votojnë këtu dhe do të shkojnë të gjithë me këngë e me valle te qendra e votimit për të votuar për Arif Tafanin e “Rilindjes”. Këto janë batërdi dhe turpe. A e dini ju se po t’ia thuash këto, jo një të huaji, por edhe një shqiptari, i cili nuk ka jetuar këto vite në Shqipëri, do të habitet dhe do të thotë se nuk ka mundësi dhe se nuk ka ndodhur kjo lloj masakre që keni bërë ju! Kjo është e vërteta. A e dini se, po t’i thuash një të huaji që ministri i Drejtësisë ka qenë i shoqëruar gjatë gjithë kohës me kontingjentë të krimit, duke bërë terror në Laç, në Mamurras, në Fushë-Kuqe, në Milot dhe në të gjithë Lezhën, nuk ta beson askush? Ja, pra, ja kjo është fytyra e “Rilindjes”. Këto janë farsat zgjedhore që keni bërë.

Edhe pesë personalitete të hairit që kanë qenë në Drejtorinë e Burgjeve, po ikin. A e keni pyetur ju veten pse po ikin policët e burgjeve? Po ikin, sepse i trajtoni si qen, nuk i trajtoni si njerëz të pushtetit dhe të shtetit. O do të bëhesh kamikaz i “Rilindjes”, ose nuk ke punë as në Policinë e Shtetit dhe as në Policinë e Burgjeve. Prisni, se jua ka thënë ky juaji: “Nuk keni parë asgjë akoma”. Prisni, se këtu do të mbeteni vetëm ju me familjarët tuaj, do t’ju braktisin të gjithë. Pse? Sepse, ose i shndërroni në kamikazë, përndryshe ndaj njerëzve të lirë, qytetarëve të denjë e keni të vështirë, nuk keni qasje, nuk i njihni dhe nuk i pranoni. Ndaj, mbajini kriminelët elektoralë, por mos harroni se një ditë do ta paguajnë. Çdo gjë do të paguhet. Asgjë nuk do të kalojë kështu. Këta janë në pushtet dhe mburren e fryhen si gjela, sepse mendojnë që nuk do t’u ndodhë asgjë. Edhe Gjushi kështu bënte dikur. E mbani mend Gjushin

e para një muaji? Dilte blinte vota, terrorizante, shantazhonte dhe intimidonte, por “babëloku” e shiti. Ulsi, bëj kujdes nga shitja, sepse pazaret janë të hapura!

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka kërkuar ministri i Drejtësisë për replikë me zotin Noka, njëkohësisht për të shprehur konsideratat e tij në raport me ligjin.

Ju kujtoj edhe një herë se ministri propozues flet pa kufizim.

**Ulsi Manja** – Unë do t’i përgjigjem zotit Noka edhe për zotin Berisha, se ka filluar ta imitojë edhe te kollarja dhe, duke iu përgjigjur zotit Noka, besoj se i përgjigjem edhe Saliut. Më ngeli merak në fillim. Flamur, thuaj Saliut që të mos mërzhitet fare për Dakon, se Saliun do ta njoftoj një javë para. Dakord? Të mos mërzhitet, meqenëse më akuzoi se kisha dekonspiruar dhe kisha nxjerrë sekretin hetimor. Se çfarë lidhjeje kam unë me këtë, e di vetëm ti dhe Saliu, por të jesh i bindur se për Saliun, për shkak të moshës që ka, do ta bëj një sakrificë, do ta konsumoj edhe një akuzë tjetër dhe do ta njoftoj 10 ditë përpara.

*(Ndërrhyrje nga salla)*

Tani, Flamur, këtë që the këtu, unë do ta titulloja: “Apologjia e burgut brenda Flamurit”, sepse nuk kam se çfarë të them tjetër. Flamur, Kol Kuka, se nuk është e ndershme të përmendësh emra në këtë sallë, është një shtetar dinjitoz, një njeri korrekt në zbatimin e ligjit, dikur ju ka shërbyer juve, por nuk është faji i Kolës që është njeri i mençur dhe e kuptoi herët se PD-ja nuk ka të ardhme në këtë vend dhe, si shtetar i përgjegjshëm, është bashkuar me vizionin tonë dhe të qeverisë së Edi Ramës dhe sot është në krye të një institucioni, që është model për trajtimin dhe respektimin e Rregullores Europiane të Burgjeve dhe i standardeve që janë vendosur në trajtimin e të dënuarve me burgim. Do të ftoj që herë tjetër në këtë sallë të mos përmendësh emra zyrtarësh apo qytetarësh shqiptarë që, falë punës dhe përkushtimit të tyre në detyrë, marrin atë rrogë dhe i ushqejnë familjet e tyre në mënyrë të ndershme.

E dyta, Flamur, e di që juve ju ka djegur shumë humbja e Bashkisë së Lezhës dhe e Bashkisë së Kurbinit, por fituat Mirditën. Ky kriminel i elektorat që ke përballë, ta ka thënë në këtë sallë dhe do ta them përsëri se isha edhe në Mirditë i deleguar, zoti Noka, por për ju atje ku fitoni janë respektuar standardet e zgjedhjeve, se këtë e keni zakon 30-vjeçar. Për ju, vjedhje votash dhe krim elektorat ka pasur vetëm atje ku fiton Partia Socialiste. Tani ti ishe edhe në Kurbin, ishe edhe në Lezhë, edhe në Mirditë. Flamur, humbe këtë radhë, se nuk ju duan qytetarët. Ky nuk është faji im. Dakord?

Të mos hyjmë te puna e shoqërimit me kriminelë, as te standardet që kam vendosur unë si Ulsi dhe si ministër, sepse edhe ju keni qenë dikur ministër. Unë edhe ti jemi si nata me ditën në raport me ligjin, me drejtësinë dhe në raport me të vërtetën. Në shpatullat e mia nuk rëndojnë humbje jetë njerëzish nën përgjegjësinë e shtetit, Flamur, kështu që mos hyr në këtë pjesë, se nuk të nderon. Gara mbaroi, zotëri, përballojeni humbjen me dinjitet. Ndërsa, nëse ke raste që Ulsi Manja, si drejtues politik i qarkut të Lezhës, por edhe në cilësinë e ministrit, po të duash ti, se në fushatë elektorale njeri politik jam edhe unë, ke prova dhe fakte për këto që the, je i lutur, zotëri, ta çosh kallëzimin në organet kompetente dhe le të hetojnë ato për këtë gjë. Ndërsa, me pallavrat këtu është mësuar ky milet me ju, se ka 30 vjet kjo punë, se e keni bërë zakon. Shkoni dërgojini provat atje dhe, si qytetar i përgjegjshëm, jam i gatshëm të shkoj sa herë të ma kërkojnë organet ligjzbatuese të përgjigjem, ndryshe nga ju që fshiheni. Kur vjen problemi që ju thirreni, thoni se nuk shkoni apo se ka qenë opinion politik dhe nuk ka qenë fakt. Ju kështu e keni. Ju jepni opinione, kur ju thërrasin organet ligjzbatuese, shkoni dhe mbroheni të gjithë me frazën se janë opinione politike dhe se nuk mbani përgjegjësi në sallën e parlamentit apo në sallën e Komisionit të Ligjeve.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Flamur, sa për votën në burgje, edhe për këtë do ta jap një përgjigje publikisht. Një nga standardet e mia në drejtimin e Ministrisë së

Drejtësisë, por edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, falë një ekipi dhe një skuadre të mrekullueshme që kam atje, jemi kujdesur që, në përputhje me Kushtetutën, me ligjet e vendit dhe Kodin Zgjedhor, nisur edhe nga të gjitha rekomandimet që kemi, t'u garantojmë të drejtën e votës të paraburgosurve dhe të dënuarve, sepse ata, Flamur, nuk konsiderohen të dënuar, por janë banorë rezidentë që i ka dënuar drejtësia dhe jo qeveria. Kuptoje këtë më në fund! Janë banorë rezidentë; janë pjesa jonë që në një stacion të jetës së tyre kanë shkelur ligjin penal, kanë marrë ndëshkimin nga drejtësia, por Kushtetuta, ligji dhe Kodi Zgjedhor u garantojnë të drejtën e votës. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në zbatim të Kodit Zgjedhor, në respektim dhe në komunikim të vazhdueshëm me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka garantuar të drejtën e votës për çdo të paraburgosur dhe të dënuar në Shqipëri. Jemi krenarë që e kemi garantuar këtë standard, sepse edhe ata meritojnë të votojnë për të zgjedhur atë që duan për të qenë në krye të bashkive, ku ata konsiderohen banorë rezidentë. Po ti nuk lexon letra. Merre korrespondencën me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe shiko cila është korrespondenca jonë; cila është përgjigjja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe si janë hartuar listat e të paraburgosurve dhe të të dënuarve me të drejtë vote. Të gjitha këto janë publike dhe transparente. Sot për fat burgjet tona, Flamur, ndryshe nga koha e Enver Hoxhës, që i shërbente udhëheqësi yt shpirtëror (se e kisha një fotografi që ngrinte grushtin), monitorohen, kanë një monitorim të brendshëm, por edhe një monitorim të jashtëm. Monitorohen nga ne, sepse e kemi detyrë dhe përgjegjësi shtetërore, por monitorohen edhe nga CPT-ja (Komiteti i Parandalimit të Torturës), një organ i Këshillit të Europës, që ishte në Tiranë para dy javësh dhe i ka vizituar dhe i ka monitoruar standardet e burgjeve tona në 22 IEVP-të dhe shumë shpejt do të nxjerrin edhe raportin. Burgjet tona, Flamur, monitorohen nga Avokati i Popullit, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe nga shumë organizata të shoqërisë civile që merren me standardet e

trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve, por ti nuk ke nga t'i dish këto, se për ty bota fillon dhe mbaron te Saliu. Je i lutur që së bashku me të gjithë kolegët deputetë të këtij parlamenti të shkosh t'i vizitosh të 22 institucionet, sepse jua lejon ligji dhe jua krijojmë këtë mundësi, sepse rregullorja e përgjithshme e burgjeve jua mundëson të shkoni t'i pyesni të dënuarit si kanë votuar dhe a kanë qenë të lirë të zgjedhin me vullnetin e tyre, për ta çuar votën atje ku duhet, se je i lirë dhe je deputet i këtij Kuvendi dhe anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Për këtë ju ftoj në një mision monitorimi dhe vëzhgimi. Bëjeni kërkesën, ejani, "bujrum", hapim dyert dhe, për aq sa e lejon ligji, shkoni dhe komunikoni vetë me ata që kanë votuar më 14 maj. Jua japin ata përgjigjen dhe lërin insinuatat këtu, se këto nuk ju nderojnë.

Hiqini etiketimet "të dënuar", "burgaxhi", "kriminelë, se sot këtu raportoi edhe Komisioneri kundër Diskriminimit. Ata janë shtetas shqiptarë të dënuar nga drejtësia e vendit tonë, që po i nënshtrohen vuajtjes së dënimit konform vendimeve gjyqësore. Ata janë aty dhe është përgjegjësia jonë t'i trajtojmë si njerëz që t'ia kthejmë shoqërisë të rehabilituar dhe të riintegruar në shoqëri, sepse janë pjesa jona. Po të them se ata në vizionin që kanë për familjen, për jetën, për shoqërinë, për punën e ndershme, janë shumë më dinjitozë sesa një pjesë e atyre që e kanë marrë peng politikën në këta 32 vjet në këtë vend.

Këtë përgjigje kam dhe do t'ju ftoj që t'i votojmë ndryshimet që kam propozuar në ligj, sepse është në nderin e këtij parlamenti dhe sepse ato ndryshime jo vetëm krijojnë një modernizim dhe fuqizim të Policisë së Burgjeve, por, duke i trajtuar në mënyrë dinjitoze punonjësit e Policisë së Burgjeve, stafet civile të burgjeve dhe mjekët e burgjeve, ne garantojmë një shërbim dinjitoz për të paraburgosurit dhe të dënuarit në Shqipëri me ato mundësi që kemi, sepse jemi vend i vogël dhe kjo është në nderin tonë. Ka ikur koha kur të dënuarit dhe të paraburgosurit trajtoheshin si në burgjet e diktaturës që lamë pas. Kjo është

dinjitoze sot. Pastaj për votën e lirë, të burgosurit politikë në këtë vend janë sakrifikuar 50 vjet, tani do t'ju dëgjojnë ju ata se për kë do të votojnë dhe të bëhen përgjegjës ata pse votojnë të lirë dhe nuk ju kanë votuar ju! Absolutisht, kanë bërë shumë mirë që nuk ju kanë votuar ju, se me mendjen tuaj ata do të jenë keq e më keq.

Ndaj do t'ju ftoj ta votojmë këtë ligj, duke rezervuar të drejtën, zonja drejtuese e seancës, që pas fjalës së kryetarit të komisionit, në emër të grupit parlamentar të them disa konsiderata për ligjin për kolegët e mi këtu në këtë sallë që diskutuan sot, sepse më besoni punonjësit e Policisë së Burgjeve janë gjithë sy e veshë të këto ndryshime që ne propozojmë sot, sepse i kanë çështje jetike. Përmirësimi i jetesës dhe i gjendjes së tyre financiare-ekonomike, trajtimi dinjitoz është ajo që ata duan, për pjesën tjetër e ka radhën zoti Noka.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Ministër!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Noka, ju e dini se nuk ka replikë mbi replikën, kështu që fjalën e ka zoti Naço.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ndodh që replika bashkohet me ndërhyrjen e ministrit, i cili është ministri përgjegjës...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, mos ndërhyini tani, se as nuk ishit fare këtu dhe e njoftova në mënyre korrekte! Dakord? Ndërkohë, ju e keni shtypur butonin që në minutën e parë të fjalës së ministrit...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju nuk e njihni fare këtë dispozitë të Rregullores dhe nuk pranoni që ta njihni.

Zoti Naço....

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk jua jap dot fjalën, sepse nuk jua lejon Rregullorja...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Zoti Naço, ju lutem, afrohuni!

*(Zoti Noka bllokoi foltoren dhe flet pa mikrofon.)*

Zoti Naço, flisni nga vendi, ju lutem! Nuk është problem fare për ne zhurma dhe bllokimi i foltores.

Zoti Naço, nga vendi.

**Nasip Naço** – E nderuar, zonja Kryetare!

Të nderuar...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Naço, ju lutem merreni fjalën, sepse Kuvendin e Shqipërisë nuk ka të drejtë ta fyejë askush, duke menduar se duke bërë të fortin mund t'i imponohet Rregullores!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, zonja Vokshi, nuk ka fjalë për procedurë! Ju nuk jeni pjesë e diskutantëve dhe, ju lutem, uluni!

*(Ndërrhyrje nga salla)*

**Nasip Naço** – Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë, ka një postulat që tashmë dihet nga të gjithë: në diktaturë, kur dikush futej në burg thoshin: “Ia hodhën çelësat në det.” Sigurisht, në demokraci kur dikush futet në burg, nga aty fillon problemi, por nga aty duhet të fillojë edhe zgjidhja. Për të përmirësuar sistemin penitenciar zgjidhja në këta 20 vjetët e fundit ka qenë investimi në të rreth 100 milionë dollarëve me fonde të BE-së, por edhe të qeverive që kanë qenë.

Sot nuk do të flasim për përmirësimin e kushteve. Sot do të flasim për ata që janë administratorë dhe ruajnë të dënuarit brenda në burgje. Sigurisht, dua ta falënderoj ministrin e Drejtësisë dhe stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për ndryshimet që sjellin me anë të këtij projektligji, të cilat kanë si qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator nëpërmjet plotësimit të disa mangësive që janë vërejtur, edhe pse ligji është miratuar jo më shumë se para 2-3 vjetësh! Sigurisht, ndryshimet e bëra para 2 vjetëve e përmirësuan dhe e reformuan gjendjen në sistemin e burgjeve. Një nga kolegët tanë këtu para disa minutave përmendi mënyrën se si trajtohen të dënuarit. Në vitin 2013, kur u emërova ministër i Drejtësisë gjeta rastin më të rëndë që një veteriner ishte emëruar në vend të mjekut. Sot kjo nuk ndodh. Sigurisht që kontributi

im ka qenë modest. Të tjerët, të cilët erdhën pas meje e përmirësuan dhe përmirësimet janë të dukshme; fenomene të kësaj natyre, që sapo i përmenda, nuk ndodhin më. Për të vijuar në këtë drejtim, ne duam të bëjmë disa përmirësime për ta motivuar stafin që gjendet sot në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar qytetarë,

Unë i dëgjova me vëmendje ministrin dhe kolegët deputetë që folën, por do të doja të ndalesha në disa momente në lidhje me një amendament që unë kam propozuar në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”. Gjatë debateve që bëmë në Komisionin e Ligjeve, një rekomandim që iu bë më pas Komisionit të Sigurisë, ishte që duhej të përmirësohej një nga nenet që ka të bëjë me gradat në Policinë e Burgjeve, pikërisht me gradën “Nëninspektor”.

Të nderuar kolegë deputetë, nga diskutimet dhe nga komentet e ndryshme që ne bëmë, pamë edhe gradat që janë përafërsisht në Policinë e Shtetit. Nëse një drejtuesi madhor në Policinë e Shtetit për të marrë gradën “Drejtues madhor” do t’i duhen gati 20 vjet, në Policinë e Burgjeve do t’i duhen rreth 25 vjet. Pra, ka një ngërç, i cili nuk shkon në lidhje me gradat. Ne e kemi parë me vëmendje dhe me dëshirën e madhe për të ndihmuar dhe për të kontribuar për përmirësimin e kushteve të punonjësve të burgjeve. Ajo që kam propozuar në atë amendament, është heqja e gradës “Nëninspektor”. Pra, duke hequr gradën “Nëninspektor”, ne i përafrojmë gradat në Policinë e Burgjeve me gradat që janë në Policinë e Shtetit (nga kjo përfitojnë jo pak, por një numër i madh punonjësish në burgje), duke filluar me gradën “Inspektor”. Kështu, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bëhet më fleksible për t’i kombinuar shërbimet e punonjësve të tyre në rrethimin e jashtëm apo të brendshëm, sepse duhet të kemi parasysh shërbimet 12 orë që bëhen brenda në burgje. E tha kolegu im, zoti Qefalia, se një pjesë e punonjësve gjatë shërbimit të tyre prej 20 vjetësh, i bie që 7 vjet të jetës së tyre i bëjnë bashkë me ata që janë të dënuar.

Pra, do të kërkoj nga ju vëmendjen e duhur, duke e lënë mënjanë politikën. Mendoni për një moment që këta administratorë, që janë sot, të cilët ruajnë këta të dënuar (duhet të keni parasysh që sot në sistemin e burgjeve janë mbi 1000 të dënuar për vrasje, nga këta mbi 200 janë me burgim të përjetshëm), duhet të jenë dinjitozë në pagë, në shpërblim, në disa të drejta që t’i kenë të barabarta me Policinë e Shtetit. Kjo nuk është ndonjë dhuratë që po ua bëjmë atyre.

Pra, deputetë të mazhorancës dhe të opozitës, mendohuni mirë kur të votoni! Kur të votoni, mendoni për një moment sigurinë në burgje dhe sigurinë e shtetit. Në qoftë se doni të bëni politikë, gjejeni diku tjetër. Kjo ka të bëjë me të gjithë. Po të bëjmë politikë, në vitin 2009, po ju them unë raste në Berat, kur Shqipëria po ndryshonte, nga 84 të dënuar në burgun e Beratit, 80 votonin për Partinë Demokratike. Po të doni ju marr rastin e vitit 2013, kur e panë që Shqipëria nuk po ndryshonte më, ndryshoi kjo balancë, por ju ishit përsëri në pushtet. Po të doni ju marr edhe raste të tanishme; po marr Beratit që e njoh, ku ndryshon ky rezultat nga programi, nga trendi i votave dhe nga shumë gjëra të tjera. E tha me të drejtë zoti Manja, kur humbisni, thoni se që jua vodhën dhe, kur fitoni pastaj, është merita juaj. Sot në këtë moment nuk është vendi për të bërë politikë. Sot i ftoj të gjithë kolegët deputetë të mendojnë për t’ua përmirësuar standardin këtyre punonjësve!

Nuk do të flas për risitë e projektligjit, por fola për risitë e amendamentit, pra çfarë kërkojmë ne të bëjmë përmes tij. A ka vende vakante? Sigurisht që ka vende vakante. Ligji në vitin 2020 nuk mund t’i parashikonte të gjitha. Sot në dinamikën e zbatimit të ligjit është propozuar me të drejtë, dhe me të drejtë Komisioni i Sigurisë Kombëtare e ka mbështetur dhe do ta mbështesë Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe do të mbështesim gjatë gjithë kohës çdo amendament që do të kërkohej të bëhet në funksion të përmirësimit. Thashë që, nëse kemi përmirësuar kushtet dhe trajtimin e të dënuarve, sigurisht, nuk mund t’i lëmë këta administratorë të burgjeve pa ua ngritur

dhe ua përmirësuar standardet. Sigurisht, mund të ketë korrupsion, e përmendi një nga kolegët që futin edhe drogë. Deri dje paga e tyre ishte shumë e vogël, fitimi ishte më i madh nëse fusnin një send të ndaluar dhe risku ishte i vogël. Me ndryshimet që kemi bërë në ligj, futja e sendeve të ndaluar në burgje i kushton punonjësit 3 deri në 4 vjet burg. Pra, risku është shumë i madh dhe fitimi është shumë i vogël. Të gjitha ndryshimet që bëjmë, kanë një logjikë për të forcuar sigurinë kombëtare dhe sigurinë në burgje.

Edhe një herë, të nderuar kolegë, do të doja që të gjithë deputetët, qofshin të mazhorancës apo opozitës, ta votojnë projektligjin, amendamentin, se nuk bëhet për ministrin e Drejtësisë, nuk bëhet për Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, por bëhet për të gjithë shqiptarët, për këta punonjës dhe për sigurinë kombëtare të vendit tonë. Në këto kohë të vështira në Ballkan është shumë e vështirë që të mendoni dhe të votoni ndryshe, por votoni për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Ju faleminderit, zoti Naço!

Këtu mbyllet diskutimi për këtë projektligj, duke ju kujtuar edhe një herë se legjislacioni që lidhet me Policinë e Burgjeve dhe me të drejtat dhe detyrimet e të paraburgosurve dhe të dënuarve, është një legjislacion i ri, i vetëm para 2 vjetëve.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Bëhet fjalë për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Ministrja e ka prezantuar përmbajtjen e këtij projektligji gjatë kohës kur foli për ligjin “Për taksat vendore”, sidoqoftë do të jetë edhe gjatë debatit. Kështu që çelim diskutimin.

Zonja Zake e ka fjalën.

(Ndërrhyrja pa mikrofon.)

Ndjesë!

Zonja Sorina Koti.

Nuk është në sallë. Konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.

Zonja Resulaj, dëshironi të mbani fjalën tuaj?

Jo. Faleminderit!

Zoti Leskaj.

Nuk është në sallë. Konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.

Zonja Koliqi, fjala për ju.

**Emilja Koliqi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Pas zbatimit të reformës territoriale në vitin 2015, bashkitë e krijuara trashëguan nga ish-njësitë vendore detyrime të prapambetura në shumën të konsiderueshme. Nuk mjaftoi vetëm bashkimi me ish-komunat, por në emër të reformës qeverisjes vendore iu transferuan shumë funksione, të cilat kishin kosto të lartë për qeverisjen qendrore, por ato nuk u shoqëruan me faturën financiare. Nga raporti i publikuar nga Ministria e Financave, në fund të vitit 2015 shumën e detyrimeve të prapambetura në total ishte 12,2 miliardë lekë. Sipas kategorive, pjesën më të madhe e zënë investimet me 54%, investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve 16%, shpenzime operative “mallra dhe shërbime” 15%, çështjet gjyqësore 9% dhe 6% të tjerat. Jo të gjitha detyrimet kanë pasur dokumentacion teknik - financiar të vlefshëm për likuidim dhe nga Ministria e Financave është kërkuar një auditim i brendshëm për këto probleme. Në komision u drejtova pyetje përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, por nuk mora përgjigje se sa nga këto detyrime janë hequr nga borxhi i detyrimeve të prapambetura, duke qenë se ato përbënin rreth 39% të borxhit të përgjithshëm.

Sipas publikimit të fundit në faqen e Ministrisë së Financave, të dhënat për detyrimet e prapambetura për vitin 2022 kanë arritur në 5,4 miliardë lekë. Megjithatë njësitë e qeverisjes vendore duket sikur i kanë ulur detyrimet e prapambetura, vihet re përsëri një përqindje e lartë që zënë investimet me 44% dhe vendimet gjyqësore me 10%. Ajo që të bën përshtypje është rritja e detyrimeve për sigurimet shoqërore, të cilat nga 31,1 milionë lekë në vitin 2020, arrijnë në 50,5 milionë lekë në vitin 2022. Kjo lidhet me rritjen e numrit të punonjësve dhe me mospasjen

e fondeve për shlyerjen e kontributeve, duke rrezikuar personat që dalin në pension.

Duket sikur janë ulur detyrimet e prapambetura, por, në fakt, vlera e tyre ka mbetur pothuaj njëloj. Nga 12,2 miliardë, duke zbritur 4,8 me dokumentacion të parregullt dhe 2 miliardë investime nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, të cilat ishin detyrime të qeverisë, vlera ka mbetur pothuajse e njëjtë. Pra, megjithëse janë shlyer disa detyrime të prapambetura, janë krijuar përsëri të reja. Po pse krijohen detyrime të reja të prapambetura? Çdo bashki, para se të fillojë prokurimin, firmos në degën e thesarit për disponueshmërinë e fondeve. Kontrolli i Lartë i Shtetit në raportet e paraqitura ka gjetur se këto detyrime krijohen nga prokurimet për punë dhe shërbime jashtë programit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor, se entet publike nuk i respektojnë udhëzimet për përdorimin e parave publike. Që nga viti 2022 tashmë kontrolli bëhet *online*. Është realizuar integrimi me sistemin e thesarit. Asnjë autoritet kontraktor i cili ndërvepron me sistemin e thesarit, nuk mund të vijojë me krijimin e procedurës së prokurimit pa u miratuar dhe pa u kontrolluar disponueshmëria e fondeve në sistem. Sipas ligjit “Për buxhetin”, kur nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme merr përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet ose në kundërshtim me këtë akt apo akte të tjera ligjore, është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit. Mosmarrja e masave, megjithëse në dijeni të problematikës edhe pas rekomandimeve të përsëritura të KLSH-së, e bën të qartë se këtu nuk është çështje e mospasjes së rregullave, por moszbatim i ligjit me pasoja në financat publike. Statusi financiar i bashkive në fund të vitit 2021, meqenëse ky është raporti i fundit i publikuar dhe raporti për vitin 2022 nuk është publikuar ende nga Ministria e Financave, rezulton se ishte: 44 bashki pa probleme financiare, 10 bashki me probleme financiare dhe 7 bashki në vështirësi financiare. Sipas ligjit të financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit bashkiak jo më pak se 3 raporte katërmujore të monitorimit të

zbatimit të buxhetit, të cilat i dërgojnë edhe në Ministrinë e Financave.

Qeverisja qendrore vazhdon të mbajë një nivel të lartë kontrolli të aktiviteteve dhe zhvillimeve në nivel vendor, përkundër reformave decentralizuese. Duke pasur në dispozicion këto raporte, Ministria e Financave duhej t’i kishte marrë masat në kohë në drejtim të këtyre njësive të qeverisjes vendore me vështirësi financiare. Por, ndërsa këto të fundit i detyron të raportojnë dhe të regjistrojnë në sistemin informatik të qeverisë detyrimet e prapambetura, nuk ndjek të njëjtin standard për detyrimet e qeverisjes qendrore. Çdo vit qeveria e fsheh borxhin real që ka. Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, detyrimet e PPP-ve me mbështetje buxhetore, vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë e të tjera nuk janë të regjistruara në sistemin informatik të qeverisë dhe as të deklaruara. Nëse shohim krijimin e detyrimeve të prapambetura, vëmendja duhet të fokusohet tek ajo se çfarë ka shkuar keq në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit. Në radhë të parë, detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes vendore lidhen me mungesën e financimit. Qeveria nuk mori përsipër nga viti 2015 e në vijim asnjë mbështetje për detyrimet e trashëguara të njësive të qeverisjes vendore, përkundrazi, qeverisja qendrore nuk ka zbatuar ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe nuk i ka kompensuar bashkitë për humbjet në buxhet nga ndryshimi i taksave. Shfuqizimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në vitin 2016, një politikë populiste në dëm të pushtetit vendor, u kushton 2 miliardë lekë në vit bashkive dhe në 7 vjet janë 14 miliardë lekë që qeveria qendrore ua ka borxh bashkive.

E njëjta gjë ndodh edhe me transferimin e taksave të ndara, 2% e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për vitet 2018-2019 nuk ua dhanë bashkive. Këto përbënin 1,65 miliardë lekë. Pra, 16 miliardë lekë, që qeveria qendrore ua ka borxh bashkive, do të mjaftonin për shlyerjen e



detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të tyre.

Neni 61 i ligjit “Për kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”, parashikon: “Kur autoritetet përgjegjëse të qeverisjes qendrore nuk i transferojnë në kohë të ardhurat nga taksat e ndara, dënohen nga ministri i Financave me gjobë në masën 100 000 deri në 200 000 lekë.”. Kush është dënuar për mostransferimin e fondeve ndaj njësive të qeverisjes vendore? Askush!

E njëjta gjë ndodhi edhe me fondin “transfer të kushtëzuar” 4% për mbrojtjen civile, i cili nuk u akordua as për fatkeqësinë natyrore Covid-19. Me buxhetin e akorduar nga qeveria, që është vetëm 1% e PBB-së (niveli më i ulët rajonal), 61 bashkitë nuk mund ta përmbushin një gamë kaq të madhe përgjegjësish, funksionesh dhe llojshmërie të shërbimeve administrative dhe publike. Transferta sektoriale nuk u përgjigjet nevojave dhe realitetit për një minimum standardi në cilësi dhe sasi shërbimi. Mosfinancimi i pengon bashkitë të rritin cilësinë e shërbimeve dhe t’i ushtrorjnë kompetencat në diskrecion të plotë, siç parashikohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Detyrimet e prapambetura të krijuara kanë lidhje edhe me vitet elektorale, me angazhime për punë publike jashtë kapaciteteve financiare, por nga viti 2019 asnjë nga bashkitë nuk e ngre zërin për mungesën e fondeve. Duke qenë të gjithë kryetarë të emëruar nga Kryeministri, asnjë nuk guxon, dhe qeveria e shfrytëzon këtë komoditet për të mos i financuar shërbimet bazë të qytetarëve. Kjo është një mungesë financimi në kurriz të shqiptarëve, të atyre që kanë mbetur, pasi rinia përditë po merr rrugët e emigracionit.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Të përgatitet zoti Dashamir Shehi.

**Bujar Leskaj** – Zonja Kryetare, që të jem i singertë që në krye të herës, ndryshimet e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” janë pozitive dhe, si të tilla, duhet të

votohen, edhe pse, për fat të keq, ndikimi pozitiv i tyre do të jetë shumë i paktë, gati nul, për një shkak më madhor: dështimi i plotë i kryerjes së reformës vendore, të cilën e morët përsipër në vitin 2014 dhe e latë në mes të rrugës. Lidhja e fortë ndërmjet financave të qëndrueshme të pushtetit vendor dhe cilësisë së shërbimeve bazë ndaj qytetarëve, është një tregues i rëndësishëm për standardin e jetesës së qytetarëve dhe shëndetin e këtyre bashkive. Financat vendore sot janë në një udhëkryq të trezëshëm me mundësinë e tyre për të kryer investime publike, me detyrime të prapambetura në shumë bashki, të cilat janë rritur kërcënueshëm. Reforma territoriale ka ngecur së bashku me atë të financave vendore. Kjo e fundit paraqet, në këndvështrimin tim, problematikat e mëposhtme, të cilat po i grupoj në 10 të tilla:

1. Në 10 vjet drejtim të shumicës së bashkive të vendit, ku në 4 vjetët e fundit keni udhëhequr 60 nga 61 bashkitë e vendit, ju i keni shkatërruar financat vendore. Keni zhytur një të katërtën e bashkive në borxhe pa mundësi kthimi. Ato ndodhen shumë pranë gjendjes së falimentit.

2. Sot të 61 bashkitë janë në gjendje të sigurojnë mesatarisht vetëm 37% të fondeve që u duhen për të qeverisur. Varësia e tyre ndaj fondeve të pushtetit qendror me 63% të shumës që u duhen, është e madhe dhe në shumë bashki është përcaktuese. Sot mbi 70% e të ardhurave vendore shkojnë për të mbajtur në punë punonjësit e bashkive dhe për shpenzimet operative. Pavarësinë në letër të pushtetit vendor, ju e keni shndërruar në një varësi të plotë *de facto* ndaj fondeve të pushtetit qendror.

3. Sot tre të katërtat e bashkive në qeverisjen tuaj kanë varësi absolute nga fondet e pushtetit qendror, duke mos përfutur asgjë nga shanset e autonomisë vendore. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka dubluar plotësisht funksionet e investimeve kapitale për bashkitë, duke ofruar projekte dhe duke dhënë tenderë për interesat e oligarkëve të sektit në qeverisje.

4. 15 nga të 61 bashkitë e vendit janë të zhytura në borxhe të pakthyeshme ose shumë

pranë falimentit. Thënë ndryshe, 25% e pushtetit vendor sot nuk ka para për të shlyer detyrimet e prapambetura, të cilat përbëjnë 60% – 80 % të buxhetit të tyre vjetor. Në tërësi, janë 22 bashki, ose më shumë se një e treta e bashkive të vendit me probleme mëdha të menaxhimit financiar.

5. Në fund të vitit 2022, totali i detyrimeve të pakthyera që kanë akumuluar bashkitë ndaj të tretëve arriti në vlerën 7,9 miliardë lekë ose mbi 72 milionë euro. Ende nuk dihet niveli i detyrimeve të reja të akumuluar në periudhën janar – maj 2023, pesëmujori i investimeve të ethshme elektorale, pa siguruar as 20% të fondit bazë për kryerjen e tyre.

6. Krahas dublimit të padrejtë dhe abuziv të investimeve kapitale nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, shumë nga bashkitë janë në vështirësi serioze ekonomike, si dhe në pamundësi për të kryer investime themelore për qytetarët e tyre. Niveli dhe cilësia e shërbimeve që qytetarët marrin nga bashkitë është në rënie të ndjeshme, ndërkohë që bashkitë rritin çdo vit stafet e tyre për të akomoduar patronazhistët dhe aktivistët e sektorit në qeverisje. Vetëm gjatë vitit 2022, numri i përgjithshëm i punonjësve të 60 bashkive të drejtuara nga socialistët u rrit me 9,3%, në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që rritja ekonomike mesatare e tyre nuk ishte më shumë se 2%. Ju i keni fryrë stafet e bashkive që qeverisni, edhe pse në 10 vjetët e fundit popullsia e vendit është tkurrur me 20%, pasi më shumë se 600 mijë veta janë larguar në emigracion, ndërkohë që shtesa natyrore e popullsisë ka qenë afër zeros.

7. Ju u tallët me bashkitë dhe administrimin financiar të tyre, kur në fillim të vitit 2021 folët për caktimin e një administratori për bashkitë në vështirësi financiare. Deri tani asgjë nuk keni bërë në këtë drejtim. Ishte thjesht presion i momentit?

8. Ju u tallët për herë të dytë me bashkitë dhe problemet e tyre të mëdha financiare kur në aktin normativ të 3 dhjetorit 2021 dhatë vetëm 500 milionë lekë për shlyerjen e borxheve të bashkive ose sa 7% e totalit të detyrimeve të papaguara të pushtetit vendor.

9. Për mendimin tim, ju nuk keni nevojë për bashki të shëndetshme financiarisht që t'u shërbejnë qytetarëve të komuniteteve të tyre, pasi për çdo investim kapital në nivel vendor përdorni Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Bashkitë ju duhen vetëm për të punësuar patronazhistët dhe aktivistët tuaj, sa herë zhvillohen zgjedhje. Jo rastësisht në garën e fundit zgjedhore të 14 majit 2023, e gjithë fushata juaj u përqendrua në një njeri të vetëm, ndërsa keni hequr vëmendjen, keni sfumuar, keni denigruar dhe gati zeruar personalitetet e 61 kandidatëve tuaj për kryetarë bashkish, pjesa më e madhe e të cilëve janë zgjedhur tashmë kryetarë bashkie dhe i marrin detyrat nga “lideri global”.

10. Për mendimin tim, juve nuk ju intereson shlyerja e borxheve të akumuluar nga bashkitë dhe përmirësimi i gjendjes së tyre financiare, por thjesht zhurma për këtë problem, pasi përmirësimi i gjendjes së tyre financiare dhe shlyerja e borxheve kërkon reformë të vërtetë në financat vendore dhe shkëputjen e bashkive nga tutela financiare e pushtetit qendror. Juve ju duhen bashkitë “dele” të bindura, ju duhen bashkitë, pushtet qendror dhe vendor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në shkelje të plotë të Kartës së Autonomisë Lokale.

Ju krijuat bashki të stërmëdha, të vështira për t'u administruar, praktikisht një mision i pamundur për t'i mirëmenaxhuar financiarisht ato. Nën qeverisjen tuaj reforma territoriale dhe administrative, së bashku me atë të financave vendore, janë në agoni të plotë.

Besoj se edhe këtu kurseva 4 minuta të tjera.

**Lindita Nikolla** – Zoti Dashamir Shehi?

Nuk është.

Atëherë, zonja Albana Vokshi.

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të gjithëve na kujtohet kur përshëndetj me tamtame reforma e famshme territoriale në vitin 2015. Ku jemi sot? Pikërisht kjo reformë i ka lënë qytetarët pa shërbime, ka zbrazur fshatra të tëra dhe ka shpopulluar një pjesë të mirë të Shqipërisë, ka falimentuar apo po falimenton shumë bashki.

Ne si opozitë e kemi ngritur sa e sa herë faktin që kjo reformë ishte e gabuar dhe ja ku po i shohim pasojat. Ka falimentuar Kavaja, ku borxhi është mbi 85% e totalit të shërbimeve vjetore. Në bazë të kërcënimit të Kryeministrit se nuk do të ketë mbështetje për bashki, të cilat janë fituar nga kandidatët e opozitës, i bie që qytetarët e Kavajës mund të mos marrim më asnjë shërbim.

Ka falimentuar Vora mbi 80%; ka falimentuar edhe Pusteci. Janë 7 bashki në limit të falimentimit. Si pasojë e borxheve të larta, 22 prej bashkive ndodhen në vështirësi financiare: Peqini, Lezha, Klosi, Selenica, Mirdita, Kamza, Cërriku, Librazhdi, Roskoveci, Libohova, Bulqiza, Tropoja, Pogradeci, Tepelena, Finiqi, Dibra, Rrogozhina, Kukësi, Poliçani, Konispoli, Ura Vajgurore. Të gjithë ekspertët thonë se kjo vjen prej keqmenaxhimit financiar. Prej disa kohësh flitet për këto bashki që janë drejt falimentimit, madje doli edhe një vendim që atyre bashkive, të cilat janë drejt falimentimit apo kanë falimentuar, do t'u çohet edhe një administrator nga pushteti qendror, në mënyrë që t'i menaxhonte ashtu siç duhej financat vendore. Ky operacion i vendosjes së administratorëve nga qendra duhej të ishte kryer deri në korrik të vitit 2022, por çfarë ndodhi? Pas korrikut të vitit 2022 dhe afrimit gjithnjë e më tepër të zgjedhjeve vendore Edi Rama vuri re: "Prit, se këto bashki nuk paskan më nevojë, gjendja nuk qenka aq e rëndë!", pavarësisht se disa prej tyre kanë falimentuar. Minimalisht kryetarët aktualë në këto bashki, të cilat kanë falimentuar apo janë drejt falimentimit, Kryeministri nuk do të duhej t'i kishte rikandiduar, pasi kanë keqmenaxhuar, kanë abuzuar me financat vendore. Kanë dështuar në punën e tyre. Po çfarë ndodhi? Të gjitha ata u rikandiduan, madje jo vetëm u rikandiduan, por pjesa më e madhe e tyre, si të babëzitur, iu vërsulën përsëri financave që i kishin apo i morën borxh dhe hapën kantiere, asfalt elektoral kudo, në të gjitha bashkitë; punësime elektorale, shërbime elektorale; kudo shpërdorim dhe abuzim i pushtetit vendor. Shumë prej kompanive që kryenin punimet, asfaltin elektoral, nuk kishin

projekt, ishin pa tabelë informative, pa u konsultuar jo e jo, madje edhe të pamiratuara fare në planin buxhetor të bashkive. U kërkohet kompanive, një pjesë e mirë afër atyre që kandidonin apo pushtetit qendror, që t'i kryenin ato vetë punimet. Një pjesë prej tyre në disa raste, si në rastin e Kuçovës apo të Beratit, ju e keni ndjekur që kanë qenë vetë banorët që i kanë ndalur këto punime, sepse dukeshin që ishin krejt abuzive dhe thjesht për vota.

Për të zgjidhur problemet e pushtetit vendor duhet vetëm vullnet politik, por ky vullnet nuk ekziston, ndaj edhe bashkitë nuk janë kontrolluar dhe nuk janë monitoruar as nga Ministria e Financave, as nga Ministria e Brendshme. Madje, nuk është identifikuar asnjë përgjegjës; nuk është marrë asnjë masë në lidhje me këtë faliment. Nëse u referohemi bashkive, atyre që kanë rritur borxhet, cila është në vendin e parë? Bashkia e Tiranës, me rritjen e borxhit 761 milionë lekë, më tej vjen Kavaja me 727 milionë dhe Vora me 702 milionë. Secila prej tyre ka 10% të borxhit të përgjithshëm. Më tej vijnë Pogradeci, Lezha dhe Roskoveci, të cilat kanë nga 5% të borxhit. Pra, pse e zë vendin e parë Bashkia e Tiranës? Sepse kryetari i Bashkisë zë vendin e parë si abuzues dhe korruptues.

E rriti çmimin e ujit më shumë se 40%, por në çezma nuk ka ujë, madje për ditë të tëra edhe në qendër të Tiranës. Atëherë, ku shkuan këto para që po i paguajmë çdo muaj? Vuri taksën antikushtetuese të infrastrukturës arsimore; antikushtetuese, sepse arsimit parauniversitar është falas në Republikën e Shqipërisë. Mbi 10 mijë fëmijë e nisën vitin shkollor 2022-2023 në turnin e dytë apo në të tretin, madje prindërit kanë lënë edhe punën e tyre, sepse duhet të çojnë fëmijët në turnin e dytë apo të tretë, për më tepër që një pjesë e shkollave janë krejt pa standarde. Ku kanë shkuar këto taksa që ne i paguajmë çdo muaj?

Ai menaxhoi edhe paratë e rindërtimit të shkollave, të cilat ia dha Edi Rama. Një pjesë ia dha Fondit, pra për ato që ishin jashtë Tiranës; për ato të Tiranës ia dha Erion Veliajt, por shkollat

ende nuk janë ndërtuar. Nuk mjaftoi kjo, por për 17 shkolla bëri edhe një PPP, pra të paguheshin çmimet për shkollat, por të paguheshin edhe interesat për kompanitë. Ja, pra, pse e ka rritur borxhin Bashkia e Tiranës! Paratë e rindërtimit, paratë e arsimit nuk janë parë asnjëherë nga Erion Veliaj dhe Edi Rama si një mënyrë për rritjen e cilësisë së arsimit, por vetëm si një thellë e majme.

Në faqen e UNDP-së mund të gjeni fare mirë të dhëna për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave nga programi i BE-së. Një shkollë me standardin më të lartë dhe më e madhja kushton 680 mijë euro. A e dini se sa kushtojnë shkollat e Erion Veliajt? Ka edhe 6 milionë euro, madje që janë shkolla të rindërtuara, si shkolla “Sami Frashëri”, e cila është rindërtuar dhe, pasi është rindërtuar, është hapur, kanë bërë mësim fëmijët, e kanë shembur; shkolla “Emin Duraku” u rindërtua, bënë mësim fëmijët 3 vjet dhe vetëm pak muaj më parë vendosi ta shembte të tërën dhe tani po e rindërton. Pra, 680 mijë euro kushton një shkollë me standardet e BE-së, 6 milionë me standardet e Erion Veliajt! Me standardin e Erion Veliajt: shkolla “Qazim Turdiu” kushton 3,6 milionë euro; shkolla “Hasan Vogli” 2,7 milionë euro; shkolla në Zall-Herr 2,2 milionë euro; shkolla në Vaqar 2 milionë euro; shkolla në Qesarakë 2 milionë euro. Çfarë u bën Erion Veliaj më shumë shkollave sesa mund t’u bëjë BE-ja? Jo vetëm kjo, por, kur e pyesim se përse nuk janë hapur shkollat që premtoi para 2 vjetëve se do të hapeshin, ua vë fajin donatorëve, pikërisht BE-së dhe PNUD-it.

E keni parë Tiranën se si u bë kantier! 32 milionë euro ka tenderuar Erion Veliaj në 104 tenderë për 2 muaj: asfaltim, rehabilitim, rikualifikim. Është krim elektorale. Nuk i ka pasur të parashikuara në planin buxhetor, është në kundërshtim me nenin 3 të VKM-së nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nuk i ka parashikuar, megjithatë i ka tenderuar. Mund të përmend edhe rastin e rrugës “Xhon Belushi”, të cilën e kemi denoncuar së bashku me Belind Këlliçin. I kishte bërë punimet; e kishte hedhur asfaltin elektorale pa standarde, pa respektuar asnjë

projekt të miratuar nga këshilli bashkiak. Po çfarë bëri? E tenderoi përsëri. U kap në flagrancë, por SPAK-u nuk e shikon; nuk e shikon se si shpërdorohen taksat e qytetarëve të Tiranës. SPAK-u nuk sheh se si po shpërdorohen taksat e bashkive të tjera. Nëse do të kishte drejtësi funksionale në Shqipëri, Erion Veliaj dhe shumë kandidatë të tjerë që janë sot, për fat të keq, kandidatë, nuk do të kishin vendin e kandidatit për bashki, por do të kishin vendin e kandidatit për qeli.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Mbarojmë diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Në rendin e ditës janë 4 projektvendime: projektvendimi “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”” (në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës); projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 67/2021 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”” (në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 21, pika 1 dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim); projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar” dhe projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”. Këto projektvendime janë pa diskutime.

Këtu mbyllet debati.

Ministre, kush e ka kërkuar fjalën?

Atëherë, 5 minuta pushim. Ju lutem, sekretaria, njoftoni deputetët që janë në godinën e

seancave plenare, se do të bëhemi gati për votimin.

(*Pas pushimit.*)

Vijojmë me seancën.

Kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi për prezencën.

Janë 84 deputetë prezentë.

Vazhdojmë me votimin e akteve: projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim elektronik.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër dhe 5 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Vijojmë me projektrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2022. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim elektronik.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, 7 kundër dhe asnjë abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri gjatë vitit 2022. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim elektronik.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, asnjë kundër dhe 2 abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2022. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim elektronik.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 pro, 7 kundër dhe asnjë abstenim.

Projektrezoluta miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë.

Hapet votimi në parim me elektronikë!

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 13 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me karton, sipas variantit të komisionit.

Para se të fillojmë votimin nen për nen, në bazë të nenit 76 të Rregullores do të votojmë amendamentet e propozuara nga deputetët Eduard Shalsi, Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Antoneta Dhima, Vullnet Sinaj dhe Pranvera Resulaj.

Në bazë të nenit 75, pika 3, të Rregullores, autori i amendamentit ka të drejtë ta paraqesë atë për jo më shumë se shtatë minuta.

Zoti Shalsi, fjala për ju!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Nuk do të shpjegoj çdo amendim të çdo neni, por do të bëj një përshkrim *on block* dhe konciz. Nëpërmjet amendamenteve të bëra nga disa deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, kemi propozuar rishikimin tërësor të ndryshimeve të paraqitura nga qeveria, që konsistonin në shfuqizimin e taksave kombëtare të importimit dhe prodhimit për produktet hurrë qumështi dhe krem qumështi. Nëpërmjet këtyre amendamenteve kemi propozuar që të mos hiqen taksat për hurrën dhe kremin e qumështit, por të saktësohen më tej përjashtimet e përcaktuara në pikën 8 të nenit 9, duke propozuar që të përjashtohen nga taksat – këtë e theksoj fort – vetëm subjektet prodhuese e përpunuese, jo tregtarët, duke marrë në konsideratë shqetësimin e fermerëve, të një grupi fermerësh, i cili na ndihmoi të përmirësonim draftin e paraqitur nga qeveria.

Sigurisht, në bashkëpunim me ministren e Financave dhe me ministren e Bujqësisë, për të evituar abuzimet që mund të ndodhnin me zhdoganimin e këtyre produkteve, jemi dakordësuar që amendamentit të propozuar për secilin produkt t'i specifikojmë edhe kodet përkatëse të nomenklaturës së kombinuar të mallrave.

Faleminderit të gjithë kolegëve deputetë për pjesëmarrjen në debat, falë së cilës u bënë edhe këto ndryshime, që e përmirësuan draftin e sjellë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Shalsi!

Hedhim në votim amendamentet.

Amendamenti për titullin dhe pjesën hyrëse.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 71 vota pro, 12 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Para se të fillojmë me nenin 1, hedhim në votim elektronik amendamentin e paraqitur.

Hidhet në votim amendamenti për heqjen e nenit 1.

Me elektronikë.

Ju lutem, votoni!

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 9 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Para se të fillojmë me nenin 2, hedhim në votim me elektronikë amendamentin e paraqitur.

Hidhet në votim me elektronikë amendamenti për heqjen e nenit 2.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 9 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Para se të fillojmë me nenin 3, hedhim në votim me elektronikë amendamentin e paraqitur.

Hidhet në votim amendamenti për heqjen e nenit 3.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 11 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Para se të fillojmë me nenin 4, hedhim në votim me elektronikë amendamentin e paraqitur.

Hidhet në votim amendamenti për nenin 4, me saktësimet e bëra nga zoti Shalsi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 10 kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin me karton të nenit 5, që, pas miratimit të amendamentit dhe rinumërimit, bëhet neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 72 vota pro, 13 kundër dhe asnjë abstenim.

Projektligji miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe 5 abstenime.

Miratohet në tërësi.

Kalojmë në votimin nen për nen, me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të fillojmë votimin e nenit 4, në bazë të nenit 76 të Rregullores do të votojmë amendamentet e propozuara nga deputeti Nasip Naço.

Në bazë të nenit 75, pika 3, të Rregullores, autori ka të drejtë t'i paraqesë ndryshimet për jo më shumë se shtatë minuta.

Zoti Naço, fjala për ju.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fjalën time unë u mora me amendamentin. Shkurtimisht do të them se në sistemin e gradave në Policinë e Burgjeve, niveli bazë është me tri grada. Ne kërkojmë që të hiqet një gradë e inspektorit, sepse, nëse e krahasojmë me gradat në Policinë e Shtetit, që të marrësh gradën më të lartë do të duhen 25 vjet në Policinë e Burgjeve, ndërsa te Policia e Shtetit 20 vjet. Heqja e gradës “Nëninspektor” do t’i shërbejë më shumë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për të qenë më fleksibël në ndarjen e tyre brenda regjimit të brendshëm e të jashtëm. Sigurisht, përparimi i tyre në gradë ka një kosto financiare, e cila përballohet nga buxheti i vetë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

I ftoj të gjithë kolegët që ta votojnë këtë amendament, sepse do t’i shërbejë më mirë iniciativës së marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Hedhim në votim amendamentet.

Hapet votimi me elektronikë.

Pas nenit 3 të projektligjit shtohen nenet 4 dhe 5, me përmbajtjet përkatëse.

Hedhim në votim propozimin për nenin 4.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, 1 kundër dhe 6 abstenime.

Miratohet.

Hedhim në votim propozimin për nenin 5.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe 5 abstenime.

Miratohet.

Para se të votojmë nenin 4, që pas miratimit të amendamentit dhe rinumërimit bëhet neni 6, hedhim në votim elektronik amendamentin për një ndryshim në përmbajtje.

E hedhim në votim.

Mbyllet votimi.

Janë 74 pro, 1 kundër dhe 4 abstenime.

Miratohet.

Vazhdojmë votimin me karton të nenit 5, që pas miratimit të amendamentit dhe rinumërimit

bëhet neni 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6, i cili pas miratimit të amendamentit dhe rinumërimit bëhet neni 8. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të votojmë nenin 7, sipas variantit të propozuesit, hedhim në votim amendamentin për një nen të ri, që pas rinumërimit bëhet neni 9.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe 6 abstenime.

Miratohet.

Vazhdojmë votimin me karton të nenit 7, që pas miratimit të amendamentit dhe rinumërimit bëhet neni 10. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 10.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe 5 abstenime.

Miratohet projektligji.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, asnjë kundër dhe 7 abstenime.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen, me karton, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.  
Mbyllet votimi.  
Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe 7 abstenime.

Projektligji miratohet.

Projektvendimi “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 72 pro, 8 kundër dhe asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Projektvendimi për një ndryshim në vendimin nr.67/2021 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”.

Deputetja Lindita Buxheli caktohet sekretare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 74 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Projektvendimi për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit” i ndryshuar.

Deputeti Ilir Metaj caktohet anëtar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 73 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Projektvendimi për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e kryesisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar.

Deputetja Monika Kryemadhi caktohet anëtare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 75 vota pro, asnjë kundër dhe 1 abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Këtu mbyllet edhe procesi i votimit.

Nga diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës është tërhequr deputeti i cili ishte regjistruar.

Këtu mbyllet seanca.

Seanca e radhës do t’ju njoftohet.

Faleminderit!

*(Seanca u mbyll në orën 19:30)*

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**